SHOQATA KOMBËTARE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË

SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS



Funksionet

23, 24, 25, 27, 28

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS

SHOQATA KOMBËTARE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË

Ky botim është produkt i Forumit të Performancës
ngritur nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë.

Mbështetur nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS

HYRJE

Ky katalog përfaqëson kulmimin e një procesi shumëvjeçar të zhvillimit dhe konsolidimit të Sistemit të Matjes së Performancës së Bashkive në Shqipëri. Ai është rezultat i asistencës teknike të ofruar për njësitë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të projektit **"Bashki të Forta"**, të implementuar nga **Helvetas** me mbështetjen financiare të **Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)**.

Gjatë një periudhe prej më shumë se një dekade, puna e përbashkët ndërmjet bashkive, institucioneve qendrore dhe ekspertëve teknikë ka mundësuar ndërtimin gradual të një sistemi unik për matjen e performancës së qeverisjes vendore. Ky proces ka kaluar nga zhvillimi i treguesve të parë të performancës, tek standardizimi i burimeve të të dhënave, konsolidimi i metodologjive të matjes, ndërtimi i raportimit kombëtar të performancës dhe, së fundi, krijimi i një arkitekture të integruar të treguesve dhe të dhënave për monitorimin e funksioneve të bashkive.

Ky katalog është konceptuar si një **dokument spirancë** për këtë proces. Ai ruan dhe sistematizon njohuritë metodologjike të krijuara ndër vite, siguron vazhdimësinë institucionale të sistemit dhe krijon një bazë të përbashkët reference për zhvillimet e ardhshme. Në këtë mënyrë, ai synon të garantojë që përvoja, metodologjitë dhe standardet e ndërtuara gjatë këtij procesi të mbeten të disponueshme dhe të përdorshme pavarësisht ndryshimeve institucionale apo evolucionit të sistemit në të ardhmen.

Katalogu nuk përfaqëson vetëm një inventar treguesish. Ai dokumenton mënyrën se si maten shërbimet vendore, cilat janë burimet e të dhënave, si llogariten treguesit dhe si duhet të interpretohen rezultatet e tyre. Për çdo tregues të konsoliduar metodologjikisht paraqiten pasaportat e treguesve dhe të dhënave, duke standardizuar përkufizimet, formulat, metodat e mbledhjes dhe verifikimit, institucionet përgjegjëse dhe kufizimet metodologjike. Për treguesit që janë përdorur në raportimet kombëtare ose vendore, por që ende nuk janë shtjelluar plotësisht metodologjikisht, katalogu ruan dokumentimin ekzistues si bazë për zhvillime të mëtejshme.

Në këtë mënyrë, katalogu shërben njëkohësisht si dokument reference metodologjike, instrument për standardizimin e raportimit, bazë për zhvillimin e sistemeve të informacionit dhe pikënisje për zgjerimin e ardhshëm të Sistemit të Matjes së Performancës.

Çfarë përmban ky katalog

Ky katalog përmbledh treguesit dhe të dhënat e zhvilluara gjatë procesit të ndërtimit të Sistemit të Matjes së Performancës së Bashkive, duke mbuluar funksionet e përcaktuara në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore". Ai përfshin si treguesit e përdorur në Raportin Kombëtar të Performancës së Bashkive, ashtu edhe tregues të zhvilluar për analiza sektoriale dhe raporte të performancës në nivel vendor.

Nga të gjithë treguesit e zhvilluar ndër vite:

- 41 funksione të bashkive janë pasuruar me tregues performance; si dhe 5 fusha horizontale sikurse cilesuar ne tabelat X dhe Y

- 168 tregues janë konsoliduar metodologjikisht dhe shoqërohen me pasaportë të plotë të treguesit dhe të dhënave;

- pjesa tjetër e treguesve është dokumentuar në nivel konceptual ose është përdorur në raportimet kombëtare dhe vendore, pa u shoqëruar ende me dokumentacion të plotë metodologjik.

Në këtë mënyrë, katalogu krijon një bazë të standardizuar për prodhimin, raportimin dhe interpretimin e të dhënave të performancës së bashkive, duke mbështetur krahasueshmërinë e rezultateve ndërmjet bashkive dhe ndërmjet viteve.

Statistika kryesore të katalogut

Tregues gjithsej	**313**
Të dhëna unike	**384**
Tregues të shtjelluar metodologjikisht (me pasaportë)	**168**

Kodi	Emërtimi sipas Ligjit nr. 139/2015	Nr. treguesish
Neni 23 – Funksionet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike		
23.1	Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm	5
23.2	Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura	5
23.3	Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara	1
23.4	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore	12
23.5	Ndriçimi i mjediseve publike	5
23.6	Transporti publik vendor	5
23.7	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit	5

23.8	Shërbimi i dekorit publik	0
23.9	Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike	5
23.10	Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake	6
23.11	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar	11
23.12	Administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe	27
23.13	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe administrimi i shërbimeve të shëndetit publik	3
23.14	Planifikimi, administrimi, zhvillimi dhe kontrolli i territorit	8
Neni 24 – Funksionet në fushën e shërbimeve sociale		
24.1	Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale	9
24.2	Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehim social	5
24.3	Ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore	9
24.4	Krijimi i fondit social për financimin e shërbimeve	2
Neni 25 – Funksionet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese		
25.1	Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore	2
25.2	Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar e lokal	6
25.3	Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave dhe ambienteve të leximit	1
25.4	Organizimi i aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese	11
Neni 26 – Funksionet në fushën e mbrojtjes së mjedisit		
26.1	Mbrojtja e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit	6
26.2	Mbrojtja nga ndotja akustike	3
26.3	Aktivitete edukuese dhe promovuese për mbrojtjen e mjedisit	4

Neni 27 – Funksionet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit		
27.1	Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	8
27.2	Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore dhe resurseve të tjera	1
27.3	Sistemi vendor i informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural	1
27.4	Skemat vendore të granteve për bujqësinë dhe zhvillimin rural	1
27.5	Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor publik	15
27.6	Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit	1
Neni 28 – Funksionet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor		
28.1	Hartimi i planeve strategjike të zhvillimit dhe programeve për zhvillimin ekonomik vendor	10
28.2	Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe rrjetit të tregtisë	25
28.3	Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël	7
28.4	Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor	13
28.5	Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj.	14
28.6	Dhënia e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm	6
Neni 29 – Funksionet në fushën e sigurisë publike		
29.1	Mbrojtja civile	5
29.2	Garantimi i shërbimit të zjarrfikësve	9
29.3	Garantimi i mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimi dhe ndërmjetësimi i konflikteve	2
29.4	Parandalimi i kundërvajtjeve administrative, inspektimi dhe monitorimi i zbatimit të akteve vendore	5

Neni 30 – Funksionet dhe kompetencat e deleguara **Administrimi i funksioneve të deleguara**	5

Fusha horizontale	Nr. treguesish
Financat	13
Transparenca	5
Integrimi në Bashkimin Evropian	5
Barazia Gjinore	3
Burimet Njerëzore	3

Si të lexohet ky katalog

Ky katalog është organizuar sipas strukturës funksionale të **Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"**. Treguesit janë grupuar sipas neneve dhe funksioneve të bashkive, duke ndjekur renditjen e përcaktuar në ligj. Për secilin nen paraqitet fillimisht një përmbledhje e funksioneve që ai mbulon dhe identifikohen funksionet për të cilat janë zhvilluar tregues performance në kuadër të Sistemit të Matjes së Performancës.

Brenda secilit funksion janë shtjelluar treguesit përkatës dhe të dhënat mbi të cilat mbështetet llogaritja e tyre. Kjo strukturë i mundëson përdoruesit të kuptojë jo vetëm rezultatin që matet, por edhe burimin e informacionit dhe metodologjinë e përdorur për prodhimin e tij.

Pasaporta e treguesit

Për çdo tregues të shtjelluar metodologjikisht paraqitet një pasaportë standarde, e cila përmban elementët kryesorë të nevojshëm për llogaritjen, interpretimin dhe përdorimin e tij.

Pasaporta e treguesit përfshin:

- **Kodin dhe emërtimin**, për identifikimin unik të treguesit I cili ndjek linjen e kodeve te funksioneve
- **Shërbimin/Funksionin**, që tregon funksionin e bashkisë ku aplikohet treguesi;

- **Përfshirjen në SMP Kombëtare**, për të identifikuar treguesit që përdoren në raportimin kombëtar të performancës;

- **Qëllimin**, që shpjegon çfarë synon të masë treguesi;

- **Përshkrimin**, që sqaron objektin e matjes;

- **Rëndësinë**, që argumenton vlerën analitike dhe përdorimin e tij në monitorimin e performancës;

- **Formulën e llogaritjes**, që standardizon mënyrën e përftimit të treguesit dhe e lidh ate me kodet e te dhenave

- **Njësinë matëse**, **interpretimin** dhe **frekuencën e raportimit**, për të siguruar përdorim të njëtrajtshëm të rezultateve;

- **Institucionin raportues** dhe **institucionin përgjegjës**, që përcaktojnë përgjegjësitë institucionale;

- **Disagregimin**, i cili mundëson analiza më të detajuara sipas territorit, gjinisë ose karakteristikave të tjera, kur këto të dhëna janë të disponueshme;

- **Metodën e verifikimit**, që garanton besueshmërinë e informacionit;

- **Kufizimet**, të cilat ndihmojnë në interpretimin korrekt të rezultateve dhe evidentojnë aspektet që treguesi nuk arrin të masë.

Pasaporta e të dhënës

Çdo tregues mbështetet në një ose më shumë të dhëna bazë. Për këtë arsye, katalogu përfshin edhe pasaportat e të dhënave, të cilat standardizojnë mënyrën e prodhimit dhe administrimit të informacionit.

Pasaporta e të dhënës përmban:

- **Kodin dhe emërtimin** e të dhënës;

- **Përshkrimin**, që përcakton saktësisht informacionin që duhet të raportohet;

- **Qëllimin e mbledhjes së të dhënës**, që shpjegon arsyen pse kjo e dhënë është e nevojshme;
- **Njësinë matëse**;
- **Metodën e mbledhjes**, e cila standardizon mënyrën e evidentimit të informacionit;
- **Frekuencën e raportimit**;
- **Institucionin raportues** dhe **institucionin përgjegjës**;
- **Disagregimin**, kur informacioni mund të raportohet në nivele më të detajuara;
- **Metodën e verifikimit**, që identifikon Burimin e të dhënës regjistrin ose sistemin administrativ nga ku merret informacioni dhe cilësinë dhe besueshmërinë e të dhënës;
- **Kufizimet**, të cilat ndihmojnë përdoruesin të kuptojë kufijtë metodologjikë të informacionit.

Shënimet metodologjike

Për disa tregues dhe të dhëna janë përgatitur gjithashtu **shënime metodologjike**, të cilat japin udhëzime shtesë për përkufizimin e koncepteve, kriteret e përfshirjes ose përjashtimit, metodat e matjes dhe procedurat e verifikimit. Këto shënime synojnë të rrisin njëtrajtshmërinë e raportimit ndërmjet bashkive dhe të mbështesin krahasueshmërinë e rezultateve ndërmjet territoreve dhe ndërmjet viteve.

Funksioni 23

Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike

Neni 23 i Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" përcakton funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Këto funksione përfshijnë përgjegjësitë e bashkive për planifikimin, organizimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve publike vendore që lidhen me infrastrukturën, mjedisin, arsimin, shëndetësinë dhe zhvillimin territorial, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së komunitetit.

Në kuadër të Sistemit të Matjes së Performancës (SMP), për këtë nen janë zhvilluar tregues performance për funksionet që lidhen me:

- ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore;
- ndriçimin e mjediseve publike;
- transportin publik vendor;
- administrimin e varrezave publike dhe shërbimin publik të varrimit;
- shërbimin e dekorit publik;
- administrimin e parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike;
- menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake;
- ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit parauniversitar;
- administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Për secilin prej këtyre funksioneve, katalogu paraqet treguesit e performancës, metodologjinë e llogaritjes, burimet e të dhënave dhe pasaportat përkatëse të treguesve, duke synuar standardizimin e monitorimit dhe vlerësimit të performancës së bashkive në ofrimin e shërbimeve publike.

Kodi	Funksioni	Tregues në katalog
23.1	Furnizimi me ujë të pijshëm	—
23.2	Ujërat e ndotura	—
23.3	Ujërat e shiut dhe kullimi	—
23.4	Rrugët vendore	✓
23.5	Ndriçimi publik	✓

23.6	Transporti publik vendor	✓
23.7	Varrezat publike	✓
23.8	Dekori publik	—
23.9	Parqet dhe hapësirat e gjelbra	✓
23.10	Menaxhimi i mbetjeve	✓
23.11	Ndërtesat arsimore	✓
23.12	Arsimi parashkollor	✓
23.13	Shërbimi parësor shëndetësor	—
23.14	Planifikimi dhe zhvillimi i territorit	—

23.4 NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE VENDORE DHE SINJALIZIMIT RRUGOR, TË TROTUAREVE DHE SHESHEVE PUBLIKE VENDORE

Ky funksion përfshin përgjegjësinë e bashkisë për planifikimin, ndërtimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e rrugëve publike vendore, sinjalizimit rrugor, trotuareve dhe shesheve publike, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore". Funksioni synon të sigurojë një infrastrukturë publike të sigurt, funksionale dhe të aksesueshme për lëvizjen e qytetarëve dhe automjeteve, si dhe përdorimin e hapësirave publike.

Në kuadër të këtij funksioni, bashkia administron rrjetin rrugor vendor, realizon investime për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve, trotuareve dhe shesheve publike, organizon mirëmbajtjen e tyre, si dhe siguron vendosjen dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal, me qëllim përmirësimin e sigurisë rrugore dhe aksesueshmërisë.

Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë nivelin e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore vendore, pajisjen me sinjalistikë rrugore, mbulimin e popullsisë me infrastrukturë rrugore dhe përdorimin e burimeve financiare për administrimin e këtij shërbimi.

234A01 - PËRQINDJA E RRJETIT RRUGOR TË SHTRUAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**234A01**
Emërtimi i treguesit	**Përqindja e rrjetit rrugor të shtruar**
Shërbimi	Rrugët publike vendore
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e zhvillimit të infrastrukturës rrugore vendore duke matur pjesën e rrjetit rrugor që është e shtruar në raport me gjatësinë totale të rrjetit.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e gjatësisë së rrjetit rrugor vendor që është e shtruar (e asfaltuar, e betonuar ose me shtresë tjetër të përhershme

	rrugore) në raport me gjatësinë totale të rrjetit rrugor në administrim të bashkisë.
Rëndësia e treguesit	Rrugët e shtruara përmirësojnë aksesueshmërinë, sigurinë në qarkullim dhe cilësinë e transportit lokal, duke ulur kostot e mirëmbajtjes dhe duke rritur lidhjen ndërmjet zonave të bashkisë.
Formula e llogaritjes	**(D103/D104)×100**
Njësia matëse	%
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të lartë zhvillimi të rrjetit rrugor vendor. Vlera 100% nënkupton që i gjithë rrjeti rrugor në administrim të bashkisë është i shtruar.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për infrastrukturën dhe shërbimet publike.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative ose sipas kategorisë së rrugëve, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm shkallën e shtrimit të rrjetit rrugor dhe nuk pasqyron gjendjen teknike, cilësinë e shtresës rrugore apo nivelin e mirëmbajtjes së saj.

D103 - GJATËSIA E RRJETIT RRUGOR TË SHTRUAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D103
Emërtimi i të dhënës	Gjatësia e rrjetit rrugor të shtruar

Përshkrimi i të dhënës	Gjatësia totale (në kilometra) e rrugëve publike vendore në administrim të bashkisë që janë të shtruara me asfalt, beton ose shtresë tjetër të përhershme rrugore në fund të periudhës raportuese.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e zhvillimit të rrjetit rrugor vendor dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	km
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në regjistrin e rrjetit rrugor vendor dhe dokumentacionin teknik të bashkisë.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të rrjetit rrugor, dokumentacionit teknik të bashkisë dhe, sipas rastit, sistemit GIS ose verifikimeve në terren.
Burimi i të dhënës	Regjistri i rrjetit rrugor, dokumentacioni teknik dhe sistemi GIS, kur është i disponueshëm.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për infrastrukturën.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësisë administrative ose kategorisë së rrugës.
Kufizimet	Përfshihen vetëm rrugët publike vendore në administrim të bashkisë. Nuk përfshihen rrugët kombëtare apo rrugët private.

SHENIM METODOLOGJIK – D103

Çfarë konsiderohet "rrugë e shtruar"? Rrugë e shtruar konsiderohet çdo segment rrugor në administrim të bashkisë që plotëson një nga kriteret e mëposhtme:
Ka shtresë përfundimtare asfaltike (bituminoze);
Ka shtresë betoni;
Ka shtresë kalldrëmi funksional të konsoliduar;
Është e aksesueshme në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit.

Nuk përfshihen: Rrugët e paasfaltuara me zhavorr; Rrugët me stabilizim provizor; Segmentet e papërfunduara.

Si mblidhen të dhënat?
Burimi primar: Regjistri teknik i infrastrukturës rrugore.
Metoda: Matje lineare sipas planimetrisë ekzistuese ose GIS.
Verifikimi: Kontroll dokumentacioni teknik + inspektim selektiv në terren.

D104 – GJATËSIA TOTALE E RRJETIT RRUGOR VENDOR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D104**
Emërtimi i të dhënës	**Gjatësia totale e rrjetit rrugor vendor**
Përshkrimi i të dhënës	Gjatësia totale (në kilometra) e të gjitha rrugëve publike vendore në administrim të bashkisë, pavarësisht gjendjes ose llojit të shtresës rrugore.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të përcaktojë bazën e referencës për llogaritjen e treguesve të lidhur me rrjetin rrugor.
Njësia matëse	km
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në regjistrin e rrugëve publike vendore dhe dokumentacionin teknik të bashkisë.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të rrjetit rrugor vendor, dokumentacionit teknik të bashkisë dhe sistemit GIS, kur është i disponueshëm.
Burimi i të dhënës	Regjistri i rrjetit rrugor, dokumentacioni teknik dhe sistemi GIS, kur është i disponueshëm.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për infrastrukturën.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësisë administrative ose kategorisë së rrugës.
Kufizimet	Përfshin vetëm rrjetin rrugor publik vendor që është në pronësi ose administrim të bashkisë. Nuk përfshihen rrugët kombëtare apo rrugët private.

234A02 – PËRQINDJA E RRJETIT RRUGOR ME SINJALISTIKË RRUGORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	234A02
Emërtimi i treguesit	Përqindja e rrjetit rrugor me sinjalistikë rrugore
Shërbimi	Rrugët vendore dhe sinjalizimi rrugor
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë shkallën e pajisjes së rrjetit rrugor vendor me sinjalistikë rrugore, si element i rëndësishëm për sigurinë dhe orientimin e përdoruesve të rrugës.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e gjatësisë së rrjetit rrugor vendor që është e pajisur me sinjalistikë rrugore funksionale, në raport me gjatësinë totale të rrjetit rrugor në administrim të bashkisë.
Rëndësia e treguesit	Sinjalistika rrugore kontribuon në rritjen e sigurisë së qarkullimit, orientimin e përdoruesve të rrugës dhe uljen e rrezikut të aksidenteve.
Formula e llogaritjes	(D105/D104)×100
Njësia matëse	%

Interpretimi	Vlera më të larta tregojnë një mbulim më të madh të rrjetit rrugor me sinjalistikë rrugore. Një vlerë prej 100% tregon se i gjithë rrjeti rrugor vendor është i pajisur me sinjalistikë sipas standardeve të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për infrastrukturën dhe transportin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative ose sipas kategorive të rrugëve.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm shtrirjen e sinjalistikës dhe nuk vlerëson cilësinë, përputhshmërinë me standardet teknike apo gjendjen funksionale të saj.

D105 - GJATËSIA E RRJETIT RRUGOR ME SINJALISTIKË RRUGORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D105
Emërtimi i të dhënës	Gjatësia e rrjetit rrugor me sinjalistikë rrugore
Përshkrimi i të dhënës	Gjatësia totale (në kilometra) e rrugëve publike vendore në administrim të bashkisë që janë të pajisura me sinjalistikë rrugore funksionale, duke përfshirë sinjalistikën horizontale dhe/ose vertikale, në fund të periudhës raportuese.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë shtrirjen e sinjalistikës rrugore në rrjetin rrugor vendor dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	km
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në regjistrin e infrastrukturës rrugore, inspektimet teknike dhe dokumentacionin e mirëmbajtjes së bashkisë.

Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të infrastrukturës rrugore, dokumentacionit teknik, raporteve të mirëmbajtjes dhe, sipas rastit, verifikimeve në terren.
Burimi i të dhënës	Regjistri i rrugëve, dokumentacioni teknik, raportet e mirëmbajtjes dhe sistemi GIS, kur është i disponueshëm.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për infrastrukturën.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative ose sipas kategorisë së rrugëve.
Kufizimet	Përfshin vetëm rrugët publike vendore në administrim të bashkisë. Nuk vlerëson nivelin e përputhshmërisë së sinjalistikës me standardet teknike ose gjendjen e saj fizike.

SHENIM METODOLOGJIK D105

Çfarë konsiderohet “rrugë me sinjalistikë”?

Segment rrugor konsiderohet me sinjalistikë nëse: Ka sinjalistikë horizontale të dukshme (vija, zebra, kufizime); Ka sinjalistikë vertikale funksionale (tabela, sinjale ndalimi, drejtimi, paralajmërimi); Të paktën 70% e segmentit është e pajisur me sinjalistikë funksionale.

Nuk konsiderohen: Sinjalistika e dëmtuar ose jo e dukshme; Tabela të vendosura por jo funksionale.

Metoda e mbledhjes Inspektim teknik periodik; Raport mirëmbajtjeje; Kontroll vizual në terren.

D104 - GJATËSIA TOTALE E RRJETIT RRUGOR VENDOR

Shtjelluar me lart

234A03 – GJATËSIA E RRJETIT RRUGOR TË MIRËMBAJTUR GJATË VITIT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**234A03**
Emërtimi i treguesit	**Gjatësia e rrjetit rrugor të mirëmbajtur gjatë vitit**
Shërbimi	Rrugët vendore dhe sinjalizimi rrugor
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë shtrirjen e aktiviteteve të mirëmbajtjes së rrjetit rrugor vendor të realizuara nga bashkia gjatë vitit raportues.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet gjatësinë totale të rrugëve publike vendore që kanë qenë objekt i punimeve të mirëmbajtjes gjatë periudhës raportuese, pavarësisht llojit të ndërhyrjes së kryer.
Rëndësia e treguesit	Mirëmbajtja e rregullt e rrugëve kontribuon në ruajtjen e funksionalitetit të infrastrukturës, rrit sigurinë në qarkullim, zgjat jetën e rrjetit rrugor dhe ul nevojën për investime rehabilituese me kosto të lartë.
Formula e llogaritjes	**D106**
Njësia matëse	km
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një shtrirje më të madhe të mirëmbajtjes së rrjetit rrugor gjatë vitit. Treguesi duhet të interpretohet së bashku me gjatësinë totale të rrjetit rrugor dhe burimet financiare të përdorura për mirëmbajtje.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për infrastrukturën dhe mirëmbajtjen e rrugëve.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative, kategorisë së rrugëve ose sipas llojit të ndërhyrjes së mirëmbajtjes, kur këto të dhëna janë të disponueshme.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm gjatësinë e rrugëve ku janë kryer ndërhyrje mirëmbajtjeje dhe nuk pasqyron intensitetin, cilësinë apo koston e punimeve të realizuara.

D106 – GJATËSIA E RRJETIT RRUGOR TË MIRËMBAJTUR GJATË VITIT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D106**
Emërtimi i të dhënës	**Gjatësia e rrjetit rrugor të mirëmbajtur gjatë vitit**
Përshkrimi i të dhënës	Gjatësia totale (në kilometra) e rrugëve publike vendore në administrim të bashkisë ku gjatë periudhës raportuese janë kryer punime mirëmbajtjeje, duke përfshirë mirëmbajtjen rutinë dhe/ose periodike.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë shtrirjen e ndërhyrjeve të mirëmbajtjes së realizuara në rrjetin rrugor vendor dhe të mundësojë monitorimin e performancës së bashkisë në administrimin e këtij shërbimi.
Njësia matëse	km
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në procesverbalet e punimeve, kontratat e mirëmbajtjes, raportet e mbikëqyrjes dhe dokumentacionin teknik të bashkisë.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet procesverbaleve të punimeve, kontratave të mirëmbajtjes, raporteve të mbikëqyrjes dhe dokumentacionit teknik të bashkisë.
Burimi i të dhënës	Regjistri i mirëmbajtjes së rrugëve, raportet teknike dhe dokumentacioni i zbatimit të punimeve.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për infrastrukturën.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësisë administrative, kategorisë së rrugëve ose llojit të mirëmbajtjes (rutinë/periudike), kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Një segment rrugor raportohet vetëm një herë gjatë periudhës raportuese, pavarësisht numrit të ndërhyrjeve të kryera mbi të. Nuk përfshihen punimet e ndërtimit të rrugëve të reja apo rehabilitimet kapitale.

SHENIM METODOLOGJIK D106

Çfarë konsiderohet "rrugë e mirëmbajtur"? Rrugë e mirëmbajtur konsiderohet segmenti ku gjatë vitit raportues është kryer:
Riparim gropash;
Riveshje asfaltike;
Stabilizim i shtresës mbajtëse;
Pastrim kanalesh anësore;
Rregullim bordurash;
Rilyerje sinjalistike.

Nuk përfshihet:
Vetëm ndërhyrje emergjente të përkohshme pa dokumentacion;
Ndërhyrje të paplota pa procesverbal teknik.

Metoda e mbledhjes: Procesverbale punimesh; Kontrata mirëmbajtjeje; Regjistër ndërhyrjesh;

234A04- SHPENZIMI PËR KILOMETËR TË RRJETIT RRUGOR VENDOR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**234A04**
Emërtimi i treguesit	**Shpenzimi për kilometër të rrjetit rrugor vendor**
Shërbimi	Rrugët vendore dhe sinjalizimi rrugor
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e investimit dhe të shpenzimeve të bashkisë për administrimin e rrjetit rrugor vendor në raport me gjatësinë e tij.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat shpenzimin mesatar të bashkisë për çdo kilometër të rrjetit rrugor vendor gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë shpenzimet për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve.
Rëndësia e treguesit	Treguesi mundëson vlerësimin e intensitetit të financimit të infrastrukturës rrugore dhe krahasimin ndërmjet bashkive me rrjete rrugore të madhësive të ndryshme.
Formula e llogaritjes	**D107/D104**
Njësia matëse	Lekë/km
Interpretimi	Vlera më të larta tregojnë një nivel më të madh shpenzimesh për kilometër rrjeti rrugor. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë gjendjen e rrjetit, projektet investuese dhe karakteristikat territoriale të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për infrastrukturën dhe drejtoria e financës.
Disagregimi	Mund të analizohet sipas burimit të financimit (buxhet vendor, transferta, fonde të donatorëve etj.), kur këto të dhëna janë të disponueshme.
Kufizimet	Treguesi nuk vlerëson efikasitetin apo cilësinë e shpenzimeve dhe mund të ndikohet nga investimet kapitale të realizuara gjatë vitit raportues.

D107 – SHPENZIMET PËR NDËRTIMIN, REHABILITIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E RRUGËVE VENDORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D107**
Emërtimi i të dhënës	**Shpenzimet për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore**
Përshkrimi i të dhënës	Vlera totale e shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës raportuese për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike vendore, përfshirë edhe sinjalizimin rrugor, trotuaret dhe sheshet publike, në përputhje me klasifikimin buxhetor të funksionit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë burimet financiare të përdorura nga bashkia për realizimin e funksionit dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	Lekë
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në sistemin e menaxhimit financiar dhe raportet e ekzekutimit të buxhetit.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet sistemit të menaxhimit financiar, raporteve të ekzekutimit të buxhetit dhe dokumentacionit kontabël të bashkisë.
Burimi i të dhënës	Sistemi financiar i bashkisë, raportet e ekzekutimit të buxhetit dhe pasqyrat financiare.
Frekuenca e raportimit	Vjetore

Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e financës, në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për infrastrukturën.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas natyrës së shpenzimeve (investime, rehabilitim, mirëmbajtje), sipas burimit të financimit ose sipas njësive administrative, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Përfshihen vetëm shpenzimet e realizuara dhe të regjistruara në sistemin financiar gjatë periudhës raportuese. Nuk përfshihen angazhimet financiare të papaguara.

D104 - GJATËSIA TOTALE E RRJETIT RRUGOR VENDOR

Shtjelluar me lart

234A05 – PËRQINDJA E POPULLSISË SË MBULUAR NGA RRJETI RRUGOR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**234A05**
Emërtimi i treguesit	**Përqindja e popullsisë së mbuluar nga rrjeti rrugor vendor**
Shërbimi	Rrugët vendore dhe sinjalizimi rrugor
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë shkallën e mbulimit të popullsisë së bashkisë me infrastrukturë rrugore vendore funksionale.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e popullsisë së bashkisë që ka akses në rrjetin rrugor vendor, në raport me popullsinë totale të bashkisë.

Rëndësia e treguesit	Treguesi ndihmon në vlerësimin e aksesueshmërisë së popullsisë ndaj infrastrukturës rrugore vendore dhe mbështet analizën e barazisë territoriale në ofrimin e këtij shërbimi.
Formula e llogaritjes	**(D108/D52)×100**
Njësia matëse	%
Interpretimi	Vlera më të larta tregojnë se një pjesë më e madhe e popullsisë së bashkisë është e mbuluar nga rrjeti rrugor vendor. Vlera 100% tregon mbulim të plotë të popullsisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për infrastrukturën, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për planifikimin territorial.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative ose zonave urbane dhe rurale, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Vlerësimi i popullsisë së mbuluar mund të bazohet pjesërisht në vlerësime teknike ose të dhëna gjeohapësinore, në varësi të metodologjisë së përdorur nga bashkia. Për këtë arsye, krahasueshmëria ndërmjet bashkive mund të ndikohet nga mënyra e vlerësimit të mbulimit.

D108 – POPULLSIA E MBULUAR NGA RRJETI RRUGOR VENDOR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D108**
Emërtimi i të dhënës	**Popullsia e mbuluar nga rrjeti rrugor vendor**

Përshkrimi i të dhënës	Numri i banorëve që banojnë në zona të pajisura me rrjet rrugor vendor funksional, i cili siguron akses të rregullt për lëvizjen e njerëzve, mjeteve dhe shërbimeve.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të mundësojë vlerësimin e mbulimit të popullsisë me infrastrukturë rrugore vendore dhe llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	Numër banorësh
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ dhe/ose analizë gjeohapësinore (GIS), bazuar në shpërndarjen e popullsisë dhe shtrirjen e rrjetit rrugor vendor.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të popullsisë, sistemit GIS të bashkisë, dokumentacionit të planifikimit territorial ose burimeve të tjera administrative.
Burimi i të dhënës	Regjistri i popullsisë, sistemi GIS i bashkisë, dokumentacioni i planifikimit territorial ose burime të tjera administrative.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për infrastrukturën dhe planifikimin territorial.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative ose zonave urbane dhe rurale.
Kufizimet	Metodologjia për përcaktimin e popullsisë së mbuluar duhet të zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme për të garantuar krahasueshmërinë ndërmjet bashkive.

D52 – POPULLSIA TOTALE E BASHKISË

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D52

Emërtimi i të dhënës	Popullsia totale e bashkisë
Përshkrimi i të dhënës	Tregon numrin total të banorëve me vendbanim të zakonshëm në territorin administrativ të bashkisë gjatë periudhës raportuese. Kjo e dhënë përdoret si bazë referimi për llogaritjen e treguesve për frymë (per capita) dhe për analizën krahasuese të shërbimeve publike.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të sigurojë bazën demografike për llogaritjen e treguesve të standardizuar për frymë dhe për analizën e mbulimit, efikasitetit dhe performancës së shërbimeve publike në nivel bashkie.
Njësia matëse	Numër banorësh
Metoda e mbledhjes	Merret nga të dhënat zyrtare të popullsisë të publikuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT) ose nga burimi zyrtar kombëtar i përcaktuar për periudhën raportuese.
Burimi i informacionit	Instituti i Statistikave (INSTAT) ose burimi tjetër zyrtar kombëtar për statistikat e popullsisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Bashkia
Disagregimi	Mund të disagregohet sipas gjinisë, grupmoshës, njësisë administrative ose zonës urbane/rurale, kur informacioni është i disponueshëm nga burimi zyrtar.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet të dhënave zyrtare të publikuara nga INSTAT ose burimi tjetër zyrtar kombëtar për statistikat e popullsisë, duke siguruar që vlera e përdorur i përket periudhës raportuese.
Kufizimet	Vlera varet nga metodologjia dhe periudha e publikimit të statistikave zyrtare të popullsisë. Ndryshimet demografike ndërmjet publikimeve zyrtare mund të mos pasqyrohen menjëherë në të dhënën e raportuar.

23.5 NDRIÇIMI PUBLIK

Ky funksion përfshin përgjegjësinë e bashkisë për planifikimin, ndërtimin, zgjerimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ndriçimit publik në territorin e saj, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore". Funksioni synon të sigurojë ndriçimin e hapësirave publike për të rritur sigurinë, aksesueshmërinë dhe cilësinë e jetës së qytetarëve.

Në kuadër të këtij funksioni, bashkia realizon investime për ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, administron dhe mirëmban infrastrukturën ekzistuese, siguron funksionimin e pikave të ndriçimit dhe menaxhon burimet financiare të dedikuara për këtë shërbim.

Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë shtrirjen dhe funksionalitetin e rrjetit të ndriçimit publik, mbulimin e hapësirave publike me ndriçim, si dhe nivelin e burimeve financiare të përdorura për administrimin e këtij shërbimi.

235A01 – GJATËSIA E RRJETIT TË NDRIÇIMIT PUBLIK TË MIRËMBAJTUR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**235A01**
Emërtimi i treguesit	**Gjatësia e rrjetit të ndriçimit publik të mirëmbajtur**
Shërbimi	Ndriçimi publik
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik që ka qenë objekt i mirëmbajtjes gjatë periudhës raportuese.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet gjatësinë totale të rrjetit të ndriçimit publik për të cilin gjatë periudhës raportuese janë kryer ndërhyrje mirëmbajtjeje, me qëllim garantimin e funksionimit të tij.
Rëndësia e treguesit	Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik është thelbësore për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit, rritjen e sigurisë publike dhe ruajtjen e infrastrukturës ekzistuese.

Formula e llogaritjes	**D109**
Njësia matëse	km
Interpretimi	Vlera më të larta tregojnë një shtrirje më të madhe të rrjetit të ndriçimit publik që ka përfituar mirëmbajtje gjatë vitit raportues. Interpretimi duhet të bëhet në raport me gjatësinë totale të rrjetit të ndriçimit publik.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për shërbimet publike dhe infrastrukturën.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative ose zonave urbane dhe rurale.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm gjatësinë e rrjetit ku janë kryer ndërhyrje mirëmbajtjeje dhe nuk pasqyron cilësinë apo intensitetin e ndërhyrjeve.

D109 – GJATËSIA E RRJETIT TË NDRIÇIMIT PUBLIK TË MIRËMBAJTUR

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D109**
Emërtimi i të dhënës	**Gjatësia e rrjetit të ndriçimit publik të mirëmbajtur**
Përshkrimi i të dhënës	Gjatësia totale (në kilometra) e rrjetit të ndriçimit publik në administrim të bashkisë ku gjatë periudhës raportuese janë kryer ndërhyrje mirëmbajtjeje, përfshirë riparimin ose zëvendësimin e elementeve të rrjetit për të garantuar funksionimin e tij.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë shtrirjen e mirëmbajtjes së rrjetit të ndriçimit publik dhe të mundësojë monitorimin e performancës së bashkisë në administrimin e këtij shërbimi.
Njësia matëse	km
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në regjistrin e rrjetit të ndriçimit publik, procesverbalet e punimeve dhe raportet e mirëmbajtjes.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të rrjetit të ndriçimit publik, procesverbaleve të punimeve, raporteve të mirëmbajtjes dhe, sipas rastit, verifikimeve në terren.
Burimi i të dhënës	Regjistri i aseteve të ndriçimit publik, dokumentacioni teknik dhe raportet e mirëmbajtjes.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për shërbimet publike dhe infrastrukturën.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative ose zonave të mbuluara nga rrjeti.
Kufizimet	Një segment i rrjetit raportohet vetëm një herë gjatë periudhës raportuese, pavarësisht numrit të ndërhyrjeve të kryera mbi të.

235A02 – SHPENZIMET PËR NDRIÇIMIN PUBLIK

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	**235A02**
Emërtimi i treguesit	**Shpenzimet për ndriçimin publik**
Shërbimi	Ndriçimi publik

Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e burimeve financiare të përdorura nga bashkia për ofrimin dhe administrimin e shërbimit të ndriçimit publik.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet vlerën totale të shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës raportuese për ndërtimin, zgjerimin, rehabilitimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ndriçimit publik.
Rëndësia e treguesit	Treguesi mundëson monitorimin e angazhimit financiar të bashkisë për garantimin e funksionimit të shërbimit të ndriçimit publik dhe analizën e evolucionit të kostove ndër vite.
Formula e llogaritjes	**D110**
Njësia matëse	Lekë
Interpretimi	Vlera më të larta tregojnë një nivel më të madh shpenzimesh për ndriçimin publik. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë shtrirjen e rrjetit, numrin e pikave të ndriçimit dhe investimet e realizuara gjatë vitit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e financës në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për shërbimet publike.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas natyrës së shpenzimeve (investime, energji elektrike, mirëmbajtje, riparime), kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi paraqet vetëm nivelin e shpenzimeve dhe nuk vlerëson efikasitetin apo cilësinë e shërbimit të ofruar.

D110 - SHPENZIMET PËR NDRIÇIMIN PUBLIK	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D110**
Emërtimi i të dhënës	**Shpenzimet për ndriçimin publik**
Përshkrimi i të dhënës	Vlera totale e shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës raportuese për ndërtimin, zgjerimin, rehabilitimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ndriçimit publik, përfshirë konsumin e energjisë elektrike, kur financohet nga bashkia. Për qëllime të raportimit, shpenzimet për ndriçimin publik përfshijnë si shpenzimet korrente (si energjia elektrike, mirëmbajtja dhe riparimet), ashtu edhe shpenzimet kapitale për ndërtimin, zgjerimin ose rehabilitimin e sistemit të ndriçimit publik, kur ato regjistrohen në funksionin përkatës buxhetor.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë burimet financiare të përdorura për ofrimin e shërbimit të ndriçimit publik dhe të mundësojë monitorimin e kostove të këtij funksioni.
Njësia matëse	Lekë
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në sistemin e menaxhimit financiar dhe raportet e ekzekutimit të buxhetit.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet sistemit të menaxhimit financiar, raporteve të ekzekutimit të buxhetit dhe dokumentacionit kontabël të bashkisë.
Burimi i të dhënës	Sistemi financiar i bashkisë, pasqyrat financiare dhe raportet e ekzekutimit të buxhetit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e financës.

Disagregimi	Mund të disagragohet sipas kategorive të shpenzimeve ose burimit të financimit.
Kufizimet	Përfshihen vetëm shpenzimet e realizuara dhe të regjistruara në sistemin financiar gjatë periudhës raportuese. Nuk përfshihen angazhimet financiare të papaguara.

235A03 – TË ARDHURAT NGA TARIFA E NDRIÇIMIT PUBLIK

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**235A03**
Emërtimi i treguesit	**Të ardhurat nga tarifa e ndriçimit publik**
Shërbimi	Ndriçimi publik
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e të ardhurave të mbledhura nga bashkia nga tarifa e ndriçimit publik dhe kontributin e tyre në financimin e këtij shërbimi.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet vlerën totale të të ardhurave të arkëtuara gjatë periudhës raportuese nga tarifa e ndriçimit publik, sipas akteve të miratuara nga bashkia.
Rëndësia e treguesit	Treguesi ndihmon në monitorimin e aftësisë së bashkisë për të gjeneruar të ardhura nga tarifat vendore dhe për të mbështetur financiarisht ofrimin e shërbimit të ndriçimit publik.
Formula e llogaritjes	**D111**
Njësia matëse	Lekë
Interpretimi	Vlera më të larta tregojnë një nivel më të madh të ardhurash të arkëtuara nga tarifa e ndriçimit publik. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë politikat tarifore, nivelin e arkëtimeve dhe shtrirjen e shërbimit.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e financës dhe struktura përgjegjëse për administrimin e të ardhurave vendore.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas kategorive të tatimpaguesve (familjarë, biznese etj.) ose sipas njësive administrative, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi pasqyron vetëm të ardhurat e arkëtuara gjatë periudhës raportuese dhe nuk përfshin detyrimet e papaguara ose të ardhurat e planifikuara.

D111 – TË ARDHURAT NGA TARIFA E NDRIÇIMIT PUBLIK

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D111**
Emërtimi i të dhënës	**Të ardhurat nga tarifa e ndriçimit publik**
Përshkrimi i të dhënës	Vlera totale e të ardhurave të arkëtuara gjatë periudhës raportuese nga tarifa e ndriçimit publik, sipas nivelit të tarifave të miratuara nga këshilli bashkiak dhe legjislacionit në fuqi.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifa e ndriçimit publik dhe të mundësojë monitorimin e financimit të këtij shërbimi.
Njësia matëse	Lekë
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në sistemin e administrimit të të ardhurave vendore dhe raportet financiare të bashkisë.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet sistemit financiar të bashkisë, regjistrave të arkëtimeve, pasqyrave financiare dhe dokumentacionit kontabël.

Burimi i të dhënës	Sistemi i administrimit të të ardhurave vendore, raportet financiare dhe pasqyrat e arkëtimeve.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e financës dhe struktura përgjegjëse për administrimin e të ardhurave vendore.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas kategorive të tatimpaguesve ose njësive administrative, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Përfshihen vetëm të ardhurat e arkëtuara gjatë periudhës raportuese. Nuk përfshihen detyrimet e papaguara, kamatëvonesat ose të ardhurat e planifikuara, nëse nuk janë arkëtuar.

235A04 – PËRQINDJA E SIPËRFAQES PUBLIKE TË MBULUAR ME NDRIÇIM PUBLIK

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**235A04**
Emërtimi i treguesit	**Përqindja e sipërfaqes publike të mbuluar me ndriçim publik**
Shërbimi	Ndriçimi publik
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë shkallën e mbulimit të hapësirave publike me ndriçim publik në territorin e bashkisë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e sipërfaqeve publike që janë të pajisura me sistem funksional të ndriçimit publik në raport me sipërfaqen totale publike që, sipas planifikimit dhe funksionit të saj, duhet të jetë e ndriçuar.

Rëndësia e treguesit	Ndriçimi i hapësirave publike ndikon drejtpërdrejt në sigurinë publike, aksesueshmërinë, përdorimin e hapësirave urbane dhe cilësinë e jetës së qytetarëve.
Formula e llogaritjes	**(D112/D113)×100**
Njësia matëse	%
Interpretimi	Vlera më të larta tregojnë një mbulim më të madh të hapësirave publike me ndriçim publik. Vlera 100% tregon se të gjitha sipërfaqet publike të planifikuara për ndriçim janë të mbuluara.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për shërbimet publike dhe planifikimin e infrastrukturës.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative ose sipas kategorive të hapësirave publike (rrugë, sheshe, parqe etj.), kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Krahasueshmëria ndërmjet bashkive varet nga mënyra e përcaktimit të sipërfaqeve publike që konsiderohen objekt i ndriçimit publik.

D112 – SIPËRFAQJA PUBLIKE E MBULUAR ME NDRIÇIM PUBLIK

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D112**
Emërtimi i të dhënës	**Sipërfaqja publike e mbuluar me ndriçim publik**
Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja totale e hapësirave publike në administrim të bashkisë që mbulohet nga një sistem funksional i ndriçimit publik në fund të periudhës raportuese.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë shtrirjen reale të mbulimit të hapësirave publike me ndriçim publik dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	m^2
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ dhe/ose analizë gjeohapësinore (GIS), bazuar në regjistrin e aseteve dhe hartat e rrjetit të ndriçimit publik.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të rrjetit të ndriçimit publik, dokumentacionit teknik të bashkisë, raporteve të mirëmbajtjes dhe, sipas rastit, verifikimeve në terren.
Burimi i të dhënës	Sistemi GIS, regjistri i aseteve të bashkisë dhe dokumentacioni teknik.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për shërbimet publike.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas kategorive të hapësirave publike ose njësive administrative.
Kufizimet	Përfshihen vetëm sipërfaqet publike në administrim të bashkisë që janë efektivisht të mbuluara nga sistemi i ndriçimit publik.

D113 – SIPËRFAQJA TOTALE PUBLIKE QË DUHET TË MBULOHET ME NDRIÇIM PUBLIK

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D113**
Emërtimi i të dhënës	**Sipërfaqja totale publike që duhet të mbulohet me ndriçim publik**

Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja totale e rrugëve, shesheve, parqeve dhe hapësirave të tjera publike që, sipas planeve, standardeve teknike ose vendimeve të bashkisë, duhet të pajisen me ndriçim publik.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të përcaktojë bazën e referencës për vlerësimin e mbulimit të hapësirave publike me ndriçim publik.
Njësia matëse	m^2
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në dokumentet e planifikimit territorial, regjistrin e aseteve dhe sistemin GIS, kur është i disponueshëm.
Burimi i të dhënës	Dokumentet e planifikimit, regjistri i aseteve dhe sistemi GIS i bashkisë.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të aseteve të ndriçimit publik, dokumentacionit teknik, procesverbaleve të dorëzimit në shfrytëzim dhe verifikimeve në terren
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për planifikimin dhe shërbimet publike.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas kategorive të hapësirave publike ose njësive administrative.
Kufizimet	Përkufizimi i sipërfaqeve që "duhet" të mbulohen me ndriçim duhet të bazohet në kritere të njëjta gjatë periudhave raportuese për të garantuar krahasueshmërinë.

SHËNIM METODOLOGJIK – E DHËNA D113

Qëllimi i të dhënës

D113 përfaqëson sipërfaqen totale të hapësirave publike në administrim të bashkisë dhe shërben si bazë për llogaritjen e treguesit **"Sipërfaqja publike e mbuluar me gjelbërim"**.

Çfarë konsiderohet "sipërfaqe publike"?

Për qëllime të këtij manuali, **sipërfaqe publike** konsiderohet çdo hapësirë që plotëson njëkohësisht këto kushte:

- është në pronësi ose administrim të bashkisë;
- është e destinuar për përdorim publik;
- është e aksesueshme për qytetarët, sipas funksionit të saj.

Përfshihen:

- rrugët dhe trotuaret publike;
- sheshet publike;
- parqet dhe lulishtet;
- hapësirat rekreative publike;
- hapësirat e destinuara për aktivitete publike.

Nuk përfshihen:

- pronat private;
- ndërtesat dhe ambientet administrative të mbyllura;
- zonat industriale private;
- tokat bujqësore;
- sipërfaqet që nuk kanë funksion publik ose nuk janë të aksesueshme për qytetarët.

Metoda e matjes

- analizë GIS e territorit publik;
- regjistri i aseteve të paluajtshme të bashkisë;
- planimetritë dhe hartat zyrtare të miratuara.

Metoda e verifikimit

- krahasim me regjistrin e pronave/aseteve publike;
- dokumentacioni kadastral;
- kontroll i konsistencës me hartat zyrtare të bashkisë dhe, kur është e nevojshme, verifikim në terren.

Rreziqe metodologjike

- përdorimi i përkufizimeve të ndryshme të "sipërfaqes publike" ndërmjet bashkive;
- përfshirja e sipërfaqeve që nuk janë realisht në administrim ose përdorim publik;

mospërputhje ndërmjet të dhënave GIS, regjistrit të aseteve dhe dokumentacionit kadastral

NP05 – NUMRI I PIKAVE TË NDRIÇIMIT FUNKSIONALE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**235A05**
Emërtimi i treguesit	**Numri i pikave të ndriçimit funksionale**
Shërbimi	Ndriçimi publik
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë shkallën e funksionalitetit të infrastrukturës së ndriçimit publik në administrim të bashkisë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet numrin e pikave të ndriçimit publik që janë funksionale në fund të periudhës raportuese dhe ofrojnë shërbim ndriçimi.
Rëndësia e treguesit	Treguesi ndihmon në monitorimin e kapacitetit operacional të sistemit të ndriçimit publik dhe në vlerësimin e cilësisë së mirëmbajtjes së tij.
Formula e llogaritjes	**D114**
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një numër më i lartë i pikave funksionale tregon një shtrirje dhe funksionalitet më të madh të sistemit të ndriçimit publik. Interpretimi duhet të bëhet në raport me madhësinë e territorit, popullsinë dhe rrjetin e ndriçimit publik të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për shërbimet publike dhe infrastrukturën.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative ose sipas kategorive të hapësirave publike, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi paraqet vetëm numrin e pikave funksionale dhe nuk jep informacion mbi fuqinë ndriçuese, efikasitetin energjetik apo gjendjen teknike të secilës pikë ndriçimi.

D114 – NUMRI I PIKAVE TË NDRIÇIMIT FUNKSIONALE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D114**
Emërtimi i të dhënës	**Numri i pikave të ndriçimit funksionale**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i pikave të ndriçimit publik në administrim të bashkisë që janë funksionale dhe në gjendje pune në fund të periudhës raportuese.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë kapacitetin funksional të sistemit të ndriçimit publik dhe të mundësojë monitorimin e performancës së këtij shërbimi.
Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në regjistrin e aseteve të ndriçimit publik, inventarët teknikë dhe raportet e mirëmbajtjes.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të aseteve të ndriçimit publik, evidencave të mirëmbajtjes, raporteve të inspektimit teknik dhe, sipas rastit, verifikimeve në terren.
Burimi i të dhënës	Regjistri i aseteve të ndriçimit publik, dokumentacioni teknik dhe raportet e inspektimit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore

Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për shërbimet publike.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative ose sipas llojit të pikës së ndriçimit, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Përfshihen vetëm pikat e ndriçimit që janë funksionale në fund të periudhës raportuese. Nuk përfshihen pikat jashtë funksionit ose ato në proces ndërtimi.

23.6 TRANSPORTI PUBLIK

Ky funksion përfshin përgjegjësinë e bashkisë për organizimin, rregullimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të transportit publik vendor, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe legjislacionin sektorial në fuqi. Funksioni synon të sigurojë një sistem transporti publik të aksesueshëm, të sigurt, efikas dhe të qëndrueshëm, i cili u përgjigjet nevojave të qytetarëve për lëvizje brenda territorit të bashkisë.

Në kuadër të këtij funksioni, bashkia planifikon rrjetin e linjave të transportit publik, përcakton itineraret dhe standardet e shërbimit, administron ose mbikëqyr operatorët që ofrojnë shërbimin, monitoron cilësinë e transportit publik dhe ndërmerr masa për përmirësimin e aksesueshmërisë dhe efikasitetit të tij.

Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë shtrirjen e shërbimit të transportit publik, kapacitetin operacional, përdorimin e shërbimit nga qytetarët dhe performancën e përgjithshme të sistemit të transportit publik vendor.

TP01 – NUMRI TOTAL I LINJAVE TË TRANSPORTIT PUBLIK

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**236A01**

Emërtimi i treguesit	**Numri total i linjave të transportit publik**
Shërbimi	Transporti publik
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë shtrirjen e rrjetit të transportit publik në territorin e bashkisë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet numrin total të linjave të transportit publik që operojnë në territorin e bashkisë gjatë periudhës raportuese. Për qëllime të këtij manuali, linjë transporti publik konsiderohet çdo itinerar i miratuar nga autoriteti kompetent, i cili ofron shërbim të rregullt për publikun, pavarësisht nëse operohet nga bashkia ose nga një operator i licencuar.
Rëndësia e treguesit	Numri i linjave të transportit publik është një tregues i shtrirjes së shërbimit dhe i aksesit të qytetarëve në transportin publik. Ai shërben si bazë për analizimin e mbulimit territorial dhe planifikimin e zhvillimit të mëtejshëm të rrjetit.
Formula e llogaritjes	**D115**
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një numër më i lartë linjash tregon një rrjet më të zhvilluar të transportit publik. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë parasysh territorin, popullsinë dhe kërkesën për transport.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për transportin publik ose struktura përgjegjëse për shërbimet publike.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas llojit të transportit (urban, ndërurban vendor) ose sipas operatorëve, kur informacioni është i disponueshëm.

Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e linjave dhe nuk pasqyron frekuencën e shërbimit, gjatësinë e linjave apo cilësinë e transportit.

D115 – NUMRI TOTAL I LINJAVE TË TRANSPORTIT PUBLIK

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D115**
Emërtimi i të dhënës	**Numri total i linjave të transportit publik**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i linjave të transportit publik që janë në funksion gjatë periudhës raportuese dhe ofrojnë shërbim të rregullt për qytetarët në territorin e bashkisë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë shtrirjen e rrjetit të transportit publik dhe të mundësojë monitorimin e zhvillimit të këtij shërbimi.
Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në lejet, kontratat ose aktet administrative që rregullojnë funksionimin e linjave të transportit publik.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet vendimeve të bashkisë, kontratave të shërbimit të transportit publik, lejeve të operimit dhe regjistrit të linjave të transportit publik.
Burimi i të dhënës	Regjistri i linjave të transportit publik, kontratat me operatorët dhe dokumentacioni administrativ i bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për transportin publik.

Disagregimi	Mund të disagragohet sipas llojit të transportit ose operatorit.
Kufizimet	Raportohen vetëm linjat aktive gjatë periudhës raportuese. Nuk përfshihen linjat e pezulluara ose të autorizuara, por jo funksionale.

236A02 – NUMRI TOTAL I MJETEVE TË TRANSPORTIT PUBLIK

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**236A02**
Emërtimi i treguesit	**Numri total i mjeteve të transportit publik**
Shërbimi	Transporti publik
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë kapacitetin operacional të sistemit të transportit publik në territorin e bashkisë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet numrin total të mjeteve të transportit publik që janë në funksion gjatë periudhës raportuese dhe përdoren për ofrimin e shërbimit të transportit publik në territorin e bashkisë.
Rëndësia e treguesit	Numri i mjeteve të transportit publik pasqyron kapacitetin e sistemit për të ofruar shërbim dhe për të përballuar kërkesën për transport të qytetarëve.
Formula e llogaritjes	**D116**
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një numër më i madh mjetesh tregon një kapacitet më të lartë potencial për ofrimin e shërbimit të transportit publik. Interpretimi duhet të bëhet në lidhje me numrin e linjave, frekuencën e shërbimit dhe numrin e udhëtarëve.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për transportin publik ose struktura përgjegjëse për shërbimet publike.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas llojit të mjetit (autobus, minibus etj.), operatorit ose llojit të shërbimit (urban, ndërurban vendor), kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e mjeteve dhe nuk pasqyron kapacitetin e tyre, gjendjen teknike, aksesueshmërinë apo frekuencën e përdorimit.

D116 – NUMRI TOTAL I MJETEVE TË TRANSPORTIT PUBLIK

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D116**
Emërtimi i të dhënës	**Numri total i mjeteve të transportit publik**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i mjeteve të transportit publik që janë në funksion gjatë periudhës raportuese dhe përdoren për ofrimin e shërbimit në linjat e transportit publik të bashkisë. Çdo mjet transporti raportohet vetëm një herë, edhe nëse operon në më shumë se një linjë gjatë periudhës raportuese. Përfshihen vetëm mjetet aktive që përdoren për transport publik të udhëtarëve në territorin e bashkisë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë kapacitetin operacional të sistemit të transportit publik dhe të mundësojë monitorimin e zhvillimit të këtij shërbimi.
Njësia matëse	Numër

Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në regjistrat e operatorëve të transportit publik, kontratat e shërbimit ose dokumentacionin administrativ të bashkisë.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të operatorëve të transportit publik, licencave të vlefshme dhe dokumentacionit administrativ të bashkisë.
Burimi i të dhënës	Regjistri i mjeteve të operatorëve të transportit publik, kontratat e shërbimit dhe dokumentacioni administrativ i bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për transportin publik.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas llojit të mjetit, operatorit ose llojit të shërbimit.
Kufizimet	Përfshihen vetëm mjetet që janë aktive dhe përdoren për ofrimin e shërbimit gjatë periudhës raportuese. Nuk përfshihen mjetet jashtë funksionit ose të çregjistruara.

236A03 – NUMRI TOTAL I UDHËTARËVE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**236A03**
Emërtimi i treguesit	**Numri total i udhëtarëve**
Shërbimi	Transporti publik
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**

Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e përdorimit të shërbimit të transportit publik nga qytetarët gjatë periudhës raportuese.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet numrin total të udhëtarëve të transportuar nga shërbimi i transportit publik gjatë periudhës raportuese.
Rëndësia e treguesit	Numri i udhëtarëve është një tregues i rëndësishëm i përdorimit të transportit publik dhe ndihmon në vlerësimin e kërkesës për shërbim, planifikimin e kapaciteteve dhe monitorimin e performancës së sistemit të transportit publik.
Formula e llogaritjes	**D117**
Njësia matëse	Numër udhëtarësh
Interpretimi	Një numër më i lartë udhëtarësh tregon një përdorim më të madh të transportit publik. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë popullsinë e bashkisë, numrin e linjave, frekuencën e shërbimit dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në kërkesën për transport.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për transportin publik ose struktura përgjegjëse për administrimin e kontratave me operatorët.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas linjës së transportit, operatorit ose llojit të shërbimit (urban, ndërurban vendor), kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi varet nga saktësia e të dhënave të raportuara nga operatorët e transportit publik dhe nga metodologjia e përdorur për numërimin e udhëtarëve.

D117 - NUMRI TOTAL I UDHËTARËVE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D117**
Emërtimi i të dhënës	**Numri total i udhëtarëve**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i udhëtarëve që kanë përdorur shërbimin e transportit publik gjatë periudhës raportuese, pavarësisht linjës ose operatorit që ka ofruar shërbimin.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e përdorimit të transportit publik dhe të mundësojë monitorimin e kërkesës për këtë shërbim.
Njësia matëse	Numër udhëtarësh
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në raportimet e operatorëve të transportit publik, sistemet elektronike të biletimit, numërimet periodike ose burime të tjera të verifikueshme.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet raporteve operative të operatorëve të transportit publik, sistemeve të numërimit të udhëtarëve ose evidencave administrative të shërbimit.
Burimi i të dhënës	Raportet e operatorëve të transportit publik, sistemet e biletimit dhe dokumentacioni administrativ i bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për transportin publik.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas linjës, operatorit ose llojit të shërbimit, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Në rastet kur nuk ekziston një sistem elektronik biletimi, numri i udhëtarëve mund të bazohet në raportimet e operatorëve ose në metoda të tjera vlerësimi, gjë që mund të ndikojë në saktësinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave.

SHENIM METODOLOGJIK D117

Cfarë konsiderohet "linjë transporti publik"?

Linjë transporti publik konsiderohet një itinerar i përcaktuar, i miratuar administrativisht, që:
Ka pikënisje dhe pikëmbërritje të përcaktuar;
Operon sipas një orari të rregullt;
Është e hapur për publikun;
Operohet nga operator i licencuar;
Ka funksionuar realisht gjatë vitit raportues (minimumi 6 muaj operim efektiv).
Çfarë NUK përfshihet: Nuk konsiderohen si linja: Itinerare të përkohshme për evente; Shërbime private pa akses publik; Linja të pezulluara gjatë gjithë vitit; Linja të autorizuara por jo operative.

Rregulla për numërimin: Çdo itinerar unik numërohet si një linjë; Linjat vajtje-ardhje konsiderohen si një linjë e vetme nëse janë pjesë e të njëjtit itinerar; Linjat urbane dhe rurale raportohen së bashk unese jane pjese e nje itenerari (me mundësi disagregimi).
Metoda e mbledhjes së të dhënës
Burimi primar: Regjistri i lejeve të operimit; Kontratat me operatorët; Vendimet e Këshillit Bashkiak.

Procesi: Identifikohen linjat e licencuara; Verifikohet operimi efektiv gjatë vitit; Përjashtohen linjat joaktive.
Metoda e verifikimit: Kontroll administrativ i dokumentacionit; Krahasim me raportet mujore të operatorëve; Verifikim rastësor i operimit real;

236A04 – NUMRI I BILETAVE TË SHITURA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**236A04**
Emërtimi i treguesit	**Numri i biletave të shitura**
Shërbimi	Transporti publik
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**

Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë përdorimin e transportit publik përmes numrit të biletave të shitura gjatë periudhës raportuese dhe të mbështesë analizën e performancës financiare të shërbimit.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet numrin total të biletave të shitura për përdorimin e transportit publik gjatë periudhës raportuese.
Rëndësia e treguesit	Numri i biletave të shitura është një tregues i rëndësishëm për monitorimin e përdorimit të shërbimit, analizën e të ardhurave dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare të transportit publik.
Formula e llogaritjes	**D118**
Njësia matëse	Numër biletash
Interpretimi	Një numër më i lartë biletash të shitura tregon një përdorim më të madh të transportit publik me pagesë. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë sistemin tarifor, përdorimin e abonimeve dhe kategoritë që përfitojnë udhëtim falas ose me tarifa të reduktuara.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për transportin publik, në bashkëpunim me operatorët e transportit publik.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas llojit të biletës (e zakonshme, abonim, kategori të veçanta), operatorit ose linjës, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi nuk përfshin udhëtarët që udhëtojnë pa biletë ose ata që përfitojnë transport falas, nëse këta nuk regjistrohen në sistemin e biletimit. Për këtë arsye, ai nuk përfaqëson domosdoshmërisht numrin total të udhëtarëve.

D118 - NUMRI I BILETAVE TË SHITURA	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D118**
Emërtimi i të dhënës	**Numri i biletave të shitura**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i biletave të shitura për përdorimin e transportit publik gjatë periudhës raportuese, pavarësisht llojit të biletës ose operatorit që ofron shërbimin. Për efekt të këtij treguesi, përfshihen të gjitha biletat e shitura gjatë periudhës raportuese, pavarësisht llojit të tyre (biletë e vetme, biletë vajtje-ardhje, abonim ose forma të tjera pagese), nëse ato regjistrohen në sistemin e operatorit. Abonimet raportohen si njësi të shitura dhe jo sipas numrit të udhëtimeve të realizuara me to.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e përdorimit të transportit publik me pagesë dhe të mbështesë monitorimin e të ardhurave të gjeneruara nga shitja e biletave.
Njësia matëse	Numër biletash
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në sistemet elektronike të biletimit, regjistrat e shitjes së biletave ose raportimet e operatorëve të transportit publik.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të shitjes së biletave, sistemeve elektronike të biletimit ose evidencave administrative të operatorëve.
Burimi i të dhënës	Sistemet e biletimit, raportet e operatorëve të transportit publik dhe dokumentacioni administrativ i bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për transportin publik.

Disagregimi	Mund të disagragohet sipas llojit të biletës, operatorit ose linjës së transportit.
Kufizimet	Në rastet kur përdoren sisteme të ndryshme biletimi ose nuk regjistrohen abonimet dhe kategoritë përfituese, krahasueshmëria e të dhënave mund të ndikohet.

236A05 – NUMRI I PËRFITUESVE NGA SUBVENCIONIMI

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**236A05**
Emërtimi i treguesit	**Numri i përfituesve nga subvencionimi**
Shërbimi	Transporti publik
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë numrin e individëve që kanë përfituar subvencionim për përdorimin e transportit publik gjatë periudhës raportuese.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet numrin total të individëve që kanë përfituar subvencionim të plotë ose të pjesshëm për transportin publik, në bazë të legjislacionit në fuqi ose vendimeve të Këshillit Bashkiak.
Rëndësia e treguesit	Treguesi ndihmon në vlerësimin e mbështetjes sociale që ofron bashkia për aksesin në transportin publik dhe në monitorimin e zbatimit të politikave për grupet përfituese.
Formula e llogaritjes	**D119**
Njësia matëse	Numër përfituesish
Interpretimi	Një numër më i lartë përfituesish tregon një shtrirje më të madhe të skemave të subvencionimit të transportit publik. Interpretimi duhet të

	bëhet në raport me kategoritë përfituese dhe kriteret e miratuara nga bashkia.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Shërbimeve Sociale
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas kategorive përfituese (pensionistë, persona me aftësi të kufizuara, nxënës, studentë ose kategori të tjera), kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi nuk pasqyron vlerën financiare të subvencionimit dhe nuk mat intensitetin e përdorimit të transportit publik nga përfituesit.

D119 – NUMRI I PËRFITUESVE NGA SUBVENCIONIMI

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D119**
Emërtimi i të dhënës	**Numri i përfituesve nga subvencionimi**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i individëve që kanë përfituar subvencionim për përdorimin e transportit publik gjatë vitit raportues, në bazë të vendimeve të Këshillit Bashkiak ose akteve të tjera përkatëse.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e përfituesve të skemave të subvencionimit të transportit publik dhe të mbështesë monitorimin e politikave sociale të bashkisë.
Njësia matëse	Numër përfituesish
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në listat zyrtare të përfituesve dhe dokumentacionin e administrimit të skemave të subvencionimit.

Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave administrativë të përfituesve të subvencionimit, dokumentacionit financiar dhe vendimeve përkatëse të bashkisë.
Burimi i të dhënës	Lista e përfituesve dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për subvencionimin e transportit publik.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Shërbimeve Sociale
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas kategorive të përfituesve ose sipas llojit të subvencionimit, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Çdo individ raportohet vetëm një herë gjatë periudhës raportuese, edhe nëse përfiton më shumë se një formë subvencionimi për transportin publik.

23.7 NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E VARREZAVE PUBLIKE, SI DHE GARANTIMI I SHËRBIMIT PUBLIK TË VARRIMIT

Ky funksion përfshin planifikimin, ndërtimin, rehabilitimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe organizimin dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit në territorin e bashkisë. Funksioni synon të sigurojë ofrimin e një shërbimi publik të vazhdueshëm, dinjitoz dhe në përputhje me standardet ligjore, duke garantuar administrimin e qëndrueshëm të varrezave publike dhe plotësimin e nevojave të komunitetit.

Në kuadër të këtij funksioni, bashkia planifikon dhe administron varrezat publike, realizon investime për ndërtimin dhe rehabilitimin e tyre, organizon mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe hapësirave të përbashkëta, siguron disponueshmërinë e vendeve të varrimit, si dhe garanton ofrimin e shërbimit publik të varrimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë:

- kapacitetin dhe shtrirjen e varrezave publike;
- nivelin e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe hapësirave të varrezave;
- aksesin dhe cilësinë e shërbimit publik të varrimit;

- investimet dhe shpenzimet për administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike;
- efikasitetin e menaxhimit të këtij shërbimi nga bashkia.

237A01 – % E VARREZAVE ME MIRËMBAJTJE SIPAS PLANIT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**237A01**
Emërtimi i treguesit	**Përqindja e varrezave me mirëmbajtje sipas planit**
Shërbimi	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e zbatimit të planit vjetor të mirëmbajtjes së varrezave publike.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet përqindjen e njësive ose zonave të varrezave ku është kryer mirëmbajtja sipas planit vjetor, në raport me numrin total të njësive ose zonave që janë subjekt i këtij plani.
Rëndësia e treguesit	Treguesi mat shkallën e mbulimit të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe ndihmon në monitorimin e realizimit të planit të mirëmbajtjes, si edhe të cilësisë së administrimit të këtij shërbimi.
Formula e llogaritjes	**(D125/D126)×100**
Njësia matëse	%
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e varrezave publike ka përfituar mirëmbajtje sipas planit vjetor. Vlera 100% tregon realizimin e plotë të planit të mirëmbajtjes.
Frekuenca e raportimit	Vjetore

Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Shërbimit përgjegjëse për administrimin e varrezave publike.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas varrezave publike ose njësive administrative, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi mat realizimin e planit të mirëmbajtjes, por nuk vlerëson cilësinë ose intensitetin e ndërhyrjeve të kryera.

D125 – NJËSI/ZONË E MIRËMBAJTUR SIPAS PLANIT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D125**
Emërtimi i të dhënës	**Njësi/zonë e mirëmbajtur sipas planit**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i njësive ose zonave të varrezave ku është kryer mirëmbajtje sipas planit vjetor të miratuar gjatë vitit raportues.
Njësia matëse	Numër
Burimi i të dhënës	Plani vjetor i mirëmbajtjes, procesverbalet e punimeve dhe raportet e zbatimit.
Metoda e mbledhjes	Raportim teknik bazuar në regjistrin e mirëmbajtjes dhe dokumentacionin e realizimit të punimeve.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet planit vjetor të mirëmbajtjes, regjistrit të ndërhyrjeve të mirëmbajtjes, procesverbaleve të punimeve dhe raporteve të inspektimit në terren.
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Shërbimit
Frekuenca e raportimit	Vjetore

Disagregimi	Sipas njësisë administrative, varrezës dhe llojit të ndërhyrjes së mirëmbajtjes.
Kufizimet	Evidentimi mund të ndikohet nga mungesa e standardeve të unifikuara për klasifikimin e ndërhyrjeve të mirëmbajtjes.

SHËNIM METODOLOGJIK D125

Qëllimi i të dhënës

DSVR01 evidenton numrin e njësive ose zonave të varrezave ku është realizuar mirëmbajtja sipas planit vjetor të miratuar.

Çfarë konsiderohet "njësi/zonë e mirëmbajtur"?

Një njësi ose zonë konsiderohet e mirëmbajtur nëse:

- është përfshirë në planin vjetor të mirëmbajtjes;
- janë kryer ndërhyrje të dokumentuara, si pastrim, sistemim, kositje ose ndërhyrje në infrastrukturë;
- ekziston procesverbal ose dokumentacion tjetër që provon realizimin e ndërhyrjes.

Nuk përfshihen:

- zona që nuk janë pjesë e planit vjetor të mirëmbajtjes;
- ndërhyrje të rastësishme ose emergjente që nuk janë dokumentuar.

Metoda e mbledhjes

- Regjistri i mirëmbajtjes;
- Plani vjetor i punimeve.

D126 - NJËSI/ZONË TOTALE PËR MIRËMBAJTJE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D126**
Emërtimi i të dhënës	**Njësi/zonë totale për mirëmbajtje**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i njësive ose zonave të varrezave publike në administrim të bashkisë që janë subjekt i planit vjetor të mirëmbajtjes.
Njësia matëse	Numër

Burimi i të dhënës	Regjistri i varrezave.
Metoda e mbledhjes	Dokumentacion administrativ.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet planimetrisë së varrezave, regjistrit administrativ të varrezave dhe inventarit të njësive/zonave në administrim të bashkisë.
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Shërbimit
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Disagregimi	Sipas njësisë administrative
Kufizimet	Varet nga përditësimi i inventarit dhe planimetrisë së varrezave.

237A02 - KAPACITET I LIRË I VARREZAVE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	**237A02**
Emërtimi i treguesit	**Kapacitet i lirë i varrezave**
Shërbimi	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë kapacitetin e disponueshëm të varrezave publike për ofrimin e shërbimit të varrimit.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet përqindjen e vendeve ose parcelave të lira në raport me kapacitetin total të varrezave publike në administrim të bashkisë.

Rëndësia e treguesit	Treguesi ndihmon në planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë të kapaciteteve të varrezave publike, duke identifikuar nevojën për zgjerim, rehabilitim ose krijimin e varrezave të reja.
Formula e llogaritjes	**(D127/D128)×100**
Njësia matëse	%
Interpretimi	Një përqindje e lartë tregon se varrezat disponojnë ende kapacitet të lirë për varrime të reja. Një vlerë e ulët sinjalizon nevojën për planifikimin e zgjerimit ose identifikimin e kapaciteteve alternative.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për administrimin e varrezave publike.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas varrezave publike ose njësive administrative.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm kapacitetin fizik të disponueshëm dhe nuk pasqyron kufizime ligjore, fetare apo teknike që mund të ndikojnë në përdorimin e parcelave të lira.

D127 - VENDE/PARCELA TË LIRA

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D127**
Emërtimi i të dhënës	**Vende/parcela të lira**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i vendeve ose parcelave të disponueshme për përdorim në varrezat publike gjatë vitit raportues.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë kapacitetin aktual të lirë të varrezave publike dhe të mbështesë planifikimin e këtij shërbimi.
Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Regjistri administrativ i parcelave dhe kontrolli fizik në terren.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të parcelave të varrezave, planimetrisë së përditësuar dhe evidencave administrative mbi disponueshmërinë e vendeve të varrimit.
Burimi i të dhënës	Regjistri i parcelave / inventari fizik.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Shërbimit.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative
Kufizimet	Disponueshmëria mund të ndryshojë gjatë vitit dhe kërkon përditësim të vazhdueshëm të regjistrit.

D128 - KAPACITET TOTAL (VENDE/PARCELA)

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D128**
Emërtimi i të dhënës	**Kapacitet total (vende/parcela)**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i vendeve ose parcelave të planifikuara dhe të regjistruara në varrezat publike në administrim të bashkisë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë kapacitetin maksimal të varrezave publike dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e kapacitetit të lirë.

Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Regjistri administrativ i parcelave dhe planimetria e varrezave.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet planimetrisë së miratuar të varrezave, regjistrit të parcelave dhe inventarit fizik të kapaciteteve në administrim të bashkisë.
Burimi i të dhënës	Regjistri zyrtar i parcelave / planimetria e varrezave.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Shërbimit.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative
Kufizimet	Nuk pasqyron domosdoshmërisht kapacitetin real të përdorshëm nëse ka kufizime fizike ose ligjore.

SHENIM METODOLOGJIK – D128

Qëllimi i të dhënës

DSVR04 përfaqëson kapacitetin maksimal të varrezave publike në administrim të bashkisë dhe shërben si bazë për llogaritjen e përqindjes së kapacitetit të lirë.

Çfarë përfshihet?

- të gjitha vendet ose parcelat e planifikuara dhe të regjistruara në varrezat publike;
- parcelat në përdorim dhe ato ende të lira.

Nuk përfshihen

- parcelat jashtë administrimit të bashkisë;
- sipërfaqet e paplanifikuara ose të paformalizuara.

Metoda e verifikimit

- regjistri zyrtar i parcelave;
- planimetria e varrezave;
- kontrolli i konsistencës me inventarin fizik.

237A03 – KOHA MESATARE E PËRPUNIMIT TË NJË KËRKESE (DITË)

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**237A03**
Emërtimi i treguesit	**Koha mesatare e përpunimit të një kërkese**
Shërbimi	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë efikasitetin e bashkisë në përpunimin e kërkesave të qytetarëve për shërbimet që lidhen me varrezat publike dhe shërbimin e varrimit.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet numrin mesatar të ditëve kalendarike të nevojshme për përpunimin e një kërkese, nga data e paraqitjes së saj deri në përfundimin e procedurës.
Rëndësia e treguesit	Treguesi ndihmon në monitorimin e shpejtësisë së ofrimit të shërbimit dhe të efikasitetit administrativ të bashkisë.
Formula e llogaritjes	**D129/D130**
Njësia matëse	Ditë
Interpretimi	Një vlerë më e ulët tregon përpunim më të shpejtë të kërkesave dhe efikasitet më të lartë administrativ.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për administrimin e varrezave publike.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas llojit të kërkesës, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm kohën e përpunimit administrativ dhe nuk reflekton raste të vonesave të shkaktuara nga faktorë jashtë kontrollit të bashkisë.

D129 – TOTALI I DITËVE TË PËRPUNIMIT (SHUMATORJA)

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D129**
Emërtimi i të dhënës	**Totali i ditëve të përpunimit (shumatorja)**
Përshkrimi i të dhënës	Shuma e ditëve kalendarike të llogaritura nga data e paraqitjes së kërkesës deri në përfundimin e procedurës për të gjitha kërkesat e përpunuara gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të shërbejë si bazë për llogaritjen e kohës mesatare të përpunimit të kërkesave.
Njësia matëse	Ditë
Metoda e mbledhjes	Llogaritje administrative: **Data e përfundimit – Data e paraqitjes së kërkesës** për çdo kërkesë të përpunuar.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të kërkesave, protokollit administrativ dhe evidencave mbi datën e marrjes dhe datën e përfundimit të çdo kërkese.
Burimi i të dhënës	Regjistri i aplikimeve dhe dokumentacioni administrativ.
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Shërbimit

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Disagregimi	Sipas llojit të kërkesës dhe njësisë administrative.
Kufizimet	Saktësia varet nga regjistrimi korrekt i datës së marrjes dhe përfundimit të kërkesës.

D130 – NUMRI I KËRKESAVE TË PËRPUNUARA

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D130**
Emërtimi i të dhënës	**Numri i kërkesave të përpunuara**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i kërkesave për shërbimin e varrezave publike që janë përfunduar gjatë vitit raportues, pavarësisht datës së paraqitjes së tyre.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë volumin e kërkesave të përpunuara dhe të shërbejë si emërues për llogaritjen e kohës mesatare të përpunimit.
Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në regjistrin e aplikimeve dhe dokumentacionin e shërbimit.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të kërkesave, sistemit të menaxhimit të dokumenteve ose protokollit administrativ të bashkisë.
Burimi i të dhënës	Regjistri i aplikimeve / dokumentacioni administrativ.
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Shërbimit
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Disagregimi	Sipas llojit të kërkesës dhe njësisë administrative.
Kufizimet	Mund të mos pasqyrojë cilësinë ose kompleksitetin e shërbimit të ofruar.

23.9 PARQET, LULISHTET DHE HAPËSIRAT E GJELBRA PUBLIKE

Ky funksion përfshin planifikimin, krijimin, administrimin, rehabilitimin, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike në territorin e bashkisë. Funksioni synon të sigurojë ruajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës së gjelbër publike, përmirësimin e cilësisë së mjedisit, rritjen e aksesit të qytetarëve në hapësira rekreative dhe promovimin e një mjedisi të shëndetshëm e të qëndrueshëm.

Në kuadër të këtij funksioni, bashkia planifikon dhe administron parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike, realizon mbjellje dhe rehabilitime, organizon mirëmbajtjen periodike të tyre, si dhe ndërmerr masa për mbrojtjen, pasurimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të këtyre hapësirave.

Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë:

- shtrirjen e parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike;
- aksesin e popullsisë në këto hapësira;
- nivelin e mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të tyre;
- investimet dhe shpenzimet për administrimin e gjelbërimit publik;
- kontributin e bashkisë në përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe të jetesës së komunitetit.

239A01 – SIPËRFAQE E GJELBËR PUBLIKE PËR FRYMË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**239A01**
Emërtimi i treguesit	**Sipërfaqe e gjelbër publike për frymë**
Funksioni	**23.9 – Gjelbërimi i sipërfaqeve publike**
Shërbimi	Gjelbërimi i sipërfaqeve publike
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo

Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë sipërfaqen mesatare të gjelbër publike që është e disponueshme për çdo banor të bashkisë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet raportin ndërmjet sipërfaqes totale të hapësirave të gjelbra publike në administrim të bashkisë dhe popullsisë totale të bashkisë.
Rëndësia e treguesit	Treguesi pasqyron nivelin e aksesit potencial të popullsisë në hapësira të gjelbra publike dhe mbështet vlerësimin e cilësisë së mjedisit dhe të jetesës në territorin e bashkisë.
Kategoria e treguesit	Planifikim
Formula e llogaritjes	**D120 / D52**
Njësia matëse	m^2/banor
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se bashkia disponon më shumë sipërfaqe të gjelbër publike për banor. Megjithatë, treguesi duhet të interpretohet së bashku me shpërndarjen territoriale, aksesueshmërinë dhe gjendjen funksionale të hapësirave të gjelbra.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për gjelbërimin, shërbimet publike ose administrimin e territorit.
Metoda e verifikimit	Regjistri i aseteve publike, të dhënat GIS, planimetritë zyrtare, dokumentacioni kadastral dhe verifikimi selektiv në terren.
Disagregimi	Sipas njësive administrative, zonave urbane dhe rurale ose kategorive të hapësirave të gjelbra, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	Treguesi paraqet një mesatare për të gjithë popullsinë dhe nuk tregon nëse hapësirat e gjelbra janë të shpërndara në mënyrë të barabartë ose lehtësisht të aksesueshme nga të gjithë banorët. Rezultati ndikohet

	gjithashtu nga saktësia e matjes së sipërfaqeve dhe e të dhënave të popullsisë.

D120 - SIPËRFAQJA TOTALE E GJELBËR PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D120**
Emërtimi i të dhënës	**Sipërfaqja totale e gjelbër publike**
Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja totale e hapësirave të gjelbra publike që janë në pronësi ose administrim të bashkisë, të destinuara për përdorim publik, me mbulesë bimore dhe të aksesueshme për qytetarët.
Çfarë përfshihet	Parqet urbane, lulishtet, hapësirat e gjelbra përgjatë rrugëve, sheshet me gjelbërim, parqet rekreative dhe zonat e gjelbra rurale në administrim publik.
Çfarë nuk përfshihet	Pyjet shtetërore, toka bujqësore private, gjelbërimi privat, zonat që nuk janë të përcaktuara për përdorim publik dhe sipërfaqet me funksion vetëm estetik brenda objekteve publike.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë sipërfaqen totale të gjelbër publike në administrim të bashkisë dhe të shërbejë si bazë për llogaritjen e treguesve për frymë, të mbulimit dhe të kostos për m².
Njësia matëse	m²
Metoda e mbledhjes	Metoda e rekomanduar është matja përmes GIS-it, duke identifikuar poligonet e hapësirave të gjelbra dhe duke agreguar sipërfaqen e tyre. Në mungesë të GIS-it, mund të përdoren planimetritë urbane të miratuara ose regjistri i aseteve të gjelbra.
Burimi i të dhënës	Sistemi GIS, regjistri i aseteve publike, planimetritë zyrtare dhe dokumentacioni i administrimit të territorit.
Metoda e verifikimit	Krahasim me regjistrin e aseteve, kontroll konsistence me planin urbanistik, dokumentim i poligoneve GIS dhe verifikim selektiv në terren.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për gjelbërimin, administrimin e territorit ose asetet publike.
Disagregimi	Sipas njësive administrative, zonave urbane dhe rurale ose llojit të hapësirës së gjelbër.
Kufizimet	Ekziston rreziku i mbivlerësimit, përfshirjes së sipërfaqeve jo të aksesueshme dhe ndryshimit të metodës së matjes nga një vit në tjetrin. Metoda dhe burimi i matjes duhet të dokumentohen dhe të ruhen të njëjta ndër vite.

SHËNIM METODOLOGJIK – E DHËNA D120

Qëllimi i të dhënës: DSGJ01 mat sipërfaqen totale të hapësirave të gjelbra publike në administrim të bashkisë, si bazë për llogaritjen e treguesve për frymë, përqindjes së mbulimit dhe kostos për m².

Çfarë konsiderohet "sipërfaqe e gjelbër publike"? Sipërfaqe e gjelbër publike konsiderohet çdo hapësirë: Në pronësi ose administrim të bashkisë; E destinuar për përdorim publik; Me mbulesë bimore (bar, pemë, shkurre); E aksesueshme për qytetarët.
Çfarë përfshihet: Parqe urbane; Lulishtet; Hapësira të gjelbra përgjatë rrugëve; Sheshe me gjelbërim; Parqe rekreative; Zona të gjelbra rurale në administrim publik.

Çfarë NUK përfshihet: Pyje shtetërore; Tokë bujqësore private; Zona të papërcaktuara si hapësira publike; Gjelbërim privat; Sipërfaqe me funksion vetëm estetik brenda objekteve publike.
Metoda e matjes: Metoda e rekomanduar – GIS
Identifikohen poligonet e hapësirave të gjelbra në hartë;
Llogaritet sipërfaqja për secilin poligon;
Agregohen në m².

Alternativë
Përdorim i planimetrive urbane të miratuara;
Regjistër i aseteve të gjelbra.

Metoda e verifikimit
Krahasim me regjistrin e aseteve;

Kontroll konsistence me planin urbanistik;
Verifikim selektiv në terren;
Dokumentim i poligoneve GIS.

Risk metodologjik
Mbivlerësim i sipërfaqeve;
Përfshirje e zonave jo-aksesueshme;
Ndryshim i metodës së matjes nga viti në vit.

Rekomandohet:
Mbajtja konstante e metodës;
Dokumentimi i burimit të matjes.

D 52 POPULLSIA E BASHKISË

E dhena eshte shtjelluar me lart

239A02 - SIPËRFAQJA PUBLIKE E MBULUAR ME GJELBËRIM

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**239A02**
Emërtimi i treguesit	**Sipërfaqja publike e mbuluar me gjelbërim**
Shërbimi	Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë peshën që zënë hapësirat e gjelbra në raport me sipërfaqen totale publike të bashkisë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet përqindjen e sipërfaqes publike të bashkisë që është e mbuluar me gjelbërim.
Rëndësia e treguesit	Treguesi ndihmon në vlerësimin e nivelit të gjelbërimit të hapësirave publike dhe mbështet planifikimin urban, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit.

Formula e llogaritjes	**(D120/D113)×100**
Njësia matëse	%
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e sipërfaqeve publike është e mbuluar me gjelbërim. Rezultati duhet të interpretohet së bashku me treguesit për sipërfaqen e gjelbër për frymë dhe shpërndarjen territoriale të hapësirave të gjelbra.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e gjelbërimit dhe aseteve publike.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative ose sipas zonave urbane dhe rurale, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm peshën relative të gjelbërimit dhe nuk jep informacion mbi cilësinë, mirëmbajtjen ose aksesueshmërinë e hapësirave të gjelbra.

D120 - SIPËRFAQE TOTALE PUBLIKE E BASHKISË E GJELBERUAR

D113 - SIPERFAQE PUBLIKE E BASHKISE

239A03 - SHKALLA E MIRËMBAJTJES

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	**239A03**
Emërtimi i treguesit	**Shkalla e mirëmbajtjes**

Shërbimi	Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë përqindjen e sipërfaqeve të gjelbra publike ku është kryer mirëmbajtje gjatë vitit raportues.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet raportin ndërmjet sipërfaqes së gjelbër publike ku është kryer mirëmbajtje dhe sipërfaqes totale të gjelbër publike në administrim të bashkisë.
Rëndësia e treguesit	Treguesi vlerëson mbulimin e shërbimit të mirëmbajtjes së gjelbërimit publik dhe ndihmon në monitorimin e performancës operacionale të bashkisë.
Formula e llogaritjes	**(D122/D120)×100**
Njësia matëse	%
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e sipërfaqeve të gjelbra publike është mirëmbajtur gjatë vitit. Vlera duhet të interpretohet së bashku me cilësinë dhe frekuencën e ndërhyrjeve të mirëmbajtjes.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Mjedisit / Drejtoria e Shërbimeve Publike
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	Treguesi mat mbulimin e mirëmbajtjes, por nuk vlerëson cilësinë ose intensitetin e ndërhyrjeve të kryera.

D122 - SIPËRFAQE E MIRËMBAJTUR GJATË VITIT	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D122**
Emërtimi i të dhënës	**Sipërfaqe e mirëmbajtur gjatë vitit**
Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike ku është kryer mirëmbajtje efektive gjatë vitit raportues.
Njësia matëse	m^2
Burimi i të dhënës	Procesverbale, kontrata mirëmbajtjeje dhe raportime teknike.
Metoda e mbledhjes	Raportim teknik dhe administrativ mbi sipërfaqet ku janë kryer ndërhyrje të dokumentuara.
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Mjedisit / Drejtoria e Shërbimeve Publike
Frekuenca e raportimit	Vjetore

SHENIM METODOLOGJIK D122

Qëllimi i të dhënës

DSGJ04 mat sipërfaqen e hapësirave të gjelbra publike ku është kryer mirëmbajtje efektive gjatë vitit raportues. Ai reflekton nivelin e aktivitetit operacional dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit të gjelbërimit.

Çfarë konsiderohet “sipërfaqe e mirëmbajtur”?

Sipërfaqe e mirëmbajtur konsiderohet ajo zonë e gjelbër ku gjatë vitit raportues është kryer të paktën një nga ndërhyrjet e mëposhtme:
Kositje periodike; Ujitje sistematike; Krasitje pemësh/shkurresh; Zëvendësim bimësh; Plehërim ose trajtim fitosanitar; Pastrim dhe sistemim i sipërfaqes.

Nuk konsiderohet mirëmbajtje: Inspektim pa ndërhyrje; Ndërhyrje të rastësishme pa dokumentim; Vetëm mbjellje e re pa mirëmbajtje pasuese.

Rregull për përfshirjen e sipërfaqes: Një sipërfaqe mund të konsiderohet e mirëmbajtur nëse: Ka evidencë dokumentare të ndërhyrjes; Është pjesë e planit vjetor të mirëmbajtjes; Është përfshirë në kontratën e shërbimit (nëse ka operator të jashtëm).
Nëse e njëjta sipërfaqe mirëmbahet disa herë gjatë vitit, ajo numërohet vetëm një herë (në m² totale), jo sa herë është ndërhyrë.

Metoda e matjes Metoda e rekomanduar – GIS
Identifikohen poligonet e mirëmbajtura;
Verifikohet ndërhyrja sipas regjistrit;
Llogaritet sipërfaqja totale në m².

Alternativë
Regjistër administrativ i zonave të mirëmbajtura;
Plan vjetor mirëmbajtjeje me sipërfaqe të specifikuara.

Metoda e verifikimit
Verifikimi kryhet përmes: Procesverbaleve të punimeve; Kontratave të mirëmbajtjes; Raporteve mujore të ndërhyrjes; Kontrollit selektiv në terren;
Krahasimit me DSGJ01 (nuk mund të tejkalojë sipërfaqen totale të gjelbër).

Risk metodologjik (DQA)
Raportim i gjithë sipërfaqes si “e mirëmbajtur” pa ndërhyrje reale;
Numërim i dyfishtë i së njëjtës sipërfaqe;
Ndryshim metodologjie nga viti në vit;
Përfshirje e zonave jo funksionale.
Rekomandohet:
Evidencë fotografike selektive;
Regjistër elektronik i ndërhyrjeve;
Dokumentim i metodës së llogaritjes.

D120 - SIPËRFAQJA TOTALE E GJELBËR PUBLIKE

Shtjelluar me lart si e dhene

239A04 - SHPENZIM PËR M² GJELBËRIM

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**239A04**
Emërtimi i treguesit	**Shpenzim për m² gjelbërim**

Shërbimi	Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e shpenzimeve të bashkisë për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e hapësirave të gjelbra në raport me sipërfaqen totale të tyre.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet shpenzimin mesatar të kryer për çdo metër katror të sipërfaqes së gjelbër publike gjatë periudhës raportuese.
Rëndësia e treguesit	Treguesi ndihmon në vlerësimin e efikasitetit financiar të shërbimit dhe krijon mundësi për krahasimin e kostove ndërmjet bashkive dhe ndërmjet viteve.
Formula e llogaritjes	**D123/D120**
Njësia matëse	Lekë/m²
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon më shumë shpenzime për njësi sipërfaqeje. Interpretimi duhet të bëhet së bashku me treguesit e shkallës së mirëmbajtjes, cilësinë e shërbimit dhe karakteristikat e hapësirave të gjelbra.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për gjelbërimin publik.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm nivelin e shpenzimeve financiare dhe nuk pasqyron cilësinë ose efektivitetin e ndërhyrjeve të kryera.

D123 - SHPENZIME TOTALE PËR GJELBËRIM	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D123**
Emërtimi i të dhënës	**Shpenzime totale për gjelbërim**
Përshkrimi i të dhënës	Totali i shpenzimeve të kryera gjatë vitit për mirëmbajtjen, administrimin dhe zhvillimin e parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë burimet financiare të përdorura për ofrimin e shërbimit të gjelbërimit publik dhe të shërbejë si bazë për llogaritjen e kostos për m².
Njësia matëse	Lekë
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ nga sistemi financiar i bashkisë.
Burimi i të dhënës	Drejtoria e Financës.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Financës.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	Të dhënat duhet të përfshijnë vetëm shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me funksionin "Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike", duke shmangur përfshirjen e shpenzimeve për funksione të tjera të shërbimeve publike.

SHËNIMIN METODOLOGJIK TË D123

Çfarë përfshihet: shpenzimet për mirëmbajtje (kositje, krasitje, ujitje, plehërim, trajtime fitosanitare), zhvillim të hapësirave të gjelbra (mbjellje të reja, rehabilitime), materiale, kontrata shërbimi dhe personel kur evidentohet drejtpërdrejt për këtë funksion.

Çfarë nuk përfshihet: investimet për funksione të tjera, shpenzimet administrative të përgjithshme dhe kostot që nuk mund të atribuohen drejtpërdrejt shërbimit të gjelbërimit.

Rrezik metodologjik: ndryshimet në klasifikimin buxhetor ose shpërndarjen e kostove ndërmjet funksioneve mund të ndikojnë në krahasueshmërinë e treguesit ndërmjet bashkive dhe ndërmjet viteve.

D120 - SIPËRFAQJA TOTALE E GJELBËR PUBLIKE

Shtjelluar me lart si e dhene

239A05 - NUMRI I PEMËVE TË MBJELLA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**239A05**
Emërtimi i treguesit	**Numri i pemëve të mbjella**
Shërbimi	Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike
Pjesë e SMP Kombëtare	**Jo**
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë zgjerimin dhe rigjenerimin e fondit të gjelbër publik përmes mbjelljes së pemëve të reja gjatë vitit raportues.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet numrin total të pemëve të mbjella nga bashkia ose nëpërmjet kontratave të realizuara në kuadër të zhvillimit dhe rehabilitimit të hapësirave të gjelbra publike gjatë periudhës raportuese.
Rëndësia e treguesit	Treguesi ndihmon në vlerësimin e përpjekjeve të bashkisë për shtimin e gjelbërimit publik, përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe rritjen e rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike.

Formula e llogaritjes	**D124**
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një numër më i lartë tregon një nivel më të madh të investimeve dhe ndërhyrjeve për zgjerimin ose rehabilitimin e gjelbërimit publik. Interpretimi duhet të bëhet së bashku me shkallën e mbijetesës së pemëve dhe sipërfaqet e gjelbëruara.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Shërbimeve Publike / Drejtoria përgjegjëse për gjelbërimin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas njësive administrative, llojit të pemës ose zonës së mbjelljes, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e pemëve të mbjella dhe nuk pasqyron gjendjen e tyre, shkallën e mbijetesës apo ndikimin afatgjatë në fondin e gjelbër.

D124 – NUMRI I PEMËVE TË MBJELLA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D124**
Emërtimi i të dhënës	**Numri i pemëve të mbjella**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i pemëve të mbjella gjatë vitit raportues në parqe, lulishte dhe hapësira të tjera të gjelbra publike në administrim të bashkisë.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë ndërhyrjet për shtimin dhe rigjenerimin e fondit të gjelbër publik dhe të mbështesë monitorimin e investimeve në gjelbërim.
Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Raportim teknik bazuar në procesverbalet e marrjes në dorëzim të punimeve, kontratat e shërbimit, raportet e mbikëqyrjes dhe evidencat e strukturës përgjegjëse për gjelbërimin.
Burimi i të dhënës	Procesverbalet e punimeve, kontratat dhe raportet teknike të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Shërbimeve Publike / Drejtoria përgjegjëse për gjelbërimin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas llojit të pemës, njësisë administrative ose projektit të investimit.
Kufizimet	Raportohen vetëm pemët e mbjella gjatë vitit raportues. Nuk përfshihen pemët ekzistuese ose ato të zëvendësuara nëse nuk dokumentohen si mbjellje të reja.

23.10 MBLEDHJA, LARGIMI DHE TRAJTIMI I MBETJEVE TË NGURTA DHE SHTËPIAKE

Ky funksion përfshin organizimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimit publik të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe shtëpiake në territorin e bashkisë. Ai synon të sigurojë mbledhjen, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve në mënyrë të sigurt, efikase dhe të qëndrueshme, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe ekonominë qarkulluese.

Në kuadër të këtij funksioni, bashkia planifikon dhe organizon shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, siguron mbulimin e zonave urbane dhe rurale me shërbim, administron kontratat e ofrimit të shërbimit kur ky delegohet, monitoron cilësinë dhe vazhdimësinë e shërbimit,

planifikon investimet në infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve dhe administron sistemin e tarifave për mbulimin e kostove të shërbimit.
Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë:

- mbulimin e territorit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve;
- efikasitetin e ofrimit të shërbimit dhe nivelin e mbetjeve të gjeneruara;
- qëndrueshmërinë financiare të shërbimit përmes mbulimit të kostove nga tarifat;
- ekzistencën dhe zbatimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve si instrumenti kryesor i planifikimit strategjik.

2310A01 – MBULIMI I POPULLSISË ME SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË ZONAT URBANE/RURALE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2310A01
Emërtimi i treguesit	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale
Shërbimi	Menaxhimi i mbetjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë shkallën e mbulimit të territorit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane dhe rurale, sipas metodologjisë së Sistemit të Monitorimit të Performancës.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat mbulimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në nivel bashkie, duke kombinuar mbulimin e qendrave administrative urbane dhe të fshatrave. Rezultati paraqitet si mesatarja e dy përqindjeve të mbulimit.
Rëndësia e treguesit	Treguesi vlerëson shtrirjen territoriale të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe mundëson monitorimin e aksesit në këtë shërbim në zonat urbane dhe rurale.
Formula	((D54/D55) × 100 + (D56/D57) × 100) / 2

Njësia matëse	%
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një mbulim më të gjerë të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë. Vlera 100% tregon se të gjitha qendrat administrative urbane dhe të gjitha fshatrat janë të mbuluara me shërbim.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve
Disagregimi	Urban / Rural
Metoda e verifikimit	DQA e formulës
Kufizimet	Treguesi llogaritet sipas metodologjisë së SMP-së duke përdorur mbulimin e qendrave administrative urbane dhe të fshatrave.

D54 – NUMRI I QENDRAVE ADMINISTRATIVE URBANE TË MBULUARA ME SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D54**
Emërtimi i të dhënës	Numri i qendrave administrative urbane të mbuluara me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve
Përshkrimi i të dhënës	Numri i qendrave administrative urbane në territorin e bashkisë ku ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë shtrirjen e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane dhe të shërbejë si bazë për llogaritjen e treguesit të mbulimit.

Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në zonat ku shërbimi ofrohet sipas organizimit të bashkisë ose kontratës së shërbimit.
Metoda E Verifikimit	
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve, kontratat e shërbimit, planet operative të mbledhjes së mbetjeve.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	
Kufizimet	

D55 – NUMRI TOTAL I QENDRAVE ADMINISTRATIVE URBANE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D55**
Emërtimi i të dhënës	Numri total i qendrave administrative urbane
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i qendrave administrative urbane në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të shërbejë si emërues për llogaritjen e mbulimit të shërbimit në zonat urbane.
Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ.

Metoda e Verifikimit	
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	
Kufizimet	

D56 – NUMRI I FSHATRAVE TË MBULUARA ME SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D56**
Emërtimi i të dhënës	Numri i fshatrave të mbuluara me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve
Përshkrimi i të dhënës	Numri i fshatrave ku ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë shtrirjen e shërbimit në zonat rurale dhe të shërbejë si bazë për llogaritjen e treguesit të mbulimit.
Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në zonat ku ofrohet shërbimi sipas planit operacional ose kontratës së shërbimit.
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve, operatori i shërbimit, kontratat dhe planet operative.
Metoda e Verifikimit	

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	
Kufizimet	

D57 - NUMRI TOTAL I FSHATRAVE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D57**
Emërtimi i të dhënës	Numri total i fshatrave
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i fshatrave në territorin administrativ të bashkisë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të shërbejë si emërues për llogaritjen e mbulimit të shërbimit në zonat rurale.
Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ.
Metoda e Verifikimit	
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	
Kufizimet	

2310A02 - MBETJET E GJENERUARA SI KG/BANOR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**2310A02**
Emërtimi i treguesit	**Mbetjet e gjeneruara si kg/banor**
Shërbimi	Menaxhimi i mbetjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	**Po**
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë sasinë mesatare të mbetjeve të gjeneruara për banor gjatë vitit raportues.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet sasinë mesatare të mbetjeve të ngurta të gjeneruara për çdo banor në territorin e bashkisë gjatë një viti.
Rëndësia e treguesit	Treguesi ndihmon në vlerësimin e nivelit të gjenerimit të mbetjeve, planifikimin e kapaciteteve të shërbimit dhe monitorimin e politikave për reduktimin dhe menaxhimin e mbetjeve.
Formula	**D58 / D52**
Njësia matëse	**kg/banor**
Interpretimi	Vlera tregon sasinë mesatare të mbetjeve të gjeneruara për banor gjatë vitit. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë karakteristikat territoriale, sezonin turistik dhe aktivitetin ekonomik të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve
Disagregimi	Nuk aplikohet
Metoda e verifikimit	DQA e formulës
Kufizimet	Treguesi mbështetet në saktësinë e të dhënave mbi sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe popullsinë totale të bashkisë.

D58 – SASIA TOTALE E MBETJEVE TË NGURTA TË GJENERUARA GJATË VITIT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D58**
Emërtimi i të dhënës	**Sasia totale e mbetjeve të ngurta të gjeneruara gjatë vitit**
Përshkrimi i të dhënës	Sasia totale e mbetjeve të ngurta urbane të gjeneruara në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues, e shprehur në kilogramë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të shërbejë si bazë për llogaritjen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara për banor dhe për monitorimin e performancës së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.
Njësia matëse	Kilogram (kg)
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në regjistrat e operatorit të shërbimit, peshimet në pikat e grumbullimit ose në landfill dhe dokumentacionin përkatës.
Metoda e Verfikimit	
Institucioni përgjegjës	Operatori i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, regjistrat e peshimit, dokumentacioni i landfillit ose i impiantit të trajtimit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore

Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	
Kufizimet	

E DHËNA D52 (POPULLSIA TOTALE E BASHKISË) ËSHTË SHTJELLUAR MË LART NË MANUAL.

2310A03 - MBULIMI I KOSTOS SË MENAXHIMIT TË MBETJEVE NGA TARIFA E SHËRBIMIT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**2310A03**
Emërtimi i treguesit	**Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit**
Shërbimi	Menaxhimi i mbetjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	**Po**
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë shkallën në të cilën të ardhurat nga tarifa e shërbimit mbulojnë kostot e menaxhimit të mbetjeve.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet raportin ndërmjet të ardhurave të arkëtuara nga tarifa e menaxhimit të mbetjeve dhe shpenzimeve totale për ofrimin e këtij shërbimi gjatë vitit raportues.
Rëndësia e treguesit	Treguesi vlerëson qëndrueshmërinë financiare të shërbimit dhe ndihmon bashkinë të monitorojë nivelin e mbulimit të kostove nga tarifat e shërbimit.
Formula	**(D59 / D60) × 100**
Njësia matëse	%

Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të mirë të mbulimit të kostove të shërbimit nga të ardhurat e arkëtuara. Vlera 100% tregon mbulim të plotë të kostove nga tarifa e shërbimit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për financat.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Metoda e verifikimit	DQA e formulës
Kufizimet	Treguesi nuk merr në konsideratë burime të tjera financimi, si transfertat ose grantet, të përdorura për financimin e shërbimit.

D59 – TË ARDHURAT E ARKËTUARA NGA TARIFA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	**D59**
Emërtimi i të dhënës	**Të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e menaxhimit të mbetjeve**
Përshkrimi i të dhënës	Vlera totale e të ardhurave të arkëtuara nga tarifa e menaxhimit të mbetjeve gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e arkëtimeve nga tarifa e shërbimit dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e mbulimit të kostove.
Njësia matëse	Lekë
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në regjistrat financiarë dhe sistemin e arkëtimeve të bashkisë.

Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet sistemit të administrimit të taksave dhe tarifave vendore, regjistrit të arkëtimeve, pasqyrave financiare dhe dokumentacionit kontabël të bashkisë.
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Financave, sistemi i taksave dhe tarifave vendore.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Mund të disagregohet sipas kategorisë së tarifapaguesve (familje, biznese, institucione), njësisë administrative ose operatorit të shërbimit, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Përfshihen vetëm të ardhurat e arkëtuara gjatë periudhës raportuese. Nuk përfshihen detyrimet e papaguara, kamatëvonesat ose të ardhurat e planifikuara që nuk janë arkëtuar.

D60 – SHPENZIMET TOTALE PËR SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D60**
Emërtimi i të dhënës	**Shpenzimet totale për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve**
Përshkrimi i të dhënës	Vlera totale e shpenzimeve të kryera për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë koston totale të shërbimit dhe të shërbejë si emërues për llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	Lekë
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në pasqyrat financiare dhe raportet e ekzekutimit të buxhetit.

Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet sistemit të menaxhimit financiar, raporteve të ekzekutimit të buxhetit, dokumentacionit kontabël të bashkisë dhe, sipas rastit, dokumentacionit financiar të operatorit të kontraktuar.
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Financave, raportet financiare të bashkisë dhe, sipas rastit, raportet e operatorit të kontraktuar.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Mund të disagregohet sipas natyrës së shpenzimeve (mbledhje, transport, trajtim, depozitim, administrim), burimit të financimit ose njësisë administrative, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Përfshihen vetëm shpenzimet e realizuara dhe të regjistruara gjatë periudhës raportuese. Nuk përfshihen angazhimet financiare të papaguara ose kostot që nuk janë regjistruar në funksionin përkatës buxhetor.

2310A04 – PLANI VENDOR I MENAXHIMIT TË MBETJEVE I MIRATUAR OSE NË ZBATIM

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	**2310A04**
Emërtimi i treguesit	**Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve i miratuar ose në zbatim**
Shërbimi	Menaxhimi i mbetjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	**Po**
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë nëse bashkia disponon një Plan Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve të miratuar dhe në zbatim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përshkrimi i treguesit	Treguesi vlerëson statusin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve si instrumenti kryesor strategjik për planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor.
Rëndësia e treguesit	Treguesi mat kapacitetin planifikues të bashkisë dhe mbështet monitorimin e zbatimit të politikave vendore për menaxhimin e mbetjeve.
Formula	**D61**
Njësia matëse	Po / Jo *(ose sipas kodifikimit të SMP-së)*
Interpretimi	Vlera pozitive tregon që bashkia ka një Plan Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve të miratuar dhe/ose në zbatim, ndërsa vlera negative tregon mungesën e këtij dokumenti ose moszbatimin e tij.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve
Disagregimi	Nuk aplikohet
Metoda e verifikimit	Verifikim dokumentar
Kufizimet	Treguesi evidenton ekzistencën dhe statusin e planit, por nuk mat nivelin apo cilësinë e zbatimit të tij.

D61 – STATUSI I PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	**D61**
Emërtimi i të dhënës	**Statusi i Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve**

Përshkrimi i të dhënës	Evidenton nëse bashkia ka një Plan Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve të miratuar dhe/ose në zbatim gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të verifikojë ekzistencën dhe statusin e instrumentit strategjik për planifikimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.
Njësia matëse	Po / Jo *(ose sipas kodifikimit të SMP-së)*
Metoda e mbledhjes	Verifikim administrativ i dokumentacionit zyrtar të bashkisë.
Metoda e Verifikimit	Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e planit, dokumenti i planit dhe dokumentacioni që provon zbatimin e tij.
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	E dhëna evidenton ekzistencën dhe statusin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve, por nuk vlerëson cilësinë, nivelin e zbatimit apo efektivitetin e masave të parashikuara në plan.

FUNKSIONI 23.11 NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E GODINAVE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE

Në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ky funksion përfshin ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.

Ky funksion mat performancën e bashkisë në sigurimin e infrastrukturës arsimore funksionale, të mirëmbajtur dhe të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve arsimore parauniversitare.

TREGUESI 2311A01: ÇERDHE TË MIRËMBAJTURA KUNDREJT NUMRIT TOTAL TË ÇERDHEVE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2311A01
Shërbimi	Çerdhet
Pjesë e SMP Kombetare	Jo
Qellimi i treguesit	Përmirësimi i cilësisë, sigurisë dhe funksionalitetit të infrastrukturës së çerdheve publike nëpërmjet mirëmbajtjes sistematike të objekteve.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e çerdheve publike në administrim të bashkisë që kanë përfituar punime mirëmbajtjeje gjatë vitit raportues, kundrejt numrit total të çerdheve publike funksionale. Ai vlerëson shkallën e mbulimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës së arsimit të hershëm dhe aftësinë e bashkisë për të garantuar kushte të përshtatshme për ofrimin e shërbimit.
Rëndësia e treguesit	Mirëmbajtja periodike e objekteve arsimore është një nga kushtet bazë për ofrimin e një shërbimi cilësor dhe të sigurt për fëmijët. Ky tregues ndihmon në monitorimin e përmbushjes së përgjegjësive të bashkisë për administrimin e infrastrukturës së çerdheve publike dhe mund të përdoret për planifikimin e investimeve dhe mirëmbajtjes.
Formula e llogaritjes	(D01 ÷ D32) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Vlera më e lartë e treguesit tregon mbulim më të mirë të mirëmbajtjes së çerdheve publike. Vlera 100% nënkupton se të gjitha çerdhet publike kanë përfituar mirëmbajtje gjatë vitit raportues.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për Arsimin dhe administrimin e objekteve arsimore.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative (kur aplikohet).
Kufizimet	Treguesi mat mbulimin e mirëmbajtjes dhe nuk vlerëson cilësinë, vlerën financiare ose kompleksitetin e punimeve të kryera.

D01 NUMRI I ÇERDHEVE PUBLIKE TË MIRËMBAJTURA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D01
Emërtimi i të dhënës	**Numri i çerdheve publike të mirëmbajtura**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i çerdheve publike në administrim të bashkisë për të cilat gjatë vitit raportues janë kryer punime mirëmbajtjeje parandaluese ose korrigjuese me qëllim ruajtjen e funksionalitetit dhe sigurisë së objektit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e çerdheve publike ku gjatë periudhës raportuese janë kryer ndërhyrje mirëmbajtjeje dhe të mundësojë monitorimin e gjendjes së infrastrukturës parashkollore.
Metoda e mbledhjes	Evidencat administrative të mirëmbajtjes së objekteve arsimore, kontratat, procesverbalet e punimeve dhe raportet teknike të njësisë përgjegjëse.
Metoda e verifikimit	Krahasimi me kontratat e mirëmbajtjes, procesverbalet e marrjes në dorëzim të punimeve, faturat, situacionet dhe dokumentacionin teknik të investimeve ose mirëmbajtjes.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për Arsimin dhe administrimin e objekteve arsimore në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative.
Kufizimet	Përfshihen vetëm çerdhet publike ku janë dokumentuar ndërhyrje mirëmbajtjeje. Nuk pasqyrohet shkalla apo cilësia e mirëmbajtjes.

D32 NUMRI I ÇERDHEVE PUBLIKE NË BASHKI

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D32
Emërtimi i të dhënës	Numri i çerdheve publike në bashki
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i çerdheve publike funksionale në administrim të bashkisë në fund të vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e godinave të çerdheve publike në administrim të bashkisë dhe të mundësojë monitorimin e kapaciteteve të infrastrukturës parashkollore.
Metoda e mbledhjes	Regjistri administrativ i institucioneve parashkollore të administruara nga bashkia dhe evidencat vjetore të sektorit përgjegjës për arsimin.

Metoda e verifikimit	Krahasimi me regjistrin zyrtar të institucioneve, vendimet administrative për hapjen ose mbylljen e institucioneve dhe inventarin e objekteve publike.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për Arsimin pranë bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative.
Kufizimet	Pasqyron vetëm numrin e godinave dhe nuk vlerëson gjendjen fizike, kapacitetin ose shkallën e përdorimit të tyre.

TREGUESI 2311A02: KOPSHTE TË MIRËMBAJTURA KUNDREJT NUMRIT TOTAL TË KOPSHTEVE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2311A02
Shërbimi	Arsimi Parashkollor
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e kopshteve publike në administrim të bashkisë që kanë përfituar punime mirëmbajtjeje gjatë vitit raportues, kundrejt numrit total të kopshteve publike funksionale. Treguesi vlerëson nivelin e mirëmbajtjes së infrastrukturës së kopshteve publike dhe aftësinë e bashkisë për të garantuar kushte të përshtatshme dhe të sigurta për zhvillimin e procesit edukativ.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë performancën e bashkisë në mirëmbajtjen e objekteve të arsimit parashkollor dhe të mbështesë planifikimin e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve publike.
Formula e llogaritjes	(D02 / D34) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Rritja e vlerës së treguesit tregon një nivel më të lartë të mbulimit të mirëmbajtjes së kopshteve publike. Vlera 100% tregon se të gjitha kopshtet publike funksionale kanë përfituar mirëmbajtje gjatë vitit raportues.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin dhe administrimin e objekteve arsimore në bashki.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Treguesi mat mbulimin e mirëmbajtjes së kopshteve publike, por nuk vlerëson cilësinë, vlerën financiare apo llojin e ndërhyrjeve të realizuara.

D02 NUMRI I KOPSHTEVE PUBLIKE TË MIRËMBAJTURA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D02
Emërtimi i të dhënës	Numri i kopshteve publike të mirëmbajtura
Përshkrimi i të dhënës	Numri i kopshteve publike në administrim të bashkisë për të cilat gjatë vitit raportues janë realizuar punime mirëmbajtjeje parandaluese ose korrigjuese, me qëllim ruajtjen ose përmirësimin e kushteve funksionale dhe të sigurisë së objektit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e kopshteve publike ku janë kryer ndërhyrje mirëmbajtjeje gjatë periudhës raportuese dhe të mundësojë monitorimin e gjendjes së infrastrukturës parashkollore.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat administrativë të bashkisë mbi mirëmbajtjen e objekteve arsimore, kontratat e mirëmbajtjes dhe raportet teknike të punimeve të realizuara.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kontratave të mirëmbajtjes, procesverbaleve të marrjes në dorëzim të punimeve, situacioneve të punimeve, faturave dhe dokumentacionit teknik përkatës.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin dhe administrimin e objekteve arsimore në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative.
Kufizimet	Përfshihen vetëm kopshtet publike ku janë dokumentuar ndërhyrje mirëmbajtjeje. Nuk pasqyrohet lloji, cilësia apo vlera e ndërhyrjeve të kryera.

D34 NUMRI I KOPSHTEVE PUBLIKE NË BASHKI

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D34

Emërtimi i të dhënës	**Numri i kopshteve publike në bashki**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i kopshteve publike funksionale në administrim të bashkisë në fund të vitit raportues. Në këtë numër përfshihen vetëm institucionet publike që ofrojnë shërbimin e arsimit parashkollor dhe janë funksionale gjatë periudhës së raportimit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e godinave të kopshteve publike dhe të mundësojë monitorimin e kapaciteteve të infrastrukturës parashkollore.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistri administrativ i institucioneve parashkollore dhe evidencat vjetore të bashkisë mbi institucionet publike të arsimit parashkollor.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit zyrtar të institucioneve, vendimeve administrative për hapjen ose mbylljen e institucioneve dhe inventarit të objekteve publike.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative.
Kufizimet	Pasqyron vetëm numrin e godinave dhe nuk vlerëson gjendjen fizike, kapacitetin ose nivelin e përdorimit të tyre.

TREGUESI 2311B01: SHKOLLA 9-VJEÇARE PUBLIKE TË MIRËMBAJTURA KUNDREJT NUMRIT TOTAL TË SHKOLLAVE 9-VJEÇARE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2311B01
Shërbimi	Arsimi bazë
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e shkollave 9-vjeçare publike në administrim të bashkisë që kanë përfituar punime mirëmbajtjeje gjatë vitit raportues, kundrejt numrit total të shkollave 9-vjeçare publike funksionale. Ai vlerëson nivelin e mirëmbajtjes së infrastrukturës së arsimit bazë dhe aftësinë e bashkisë për të garantuar ambiente të sigurta dhe funksionale për zhvillimin e procesit mësimor.

Qëllimi i treguesit	Të monitorojë performancën e bashkisë në mirëmbajtjen e objekteve të arsimit bazë dhe të mbështesë planifikimin e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës së shkollave 9-vjeçare publike.
Formula e llogaritjes	(D03 / D36) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Rritja e vlerës së treguesit tregon një nivel më të lartë të mbulimit të mirëmbajtjes së shkollave 9-vjeçare publike. Vlera 100% tregon se të gjitha shkollat 9-vjeçare publike funksionale kanë përfituar mirëmbajtje gjatë vitit raportues.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin dhe administrimin e objekteve arsimore në bashki.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Treguesi mat mbulimin e mirëmbajtjes së shkollave 9-vjeçare publike, por nuk vlerëson cilësinë, vlerën financiare apo kompleksitetin e ndërhyrjeve të kryera.

D03 NUMRI I SHKOLLAVE 9-VJEÇARE PUBLIKE TË MIRËMBAJTURA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D03
Emërtimi i të dhënës	**Numri i shkollave 9-vjeçare publike të mirëmbajtura**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i shkollave 9-vjeçare publike në administrim të bashkisë për të cilat gjatë vitit raportues janë realizuar punime mirëmbajtjeje parandaluese ose korrigjuese, me qëllim ruajtjen ose përmirësimin e kushteve funksionale, teknike dhe të sigurisë së objektit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e shkollave 9-vjeçare publike ku janë kryer ndërhyrje mirëmbajtjeje gjatë periudhës raportuese dhe të mundësojë monitorimin e gjendjes së infrastrukturës arsimore.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat administrativë të bashkisë mbi mirëmbajtjen e objekteve arsimore, kontratat e mirëmbajtjes, procesverbalet e punimeve dhe raportet teknike të njësisë përgjegjëse.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kontratave të mirëmbajtjes, procesverbaleve të marrjes në dorëzim të punimeve, situacioneve të punimeve, faturave dhe dokumentacionit teknik përkatës.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin dhe administrimin e objekteve arsimore në bashki.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative.
Kufizimet	Përfshihen vetëm shkollat ku janë dokumentuar ndërhyrje mirëmbajtjeje. Nuk pasqyrohet lloji, cilësia apo shtrirja e ndërhyrjeve të kryera.

D36 NUMRI I SHKOLLAVE 9-VJEÇARE PUBLIKE NË BASHKI

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D36
Emërtimi i të dhënës	**Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i shkollave 9-vjeçare publike funksionale në administrim të bashkisë në fund të vitit raportues. Në këtë numër përfshihen vetëm institucionet publike të arsimit bazë që zhvillojnë aktivitetin e tyre gjatë periudhës së raportimit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e godinave të shkollave 9-vjeçare publike dhe të mundësojë monitorimin e kapaciteteve të infrastrukturës arsimore.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistri administrativ i institucioneve arsimore publike dhe evidencat vjetore të bashkisë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit zyrtar të institucioneve arsimore, vendimeve administrative për hapjen ose mbylljen e institucioneve dhe inventarit të objekteve publike.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative.
Kufizimet	Pasqyron vetëm numrin e godinave dhe nuk vlerëson gjendjen teknike, kapacitetin ose shkallën e përdorimit të tyre.

TREGUESI 2311B02 SHKOLLA 9-VJEÇARE PUBLIKE TË RIKONSTRUKTUARA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2311B02
Shërbimi	Arsimi bazë
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin e ndërtesave të shkollave 9-vjeçare publike për të cilat gjatë vitit raportues janë përfunduar punime rikonstruksioni. Rikonstruksioni përfshin ndërhyrje të konsiderueshme që përmirësojnë gjendjen strukturore, funksionale ose teknike të godinës, duke rritur cilësinë dhe sigurinë e infrastrukturës arsimore.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë investimet e bashkisë në rehabilitimin e infrastrukturës së arsimit bazë dhe të vlerësojë përmirësimin e kushteve fizike të shkollave 9-vjeçare publike.
Formula e llogaritjes	D08*1
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë e treguesit tregon një nivel më të madh investimesh në rikonstruksionin e infrastrukturës së arsimit bazë. Interpretimi duhet të bëhet në raport me nevojat për investime, numrin total të shkollave dhe planifikimin shumëvjeçar të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin dhe administrimin e objekteve arsimore në bashki.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Treguesi paraqet vetëm numrin e objekteve të rikonstruktuara dhe nuk pasqyron vlerën financiare, shkallën e ndërhyrjes apo ndikimin e investimit në cilësinë e procesit mësimor.

D08 NUMRI I NDËRTESAVE PUBLIKE TË ARSIMIT BAZË TË RIKONSTRUKTUARA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D08
Emërtimi i të dhënës	**Numri i ndërtesave publike të arsimit bazë të rikonstruktuara**

Përshkrimi i të dhënës	Numri i ndërtesave publike të arsimit bazë për të cilat gjatë vitit raportues janë përfunduar punime rikonstruksioni, të cilat përmirësojnë ndjeshëm gjendjen strukturore, funksionale ose teknike të objektit. Në këtë kategori nuk përfshihen ndërhyrjet rutinë të mirëmbajtjes.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e shkollave 9-vjeçare publike ku janë përfunduar punime rikonstruksioni gjatë periudhës raportuese dhe të mundësojë monitorimin e investimeve në infrastrukturën arsimore.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistri i investimeve të bashkisë, kontratat e punimeve dhe dokumentacioni teknik i projekteve të përfunduara.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kontratave të investimit, procesverbaleve të kolaudimit ose marrjes në dorëzim të punimeve, situacioneve përfundimtare të punimeve dhe dokumentacionit financiar përkatës.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për investimet publike dhe administrimin e objekteve arsimore në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative
Kufizimet	Përfshihen vetëm rikonstruksionet e përfunduara gjatë periudhës raportuese. Nuk përfshihen ndërhyrjet e zakonshme të mirëmbajtjes.

TREGUESI 2311A04: KOPSHTE PUBLIKE TË RIKONSTRUKTUARA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2311A04
Shërbimi	Arsimi Parashkollor
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin e godinave të kopshteve publike për të cilat gjatë vitit raportues janë përfunduar punime rikonstruksioni. Rikonstruksioni përfshin ndërhyrje që përmirësojnë ndjeshëm gjendjen strukturore, funksionale ose teknike të godinës, duke garantuar kushte më të mira për zhvillimin e procesit edukativ.

Qëllimi i treguesit	Të monitorojë investimet e bashkisë në përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve publike dhe të vlerësojë progresin në rehabilitimin e objekteve të arsimit parashkollor.
Formula e llogaritjes	D09*1
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë e treguesit tregon rritje të investimeve në rikonstruksionin e kopshteve publike. Interpretimi duhet të bëhet në raport me gjendjen e infrastrukturës ekzistuese, nevojat për rehabilitim dhe planin e investimeve të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin dhe administrimin e objekteve arsimore në bashki.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Treguesi paraqet vetëm numrin e objekteve të rikonstruktuara dhe nuk pasqyron vlerën financiare, shkallën e ndërhyrjes apo ndikimin në cilësinë e shërbimit.

D09 NUMRI I NDËRTESAVE PUBLIKE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR TË RIKONSTRUKTUARA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D09
Emërtimi i të dhënës	**Numri i ndërtesave publike të arsimit parashkollor të rikonstruktuara**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i godinave publike të kopshteve dhe çerdheve për të cilat gjatë vitit raportues janë përfunduar punime rikonstruksioni që përmirësojnë ndjeshëm gjendjen strukturore, funksionale ose teknike të objektit. Nuk përfshihen ndërhyrjet rutinë të mirëmbajtjes.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e kopshteve dhe cerdheve publike ku janë përfunduar punime rikonstruksioni gjatë periudhës raportuese dhe të mundësojë monitorimin e investimeve në infrastrukturën parashkollore.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistri i investimeve të bashkisë, kontratat e punimeve dhe dokumentacioni teknik i projekteve të përfunduara.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kontratave të investimit, procesverbaleve të kolaudimit ose marrjes në dorëzim të punimeve, situacioneve përfundimtare të punimeve dhe dokumentacionit financiar përkatës.

Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për investimet publike dhe administrimin e objekteve arsimore në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas llojit të institucionit (çerdhe/kopsht) dhe njësisë administrative
Kufizimet	Përfshihen vetëm rikonstruksionet e përfunduara gjatë periudhës raportuese. Nuk përfshihen ndërhyrjet rutinë të mirëmbajtjes.

TREGUESI 2311C01: PUNONJËS MBËSHTETËS PËR SHKOLLË TË MESME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	2311C01
Shërbimi	Arsimi i mesëm i përgjithshëm
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin mesatar të punonjësve mbështetës për çdo shkollë të mesme të përgjithshme publike në administrim të bashkisë. Në punonjësit mbështetës përfshihen punonjësit administrativë, mirëmbajtësit, rojet, sanitaret dhe personeli tjetër që kontribuon në funksionimin e përditshëm të institucionit arsimor.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë kapacitetin mbështetës të shkollave të mesme të përgjithshme publike dhe të vlerësojë nëse burimet njerëzore jo-mësimore janë të mjaftueshme për administrimin dhe funksionimin normal të institucioneve arsimore.
Formula e llogaritjes	D13 / D38
Njësia matëse	Punonjës mbështetës / shkollë
Interpretimi	Një vlerë më e lartë e treguesit tregon disponueshmëri më të madhe të personelit mbështetës për çdo shkollë. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë madhësinë e shkollave, numrin e nxënësve, sipërfaqen e objekteve dhe nevojat organizative të secilit institucion.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin dhe administrimin e objekteve arsimore në bashki.

Disagregimi	Sipas njësisë administrative (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Treguesi paraqet një raport mesatar dhe nuk reflekton shpërndarjen reale të personelit ndërmjet shkollave apo llojin e funksioneve që kryen secili punonjës mbështetës.

D13 NUMRI I STAFIT MBËSHTETËS NË SHKOLLA TË MESME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D13
Emërtimi i të dhënës	**Numri i stafit mbështetës në shkolla të mesme të përgjithshme publike**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i punonjësve mbështetës të angazhuar në shkollat e mesme të përgjithshme publike gjatë vitit raportues. Në këtë kategori përfshihen punonjësit administrativë, sanitaret, rojet, mirëmbajtësit dhe personeli tjetër mbështetës që nuk ushtron funksione mësimore.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e punonjësve mbështetës të angazhuar në funksionimin e shkollave të mesme publike dhe të mundësojë monitorimin e kapaciteteve mbështetëse të këtyre institucioneve.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të personelit dhe evidencat e burimeve njerëzore të institucioneve arsimore dhe të bashkisë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet organikës së miratuar, kontratave të punës, listëpagesave dhe evidencave të administrimit të personelit.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin dhe burimet njerëzore në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas kategorisë së personelit, gjinisë (kur disponohet) dhe njësisë administrative.
Kufizimet	Nuk pasqyron funksionet specifike, nivelin e kualifikimit apo ngarkesën në punë të personelit.

D38 NUMRI I SHKOLLAVE TË MESME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE NË BASHKI

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D38

Emërtimi i të dhënës	**Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i shkollave të mesme të përgjithshme publike funksionale në territorin e bashkisë në fund të vitit raportues. Në këtë numër përfshihen vetëm institucionet publike që ofrojnë arsim të mesëm të përgjithshëm dhe zhvillojnë aktivitet gjatë periudhës së raportimit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e shkollave të mesme publike në territorin e bashkisë dhe të mundësojë monitorimin e kapaciteteve të rrjetit të institucioneve të arsimit të mesëm.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistri administrativ i institucioneve arsimore publike dhe evidencat vjetore të bashkisë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit zyrtar të institucioneve arsimore, vendimeve administrative për hapjen ose mbylljen e institucioneve dhe inventarit të objekteve publike.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative.
Kufizimet	Pasqyron vetëm numrin e shkollave të mesme publike dhe nuk jep informacion mbi kapacitetin, gjendjen e infrastrukturës, numrin e nxënësve apo cilësinë e shërbimit.

TREGUESI 2311V01: SHPENZIME PËR KONVIKTET E ARSIMIT PROFESIONAL KUNDREJT NUMRIT TOTAL TË STUDENTËVE TË AKOMODUAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2311V01
Shërbimi	Konviktet e arsimit profesional
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat shpenzimin mesatar të bashkisë për çdo student të akomoduar në konviktet e arsimit profesional gjatë vitit raportues. Në llogaritje përfshihen shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe investimet që lidhen me funksionimin e konvikteve.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë nivelin e financimit të shërbimit të akomodimit në konviktet e arsimit profesional dhe të mbështesë vlerësimin e efikasitetit në përdorimin e burimeve financiare.

Formula e llogaritjes	D14 / D15
Njësia matëse	Mijë lekë / student i akomoduar
Interpretimi	Treguesi paraqet shpenzimin mesatar për student të akomoduar në konvikt. Interpretimi duhet të bëhet në raport me standardet e ofrimit të shërbimit, kapacitetin e konvikteve, nivelin e zënies së tyre dhe strukturën e shpenzimeve. Vlera më të larta nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht performancë më të mirë, pasi mund të reflektojnë investime kapitale, kosto më të larta operative ose numër më të ulët përfituesish.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e konvikteve dhe financat në bashki.
Disagregimi	Sipas konviktit (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Treguesi nuk diferencon ndërmjet shpenzimeve operative dhe investimeve kapitale. Për këtë arsye, krahasimet ndërmjet bashkive ose ndërmjet viteve duhet të interpretohen duke marrë në konsideratë natyrën e shpenzimeve të raportuara.

D14 TOTALI I SHPENZIMEVE PËR KONVIKTET E ARSIMIT PROFESIONAL

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D14
Emërtimi i të dhënës	**Totali i shpenzimeve për konviktet e arsimit profesional**
Përshkrimi i të dhënës	Totali i shpenzimeve të kryera gjatë vitit raportues për administrimin e konvikteve të arsimit profesional. Përfshin shpenzimet operative, shpenzimet e mirëmbajtjes dhe investimet kapitale të financuara nga bashkia për funksionimin dhe përmirësimin e konvikteve.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë shpenzimet e realizuara për funksionimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e konvikteve dhe të mundësojë monitorimin e përdorimit të burimeve financiare.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat nxirren nga sistemi financiar dhe kontabël i bashkisë dhe nga evidencat financiare të njësisë administruese të konvikteve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet raporteve të ekzekutimit të buxhetit, librave kontabël, urdhër-pagesave, faturave dhe dokumentacionit financiar mbështetës.
Njësia matëse	Mijë lekë

Institucioni Përgjegjës	Drejtoria e Financave dhe struktura përgjegjëse për administrimin e konvikteve në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas konviktit dhe sipas kategorisë së shpenzimeve (operative, mirëmbajtje, investime), kur është e disponueshme.
Kufizimet	Përfshihen vetëm shpenzimet e realizuara dhe të regjistruara gjatë periudhës raportuese. Nuk përfshihen angazhimet financiare të papaguara.

D15 NUMRI TOTAL I STUDENTËVE TË AKOMODUAR NË KONVIKTE TË ARSIMIT PROFESIONAL

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D15
Emërtimi i të dhënës	**Numri total i studentëve të akomoduar në konvikte të arsimit profesional**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i studentëve/nxënësve që kanë qenë të akomoduar në konviktet e arsimit profesional gjatë vitit raportues, pavarësisht kohëzgjatjes së akomodimit, sipas evidencave administrative të konvikteve.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e nxënësve të akomoduar në konvikte dhe të mundësojë monitorimin e përdorimit të kapaciteteve akomoduese.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të konvikteve dhe evidencat e akomodimit të përditësuara gjatë vitit raportues.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të akomodimit, listave të banorëve të konvikteve dhe raporteve administrative të institucionit.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Administrata e konviktit dhe struktura përgjegjëse për administrimin e konvikteve në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas gjinisë dhe konviktit (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Pasqyron gjendjen gjatë periudhës raportuese dhe nuk vlerëson kohëzgjatjen e akomodimit ose nivelin e shfrytëzimit gjatë gjithë vitit.

TREGUESI 2311V02: NUMRI MESATAR I NXËNËSVE TË AKOMODUAR PËR DHOMË NË KONVIKTET E ARSIMIT PROFESIONAL

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2311V02
Shërbimi	Konviktet e arsimit profesional
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin mesatar të nxënësve të akomoduar për çdo dhomë funksionale në konviktet e arsimit profesional. Ai vlerëson nivelin e shfrytëzimit të kapacitetit akomodues të konvikteve.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë shkallën e shfrytëzimit të kapaciteteve akomoduese të konvikteve dhe të mbështesë planifikimin e investimeve për zgjerimin ose optimizimin e tyre.
Formula e llogaritjes	D18 / D19
Njësia matëse	Nxënës për dhomë
Interpretimi	Treguesi paraqet numrin mesatar të nxënësve të akomoduar për çdo dhomë funksionale. Vlera më të larta tregojnë një nivel më të lartë të shfrytëzimit të kapacitetit akomodues, ndërsa vlera shumë të larta mund të sinjalizojnë mbingarkesë të kapaciteteve. Interpretimi duhet të bëhet në raport me standardet e akomodimit dhe kapacitetin projektues të konvikteve.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e konvikteve.
Disagregimi	Sipas konviktit (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Treguesi nuk merr në konsideratë sipërfaqen e dhomave, standardet e akomodimit apo shpërndarjen sipas gjinisë dhe nevojave të veçanta të nxënësve.

D18 NUMRI I NXËNËSVE TË AKOMODUAR NË KONVIKTET E ARSIMIT PROFESIONAL

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D18
Emërtimi i të dhënës	**Numri i nxënësve të akomoduar në konviktet e arsimit profesional**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i nxënësve që rezultojnë të akomoduar në konviktet e arsimit profesional gjatë vitit raportues, sipas evidencave administrative të konvikteve.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të konvikteve dhe evidencat e akomodimit të përditësuara gjatë vitit raportues.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të akomodimit, listave të banorëve të konvikteve dhe raporteve administrative të institucionit.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Administrata e konvikteve dhe struktura përgjegjëse për administrimin e tyre në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas gjinisë dhe konviktit (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Pasqyron vetëm kapacitetin teorik të akomodimit dhe nuk tregon numrin e shtretërve aktualisht në përdorim ose jashtë funksionit.

D19 NUMRI I DHOMAVE TË KONVIKTEVE TË ARSIMIT PROFESIONAL

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D19
Emërtimi i të dhënës	**Numri i dhomave të konvikteve të arsimit profesional**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i dhomave funksionale të destinuara për akomodimin e nxënësve në konviktet e arsimit profesional gjatë vitit raportues. Përfshihen vetëm dhomat që janë në gjendje funksionale dhe të disponueshme për përdorim.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e dhomave të konvikteve dhe të mundësojë monitorimin e kapaciteteve infrastrukturore të tyre.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga inventari i objekteve dhe regjistri administrativ i konvikteve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet inventarit të aseteve, dokumentacionit teknik të godinës dhe evidencave të administrimit të konvikteve.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e konvikteve dhe administrimin e aseteve në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore

Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas konviktit.
Kufizimet	Nuk pasqyron gjendjen fizike, kapacitetin funksional ose shkallën e përdorimit të dhomave.

TREGUESI 2311V03 NUMRI I KONVIKTEVE FUNKSIONALE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2311V03
Shërbimi	Konviktet e arsimit profesional
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin e konvikteve të arsimit profesional që janë funksionale dhe ofrojnë shërbimin e akomodimit gjatë vitit raportues. Në këtë kategori përfshihen vetëm konviktet që janë në përdorim dhe plotësojnë kushtet për akomodimin e nxënësve.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë disponueshmërinë e kapaciteteve akomoduese për nxënësit e arsimit profesional dhe të mbështesë planifikimin e investimeve për mirëmbajtjen, rehabilitimin ose zgjerimin e tyre.
Formula e llogaritjes	D20*1
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Treguesi paraqet numrin e konvikteve funksionale në administrim të bashkisë. Interpretimi duhet të bëhet në raport me nevojat për akomodim të nxënësve, shpërndarjen territoriale të konvikteve dhe kapacitetin e tyre akomodues. Rritja ose ulja e treguesit nuk përbën domosdoshmërisht përmirësim ose përkeqësim të performancës, por duhet të analizohet në kontekstin e politikave të arsimit profesional dhe investimeve në infrastrukturë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e konvikteve.
Disagregimi	Sipas konviktit dhe njësisë administrative (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e konvikteve funksionale dhe nuk jep informacion mbi kapacitetin, nivelin e zënies, gjendjen teknike apo cilësinë e kushteve të akomodimit.

D20 NUMRI I KONVIKTEVE FUNKSIONALE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D20
Emërtimi i të dhënës	**Numri i konvikteve funksionale**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i konvikteve të arsimit profesional që janë funksionale dhe ofrojnë shërbimin e akomodimit gjatë vitit raportues. Përfshihen vetëm konviktet që janë në përdorim dhe plotësojnë kushtet minimale për akomodimin e nxënësve.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e konvikteve funksionale në administrim të bashkisë dhe të mundësojë monitorimin e kapaciteteve të shërbimit të akomodimit.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistri administrativ i konvikteve dhe evidencat e administrimit të institucioneve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet inventarit të objekteve, dokumentacionit të administrimit të konvikteve, raporteve të funksionimit dhe akteve administrative që vërtetojnë statusin funksional të tyre.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e konvikteve dhe administrimin e aseteve në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas konviktit dhe njësisë administrative.
Kufizimet	Pasqyron vetëm numrin e konvikteve funksionale dhe nuk vlerëson kapacitetin, cilësinë e shërbimit ose nivelin e shfrytëzimit të tyre.

TREGUESI 2311C06 GODINA ARSIMORE SIPAS NIVELIT ARSIMOR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2311C06
Shërbimi	Infrastrukturë arsimore
Pjesë e SMP	Po
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet numrin total të godinave të institucioneve të arsimit parauniversitar në territorin e bashkisë, sipas nivelit arsimor dhe llojit të institucionit (publik ose privat). Ai ofron një pasqyrë të kapacitetit fizik të rrjetit arsimor dhe shërben si bazë për analizën e mbulimit të shërbimit dhe planifikimin e investimeve në infrastrukturën arsimore.

Qëllimi i treguesit	Të monitorojë kapacitetin infrastrukturor të sistemit arsimor parauniversitar në territorin e bashkisë dhe të mbështesë planifikimin e investimeve, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të rrjetit të institucioneve arsimore.
Formula e llogaritjes	D32 + D33 + D34 + D35 + D36 + D37 + D38 + D39
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Treguesi paraqet numrin total të institucioneve arsimore sipas nivelit arsimor dhe statusit (publik/privat). Ai nuk mat performancën e bashkisë në vetvete, por përshkruan kapacitetin infrastrukturor mbi të cilin analizohen treguesit e tjerë të funksionit. Ndryshimet në vlerën e treguesit zakonisht lidhen me hapjen, mbylljen ose riorganizimin e institucioneve arsimore.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin në bashki.
Disagregimi	Sipas nivelit arsimor, llojit të institucionit (publik/privat) dhe njësisë administrative.
Kufizimet	Treguesi mat numrin e institucioneve arsimore dhe nuk jep informacion mbi kapacitetin e tyre, gjendjen fizike, numrin e nxënësve apo cilësinë e shërbimit të ofruar.

Kodi	E dhëna	Njësia matëse	Metoda e verifikimit	Burimi i informacionit
D32	Numri i çerdheve publike në bashki	Numër	Verifikohet nëpërmjet regjistrit zyrtar të institucioneve publike, vendimeve për krijimin, mbylljen ose riorganizimin e çerdheve dhe evidencave administrative të bashkisë.	Struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor në bashki.
D33	Numri i çerdheve private në bashki	Numër	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të institucioneve private të licencuara dhe dokumentacionit të licencimit të autoriteteve përgjegjëse.	Drejtoria Arsimore Vendore / institucionet përgjegjëse për licencimin.
D34	Numri i kopshteve publike në bashki	Numër	Verifikohet nëpërmjet regjistrit zyrtar të institucioneve publike, vendimeve administrative për hapjen ose mbylljen e kopshteve dhe evidencave të bashkisë.	Struktura përgjegjëse për arsimin në bashki.
D35	Numri i kopshteve private në bashki	Numër	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të institucioneve private të licencuara dhe dokumentacionit përkatës të licencimit.	Drejtoria Arsimore Vendore.
D36	Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki	Numër	Verifikohet nëpërmjet regjistrit kombëtar të institucioneve arsimore, vendimeve administrative dhe evidencave të Drejtorisë Arsimore Vendore.	Drejtoria Arsimore Vendore dhe bashkia.
D37	Numri i shkollave 9-vjeçare private në bashki	Numër	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të shkollave private të licencuara dhe dokumentacionit të licencimit.	Drejtoria Arsimore Vendore.
D38	Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki	Numër	Verifikohet nëpërmjet regjistrit zyrtar të institucioneve arsimore publike, vendimeve administrative dhe evidencave të Drejtorisë Arsimore Vendore.	Drejtoria Arsimore Vendore dhe bashkia.
D39	Numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në bashki	Numër	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të institucioneve private të licencuara dhe dokumentacionit të licencimit.	Drejtoria Arsimore Vendore.

FUNKSIONI 23.12

Administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe

Përshkrimi i funksionit

Ky funksion përfshin përgjegjësinë e bashkisë për administrimin dhe organizimin e shërbimit të arsimit parashkollor në çerdhe dhe kopshte publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Funksioni synon të sigurojë akses në shërbim, cilësi në ofrimin e tij, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.

Në kuadër të Sistemit të Matjes së Performancës (SMP) dhe katalogut të treguesve, ky funksion monitorohet nëpërmjet treguesve që lidhen me mbulimin e shërbimit, kapacitetet njerëzore, organizimin e institucioneve, zhvillimin profesional të personelit, pjesëmarrjen e prindërve dhe aksesin e fëmijëve në arsimin parashkollor.

TREGUESI 2312B02: RAPORTI NXËNËS/MËSUES NË SHKOLLAT 9-VJEÇARE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312B02
Shërbimi	Arsimi bazë
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin mesatar të nxënësve për çdo mësues në shkollat 9-vjeçare publike. Ai shërben për të vlerësuar raportin ndërmjet burimeve njerëzore në dispozicion dhe numrit të nxënësve që përfitojnë shërbimin arsimor.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë kapacitetin e sistemit arsimor për të ofruar mësimdhënie cilësore nëpërmjet një raporti të përshtatshëm ndërmjet nxënësve dhe mësuesve, duke mbështetur planifikimin e burimeve njerëzore në arsimin bazë.
Formula e llogaritjes	D04 / D05
Njësia matëse	Nxënës për mësues
Interpretimi	Një raport më i ulët nxënës/mësues tregon disponueshmëri më të madhe të burimeve njerëzore për procesin mësimor dhe potencialisht kushte më të favorshme për mësimdhënie. Raporte shumë të larta mund të sinjalizojnë mbingarkesë të personelit mësimor dhe nevojë për rishikim të shpërndarjes së burimeve njerëzore. Interpretimi duhet të bëhet në raport me standardet dhe politikat kombëtare të arsimit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin në bashki.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Treguesi nuk reflekton shpërndarjen e mësuesve sipas profileve, lëndëve ose ngarkesës mësimore dhe nuk mat cilësinë e procesit të mësimdhënies.

D04 -NUMRI I NXËNËSVE TË REGJISTRUAR NË SHKOLLA 9-VJEÇARE PUBLIKE

Shtjelluar me lart

D05- NUMRI I MËSUESVE QË JAPIN MËSIM NË SHKOLLA 9-VJEÇARE PUBLIKE

Shtjelluar me lart

TREGUESI 2312A03 NUMRI MESATAR I FËMIJËVE PËR KLASË NË KOPSHTET PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312A03
Shërbimi	Arsimi Parashkollor
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin mesatar të fëmijëve të regjistruar për çdo klasë funksionale në kopshtet publike. Ai vlerëson shkallën e shfrytëzimit të kapaciteteve të klasave dhe mbështet analizën e kushteve të organizimit të procesit edukativ në institucionet parashkollore.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë raportin ndërmjet numrit të fëmijëve dhe kapaciteteve fizike të kopshteve publike, si bazë për planifikimin e zgjerimit të kapaciteteve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.
Formula e llogaritjes	D28 / D06
Njësia matëse	Fëmijë për klasë
Interpretimi	Treguesi paraqet numrin mesatar të fëmijëve për klasë në kopshtet publike. Vlera të larta mund të tregojnë shfrytëzim të lartë të kapaciteteve dhe mbingarkesë të klasave, ndërsa vlera të ulëta mund të tregojnë kapacitete të pashfrytëzuara. Interpretimi duhet të bëhet në raport me standardet kombëtare për organizimin e grupeve në arsimin parashkollor.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor në bashki.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Treguesi nuk merr në konsideratë madhësinë fizike të klasave, moshën e fëmijëve apo organizimin e grupeve sipas grupmoshave.

D28 NUMRI I FËMIJËVE TË MOSHËS 3-6 VJEÇ QË FREKUENTOJNË KOPSHTET PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D28
Emërtimi i të dhënës	**Numri i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç të regjistruar dhe që frekuentojnë kopshtet publike gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat administrativë të kopshteve publike dhe konsolidohen nga struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor në bashki.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të fëmijëve të regjistruar, raporteve periodike të kopshteve dhe evidencave të Drejtorisë Arsimore Vendore.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor në bashki dhe Drejtoria Arsimore Vendore.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas gjinisë dhe njësisë administrative.
Kufizimet	Pasqyron vetëm regjistrimet në institucionet publike.

D06 NUMRI I KLASAVE TË KOPSHTEVE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D06
Emërtimi i të dhënës	**Numri i klasave të kopshteve publike**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i klasave funksionale në kopshtet publike gjatë vitit raportues. Përfshihen vetëm klasat që përdoren për zhvillimin e procesit edukativ.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë kapacitetin organizativ të kopshteve publike dhe të mundësojë llogaritjen e treguesve të dendësisë së klasave.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat administrativë të kopshteve publike dhe inventari i kapaciteteve të institucioneve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të institucioneve, inventarit të klasave dhe raporteve administrative të kopshteve publike.
Njësia matëse	Numër
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative dhe institucionit.
Kufizimet	Nuk pasqyron kapacitetin fizik ose madhësinë e klasave.

TREGUESI 2312B03 NUMRI MESATAR I NXËNËSVE NË NJË KLASË TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312B03
Shërbimi	Arsimi bazë
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin mesatar të nxënësve për klasë në shkollat 9-vjeçare publike. Ai pasqyron shkallën e shfrytëzimit të kapaciteteve mësimore dhe nivelin e ngarkesës së klasave në arsimin bazë.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë raportin ndërmjet numrit të nxënësve dhe klasave funksionale në shkollat 9-vjeçare publike, duke mbështetur planifikimin e kapaciteteve infrastrukturore dhe organizimin e procesit mësimor sipas standardeve kombëtare.
Formula e llogaritjes	D04 / D07
Njësia matëse	Nxënës/klasë
Interpretimi	Treguesi paraqet numrin mesatar të nxënësve për klasë në shkollat 9-vjeçare publike. Vlera të larta mund të tregojnë mbingarkesë të klasave, ndërsa vlera të ulëta mund të tregojnë kapacitete të pashfrytëzuara. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë standardet kombëtare për organizimin e klasave, shpërndarjen territoriale të nxënësve dhe karakteristikat demografike të bashkisë.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin në bashki.
Disagregimi	Gjinor dhe sipas njësisë administrative (kur është e aplikueshme).
Kufizimet	Treguesi nuk merr në konsideratë madhësinë fizike të klasave, organizimin me turne ose klasat kolektive në zonat rurale.

D04 - NUMRI I NXËNËSVE TË REGJISTRUAR NË SHKOLLA 9-VJEÇARE PUBLIKE

Shtjelluar me lart

D07 NUMRI I KLASAVE TË SHKOLLAVE 9-VJEÇARE PUBLIKE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D07
Emërtimi i të dhënës	**Numri i klasave të shkollave 9-vjeçare publike**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i klasave funksionale në shkollat publike 9-vjeçare gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë strukturën organizative të shkollave 9-vjeçare.
Metoda e mbledhjes	Krahasimi me regjistrin e klasave dhe raportimet e shkollave.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Evidencat administrative të shkollave publike.
Institucioni Përgjegjës	Drejtoria Arsimore Vendore dhe bashkia.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative
Kufizimet	Nuk pasqyron numrin maksimal të nxënësve që mund të akomodohen në klasë.

TREGUESI 2312B05 PUNONJËS MBËSHTETËS PËR SHKOLLË 9-VJEÇARE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312B05
Shërbimi	Arsimi bazë
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Mat raportin e kapaciteteve mbështetëse në institucionet e arsimit bazë, si psikologë, punonjës socialë apo teknikë ndihmës e staf sanitar.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë disponueshmërinë e personelit mbështetës në raport me numrin e shkollave 9-vjeçare publike dhe të mbështesë planifikimin e burimeve njerëzore për ofrimin e shërbimeve mbështetëse në institucionet e arsimit bazë.
Formula e llogaritjes	D10 / D36
Njësia matëse	Punonjës mbështetës/shkollë 9-vjeçare
Interpretimi	Treguesi paraqet numrin mesatar të punonjësve mbështetës për çdo shkollë 9-vjeçare publike. Vlera më të larta tregojnë disponueshmëri më të madhe të personelit mbështetës. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë madhësinë e shkollave, numrin e nxënësve dhe organizimin e shërbimeve mbështetëse në bashki.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin në bashki.
Kufizimet	Treguesi nuk jep informacion mbi shpërndarjen e personelit ndërmjet shkollave apo mbi kategoritë e ndryshme të stafit mbështetës.

D10 NUMRI I STAFIT MBËSHTETËS NË ARSIMIN BAZË NË SHKOLLAT 9-VJEÇARE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D10
Emërtimi i të dhënës	Burime njerëzore
Përshkrimi i të dhënës	Numri i punonjësve mbështetës (sanitare, roje, mirëmbajtës, punonjës administrativë dhe funksione të tjera mbështetëse) të angazhuar në shkollat publike 9-vjeçare.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë burimet njerëzore mbështetëse të angazhuara në funksionimin e shkollave 9-vjeçare.
Metoda e mbledhjes	Krahasimi me organikën, kontratat e punës dhe listëpagesat.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Regjistri administrativ i personelit.
Institucioni Përgjegjës	Bashkia / Drejtoria përgjegjëse për arsimin dhe burimet njerëzore.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas gjinisë (kur disponohet) dhe njësisë administrative
Kufizimet	Nuk pasqyron ngarkesën e punës apo funksionet specifike të secilit punonjës.

D36 -NUMRI I SHKOLLAVE 9-VJEÇARE PUBLIKE NË BASHKI

TREGUESI 2312A05 RAPORTI I SHPENZIMEVE PËR INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KUNDREJT NUMRIT TOTAL TË INSTITUCIONEVE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	2312A05
Nën-shërbimi	Arsimi parauniversitar
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Mat nivelin mesatar të shpenzimeve për institucion në arsimin bazë, parashkollor dhe të mesëm, duke ndihmuar në vlerësimin e efikasitetit financiar dhe alokimit të burimeve.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë nivelin mesatar të financimit të institucioneve publike të arsimit parauniversitar dhe të mbështesë vlerësimin e shpërndarjes së burimeve financiare ndërmjet institucioneve arsimore.
Formula e llogaritjes	D11 / (D32 + D34 + D36 + D38)
Njësia matëse	Mijë lekë/institucion
Interpretimi	Treguesi paraqet nivelin mesatar të shpenzimeve për një institucion publik të arsimit parauniversitar. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë strukturën e shpenzimeve (operative, mirëmbajtje dhe investime), madhësinë e institucioneve dhe ndryshimet në numrin e tyre ndërmjet viteve. Vlera më të larta nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht performancë më të mirë, pasi mund të reflektojnë investime kapitale ose kosto më të larta operative.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin dhe financat në bashki.
Kufizimet	Treguesi nuk diferencon ndërmjet llojeve të institucioneve dhe nuk pasqyron madhësinë, numrin e përfituesve apo strukturën e kostove të secilit institucion.

D11 SHPENZIME PËR INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D11
Emërtimi i të dhënës	**Shpenzime për institucionet publike të arsimit parauniversitar**
Përshkrimi i të dhënës	Totali i shpenzimeve operative, mirëmbajtjes dhe investimeve të financuara nga bashkia për institucionet publike të arsimit parauniversitar gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë burimet financiare të përdorura për funksionimin e institucioneve publike të arsimit parauniversitar.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet me raportet e ekzekutimit të buxhetit, librat kontabël dhe dokumentacionin financiar.
Metoda e verifikimit	Mijë lekë
Njësia matëse	Nxirret nga sistemi financiar dhe raportet e zbatimit të buxhetit të bashkisë.
Institucioni Përgjegjës	Drejtoria e Financave dhe Drejtoria përgjegjëse për Arsimin.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas natyrës së shpenzimit, burimit të financimit, institucionit dhe njësisë administrative, kur informacioni është i disponueshëm
Kufizimet	Përfshihen vetëm shpenzimet e realizuara dhe të regjistruara gjatë periudhës raportuese.

PASAPORTA E TË DHËNËS D32 - REFEROJU XXX

PASAPORTA E TË DHËNËS D34- REFEROJU XXX

PASAPORTA E TË DHËNËS D36 REFEROJU XXX

PASAPORTA E TË DHËNËS D38 REFEROJU XXX

TREGUESI 2312A06 KOPSHTE KU JANË NGRITUR KËSHILLAT E PRINDËRVE KUNDREJT NUMRIT TOTAL TË KOPSHTEVE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312A06
Shërbimi	Arsimi parashkollor
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Reflekton nivelin e përfshirjes së komunitetit dhe prindërve në procesin arsimor përmes ngritjes së këshillave të prindërve në institucionet parashkollore publike.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë shkallën e funksionimit të mekanizmave të pjesëmarrjes së prindërve në institucionet publike parashkollore dhe të mbështesë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore dhe komunitetit.
Formula e llogaritjes	(D12/D34) × 100
Njësia matëse	%
Interpretimi	Treguesi paraqet përqindjen e kopshteve publike ku janë ngritur dhe funksionojnë këshillat e prindërve. Vlera më të larta tregojnë një nivel më të lartë të organizimit dhe përfshirjes së prindërve në jetën e institucionit arsimor.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor në bashki.
Kufizimet	Treguesi mat ekzistencën e këshillave të prindërve, por nuk vlerëson nivelin e aktivitetit apo efektivitetin e tyre në procesin e vendimmarrjes.

D12 NUMRI I KOPSHTEVE PUBLIKE KU JANË NGRITUR KËSHILLAT E PRINDËRVE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D12
Emërtimi i të dhënës	**Numri i kopshteve publike ku janë ngritur këshillat e prindërve**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i kopshteve publike ku funksionon këshilli i prindërve sipas legjislacionit dhe akteve rregullatore në fuqi.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e organizimit të mekanizmave të pjesëmarrjes së prindërve në kopshtet publike.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet me urdhrat e ngritjes, procesverbalet e mbledhjeve dhe dokumentacionin administrativ të institucionit.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Evidencat administrative të kopshteve publike.
Institucioni Përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për Arsimin.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas kopshtit dhe njësisë administrative.
Kufizimet	Evidenton ekzistencën e këshillit të prindërve, por jo funksionimin apo efektivitetin e tij.

D34 NUMRI I KOPSHTEVE PUBLIKE NË BASHKI

Shtjelluar me lart.

TREGUESI 2312A07 NUMRI I PRINDËRVE TË INFORMUAR NË LIDHJE ME PRINDËRIMIN POZITIV PËR FËMIJËT 0-3 VJEÇ

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312A07
Shërbimi	Çerdhet
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Reflekton përpjekjet e bashkive për të promovuar prindërimin e ndërgjegjshëm përmes aktiviteteve informuese dhe ndërhyrjeve të hershme në ndihmë të zhvillimit të hershëm të fëmijëve.

Qëllimi i treguesit	Të monitorojë shtrirjen e aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së prindërve për zhvillimin e hershëm të fëmijëve, si pjesë e shërbimeve parandaluese dhe promovuese të bashkisë.
Formula e llogaritjes	D21
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Treguesi paraqet numrin e prindërve ose kujdestarëve ligjorë që kanë marrë pjesë në aktivitete informuese ose sensibilizuese mbi prindërimin pozitiv gjatë vitit raportues. Vlera më të larta tregojnë një shtrirje më të madhe të aktiviteteve të informimit dhe ndërgjegjësimit të organizuara ose mbështetura nga bashkia.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor ose shërbimet sociale në bashki.
Kufizimet	Treguesi mat numrin e pjesëmarrësve në aktivitete, por nuk vlerëson cilësinë e aktiviteteve, nivelin e përvetësimit të njohurive apo ndikimin e tyre në praktikat e prindërimit.

D21 NUMRI I PRINDËRVE TË INFORMUAR NË LIDHJE ME PRINDËRIMIN POZITIV PËR FËMIJËT 0-3 VJEÇ

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D21
Emërtimi i të dhënës	**Numri i prindërve të informuar në lidhje me prindërimin pozitiv për fëmijët 0–3 vjeç**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i prindërve ose kujdestarëve ligjorë që kanë marrë pjesë në aktivitete informuese, trajnuese ose sensibilizuese mbi prindërimin pozitiv për fëmijët e moshës 0–3 vjeç, të organizuara ose mbështetura nga bashkia gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë shtrirjen e aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së prindërve për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet nëpërmjet listave të pjesëmarrjes, raporteve të aktiviteteve dhe dokumentacionit mbështetës.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Evidencat administrative të aktiviteteve dhe listat e pjesëmarrësve.

Institucioni Përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për arsimin parashkollor ose shërbimet sociale.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, aktivitetit dhe, kur është e mundur, sipas gjinisë së pjesëmarrësve.
Kufizimet	Një prind mund të marrë pjesë në më shumë se një aktivitet nëse nuk përdoret një sistem unik identifikimi.

TREGUESI 2312A08 RAPORTI I PERSONELIT TË TRAJNUAR KUNDREJT NUMRIT TOTAL TË PERSONELIT NË ÇERDHE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312A08
Shërbimi	Çerdhet
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Reflekton shkallën e përgatitjes profesionale të stafit të çerdheve nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime të vazhdueshme.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë nivelin e zhvillimit profesional të personelit të çerdheve publike dhe të mbështesë planifikimin e programeve të trajnimit për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme.
Formula e llogaritjes	(D23/D22) × 100
Njësia matëse	%
Interpretimi	Treguesi paraqet përqindjen e personelit të çerdheve publike që ka përfituar trajnime profesionale gjatë vitit raportues. Vlera më të larta tregojnë një nivel më të lartë të investimit në zhvillimin profesional të personelit dhe potencialisht në përmirësimin e cilësisë së shërbimit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor dhe burimet njerëzore në bashki.
Kufizimet	Treguesi mat pjesëmarrjen në trajnime, por nuk vlerëson cilësinë, kohëzgjatjen apo efektivitetin e tyre në përmirësimin e performancës së personelit.

D23 NUMRI I PERSONELIT TË TRAJNUAR TË ÇERDHEVE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D23
Emërtimi i të dhënës	**Numri i personelit të trajnuar të çerdheve publike**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i punonjësve të çerdheve publike që kanë përfunduar trajnime profesionale ose programe të zhvillimit të kapaciteteve gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e zhvillimit profesional të personelit të çerdheve.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet me certifikatat e trajnimit, listat e pjesëmarrjes dhe raportet e zhvillimit profesional.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Evidencat administrative të trajnimeve.
Institucioni Përgjegjës	Bashkia / Institucioni organizues i trajnimit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas çerdhes, njësisë administrative dhe llojit të trajnimit.
Kufizimet	Nuk vlerëson cilësinë, kohëzgjatjen ose ndikimin e trajnimit.

D22 NUMRI TOTAL I PERSONELIT TË ÇERDHEVE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D22
Emërtimi i të dhënës	Numri Total I personelit **të çerdheve publike**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i punonjësve të angazhuar në çerdhet publike, duke përfshirë personelin edukativ, administrativ dhe mbështetës.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë burimet njerëzore të angazhuara në ofrimin e shërbimit të çerdheve.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet me organikën, kontratat e punës dhe listëpagesat.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Regjistri administrativ i personelit.
Institucioni Përgjegjës	Bashkia / Drejtoria përgjegjëse për arsimin parashkollor dhe burimet njerëzore.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Disagregimi	Sipas çerdhes, njësisë administrative dhe kategorisë së personelit.
Kufizimet	Nuk pasqyron nivelin e kualifikimit apo ngarkesën e punës.

TREGUESI 2312A09 RAPORTI I ÇERDHEVE TË FURNIZUARA ME MATERIAL DIDAKTIK KUNDREJT NUMRIT TOTAL TË ÇERDHEVE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312A09
Shërbimi	Çerdhet
Pjesë e SMP	Jo
Përshkrimi i treguesit	Mat përqindjen e çerdheve që janë të pajisura me material didaktik bazë për zhvillimin dhe edukimin e hershëm të fëmijëve.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë nivelin e pajisjes së çerdheve publike me materiale didaktike dhe edukative, si një element i rëndësishëm për ofrimin e një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme.
Formula e llogaritjes	(D24/D32) × 100
Njësia matëse	%
Interpretimi	Treguesi paraqet përqindjen e çerdheve publike të pajisura me materiale didaktike. Vlera më të larta tregojnë një nivel më të mirë të mbështetjes materiale të institucioneve dhe krijimin e kushteve më të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve edukative me fëmijët.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor në bashki.
Kufizimet	Treguesi mat ekzistencën e materialeve didaktike, por nuk vlerëson cilësinë, përshtatshmërinë apo nivelin e përdorimit të tyre në procesin edukativ.

D24 NUMRI I ÇERDHEVE PUBLIKE TË FURNIZUARA ME MATERIAL DIDAKTIK

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D24
Emërtimi i të dhënës	**Numri i çerdheve publike të furnizuara me material didaktik**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i çerdheve publike që gjatë vitit raportues janë pajisur me materiale didaktike, edukative ose mjete mësimore të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve me fëmijët.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë disponueshmërinë e materialeve didaktike në çerdhe.

Metoda e mbledhjes	Verifikohet me procesverbalet e dorëzimit, inventarët dhe dokumentacionin e furnizimit.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Evidencat e furnizimeve dhe inventarët e institucioneve.
Institucioni Përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për arsimin parashkollor.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas çerdhes dhe njësisë administrative.
Kufizimet	Nuk pasqyron sasinë, cilësinë apo përditësimin e materialeve.

PASAPORTA E TË DHËNËS D32

Shënim: Për përshkrimin e plotë të të dhënës **D32 – Numri i çerdheve publike në bashki**, referojuni **pasaportës së të dhënës D32**, e cila paraqitet për herë të parë te **treguesi 2311A01 – Numri i çerdheve publike të mirëmbajtura**.

TREGUESI 2312A10 SHKALLA E REGJISTRIMIT NË ÇERDHE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312A10
Shërbimi	Çerdhet
Pjesë e SMP	Po
Kodi SMP	A01
Përshkrimi i treguesit	Mat nivelin e pjesëmarrjes së fëmijëve të moshës nga 6 muaj deri në 3 vjeç në çerdhet publike të menaxhuara nga bashkia.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë nivelin e aksesit të fëmijëve të moshës 6 muaj–3 vjeç në shërbimet publike të kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme, si bazë për planifikimin e kapaciteteve dhe zgjerimin e mbulimit të shërbimit.
Formula e llogaritjes	(D26/D25) × 100
Njësia matëse	%
Interpretimi	Treguesi paraqet përqindjen e fëmijëve të grupmoshës 6 muaj–3 vjeç që frekuentojnë çerdhet publike në raport me numrin total të fëmijëve të kësaj grupmoshe në territorin e bashkisë. Vlera më të larta tregojnë mbulim më të madh të shërbimit dhe akses më të mirë në edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor në bashki.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm regjistrimet në çerdhet publike dhe nuk përfshin fëmijët që frekuentojnë çerdhe private apo forma të tjera alternative të kujdesit për fëmijët.

D26 NUMRI I FËMIJËVE TË MOSHËS 6 MUAJ DERI NË 3 VJEÇ TË REGJISTRUAR NË ÇERDHE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D26
Emërtimi i të dhënës	**Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i fëmijëve të grupmoshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar dhe që frekuentojnë çerdhet publike gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e përdorimit të shërbimit të çerdheve publike.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet me regjistrat e çerdheve publike dhe evidencat e regjistrimit.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Regjistrat administrativë të çerdheve publike.
Institucioni Përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për arsimin parashkollor.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Gjinor
Kufizimet	Pasqyron vetëm regjistrimet në çerdhet publike.

D25 NUMRI I FËMIJËVE TË MOSHËS NGA 6 MUAJ-3 VJEÇ NË BASHKI

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D25

Emërtimi i të dhënës	**Numri i fëmijëve të moshës nga 6 muaj–3 vjeç në bashki**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i fëmijëve rezidentë të grupmoshës 6 muaj deri në 3 vjeç në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të përcaktojë popullsinë referuese për vlerësimin e mbulimit me shërbimin e çerdheve.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile ose burimeve zyrtare statistikore.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Të dhëna administrative ose statistikore.
Institucioni Përgjegjës	Gjendja Civile, INSTAT ose burimi zyrtar i përdorur nga bashkia.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, grupmoshës dhe gjinisë.
Kufizimet	Varet nga saktësia e të dhënave demografike.

TREGUESI 2312B06 SHKALLA E REGJISTRIMIT NË KOPSHTE PUBLIKE DHE PRIVATE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312B06
Shërbimi	Arsimi bazë
Pjesë e SMP	Po
Kodi SMP	A02
Përshkrimi i treguesit	Reflekton përfshirjen e fëmijëve të moshës 3–6 vjeç në institucionet e arsimit parashkollor, duke ndarë pjesëmarrjen në sektorin publik dhe atë privat.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë shkallën e aksesit të fëmijëve të grupmoshës 3–6 vjeç në arsimin parashkollor dhe të mbështesë planifikimin e politikave për zgjerimin e mbulimit të shërbimit në nivel vendor.
Formula e llogaritjes	((D28+D29)/D27) × 100
Njësia matëse	%
Interpretimi	Treguesi paraqet përqindjen e fëmijëve të grupmoshës 3–6 vjeç të regjistruar në kopshte publike dhe private në raport me numrin total të fëmijëve të kësaj

	grupmoshe në bashki. Vlera më të larta tregojnë akses më të madh në arsimin parashkollor. Treguesi mund të disagregohet sipas sektorit publik dhe privat për të analizuar strukturën e ofrimit të shërbimit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor në bashki.
Kufizimet	Treguesi mat nivelin e regjistrimit, por nuk vlerëson frekuentimin efektiv, cilësinë e shërbimit apo kohëzgjatjen e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor.

PASAPORTA E TË DHËNËS D28

Shënim: Për përshkrimin e plotë të të dhënës **D28 – Numri i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike**, referojuni **pasaportës së të dhënës D28**, e cila paraqitet për herë të parë te **treguesi 2312A03 – Numri mesatar i fëmijëve në një klasë kopshti publik**.

D29 NUMRI I FËMIJËVE TË MOSHËS 3-6 VJEÇ QË FREKUENTOJNË KOPSHTET PRIVATE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D29
Emërtimi i të dhënës	**Numri i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private**
Përshkrimi i të dhënës	Numri i fëmijëve të grupmoshës 3–6 vjeç të regjistruar dhe që frekuentojnë kopshte private të licencuara në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshtet private.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet me raportimet e institucioneve private dhe regjistrat e Drejtorisë Arsimore.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Raportimet administrative të institucioneve private.
Institucioni Përgjegjës	Drejtoria Arsimore Vendore dhe institucionet private.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Gjinor
Kufizimet	Varet nga raportimi i plotë dhe në kohë i institucioneve private.

D27 NUMRI I FËMIJËVE TË MOSHËS 3-6 VJEÇ NË BASHKI

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D27
Emërtimi i të dhënës	**Numri i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç në bashki**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i fëmijëve rezidentë të grupmoshës 3 deri në 6 vjeç në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të përcaktojë popullsinë referuese për vlerësimin e mbulimit me arsimin parashkollor.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile ose statistikave zyrtare.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Të dhëna administrative ose statistikore.
Institucioni Përgjegjës	Gjendja Civile, INSTAT ose burimi zyrtar i përdorur nga bashkia.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, grupmoshës dhe gjinisë.
Kufizimet	Varet nga saktësia e të dhënave demografike.

TREGUESI 2312B07 RAPORTI FËMIJË-MËSUES NË KOPSHTE PUBLIKE DHE PRIVATE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312B07
Shërbimi	Arsimi bazë
Pjesë e SMP	Po
Kodi SMP	A03
Përshkrimi i treguesit	Numri mesatar i fëmijëve për një punonjës mësimor në arsimin parashkollor, kopshte publike dhe private.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë raportin ndërmjet numrit të fëmijëve dhe personelit edukativ në institucionet publike dhe private të arsimit parashkollor, si një tregues i rëndësishëm i cilësisë së ofrimit të shërbimit.
Formula e llogaritjes	((D28/D30) + (D29/D31)) / 2
Njësia matëse	Fëmijë/mësues
Interpretimi	Treguesi paraqet numrin mesatar të fëmijëve për një edukator në kopshte publike dhe private. Vlera më të ulëta tregojnë një raport më të favorshëm ndërmjet fëmijëve dhe personelit edukativ, ndërsa vlera më të larta mund të

	sinjalizojnë ngarkesë më të madhe të edukatorëve. Interpretimi duhet të bëhet duke analizuar veçmas sektorin publik dhe privat, si dhe ndryshimet ndërmjet bashkive.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin parashkollor në bashki.
Kufizimet	Treguesi nuk merr në konsideratë organizimin e grupeve sipas moshës, punonjësit me kohë të pjesshme apo dallimet në standardet organizative ndërmjet kopshteve publike dhe private.

PASAPORTA E TË DHËNËS D28

Shënim: Për përshkrimin e plotë të të dhënës **D28 – Numri i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike**, referojuni **pasaportës së të dhënës D28**, e cila paraqitet për herë të parë te **treguesi 2312A03 – Numri mesatar i fëmijëve në një klasë kopshti publik**.

PASAPORTA E TË DHËNËS D29

Shënim: Për përshkrimin e plotë të të dhënës **D29 – Numri i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private**, referojuni **pasaportës së të dhënës D29**, e cila paraqitet për herë të parë te **treguesi 2312B06 – Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private**.

D30 NUMRI I EDUKATORËVE NË KOPSHTE PUBLIKE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D30
Emërtimi i të dhënës	**Numri i edukatorëve në kopshte publike**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i edukatorëve të punësuar në kopshtet publike gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë burimet njerëzore mësimore në kopshtet publike.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet me organikën, kontratat e punës dhe listëpagesat.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Regjistri administrativ i personelit.
Institucioni Përgjegjës	Bashkia / Drejtoria përgjegjëse për arsimin parashkollor.
Frekuenca e raportimit	Vjetore

Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas kopshtit, njësisë administrative dhe profilit të edukatorit.
Kufizimet	Nuk pasqyron kualifikimin, përvojën ose ngarkesën në punë.

D31 NUMRI I EDUKATORËVE NË KOPSHTE PRIVATE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D31
Emërtimi i të dhënës	**Numri i edukatorëve në kopshte private**
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i edukatorëve të punësuar në kopshtet private të licencuara që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë burimet njerëzore mësimore në kopshtet private.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet nëpërmjet raportimeve të institucioneve private dhe evidencave të Drejtorisë Arsimore Vendore.
Metoda e verifikimit	Numër
Njësia matëse	Raportime administrative të institucioneve private.
Institucioni Përgjegjës	Drejtoria Arsimore Vendore dhe institucionet private.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Sipas institucionit privat dhe njësisë administrative.
Kufizimet	Varet nga cilësia dhe plotësia e raportimit të institucioneve private.

TREGUESI 2312C07PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	2312C07
Nën-shërbimi	Arsimi parauniversitar
Pjesë e SMP	Po
Kodi SMP	A05
Përshkrimi i treguesit	Reflekton nivelin e planifikimit strategjik të arsimit në nivel vendor dhe monitoron ekzistencën, miratimin dhe zbatimin e planit.
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë nëse bashkia ka hartuar, miratuar dhe është duke zbatuar një Plan Vendor të Arsimit Parauniversitar, në përputhje me prioritetet

	kombëtare dhe nevojat lokale, si instrument për planifikimin dhe zhvillimin e shërbimit.
Formula e llogaritjes	D40
Njësia matëse	Po/Jo
Interpretimi	Treguesi merr vlerën "Po" kur bashkia ka një Plan Vendor të Arsimit Parauniversitar të miratuar nga organi kompetent dhe në zbatim gjatë vitit raportues. Në të kundërt, raportohet "Jo". Ky tregues vlerëson ekzistencën e instrumentit strategjik dhe jo cilësinë apo nivelin e zbatimit të tij.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për arsimin dhe planifikimin strategjik në bashki.
Kufizimet	Treguesi konfirmon ekzistencën dhe zbatimin e planit, por nuk mat cilësinë e dokumentit, progresin e zbatimit apo ndikimin e tij në përmirësimin e shërbimeve arsimore.

D40 PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, I MIRATUAR OSE ZBATUAR

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D40
Emërtimi i të dhënës	**Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar, i miratuar ose zbatuar**
Përshkrimi i të dhënës	Tregon nëse bashkia ka miratuar dhe/ose është duke zbatuar një Plan Vendor për Arsimin Parauniversitar në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare dhe nevojat lokale. Vlera raportohet "Po" kur plani është miratuar nga organi kompetent dhe është në zbatim gjatë vitit raportues; në të kundërt raportohet "Jo".
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nëse bashkia ka miratuar dhe është duke zbatuar një Plan Vendor të Arsimit Parauniversitar, si instrument për planifikimin strategjik dhe zhvillimin e shërbimeve arsimore në nivel vendor.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet me vendimin e Këshillit Bashkiak ose aktin administrativ të miratimit, dokumentin e planit dhe evidencat e zbatimit.
Metoda e verifikimit	Po/Jo
Njësia matëse	Shqyrtimi i dokumentacionit strategjik dhe administrativ të bashkisë.
Institucioni Përgjegjës	Bashkia – Drejtoria/Sektori përgjegjës për arsimin dhe planifikimin strategjik.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Disagregimi	Nuk Aplikohet

Kufizimet	E dhëna konfirmon ekzistencën, miratimin dhe zbatimin formal të planit, por nuk vlerëson cilësinë e dokumentit, shkallën e realizimit të masave, rezultatet e arritura apo ndikimin e tij në përmirësimin e shërbimeve arsimor



SHOQATA KOMBËTARE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË

SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS



FUNKSIONI 24.1

Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale në nivel vendor

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS

SHOQATA KOMBËTARE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË

Ky botim është produkt i Forumit të Performancës
ngritur nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë.

Mbështetur nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS

FUNKSIONI 24.1

Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale në nivel vendor

FUNKSIONI 24.1 KRIJIMI DHE ADMINISTRIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE NË NIVEL VENDOR

Funksioni 24.1 përfshin krijimin, organizimin dhe administrimin nga bashkia të shërbimeve sociale në nivel vendor për individët, familjet dhe grupet në nevojë. Në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, shërbimet u drejtohen ndër të tjera personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve, grave, grave kryefamiljare, grave të dhunuara, viktimave të trafikimit, prindërve me shumë fëmijë, të moshuarve dhe kategorive të tjera që kanë nevojë për mbështetje sociale.
Ushtrimi i funksionit kërkon që bashkia të identifikojë nevojat sociale të territorit, të planifikojë shërbimet, të referojë dhe menaxhojë rastet, të bashkëpunojë me institucionet publike dhe ofruesit e shërbimeve, si dhe të monitorojë mbulimin e grupeve në nevojë.
Treguesit e përfshirë në pasaportat ekzistuese matin katër dimensione kryesore:

- mbulimin e familjeve në nevojë me ndihmë ekonomike;
- trajtimin e rasteve të referuara për mbrojtje nga dhuna;
- mbështetjen sociale për personat me aftësi të kufizuara;
- planifikimin dhe administrimin vendor të shërbimeve sociale.

TREGUESI 241A01 – PËRQINDJA E FAMILJEVE QË MARRIN NDIHMË EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	241A01
Shërbimi	Ndihmë ekonomike
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi i treguesit	Monitorimi i shkallës së mbulimit të familjeve aplikuese me ndihmë ekonomike dhe vlerësimi i efektivitetit të administrimit të skemës së ndihmës ekonomike nga bashkia.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike kundrejt numrit total të familjeve që kanë aplikuar për këtë mbështetje gjatë periudhës raportuese. Ai vlerëson shkallën e mbulimit të aplikimeve me ndihmë ekonomike në përputhje me kriteret e përcaktuara nga

	legjislacioni në fuqi dhe pasqyron aftësinë e bashkisë për të administruar skemën e ndihmës ekonomike.
Rëndësia e treguesit	Ndihma ekonomike përbën një nga instrumentet kryesore të mbrojtjes sociale për familjet në nevojë. Ky tregues mundëson monitorimin e mbulimit të aplikimeve me ndihmë ekonomike, identifikimin e ndryshimeve në kërkesën për mbështetje sociale dhe vlerësimin e kapacitetit administrativ të bashkisë për administrimin e skemës. Ai shërben gjithashtu për planifikimin e politikave sociale dhe analizën e tendencave të varfërisë dhe përjashtimit social në territor.
Formula e llogaritjes	(D63 ÷ D62) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Vlera më e lartë e treguesit tregon se një përqindje më e madhe e familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike kanë përfituar nga skema. Vlera 100% nënkupton se të gjitha familjet aplikuese janë trajtuar si përfituese sipas të dhënave të raportuara.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për administrimin e shërbimeve sociale dhe skemës së ndihmës ekonomike.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative (kur aplikohet).
Kufizimet	Treguesi mat mbulimin e familjeve aplikuese me ndihmë ekonomike dhe nuk vlerëson nivelin e përfitimit, kohëzgjatjen e mbështetjes, cilësinë e administrimit të rastit apo familjet në nevojë që nuk kanë aplikuar ose nuk plotësojnë kriteret ligjore të përfitimit.

D62 – NUMRI I FAMILJEVE QË KANË APLIKUAR PËR NDIHMË EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D62
Emërtimi i të dhënës	Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike
Përshkrimi i të dhënës	Kjo e dhënë përfaqëson numrin total të familjeve që kanë paraqitur një aplikim për përfitimin e ndihmës ekonomike pranë bashkisë gjatë periudhës raportuese, pavarësisht nëse aplikimi është miratuar ose jo.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të sigurojë bazën për matjen e mbulimit të familjeve aplikuese me ndihmë ekonomike dhe të mundësojë monitorimin e kërkesës për këtë shërbim social.
Njësia matëse	Numër familjesh
Metoda e mbledhjes	Të dhënat nxirren nga regjistrat administrativë ose sistemi elektronik i administrimit të skemës së ndihmës ekonomike, duke numëruar të gjitha aplikimet e regjistruara gjatë periudhës raportuese.
Metoda e Verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit administrativ të aplikimeve për ndihmë ekonomike, sistemit elektronik të administrimit të skemës së ndihmës ekonomike dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për administrimin e ndihmës ekonomike.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative (kur aplikohet).

Kufizimet	E dhëna përfshin vetëm familjet që kanë paraqitur aplikim pranë bashkisë dhe nuk pasqyron familjet në nevojë që nuk kanë aplikuar.

D63 – NUMRI I FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NDIHMË EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D63
Emërtimi i të dhënës	Numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike
Përshkrimi i të dhënës	Kjo e dhënë përfaqëson numrin e familjeve që janë miratuar si përfituese të ndihmës ekonomike gjatë periudhës raportuese, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e familjeve që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike dhe të mundësojë llogaritjen e treguesve të mbulimit të shërbimit.
Njësia matëse	Numër familjesh
Metoda e mbledhjes	Të dhënat nxirren nga regjistri administrativ ose sistemi elektronik i administrimit të skemës së ndihmës ekonomike, duke numëruar familjet e miratuara si përfituese gjatë periudhës raportuese.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit administrativ të familjeve përfituese, vendimeve për miratimin e ndihmës ekonomike dhe sistemit elektronik të administrimit të skemës.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për administrimin e ndihmës ekonomike.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative (kur aplikohet).
Kufizimet	E dhëna pasqyron vetëm familjet e miratuara si përfituese gjatë periudhës raportuese dhe nuk jep informacion mbi nivelin e përfitimit apo kohëzgjatjen e mbështetjes.

241B01 – PËRQINDJA E RASTEVE TË REFERUARA NGA MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT QË PËRFITOJNË SHËRBIME SOCIALE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	241B01
Shërbimi	Mbrojtja nga dhuna
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi i treguesit	Monitorimi i shkallës së trajtimit të rasteve të referuara nëpërmjet Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) dhe vlerësimi i efektivitetit të ofrimit të shërbimeve sociale nga bashkia.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e rasteve të referuara nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit që kanë përfituar shërbime sociale kundrejt numrit total të rasteve të referuara gjatë periudhës raportuese. Ai vlerëson aftësinë e bashkisë për të garantuar ndjekjen e rasteve dhe ofrimin e shërbimeve sociale sipas nevojave të identifikuara.
Rëndësia e treguesit	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit është instrumenti kryesor për identifikimin, referimin dhe trajtimin e rasteve që kanë nevojë për mbështetje sociale, veçanërisht viktimat e dhunës në familje dhe kategoritë e tjera në rrezik. Ky tregues mundëson monitorimin e efektivitetit të koordinimit ndërinstitucional dhe të aksesit të rasteve të referuara në shërbimet sociale.

Formula e llogaritjes	(D69 ÷ D68) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Vlera më e lartë e treguesit tregon se një përqindje më e madhe e rasteve të referuara kanë përfituar shërbime sociale. Vlera 100% nënkupton se të gjitha rastet e referuara kanë marrë të paktën një shërbim social gjatë periudhës raportuese.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për shërbimet sociale dhe koordinimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, gjinisë, grupmoshës dhe kategorisë së rastit, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	Treguesi mat mbulimin e rasteve të referuara me shërbime sociale dhe nuk vlerëson cilësinë, intensitetin apo rezultatet e ndërhyrjes së ofruar.

D68 – NUMRI I RASTEVE TË REFERUARA NGA MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D68
Emërtimi i të dhënës	Numri i rasteve të referuara nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit

Përshkrimi i të dhënës	Kjo e dhënë përfaqëson numrin total të rasteve të referuara nëpërmjet Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) gjatë periudhës raportuese për të përfituar shërbime sociale ose shërbime të tjera mbështetëse. Çdo rast regjistrohet vetëm një herë, pavarësisht numrit të institucioneve të përfshira në trajtimin e tij.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e rasteve të referuara nëpërmjet MKR dhe të shërbejë si bazë për monitorimin e aksesit të tyre në shërbimet sociale.
Njësia matëse	Numër rastesh
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe regjistrat e strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki. Numërohen të gjitha rastet e referuara gjatë periudhës raportuese.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), dokumentacionit të referimit dhe regjistrave administrativë të strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për shërbimet sociale dhe koordinimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, gjinisë, grupmoshës dhe kategorisë së rastit, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	E dhëna mbështetet në rastet e referuara dhe të regjistruara në MKR dhe nuk përfshin rastet që nuk janë identifikuar ose nuk janë referuar në mekanizëm.

D69 – NUMRI I RASTEVE TË REFERUARA NGA MEKANIZMI I KOORDINUAR I REFERIMIT QË PËRFITOJNË SHËRBIME SOCIALE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D69
Emërtimi i të dhënës	Numri i rasteve të referuara nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit që përfitojnë shërbime sociale
Përshkrimi i të dhënës	Kjo e dhënë përfaqëson numrin e rasteve të referuara nëpërmjet Mekanizmit të Koordinuar të Referimit që kanë përfituar të paktën një shërbim social gjatë periudhës raportuese, sipas planit të ndërhyrjes ose vendimmarrjes së strukturave përgjegjëse.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë rastet e referuara që kanë marrë shërbime sociale dhe të mundësojë vlerësimin e mbulimit të rasteve me shërbime.
Njësia matëse	Numër rastesh
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të shërbimeve sociale dhe dokumentacioni i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit. Numërohen rastet për të cilat është dokumentuar ofrimi i të paktën një shërbimi social gjatë periudhës raportuese.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, regjistrave administrativë të shërbimeve sociale dhe dokumentacionit që provon ofrimin e të paktën një shërbimi social.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për shërbimet sociale dhe koordinimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit.

Disagregimi	Sipas njësisë administrative, gjinisë, grupmoshës, kategorisë së rastit dhe llojit të shërbimit të ofruar, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm rastet për të cilat është dokumentuar ofrimi i një shërbimi social. Ajo nuk vlerëson cilësinë, intensitetin, kohëzgjatjen apo rezultatet e ndërhyrjes së ofruar.

241C01 – PËRQINDJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË REFERUAR NGA KOMISIONET BIO-PSIKO-SOCIALE QË MARRIN MBËSHTETJE SOCIALE TË INTEGRUAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	241C01
Shërbimi	Shërbime për personat me aftësi të kufizuara
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi i treguesit	Monitorimi i shkallës së mbulimit të personave me aftësi të kufizuara, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale, me shërbime sociale të integruara dhe vlerësimi i aksesit të tyre në shërbimet vendore.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e personave me aftësi të kufizuara të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që kanë përfituar mbështetje sociale të integruar gjatë periudhës raportuese, kundrejt numrit total të personave të referuar. Ai vlerëson aftësinë e bashkisë për të siguruar akses në shërbime sociale për këtë kategori përfituesish.
Rëndësia e treguesit	Personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një nga grupet prioritare të mbrojtjes sociale. Ky tregues mundëson monitorimin e mbulimit të tyre me shërbime sociale, evidenton nivelin e aksesit në mbështetjen e integruar dhe ndihmon bashkinë në planifikimin e shërbimeve dhe burimeve për këtë kategori.

Formula e llogaritjes	(D71 ÷ D70) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Vlera më e lartë e treguesit tregon se një përqindje më e madhe e personave me aftësi të kufizuara të referuar kanë përfituar mbështetje sociale të integruar. Vlera 100% nënkupton se të gjithë personat e referuar kanë marrë shërbimet përkatëse gjatë periudhës raportuese.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për shërbimet sociale.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, grupmoshës, gjinisë dhe llojit të aftësisë së kufizuar, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	Treguesi mat mbulimin e personave të referuar me mbështetje sociale të integruar dhe nuk vlerëson cilësinë, intensitetin apo rezultatet e shërbimeve të ofruara.

D70 – NUMRI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË REFERUAR NGA KOMISIONET BIO-PSIKO-SOCIALE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D70
Emërtimi i të dhënës	Numri i personave me aftësi të kufizuara të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale

Përshkrimi i të dhënës	Kjo e dhënë përfaqëson numrin e personave me aftësi të kufizuara të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale për përfitimin e shërbimeve sociale gjatë periudhës raportuese. Çdo person regjistrohet vetëm një herë gjatë periudhës së raportimit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e personave me aftësi të kufizuara të referuar për përfitimin e shërbimeve sociale dhe të shërbejë si bazë për matjen e mbulimit të tyre me mbështetje sociale.
Njësia matëse	Numër personash
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të bashkisë dhe dokumentacioni i referimeve nga komisionet bio-psiko-sociale. Numërohen të gjithë personat e referuar gjatë periudhës raportuese.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet dokumentacionit të referimit nga komisionet bio-psiko-sociale, regjistrave administrativë të bashkisë dhe regjistrave të shërbimeve sociale.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për shërbimet sociale.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, grupmoshës, gjinisë dhe llojit të aftësisë së kufizuar, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	E dhëna përfshin vetëm personat e referuar nga komisionet bio-psiko-sociale dhe nuk pasqyron personat me aftësi të kufizuara që nuk janë referuar ose nuk kanë kërkuar shërbime sociale.

D71 – NUMRI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA QË MARRIN MBËSHTETJE SOCIALE TË INTEGRUAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D71
Emërtimi i të dhënës	Numri i personave me aftësi të kufizuara që marrin mbështetje sociale të integruar
Përshkrimi i të dhënës	Kjo e dhënë përfaqëson numrin e personave me aftësi të kufizuara që kanë përfituar të paktën një shërbim social të integruar gjatë periudhës raportuese, pas referimit nga komisionet bio-psiko-sociale.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë mbështetje sociale të integruar dhe të mundësojë monitorimin e mbulimit të tyre me shërbime sociale.
Njësia matëse	Numër personash
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të shërbimeve sociale të bashkisë, duke numëruar personat që kanë përfituar shërbime gjatë periudhës raportuese.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave administrativë të shërbimeve sociale, dokumentacionit të ofrimit të shërbimeve dhe evidencave të rasteve përfituese.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për shërbimet sociale.

Disagregimi	Sipas njësisë administrative, grupmoshës, gjinisë, llojit të aftësisë së kufizuar dhe llojit të shërbimit të ofruar, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm personat që kanë përfituar shërbime sociale dhe nuk jep informacion mbi intensitetin, kohëzgjatjen apo rezultatet e mbështetjes së ofruar.

241D01 – PLANI VENDOR SOCIAL

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	241D01
Emërtimi i treguesit	Plani Vendor Social
Shërbimi	Planifikimi i shërbimeve sociale
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë nëse bashkia ka hartuar dhe miratuar një Plan Vendor Social, në përputhje me legjislacionin dhe dokumentet strategjike për zhvillimin e shërbimeve sociale.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi evidenton ekzistencën e një Plani Vendor Social të miratuar nga këshilli bashkiak dhe në fuqi gjatë periudhës raportuese. Ai vlerëson nëse bashkia disponon instrumentin bazë strategjik për planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e shërbimeve sociale vendore.
Rëndësia e treguesit	Plani Vendor Social përbën dokumentin kryesor strategjik për identifikimin e nevojave sociale, planifikimin e shërbimeve, prioritizimin e ndërhyrjeve dhe koordinimin me institucionet publike dhe partnerët lokalë. Prania e këtij dokumenti tregon nivelin e planifikimit strategjik të bashkisë në fushën e mbrojtjes sociale.

Formula e vlerësimit	Po = 1; Jo = 0
Njësia matëse	Po/Jo
Interpretimi	Vlera "Po" tregon se bashkia ka një Plan Vendor Social të miratuar dhe në fuqi gjatë periudhës raportuese. Vlera "Jo" tregon mungesën e një plani të tillë ose faktin që ai nuk është më në fuqi.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për shërbimet sociale.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm ekzistencën e Planit Vendor Social dhe nuk vlerëson cilësinë e tij, nivelin e zbatimit apo ndikimin e masave të planifikuara.

D72 – EKZISTENCA E PLANIT VENDOR SOCIAL TË MIRATUAR

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D72
Emërtimi i të dhënës	Ekzistenca e Planit Vendor Social të miratuar
Përshkrimi i të dhënës	Kjo e dhënë evidenton nëse bashkia disponon një Plan Vendor Social të miratuar nga këshilli bashkiak dhe në fuqi gjatë periudhës raportuese.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të verifikojë ekzistencën e dokumentit strategjik që orienton planifikimin dhe zhvillimin e shërbimeve sociale në nivel vendor.
Njësia matëse	Po/Jo
Metoda e mbledhjes	Verifikimi i vendimit të këshillit bashkiak për miratimin e Planit Vendor Social dhe dokumentit përkatës në fuqi gjatë periudhës raportuese.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor Social, dokumentit të planit dhe dokumentacionit administrativ që dëshmon se plani është në fuqi gjatë periudhës raportuese.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për shërbimet sociale.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm ekzistencën e dokumentit dhe nuk jep informacion mbi cilësinë, përditësimin apo nivelin e zbatimit të Planit Vendor Social.

24.2 Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj

Përshkrimi i funksionit
Funksioni "Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social" përfshin përgjegjësinë e bashkisë për planifikimin, zhvillimin, administrimin dhe monitorimin e programeve të strehimit social, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së familjeve dhe individëve që nuk kanë mundësi të sigurojnë strehim të përshtatshëm në tregun e lirë të banesave.
Në kuadër të këtij funksioni, bashkia identifikon nevojat për strehim social, harton dhe zbaton programe të strehimit në përputhje me legjislacionin në fuqi, administron fondin e

banesave sociale dhe bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për garantimin e aksesit të grupeve prioritare në skemat e strehimit social.
Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë kapacitetin e bashkisë për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme strehimi për familjet në nevojë dhe për të siguruar administrimin efektiv të programeve të strehimit social.

242A01 – PËRQINDJA E FAMILJEVE TË PASTREHA QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	242A01
Emërtimi i treguesit	Përqindja e familjeve të pastreha që përfitojnë nga programet e strehimit social
Shërbimi	Strehimi social
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi i treguesit	Monitorimi i shkallës së mbulimit të familjeve të pastreha me programet e strehimit social dhe vlerësimi i aftësisë së bashkisë për t'iu përgjigjur nevojave për strehim të grupeve në nevojë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e familjeve të pastreha që kanë përfituar nga programet e strehimit social gjatë periudhës raportuese, kundrejt numrit total të familjeve të identifikuara si të pastreha. Ai vlerëson mbulimin e nevojave për strehim social nga bashkia në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Rëndësia e treguesit	Strehimi social është një nga instrumentet kryesore të politikave sociale për garantimin e të drejtës për strehim të përshtatshëm. Ky tregues mundëson monitorimin e mbulimit të familjeve të pastreha me programe strehimi, evidentimin e hendekut ndërmjet nevojës dhe përfitimit, si dhe mbështet planifikimin e fondeve dhe programeve vendore të strehimit.

Formula e llogaritjes	(D65 ÷ D64) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Vlera më e lartë e treguesit tregon se një përqindje më e madhe e familjeve të pastreha kanë përfituar nga programet e strehimit social. Vlera 100% nënkupton se të gjitha familjet e identifikuara si të pastreha kanë përfituar nga një program strehimi social gjatë periudhës raportuese.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për strehimin social.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, programit të strehimit social dhe kategorisë përfituese, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	Treguesi mat mbulimin e familjeve të pastreha me programet e strehimit social dhe nuk vlerëson cilësinë e banesës, kohëzgjatjen e mbështetjes apo ndikimin afatgjatë të programit në mirëqenien e familjeve.

D64 – NUMRI I FAMILJEVE TË PASTREHA

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D64
Emërtimi i të dhënës	Numri i familjeve të pastreha
Përshkrimi i të dhënës	Kjo e dhënë përfaqëson numrin e familjeve të identifikuara dhe të regjistruara nga bashkia si të pastreha, sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin për strehimin social, gjatë periudhës raportuese.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e familjeve që kanë nevojë për strehim social dhe të shërbejë si bazë për planifikimin e programeve të strehimit dhe për llogaritjen e treguesve të mbulimit.
Njësia matëse	Numër familjesh
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistri administrativ i aplikimeve dhe përfituesve të programeve të strehimit social, duke numëruar familjet e regjistruara si të pastreha gjatë periudhës raportuese.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit administrativ të strehimit social, dokumentacionit të identifikimit të familjeve të pastreha dhe dosjeve të aplikimit për programet e strehimit social.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për strehimin social.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative dhe kategorisë përfituese, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	E dhëna përfshin vetëm familjet e identifikuara dhe të regjistruara pranë bashkisë sipas kritereve ligjore dhe nuk pasqyron familjet që ndodhen në nevojë për strehim, por nuk janë regjistruar ose nuk kanë aplikuar.

D65 – NUMRI I FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D65

Emërtimi i të dhënës	Numri i familjeve që përfitojnë nga programet e strehimit social
Përshkrimi i të dhënës	Kjo e dhënë përfaqëson numrin e familjeve që kanë përfituar nga një ose më shumë programe të strehimit social gjatë periudhës raportuese, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Çdo familje numërohet vetëm një herë, pavarësisht llojit të programit nga i cili përfiton.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e familjeve që kanë përfituar nga programet e strehimit social dhe të mundësojë monitorimin e mbulimit të nevojave për strehim.
Njësia matëse	Numër familjesh
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të bashkisë për programet e strehimit social, duke numëruar familjet përfituese gjatë periudhës raportuese.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit administrativ të programeve të strehimit social, vendimeve për përfitim dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për strehimin social.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, llojit të programit të strehimit social dhe kategorisë përfituese, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	E dhëna pasqyron vetëm familjet që kanë përfituar nga programet e strehimit social gjatë periudhës raportuese dhe nuk jep informacion mbi kohëzgjatjen e mbështetjes, kushtet e strehimit apo rezultatet afatgjata të ndërhyrjes.

24.3 Ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore
Përshkrimi i funksionit

Ky funksion përfshin përgjegjësinë e bashkisë për planifikimin, ndërtimin, administrimin dhe mbështetjen e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto qendra ofrojnë shërbime sociale për individët, familjet dhe grupet në nevojë, nëpërmjet shërbimeve ditore dhe rezidenciale, duke synuar përmirësimin e mirëqenies dhe nxitjen e përfshirjes sociale.
Në kuadër të këtij funksioni, bashkia siguron funksionimin e qendrave sociale komunitare publike, mbështet licencimin e tyre sipas legjislacionit përkatës, administron burimet e nevojshme për funksionimin e tyre dhe bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për garantimin e ofrimit të shërbimeve sociale sipas standardeve kombëtare.
Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë disponueshmërinë e qendrave sociale komunitare publike të licencuara në raport me popullsinë e bashkisë, si një tregues i kapacitetit institucional për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

243A01 – QENDRA SOCIALE KOMUNITARE PUBLIKE TË LICENCUARA PËR 10 000 BANORË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	243A01
Emërtimi i treguesit	Qendra sociale komunitare publike të licencuara për 10 000 banorë
Shërbimi	Shërbime sociale ditore dhe rezidenciale
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi i treguesit	Monitorimi i disponueshmërisë së qendrave sociale komunitare publike të licencuara në raport me popullsinë e bashkisë dhe vlerësimi i kapacitetit vendor për ofrimin e shërbimeve sociale ditore dhe rezidenciale.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin e përgjithshëm të qendrave sociale komunitare publike ditore dhe rezidenciale të licencuara, të standardizuar për çdo 10

	000 banorë të bashkisë. Në llogaritje përfshihen qendrat funksionale që kanë licencë të vlefshme gjatë periudhës raportuese.
Rëndësia e treguesit	Qendrat sociale komunitare përbëjnë një pjesë të rëndësishme të infrastrukturës vendore për ofrimin e shërbimeve ndaj individëve dhe grupeve në nevojë. Standardizimi për 10 000 banorë mundëson krahasimin ndërmjet bashkive me madhësi të ndryshme dhe evidenton nivelin relativ të disponueshmërisë së këtyre shërbimeve.
Formula e llogaritjes	((D66 + D67) ÷ D52) × 10 000
Njësia matëse	Qendra të licencuara për 10 000 banorë
Interpretimi	Vlera më e lartë tregon një numër më të madh qendrash sociale komunitare publike të licencuara në raport me popullsinë. Vlera zero tregon se bashkia nuk ka raportuar qendra publike ditore ose rezidenciale të licencuara gjatë periudhës raportuese.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për shërbimet sociale.
Disagregimi	Sipas llojit të qendrës: ditore dhe rezidenciale. Mund të paraqitet edhe sipas njësisë administrative, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	Treguesi mat numrin relativ të qendrave dhe jo kapacitetin e tyre pritës, numrin e përfituesve, shpërndarjen territoriale, gamën apo cilësinë e shërbimeve. Një qendër numërohet vetëm nëse është publike, funksionale dhe me licencë të vlefshme gjatë periudhës raportuese.

D66 – QENDRA SOCIALE KOMUNITARE PUBLIKE DITORE TË LICENCUARA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D66
Emërtimi i të dhënës	Qendra sociale komunitare publike ditore të licencuara
Përshkrimi i të dhënës	Kjo e dhënë përfaqëson numrin e qendrave sociale komunitare publike që ofrojnë shërbime ditore, janë funksionale dhe disponojnë licencë të vlefshme gjatë periudhës raportuese. Qendrat ditore ofrojnë shërbime pa akomodim të përhershëm ose gjatë natës.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë disponueshmërinë e qendrave publike të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale ditore dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit 243A01.
Njësia matëse	Numër qendrash
Metoda e mbledhjes	Identifikohen dhe numërohen qendrat publike ditore që administrohen nga bashkia, janë funksionale gjatë periudhës raportuese dhe kanë licencë të vlefshme. Informacioni verifikohet me dokumentacionin administrativ dhe licencën përkatëse.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit administrativ të qendrave sociale, licencës së vlefshme për ofrimin e shërbimeve sociale dhe dokumentacionit që provon funksionimin e qendrës gjatë periudhës raportuese.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për shërbimet sociale.

Disagregimi	Sipas njësisë administrative dhe kategorisë së përfituesve të cilëve u shërben qendra, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	E dhëna nuk përfshin qendrat private ose jopublike, qendrat pa licencë të vlefshme dhe strukturat që nuk kanë qenë funksionale gjatë periudhës raportuese. Ajo nuk jep informacion mbi kapacitetin, numrin e përfituesve apo cilësinë e shërbimeve.

D67 – QENDRA SOCIALE KOMUNITARE PUBLIKE REZIDENCIALE TË LICENCUARA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D67
Emërtimi i të dhënës	Qendra sociale komunitare publike rezidenciale të licencuara
Përshkrimi i të dhënës	Kjo e dhënë përfaqëson numrin e qendrave sociale komunitare publike që ofrojnë shërbime rezidenciale, janë funksionale dhe disponojnë licencë të vlefshme gjatë periudhës raportuese. Shërbimet rezidenciale përfshijnë akomodimin dhe kujdesin e përfituesve për një periudhë të përcaktuar ose të vazhdueshme.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë disponueshmërinë e qendrave publike të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale rezidenciale dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit 243A01.
Njësia matëse	Numër qendrash
Metoda e mbledhjes	Identifikohen dhe numërohen qendrat publike rezidenciale që administrohen nga bashkia, janë funksionale gjatë periudhës raportuese dhe kanë licencë të vlefshme. Informacioni verifikohet me regjistrat administrativë dhe dokumentacionin e licencimit.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit administrativ të qendrave sociale, licencës së vlefshme për ofrimin e shërbimeve sociale rezidenciale dhe dokumentacionit që provon funksionimin e qendrës gjatë periudhës raportuese.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria/Sektori përgjegjës për shërbimet sociale.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, kategorisë së përfituesve dhe llojit të shërbimit rezidencial, kur është e aplikueshme.
Kufizimet	E dhëna nuk përfshin qendrat private ose jopublike, qendrat pa licencë të vlefshme dhe strukturat që nuk kanë qenë funksionale gjatë periudhës raportuese. Ajo nuk mat kapacitetin akomodues, nivelin e shfrytëzimit, numrin e përfituesve ose cilësinë e shërbimit.

D 52 POPULLSIA E BASHKISË

E dhena eshte shtejuar me lart



SHOQATA KOMBËTARE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË

SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS



FUNKSIONI 25.1

Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS

SHOQATA KOMBËTARE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË

Ky botim është produkt i Forumit të Performancës
ngritur nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë.

Mbështetur nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS

FUNKSIONI 25.1

Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve

Ky funksion përfshin përgjegjësinë e bashkisë për ruajtjen, mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e vlerave dhe të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve dhe infrastrukturës që shërbejnë për ushtrimin e këtij funksioni. Në kuadër të këtij funksioni, bashkia kontribuon në ruajtjen e identitetit kulturor vendor, promovimin e vlerave historike, artistike dhe kulturore të komunitetit, si dhe siguron administrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve kulturore në përgjegjësinë e saj.

Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë kapacitetin e bashkisë për të administruar infrastrukturën kulturore, për të mbështetur zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore vendore dhe për të siguruar burimet e nevojshme për funksionimin e këtij sektori.

252A01 – NUMRI I AKTIVITETEVE KULTURORE PËR 1 000 BANORË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	252A01
Emërtimi i treguesit	Numri i aktiviteteve kulturore për 1 000 banorë
Shërbimi	Shërbimi i Kulturës
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi i treguesit	Vlerëson intensitetin e ofertës kulturore të ofruar nga bashkia në raport me popullsinë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin e aktiviteteve kulturore të organizuara ose bashkë-organizuara nga bashkia gjatë vitit raportues, të standardizuar për çdo 1 000 banorë. Ai mundëson krahasimin e nivelit të ofertës kulturore ndërmjet bashkive me madhësi të ndryshme.
Rëndësia e treguesit	Organizimi i aktiviteteve kulturore është një nga instrumentet kryesore për promovimin e kulturës dhe identitetit lokal. Ky tregues ndihmon në vlerësimin e angazhimit të bashkisë për zhvillimin e jetës kulturore dhe aksesit të komunitetit në aktivitete kulturore.

Formula e llogaritjes	(D134 ÷ D52) × 1 000
Njësia matëse	Numër aktivitetesh për 1 000 banorë
Interpretimi	Vlera më e lartë tregon një ofertë kulturore më intensive në raport me popullsinë. Treguesi nuk mat cilësinë apo ndikimin e aktiviteteve, por vetëm frekuencën e tyre relative.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për kulturën
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	Treguesi nuk merr në konsideratë madhësinë, kohëzgjatjen, cilësinë apo numrin e pjesëmarrësve në secilin aktivitet. Gjithashtu, nuk bën dallim ndërmjet aktiviteteve të organizuara drejtpërdrejt nga bashkia dhe atyre të bashkë-organizuara, nëse të dyja raportohen sipas të njëjtit standard.

D134 – NUMRI TOTAL I AKTIVITETEVE KULTURORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D134
Emërtimi i të dhënës	Numri total i aktiviteteve kulturore
Përshkrimi i të dhënës	Numri i aktiviteteve kulturore të organizuara ose bashkë-organizuara nga bashkia gjatë vitit raportues.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë volumin e aktiviteteve kulturore të zhvilluara nga bashkia dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Numërohen të gjitha aktivitetet kulturore të organizuara ose bashkë-organizuara nga bashkia gjatë periudhës raportuese, bazuar në dokumentacionin administrativ.
Metoda e Verifikimit	Kalendari kulturor, raportet e realizimit të aktiviteteve dhe dokumentacioni përkatës i eventeve.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për kulturën
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	E dhëna paraqet vetëm numrin e aktiviteteve dhe nuk ofron informacion mbi përmasën, cilësinë, kohëzgjatjen apo numrin e pjesëmarrësve në secilin aktivitet.

D 52 POPULLSIA E BASHKISË

E dhena eshte shtjelluar me lart

252A02 – NUMRI I PJESËMARRËSVE NË AKTIVITETE KULTURORE PËR 1 000 BANORË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	252A02
Emërtimi i treguesit	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete kulturore për 1 000 banorë
Shërbimi	Shërbimi i Kulturës
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e pjesëmarrjes së komunitetit në aktivitetet kulturore të organizuara ose të mbështetura nga bashkia.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin total të pjesëmarrësve në aktivitetet kulturore gjatë vitit raportues, të standardizuar për çdo 1 000 banorë. Ai shërben si tregues i përdorimit të shërbimit kulturor dhe i aksesit të qytetarëve në jetën kulturore të bashkisë.
Rëndësia e treguesit	Një ofertë e pasur kulturore nuk garanton domosdoshmërisht pjesëmarrje të lartë. Ky tregues ndihmon në vlerësimin e aftësisë së bashkisë për të angazhuar komunitetin dhe për të ofruar aktivitete që tërheqin dhe përfshijnë qytetarët.
Formula e llogaritjes	(D135 ÷ D52) × 1 000
Njësia matëse	Numër pjesëmarrësish për 1 000 banorë
Interpretimi	Vlera më e lartë tregon një nivel më të lartë pjesëmarrjeje të qytetarëve në aktivitetet kulturore në raport me popullsinë e bashkisë.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për kulturën
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	Treguesi mat numrin e pjesëmarrjeve dhe jo domosdoshmërisht numrin e individëve unikë. I njëjti person mund të marrë pjesë në më shumë se një aktivitet gjatë vitit dhe të numërohet më shumë se një herë. Gjithashtu, saktësia e treguesit varet nga mënyra e regjistrimit të pjesëmarrësve në çdo aktivitet.

D135 – NUMRI TOTAL I PJESËMARRËSVE NË AKTIVITETET KULTURORE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D135
Emërtimi i të dhënës	Numri total i pjesëmarrësve në aktivitetet kulturore
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i pjesëmarrësve në aktivitetet kulturore gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitetet kulturore dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Numërim administrativ bazuar në listat e pjesëmarrësve, sistemin e biletimit ose raportet e organizatorëve të aktiviteteve.

Metoda e Verifikimit	Listat e pjesëmarrësve, biletat ose raportet e organizatorëve të aktiviteteve kulturore.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për kulturën
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	E dhëna paraqet numrin total të pjesëmarrjeve dhe nuk mundëson identifikimin e pjesëmarrësve unikë. Në mungesë të një sistemi të standardizuar regjistrimi, mund të ketë ndryshime në mënyrën e raportimit ndërmjet bashkive.

D 52 POPULLSIA E BASHKISË

E dhena eshte shtjelluar me lart

252A03 - PËRQINDJA E OBJEKTEVE KULTURORE FUNKSIONALE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	252A03
Emërtimi i treguesit	Përqindja e objekteve kulturore funksionale
Shërbimi	Shërbimi i Kulturës
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo

Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë funksionalitetin e infrastrukturës kulturore në administrim të bashkisë dhe kapacitetin e saj për të mbështetur ofrimin e shërbimeve kulturore.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e objekteve kulturore në administrim të bashkisë që janë funksionale gjatë periudhës raportuese, në raport me numrin total të objekteve kulturore.
Rëndësia e treguesit	Infrastrukturat kulturore përbëjnë bazën fizike për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Një nivel i lartë funksionaliteti tregon kapacitet më të mirë të bashkisë për të ofruar shërbime kulturore dhe për të administruar asetet publike të sektorit.
Formula e llogaritjes	(D136/D137)×100
Njësia matëse	%
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e objekteve kulturore janë funksionale dhe të disponueshme për përdorim. Vlera 100% nënkupton se të gjitha objektet kulturore në administrim të bashkisë janë funksionale.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për kulturën
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm funksionalitetin e objekteve dhe nuk jep informacion mbi gjendjen teknike, kapacitetin, shkallën e përdorimit apo cilësinë e shërbimeve që ofrohen në secilin objekt.

D136 – NUMRI I OBJEKTEVE KULTURORE FUNKSIONALE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D136
Emërtimi i të dhënës	Numri i objekteve kulturore funksionale
Përshkrimi i të dhënës	Numri i objekteve kulturore në administrim të bashkisë që janë funksionale dhe përdoren për ushtrimin e veprimtarive kulturore gjatë periudhës raportuese.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e objekteve kulturore funksionale dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	Numër objektesh
Metoda e mbledhjes	Numërim administrativ bazuar në regjistrin e aseteve dhe dokumentacionin e administrimit të objekteve kulturore.
Metoda e Verifikimit	Regjistri i aseteve të bashkisë dhe dokumentacioni i administrimit të objekteve kulturore.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për kulturën
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	Klasifikimi si "funksional" duhet të bazohet në kritere të njëjta ndërmjet bashkive për të siguruar krahasueshmërinë e të dhënave.

D137 – NUMRI TOTAL I OBJEKTEVE KULTURORE NË ADMINISTRIM TË BASHKISË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D137
Emërtimi i të dhënës	Numri total i objekteve kulturore në administrim të bashkisë
Përshkrimi i të dhënës	Numri i përgjithshëm i objekteve kulturore që administrohen nga bashkia, pavarësisht statusit të tyre funksional.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të përcaktojë bazën e referencës për llogaritjen e përqindjes së objekteve kulturore funksionale.
Njësia matëse	Numër objektesh
Metoda e mbledhjes	Numërim administrativ bazuar në regjistrin e aseteve dhe inventarin e objekteve kulturore të administruara nga bashkia.
Metoda e Verifikimit	Regjistri i aseteve dhe inventari i objekteve kulturore të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për kulturën
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	E dhëna nuk jep informacion mbi gjendjen fizike, përdorimin apo nivelin e shfrytëzimit të objekteve kulturore, por vetëm mbi numrin e tyre.

252A04 - SHPENZIM PËR BANOR PËR KULTURË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	252A04
Emërtimi i treguesit	Shpenzim për banor për kulturë
Shërbimi	Shërbimi i Kulturës
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e investimit financiar të bashkisë për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve kulturore në raport me popullsinë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat shumën e shpenzimeve të bashkisë për sektorin e kulturës gjatë vitit raportues, të ndarë me popullsinë rezidente të bashkisë. Ai paraqet nivelin e financimit të shërbimit kulturor për çdo banor.
Rëndësia e treguesit	Burimet financiare të dedikuara kulturës pasqyrojnë prioritetin që bashkia i jep zhvillimit kulturor, administrimit të infrastrukturës kulturore dhe organizimit të aktiviteteve kulturore. Standardizimi për banor mundëson krahasimin ndërmjet bashkive me madhësi të ndryshme.
Formula e llogaritjes	D138 ÷ D52
Njësia matëse	Lekë për banor
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të madh të shpenzimeve publike për kulturën për çdo banor. Treguesi nuk vlerëson eficiencën ose cilësinë e përdorimit të këtyre fondeve.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për kulturën, në bashkëpunim me drejtorinë e financës.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm nivelin e shpenzimeve dhe nuk jep informacion mbi rezultatet, ndikimin apo eficiencën e investimeve në sektorin kulturor. Diferencat ndërmjet bashkive mund të ndikohen edhe nga projekte të veçanta investimi gjatë vitit raportues.

D138 – SHPENZIMET TOTALE TË BASHKISË PËR KULTURËN

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D138
Emërtimi i të dhënës	Shpenzimet totale të bashkisë për kulturën
Përshkrimi i të dhënës	Vlera totale e shpenzimeve buxhetore të realizuara nga bashkia për sektorin e kulturës gjatë vitit raportues, duke përfshirë shpenzimet korrente dhe kapitale sipas klasifikimit buxhetor.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e financimit të sektorit të kulturës dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	Lekë
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga sistemi i menaxhimit financiar dhe raportet e ekzekutimit të buxhetit të bashkisë për funksionin e kulturës.

Metoda e Verifikimit	Raportet financiare dhe sistemi i ekzekutimit të buxhetit të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Financës në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për kulturën.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas shpenzimeve korrente dhe kapitale, kur kjo kërkohet për analiza.
Kufizimet	Të dhënat financiare nuk japin informacion mbi rezultatet ose cilësinë e shërbimeve të financuara dhe mund të ndikohen nga investime të jashtëzakonshme gjatë një viti të caktuar.

D 52 POPULLSIA E BASHKISË

E dhena eshte shtjelluar me lart

252A05 - TË ARDHURA NGA AKTIVITETET KULTURORE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	252A05
Emërtimi i treguesit	Të ardhura nga aktivitetet kulturore
Shërbimi	Shërbimi i Kulturës
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo

Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë aftësinë e bashkisë për të gjeneruar të ardhura nga aktivitetet dhe shërbimet kulturore që administron ose organizon.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat vlerën totale të të ardhurave të realizuara nga aktivitetet kulturore gjatë vitit raportues. Në këto të ardhura mund të përfshihen tarifat e hyrjes, shitja e biletave, qiradhënia e ambienteve kulturore dhe burime të tjera të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin kulturor, sipas klasifikimit financiar të bashkisë.
Rëndësia e treguesit	Gjenerimi i të ardhurave kontribuon në qëndrueshmërinë financiare të sektorit kulturor dhe tregon aftësinë e bashkisë për të mobilizuar burime shtesë për zhvillimin e aktiviteteve dhe administrimin e infrastrukturës kulturore.
Formula e llogaritjes	D139
Njësia matëse	Lekë
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon kapacitet më të madh të bashkisë për të gjeneruar të ardhura nga aktivitetet kulturore. Megjithatë, treguesi nuk vlerëson nëse niveli i të ardhurave është rezultat i një oferte më të mirë kulturore apo i faktorëve të tjerë, si numri i vizitorëve ose politika tarifore.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për kulturën, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas burimit të të ardhurave (bileta, tarifa shërbimi, qiradhënie ambientesh, etj.), kur këto të dhëna janë të disponueshme.

Kufizimet	Niveli i të ardhurave mund të ndikohet nga politika tarifore, madhësia e bashkisë, karakteri falas ose me pagesë i aktiviteteve, si dhe nga ngjarje të veçanta gjatë vitit raportues. Për këtë arsye, treguesi duhet të interpretohet së bashku me treguesit e ofertës dhe pjesëmarrjes kulturore.

D139 – TË ARDHURAT E REALIZUARA NGA AKTIVITETET KULTURORE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D139
Emërtimi i të dhënës	Të ardhurat e realizuara nga aktivitetet kulturore
Përshkrimi i të dhënës	Vlera totale e të ardhurave të realizuara nga bashkia gjatë vitit raportues nga organizimi i aktiviteteve kulturore dhe administrimi i shërbimeve apo objekteve kulturore.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e të ardhurave të gjeneruara nga sektori kulturor dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	Lekë
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga sistemi financiar i bashkisë dhe raportet e realizimit të të ardhurave sipas klasifikimit buxhetor.
Metoda e Verifikimit	Raportet financiare të bashkisë dhe sistemi i menaxhimit financiar.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Financës në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për kulturën.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas burimit të të ardhurave, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	E dhëna pasqyron vetëm të ardhurat financiare dhe nuk mat ndikimin kulturor, cilësinë e shërbimeve apo nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve.

25.2 ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE KULTURORE DHE PROMOVIMI I IDENTITETIT KOMBËTAR E LOKAL, SI DHE ADMINISTRIMI I OBJEKTEVE QË LIDHEN ME USHTRIMIN E KËTYRE FUNKSIONEVE

Ky funksion përfshin përgjegjësinë e bashkisë për organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve kulturore, artistike dhe promovuese që synojnë pasurimin e jetës kulturore të komunitetit dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal. Në kuadër të këtij funksioni, bashkia organizon ose mbështet aktivitete kulturore, festivale, ekspozita, shfaqje artistike dhe iniciativa të tjera që nxisin pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën kulturore, duke administruar njëkohësisht objektet dhe hapësirat ku zhvillohen këto aktivitete.

Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë intensitetin e aktivitetit kulturor, pjesëmarrjen e qytetarëve, funksionalitetin e infrastrukturës kulturore dhe burimet financiare të dedikuara për organizimin dhe zhvillimin e shërbimeve kulturore.

Monitorimi i këtij funksioni mbështetet në të njëjtin grup treguesish të paraqitur në funksionin 25.1 (252A01–252A05). Këta tregues vlerësojnë dimensione të ndryshme të shërbimit kulturor dhe përdoren për monitorimin e të dy funksioneve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 25 të Ligjit nr. 139/2015. Për të shmangur përsëritjen, pasaportat e treguesve paraqiten vetëm një herë, në seksionin 25.1.

25.4 ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE SPORTIVE, ÇLODHËSE E ARGËTUESE, ZHVILLIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONEVE E TË OBJEKTEVE QË LIDHEN ME USHTRIMIN E KËTYRE FUNKSIONEVE

Ky funksion përfshin përgjegjësinë e bashkisë për organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive, çlodhëse dhe argëtuese, si dhe për zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës sportive dhe rekreative në administrimin e saj, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Në kuadër të këtij funksioni, bashkia organizon ose mbështet aktivitete sportive dhe rekreative për grupmosha të ndryshme, administron objektet sportive dhe hapësirat publike të dedikuara për sport dhe argëtim, si dhe krijon kushte për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitet fizik dhe jetën sportive të komunitetit.

Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë kapacitetin e bashkisë për të ofruar shërbime sportive dhe rekreative nëpërmjet organizimit të aktiviteteve sportive, pjesëmarrjes së qytetarëve në këto aktivitete, funksionalitetit të infrastrukturës sportive, nivelit të financimit të sektorit dhe aksesit të komunitetit në hapësira sportive publike.

254A01- NUMRI I AKTIVITETEVE SPORTIVE PËR 1 000 BANORË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	254A01
Emërtimi i treguesit	Numri i aktiviteteve sportive për 1 000 banorë
Shërbimi	Sport dhe Rekreacion
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e ofertës së aktiviteteve sportive të organizuara ose të bashkëorganizuara nga bashkia në raport me popullsinë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin e aktiviteteve sportive të organizuara ose të mbështetura nga bashkia gjatë vitit raportues, të standardizuar për 1 000 banorë.
Rëndësia e treguesit	Organizimi i aktiviteteve sportive përbën një nga instrumentet kryesore për promovimin e aktivitetit fizik, përfshirjes sociale dhe jetës komunitare. Standardizimi për 1 000 banorë mundëson krahasimin e ofertës sportive ndërmjet bashkive me madhësi të ndryshme.

Formula e llogaritjes	(D140 ÷ D52) × 1000
Njësia matëse	Aktivitete për 1 000 banorë
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një ofertë më të madhe aktivitetesh sportive në raport me popullsinë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për sportin dhe rekreacionin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas llojit të aktivitetit sportiv ose grupmoshës së përfituesve, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi mat numrin e aktiviteteve dhe jo domosdoshmërisht cilësinë, kohëzgjatjen apo nivelin e pjesëmarrjes në secilin aktivitet.

D140 – NUMRI TOTAL I AKTIVITETEVE SPORTIVE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D140
Emërtimi i të dhënës	Numri total i aktiviteteve sportive
Përshkrimi i të dhënës	Numri i aktiviteteve sportive të organizuara ose të bashkëorganizuara nga bashkia gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë ofertën vjetore të aktiviteteve sportive dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.

Njësia matëse	Numër aktivitetesh
Metoda e mbledhjes	Numërim administrativ bazuar në kalendarin vjetor të aktiviteteve sportive dhe raportet e realizimit.
Metoda e Verifikimit	Dokumentacioni administrativ i bashkisë mbi aktivitetet sportive
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për sportin dhe rekreacionin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas disiplinës sportive, grupmoshës ose nivelit të aktivitetit, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Për krahasueshmëri ndërmjet bashkive duhet të zbatohen kritere të njëjta për përcaktimin e një "aktiviteti sportiv".

D 52 POPULLSIA E BASHKISË

E dhena eshte shtjelluar me lart

254A02- NUMRI I PJESËMARRËSVE NË AKTIVITETE SPORTIVE PËR 1 000 BANORË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	254A02
Emërtimi i treguesit	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete sportive për 1 000 banorë
Shërbimi	Sport dhe Rekreacion

Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitetet sportive të organizuara ose të mbështetura nga bashkia.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat numrin total të pjesëmarrësve në aktivitetet sportive gjatë vitit raportues, të standardizuar për 1 000 banorë.
Rëndësia e treguesit	Përveç numrit të aktiviteteve të organizuara, rëndësi ka edhe shkalla e pjesëmarrjes së komunitetit. Treguesi jep informacion mbi aksesin dhe angazhimin e qytetarëve në jetën sportive të bashkisë dhe mund të përdoret për të vlerësuar efektivitetin e ofertës sportive.
Formula e llogaritjes	(D141 ÷ D52) × 1000
Njësia matëse	Pjesëmarrës për 1 000 banorë
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të madh pjesëmarrjeje të komunitetit në aktivitetet sportive të organizuara ose të mbështetura nga bashkia.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për sportin dhe rekreacionin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas gjinisë, grupmoshës, disiplinës sportive ose kategorisë së aktivitetit, kur këto të dhëna janë të disponueshme.
Kufizimet	I njëjti individ mund të marrë pjesë në më shumë se një aktivitet gjatë vitit raportues; për këtë arsye treguesi pasqyron numrin e pjesëmarrjeve dhe jo domosdoshmërisht numrin e individëve unikë.

D141 – NUMRI TOTAL I PJESËMARRËSVE NË AKTIVITETET SPORTIVE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D141
Emërtimi i të dhënës	Numri total i pjesëmarrësve në aktivitetet sportive
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i pjesëmarrësve në aktivitetet sportive të organizuara ose të bashkëorganizuara nga bashkia gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e pjesëmarrjes në aktivitetet sportive dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit .
Njësia matëse	Numër pjesëmarrësish
Metoda e mbledhjes	Numërim administrativ bazuar në listat e pjesëmarrësve, regjistrimet në aktivitete ose raportet e organizatorëve.
Metoda e Verifikimit	Listat e pjesëmarrësve dhe raportet e aktiviteteve sportive.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për sportin dhe rekreacionin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas gjinisë, grupmoshës ose disiplinës sportive, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Në mungesë të një sistemi unik regjistrimi, i njëjti person mund të numërohet më shumë se një herë nëse merr pjesë në aktivitete të ndryshme gjatë vitit.

D 52 POPULLSIA E BASHKISË

E dhena eshte shtjelluar me lart

254A03 – PËRQINDJA E OBJEKTEVE SPORTIVE FUNKSIONALE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	254A03
Emërtimi i treguesit	Përqindja e objekteve sportive funksionale
Shërbimi	Sport dhe Rekreacion
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e funksionalitetit të infrastrukturës sportive në administrim të bashkisë dhe kapacitetin e saj për të mbështetur zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përqindjen e objekteve sportive në administrim të bashkisë që janë funksionale gjatë periudhës raportuese, në raport me numrin total të objekteve sportive.
Rëndësia e treguesit	Infrastrukturat sportive përbëjnë bazën fizike për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative. Një nivel i lartë funksionaliteti tregon kapacitet më të mirë të bashkisë për të ofruar shërbime sportive dhe për të garantuar akses të qytetarëve në ambiente të përshtatshme.
Formula e llogaritjes	(D142 ÷ D143) × 100
Njësia matëse	%

Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e objekteve sportive janë funksionale dhe të disponueshme për përdorim. Vlera 100% nënkupton që të gjitha objektet sportive në administrim të bashkisë janë funksionale.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për sportin dhe rekreacionin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas llojit të objektit sportiv (fusha sportive, palestra, stadiume, terrene multifunksionale etj.), kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm funksionalitetin e objekteve dhe nuk jep informacion mbi gjendjen teknike, kapacitetin, shkallën e përdorimit apo cilësinë e infrastrukturës sportive.

D142 – NUMRI I OBJEKTEVE SPORTIVE FUNKSIONALE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D142
Emërtimi i të dhënës	Numri i objekteve sportive funksionale
Përshkrimi i të dhënës	Numri i objekteve sportive publike në pronësi ose administrim të bashkisë që janë funksionale dhe të përdorshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive gjatë periudhës raportuese. Në këtë kategori përfshihen stadiumet, palestrat, fushat sportive, terrenet multifunksionale dhe infrastruktura të tjera sportive, **përfshirë objektet sportive pranë institucioneve arsimore, kur ato janë të disponueshme për përdorim**

	nga komuniteti jashtë procesit mësimor ose në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga bashkia.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e objekteve sportive funksionale dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	Numër objektesh
Metoda e mbledhjes	Numërim administrativ bazuar në regjistrin e aseteve të bashkisë dhe dokumentacionin e administrimit të objekteve sportive.
Metoda e Verifikimit	Regjistri i aseteve, inventari i objekteve sportive dhe dokumentacioni i administrimit të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për sportin dhe rekreacionin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas kategorisë së objektit sportiv.
Kufizimet	Statusi "funksional" duhet të përcaktohet sipas kritereve të njëjta në të gjitha bashkitë. Objektet sportive pranë institucioneve arsimore raportohen vetëm nëse janë të aksesueshme për komunitetin sipas kritereve të mësipërme.

D143 – NUMRI TOTAL I OBJEKTEVE SPORTIVE NË ADMINISTRIM TË BASHKISË

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D143

Emërtimi i të dhënës	Numri total i objekteve sportive publike
Përshkrimi i të dhënës	Numri i përgjithshëm i objekteve sportive publike në pronësi ose administrim të bashkisë, pavarësisht statusit të tyre funksional. Në këtë kategori përfshihen stadiumet, palestrat, fushat sportive, terrenet multifunksionale dhe infrastruktura të tjera sportive, **përfshirë objektet sportive pranë institucioneve arsimore, kur ato janë të disponueshme për përdorim nga komuniteti jashtë procesit mësimor ose në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga bashkia.**
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të përcaktojë bazën e referencës për llogaritjen e përqindjes së objekteve sportive funksionale.
Njësia matëse	Numër objektesh
Metoda e mbledhjes	Numërim administrativ bazuar në regjistrin e aseteve dhe inventarin e objekteve sportive të bashkisë.
Metoda e Verifikimit	Regjistri i aseteve dhe inventari i objekteve sportive të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për sportin dhe rekreacionin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas llojit të objektit sportiv.
Kufizimet	Për qëllime të krahasueshmërisë, objektet sportive pranë institucioneve arsimore përfshihen vetëm nëse janë të disponueshme për përdorim nga komuniteti sipas kritereve të përcaktuara në këtë manual.

254A04 - SHPENZIM PËR BANOR PËR SPORT DHE REKREACION

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	254A04
Emërtimi i treguesit	Shpenzim për banor për sport dhe rekreacion
Shërbimi	Sport dhe Rekreacion
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë nivelin e investimit financiar të bashkisë për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve sportive dhe rekreative në raport me popullsinë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat shumën e shpenzimeve të realizuara nga bashkia për sportin dhe rekreacionin gjatë vitit raportues, të ndarë me popullsinë rezidente të bashkisë.
Rëndësia e treguesit	Burimet financiare të dedikuara sportit dhe rekreacionit pasqyrojnë prioritetin që bashkia i jep zhvillimit të aktivitetit fizik, administrimit të infrastrukturës sportive dhe organizimit të aktiviteteve sportive e rekreative. Standardizimi për banor mundëson krahasimin ndërmjet bashkive me madhësi të ndryshme.
Formula e llogaritjes	D144 ÷ D52
Njësia matëse	Lekë për banor
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të madh të shpenzimeve publike për sportin dhe rekreacionin për çdo banor. Treguesi nuk vlerëson eficiencën ose cilësinë e përdorimit të këtyre fondeve.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për sportin dhe rekreacionin, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas shpenzimeve korrente dhe kapitale, kur kjo kërkohet për analiza.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm nivelin e shpenzimeve dhe nuk jep informacion mbi rezultatet, ndikimin apo eficiencën e investimeve në sektorin e sportit dhe rekreacionit. Diferencat ndërmjet bashkive mund të ndikohen nga investime të veçanta kapitale gjatë vitit raportues.

D144 – SHPENZIMET TOTALE TË BASHKISË PËR SPORTIN DHE REKREACIONIN

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D 144
Emërtimi i të dhënës	Shpenzimet totale të bashkisë për sportin dhe rekreacionin
Përshkrimi i të dhënës	Vlera totale e shpenzimeve buxhetore të realizuara nga bashkia për sportin dhe rekreacionin gjatë vitit raportues, duke përfshirë shpenzimet korrente dhe kapitale sipas klasifikimit buxhetor.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e financimit të sektorit të sportit dhe rekreacionit dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	Lekë
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga sistemi i menaxhimit financiar dhe raportet e ekzekutimit të buxhetit të bashkisë për funksionin e sportit dhe rekreacionit.
Metoda e Verifikimit	Raportet financiare dhe sistemi i ekzekutimit të buxhetit të bashkisë.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria e Financës në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për sportin dhe rekreacionin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas shpenzimeve korrente dhe kapitale, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Të dhënat financiare nuk japin informacion mbi rezultatet ose cilësinë e shërbimeve të financuara dhe mund të ndikohen nga investime të jashtëzakonshme gjatë një viti të caktuar.

D 52 POPULLSIA E BASHKISË

E dhena eshte shtjelluar me lart

254A05- SIPËRFAQJA E OBJEKTEVE SPORTIVE PUBLIKE PËR 1 000 BANORË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	254A05
Emërtimi i treguesit	Sipërfaqja e objekteve sportive publike për 1 000 banorë
Shërbimi	Sport dhe Rekreacion
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi i treguesit	Të vlerësojë disponueshmërinë e infrastrukturës sportive publike në raport me popullsinë e bashkisë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat sipërfaqen totale të objekteve sportive publike në administrim të bashkisë, të standardizuar për 1 000 banorë. Ai pasqyron

	kapacitetin fizik të infrastrukturës sportive të vënë në dispozicion të komunitetit.
Rëndësia e treguesit	Disponueshmëria e hapësirave sportive është një element i rëndësishëm për promovimin e aktivitetit fizik, përfshirjes sociale dhe një stili jetese të shëndetshëm. Standardizimi për 1 000 banorë mundëson krahasimin ndërmjet bashkive me madhësi të ndryshme.
Formula e llogaritjes	(D145 ÷ D52) × 1000
Njësia matëse	m² për 1 000 banorë
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon disponueshmëri më të madhe të hapësirave sportive publike në raport me popullsinë. Megjithatë, treguesi nuk pasqyron cilësinë, funksionalitetin apo shkallën e përdorimit të këtyre objekteve.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për sportin dhe rekreacionin.
Disagregimi	Mund të disagragohet sipas kategorisë së objektit sportiv (stadiume, palestra, fusha sportive, terrene multifunksionale, etj.), kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm sipërfaqen fizike të objekteve sportive dhe nuk jep informacion mbi gjendjen teknike, aksesueshmërinë, cilësinë apo intensitetin e përdorimit të tyre.

D145 – SIPËRFAQJA TOTALE E OBJEKTEVE SPORTIVE PUBLIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D145
Emërtimi i të dhënës	Sipërfaqja totale e objekteve sportive publike
Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja totale (në m²) e objekteve sportive publike në pronësi ose administrim të bashkisë, të destinuara për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative. Në këtë sipërfaqe përfshihen stadiumet, palestrat, fushat sportive, terrenet multifunksionale dhe infrastruktura të tjera sportive, **përfshirë objektet sportive pranë institucioneve arsimore, kur ato janë të disponueshme për përdorim nga komuniteti jashtë procesit mësimor ose në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga bashkia.**
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë kapacitetin fizik të infrastrukturës sportive publike dhe të mundësojë llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	m²
Metoda e mbledhjes	Matje ose evidentim administrativ bazuar në regjistrin e aseteve dhe dokumentacionin teknik të objekteve sportive.
Metoda e Verifikimit	Regjistri i aseteve, dokumentacioni teknik dhe inventari i objekteve sportive të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Drejtoria përgjegjëse për sportin dhe rekreacionin.

Disagregimi	Mund të disagragohet sipas kategorisë së objektit sportiv ose njësisë administrative.
Kufizimet	Nuk përfshihen objektet sportive private apo objektet në administrim të institucioneve të tjera publike, me përjashtim të objekteve sportive pranë institucioneve arsimore që janë të aksesueshme për komunitetin sipas kritereve të përcaktuara në këtë manual.

D 52 POPULLSIA E BASHKISË

E dhena eshte shtjelluar me lart



SHOQATA KOMBËTARE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË

SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS

FUNKSIONI 27.1

Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden Sverige

HELVETAS

SHOQATA KOMBËTARE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË

Ky botim është produkt i Forumit të Performancës
ngritur nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë.

Mbështetur nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS

FUNKSIONI 27.1

Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj

27.1 ADMINISTRIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, TË TRANSFERUAR NË PRONËSI TË TYRE, SIPAS MËNYRËS SË PËRCAKTUAR ME LIGJ

Ky funksion përfshin administrimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të transferuar në pronësi ose administrim të bashkisë, me qëllim garantimin e funksionimit të saj në mbështetje të zhvillimit të aktivitetit bujqësor. Funksioni synon të sigurojë funksionimin e qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes dhe kullimit, të përmirësojë aksesin e tokës bujqësore në këto sisteme dhe të kontribuojë në rritjen e produktivitetit bujqësor dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Në kuadër të këtij funksioni, bashkia planifikon dhe realizon mirëmbajtjen periodike të kanaleve ujitëse dhe kulluese, administron asetet e infrastrukturës së transferuar, monitoron gjendjen funksionale të rrjetit, planifikon ndërhyrje rehabilituese dhe bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore dhe zhvillimin rural.

Monitorimi i këtij funksioni synon të vlerësojë:

- shtrirjen e tokës bujqësore të pajisur me infrastrukturë ujitjeje dhe kullimi;
- gjendjen funksionale të rrjetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese;
- nivelin e mirëmbajtjes së infrastrukturës së transferuar;
- kapacitetin e bashkisë për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes dhe kullimit.

TREGUESI 271A01 - TOKË BUJQËSORE E PAJISUR ME KANALE UJITJE/KULLIMI

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	271A01
Emërtimi i treguesit	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi
Shërbimi	Ujitja dhe kullimi
Pjesë e SMP Kombëtare	Po

Qëllimi i treguesit	Të monitorojë shkallën e mbulimit të tokës bujqësore me infrastrukturë funksionale të ujitjes dhe kullimit.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet përqindjen e sipërfaqes së tokës bujqësore që mbulohet nga sisteme funksionale të ujitjes dhe/ose kullimit në raport me sipërfaqen totale të tokës bujqësore në territorin e bashkisë.
Rëndësia e treguesit	Treguesi vlerëson aksesin e tokës bujqësore në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit, një element kyç për produktivitetin bujqësor, menaxhimin e burimeve ujore dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
Formula	(D42 / D41) × 100
Njësia matëse	%
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e tokës bujqësore përfiton nga infrastruktura funksionale e ujitjes dhe kullimit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.
Disagregimi	Funksional: Ujitje / Kullim
Metoda e verifikimit	DQA e formulës
Kufizimet	Treguesi mat mbulimin e tokës me infrastrukturë funksionale, por nuk vlerëson gjendjen teknike ose performancën hidraulike të sistemit.

D41 – SIPËRFAQJA TOTALE E TOKËS BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D41
Emërtimi i të dhënës	Sipërfaqja totale e tokës bujqësore
Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja totale e tokës bujqësore në territorin administrativ të bashkisë, e shprehur në hektarë, e regjistruar sipas inventarit zyrtar të tokës bujqësore gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë sipërfaqen totale të tokës bujqësore në administrim të bashkisë dhe të shërbejë si bazë për llogaritjen e treguesve që lidhen me infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit.
Njësia matëse	Hektar (ha)
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në regjistrat e tokës bujqësore, inventarin e pronave dhe dokumentacionin teknik të bashkisë.
Metoda e Verifikimit	Regjistri i tokës bujqësore, inventari i pronave publike, dokumentacioni i strukturës përgjegjëse për bujqësinë dhe administrimin e tokës.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tokës bujqësore dhe infrastrukturës së ujitjes e kullimit.

SHËNIM METODOLOGJIK D41

Qëllimi i të dhënës

D41 evidenton sipërfaqen totale të tokës bujqësore në territorin e bashkisë dhe shërben si bazë për llogaritjen e treguesve të mbulimit me infrastrukturë ujitjeje dhe kullimi.

Përfshihen:

- të gjitha sipërfaqet e klasifikuara si tokë bujqësore sipas regjistrave zyrtarë;
- toka arë, pemëtore, vreshta, ullishte dhe kategori të tjera të tokës bujqësore, sipas klasifikimit në fuqi.

Nuk përfshihen:

- sipërfaqet pyjore;
- kullotat;
- tokat urbane;
- sipërfaqet ujore dhe kategori të tjera që nuk klasifikohen si tokë bujqësore.

Metoda e verifikimit

- regjistri i tokës bujqësore;
- inventari zyrtar i pronave;
- hartat kadastrale ose GIS, kur janë të disponueshme.

D42 – SIPËRFAQJA E TOKËS BUJQËSORE E PAJISUR ME KANALE UJITJEJE DHE/OSE KULLIMI FUNKSIONALE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D42
Emërtimi i të dhënës	Sipërfaqja e tokës bujqësore e pajisur me kanale ujitjeje dhe/ose kullimi funksionale

Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja e tokës bujqësore (në hektarë) që shërbehet nga sisteme funksionale të ujitjes dhe/ose kullimit gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë sipërfaqen e tokës që përfiton nga infrastruktura funksionale e ujitjes dhe kullimit dhe të shërbejë si bazë për llogaritjen e treguesit.
Njësia matëse	Hektar (ha)
Metoda e mbledhjes	Evidentim administrativ bazuar në inventarin e infrastrukturës, hartat teknike dhe evidencat e strukturës përgjegjëse.
Metoda e Verifikimit	Inventari i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, dokumentacioni teknik i bashkisë, verifikimet në terren.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tokës bujqësore dhe infrastrukturës së ujitjes e kullimit.
Kufizimet	E dhëna evidenton sipërfaqen e tokës bujqësore të mbuluar nga sisteme funksionale të ujitjes dhe/ose kullimit, por nuk vlerëson gjendjen teknike, kapacitetin hidraulik, intensitetin e përdorimit apo cilësinë e funksionimit të infrastrukturës.

271A02 - PËRQINDJA E KANALEVE UJITËSE DHE KULLUESE FUNKSIONALE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	271A02

Emërtimi i treguesit	Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale
Shërbimi	Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë gjendjen funksionale të rrjetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese në administrim të bashkisë.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet përqindjen e gjatësisë së kanaleve ujitëse dhe kulluese që janë funksionale në raport me gjatësinë totale të rrjetit në administrim të bashkisë.
Rëndësia e treguesit	Treguesi vlerëson shkallën e funksionalitetit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe ndihmon në identifikimin e nevojave për mirëmbajtje dhe rehabilitim.
Formula	((D44/D43) × 100 + (D46/D45) × 100) / 2
Njësia matëse	%
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e rrjetit të kanaleve është funksionale dhe në gjendje të ofrojë shërbimin e ujitjes dhe/ose kullimit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

Disagregimi	Mund të disagragohet sipas kanaleve ujitëse dhe kanaleve kulluese, kur informacioni është i disponueshëm.
Metoda e verifikimit	DQA e formulës
Kufizimet	Treguesi mat funksionalitetin fizik të rrjetit, por nuk vlerëson kapacitetin hidraulik ose cilësinë e funksionimit të tij.

D43 GJATËSIA TOTALE E KANALEVE UJITËSE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D43
Kategoria e të dhënës	Infrastrukturë e ujitjes
Përshkrimi i të dhënës	Gjatësia totale e rrjetit të kanaleve ujitëse që ndodhet në territorin e bashkisë, pavarësisht gjendjes së tij funksionale.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë gjatësinë totale të rrjetit të kanaleve ujitëse në administrim të bashkisë dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e shkallës së funksionalitetit të infrastrukturës së ujitjes.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, kur informacioni është i disponueshëm.
Metoda e verifikimit	Verifikohet në VKM-në përkatëse dhe në inventarët e infrastrukturës së transferuar ose të administruar nga bashkia.
Njësia matëse	Kilometër (km); metër (m)
Metoda e mbledhjes	E dhëna nxirret nga inventari i infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet.
Frekuenca e raportimit	Vjetore

Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Njësia përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes, sipas organikës së bashkisë.
Kufizimet	E dhëna pasqyron vetëm gjatësinë fizike të rrjetit dhe nuk jep informacion mbi gjendjen funksionale, kapacitetin hidraulik apo nivelin e mirëmbajtjes së kanaleve.

D44 GJATËSIA E KANALEVE UJITËSE FUNKSIONALE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D44
Kategoria e të dhënës	Infrastrukturë funksionale e ujitjes
Përshkrimi i të dhënës	Gjatësia e kanaleve ujitëse që gjatë periudhës së raportimit janë në gjendje funksionale për kryerjen e procesit të ujitjes.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë gjatësinë e kanaleve ujitëse funksionale dhe të mundësojë monitorimin e shkallës së funksionalitetit të rrjetit të ujitjes.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, kur informacioni është i disponueshëm.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet tabelës së plotësuar dhe të firmosur nga njësia përgjegjëse për shërbimin.
Njësia matëse	Kilometër (km); metër (m)
Metoda e mbledhjes	Raportim vjetor nga sektorët përgjegjës për mirëmbajtjen dhe monitorimin e kanaleve, i mbështetur në regjistra dhe inspektime.

Institucioni përgjegjës	Njësia përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes, sipas organikës së bashkisë.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm kanalet që konsiderohen funksionale gjatë periudhës raportuese dhe nuk vlerëson kapacitetin e tyre hidraulik, cilësinë e funksionimit apo frekuencën e mirëmbajtjes.

D45 GJATËSIA TOTALE E KANALEVE KULLUESE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D45
Kategoria e të dhënës	Infrastrukturë e kullimit
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë gjatësinë totale të rrjetit të kanaleve kulluese në administrim të bashkisë dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e funksionalitetit të infrastrukturës së kullimit.
Përshkrimi i të dhënës	Gjatësia totale e rrjetit të kanaleve kulluese që ndodhet në territorin e bashkisë, pavarësisht gjendjes së tij funksionale.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, kur informacioni është i disponueshëm.
Metoda e verifikimit	Verifikohet në VKM-në përkatëse dhe në inventarët e infrastrukturës së transferuar ose të administruar nga bashkia.
Njësia matëse	Kilometër (km); metër (m)
Metoda e mbledhjes	E dhëna nxirret nga inventari i infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet.
Institucioni përgjegjës	Njësia përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së kullimit, sipas organikës së bashkisë.

Kufizimet	E dhëna pasqyron vetëm gjatësinë fizike të rrjetit dhe nuk jep informacion mbi gjendjen funksionale, kapacitetin kullues apo nivelin e mirëmbajtjes së kanaleve.

D46 GJATËSIA E KANALEVE KULLUESE FUNKSIONALE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D46
Kategoria e të dhënës	Infrastrukturë funksionale e kullimit
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë gjatësinë e kanaleve kulluese funksionale dhe të mundësojë monitorimin e shkallës së funksionalitetit të rrjetit të kullimit.
Përshkrimi i të dhënës	Gjatësia e kanaleve kulluese që gjatë periudhës së raportimit janë në gjendje funksionale për kryerjen e procesit të kullimit.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, kur informacioni është i disponueshëm.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet tabelës së plotësuar dhe të firmosur nga njësia përgjegjëse për shërbimin.
Njësia matëse	Kilometër (km); metër (m)
Metoda e mbledhjes	Raportim nga sektorët përgjegjës për mirëmbajtjen dhe monitorimin e kanaleve, i verifikuar nëpërmjet regjistrave dhe inspektimeve.
Institucioni përgjegjës	Njësia përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, sipas organikës së bashkisë.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm kanalet kulluese funksionale gjatë periudhës raportuese dhe nuk vlerëson kapacitetin kullues, gjendjen teknike apo cilësinë e funksionimit të tyre.

FUNKSIONI 27.5 – ADMINISTRIMI I FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK

Funksioni 27.5 ka për qëllim administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përmes planifikimit, mbrojtjes, mirëmbajtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve pyjore dhe kullosore. Funksioni synon të sigurojë ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes së fondit pyjor dhe kullosor, përdorimin e qëndrueshëm të tij, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të bashkive për administrimin e këtyre pasurive publike.

Monitorimi i këtij funksioni mbështetet në tre dimensione kryesore:

- **planifikimin**, nëpërmjet ekzistencës dhe zbatimit të Planeve Vendore të Mbarështimit;
- **mbulimin**, nëpërmjet sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullosor të mbuluar me plane mbarështimi;
- **kapacitetin institucional**, nëpërmjet numrit të punonjësve të dedikuar për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor në raport me sipërfaqen në administrim.

275A01 – PLAN VENDOR MBARËSHTIMI I MIRATUAR OSE ZBATUAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	275A01
Emërtimi i treguesit	Plan Vendor Mbarështimi i miratuar ose zbatuar
Shërbimi	Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor publik
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë nëse bashkia disponon një Plan Vendor Mbarështimi të miratuar ose të zbatuar, si bazë për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor publik.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi evidenton ekzistencën e një Plani Vendor Mbarështimi të miratuar nga autoritetet kompetente ose të zbatuar gjatë vitit raportues.

	Ai paraqet statusin e bashkisë në lidhje me instrumentin bazë të planifikimit për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor.
Rëndësia e treguesit	Plani Vendor i Mbarështimit përbën dokumentin themelor për planifikimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor. Ekzistenca e tij mundëson administrimin sipas objektivave afatgjata, planifikimin e ndërhyrjeve dhe monitorimin e përdorimit të burimeve natyrore në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Formula	D47
Njësia matëse	Po / Jo
Interpretimi	Vlera **"Po"** tregon se bashkia disponon një Plan Vendor Mbarështimi të miratuar ose të zbatuar gjatë vitit raportues. Vlera **"Jo"** tregon mungesën e një plani të tillë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Metoda e verifikimit	DQA e formulës dhe verifikimi i dokumentacionit administrativ që provon miratimin ose zbatimin e Planit Vendor të Mbarështimit.
Kufizimet	Treguesi evidenton vetëm ekzistencën e Planit Vendor të Mbarështimit dhe nuk vlerëson cilësinë e planit, nivelin e zbatimit të tij apo efektivitetin e masave të parashikuara.

D47 PLAN VENDOR MBARËSHTIMI I MIRATUAR OSE ZBATUAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D47
Emërtimi i të dhënës	Plan Vendor Mbarështimi i miratuar ose zbatuar
Përshkrimi i të dhënës	Evidenton ekzistencën e planeve të mbarështimit të miratuara nga Këshilli Bashkiak brenda vitit të raportimit ose të zbatuara gjatë vitit të raportimit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nëse bashkia disponon një Plan Vendor Mbarështimi të miratuar ose në zbatim, si instrument bazë për planifikimin dhe administrimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor publik.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Metoda e mbledhjes	Kontroll i dokumentacionit zyrtar të miratimit të planit: Vendimi i Këshillit Bashkiak, publikimi zyrtar në faqen e internetit të bashkisë, Urdhri i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit që miraton Planin e Mbarështimit të Pyjeve. Nëse dokumentacioni ekziston, vlera konsiderohet **"Po"**, në të kundërt **"Jo"**.
Metoda e verifikimit	Verifikohet përmes numrit të vendimit të Këshillit Bashkiak, publikimit zyrtar në faqen e internetit të bashkisë, numrit të urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, si dhe aktit të konfirmimit të vendimit nga Institucioni i Prefektit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik..

Kufizimet	E dhëna konfirmon ekzistencën ose zbatimin formal të Planit Vendor të Mbarështimit, por nuk vlerëson cilësinë e planit, shkallën e zbatimit të masave apo ndikimin e tij në administrimin e fondit pyjor dhe kullosor.

275A02 – SHKALLA E PAJISJES ME PLANE MBARËSHTIMI

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	275A02
Emërtimi i treguesit	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi
Shërbimi	Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor publik
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë shkallën e mbulimit të fondit pyjor dhe kullosor me plane mbarështimi të miratuara, si bazë për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve natyrore.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi paraqet përqindjen e sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullosor të mbuluar me plane mbarështimi në raport me sipërfaqen totale të fondit pyjor dhe kullosor në administrim të bashkisë.
Rëndësia e treguesit	Treguesi vlerëson nivelin e planifikimit të menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor dhe mbështet monitorimin e zbatimit të praktikave të qëndrueshme të administrimit të këtyre pasurive publike.
Formula	(D49 / D48) × 100
Njësia matëse	%

Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e fondit pyjor dhe kullosor është e mbuluar me plane mbarështimi, duke reflektuar një nivel më të lartë planifikimi dhe administrimi të qëndrueshëm.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Metoda e verifikimit	DQA e formulës.
Kufizimet	Treguesi mat mbulimin e fondit pyjor dhe kullosor me plane mbarështimi, por nuk vlerëson cilësinë e planeve ose nivelin e zbatimit të tyre në praktikë.

D48 SIPËRFAQJA GJITHSEJ E FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR NË BASHKI

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D48
Emërtimi i të dhënës	Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki
Përshkrimi i të dhënës	Reflekton sipërfaqen gjithsej që bashkia ka në juridiksion për menaxhim si fond pyjor ose kullosor.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë sipërfaqen totale të fondit pyjor dhe kullosor në administrim të bashkisë dhe të shërbejë si bazë për llogaritjen e

	treguesve që lidhen me planifikimin dhe kapacitetin e administrimit të këtij fondi.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Metoda e mbledhjes	Raportim nga bashkia në bazë të inventarit lokal dhe kombëtar (regjistri i aseteve të bashkisë dhe VKM-të e transferimit të fondit pyjor dhe kullosor).
Metoda e verifikimit	Në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe regjistrin zyrtar të fondit kullosor; në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme; në sistemin shqiptar të informacionit për pyjet **ALFIS (Albanian Forest Information System)**.
Njësia matëse	Hektarë
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor, sipas organikës së miratuar të bashkisë.
Kufizimet	E dhëna pasqyron sipërfaqen në administrim të bashkisë, por nuk jep informacion mbi gjendjen, cilësinë, produktivitetin apo statusin e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor.

D49 SIPËRFAQJA E FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR E MBULUAR ME PLAN MBARËSHTIMI

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D49
Emërtimi i të dhënës	Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plan mbarështimi

Përshkrimi i të dhënës	Tregon pjesën e sipërfaqes që është aktualisht e përfshirë në një plan mbarështimi të miratuar.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor të mbuluar me plane mbarështimi të miratuara dhe të mundësojë vlerësimin e shkallës së planifikimit të administrimit të këtyre burimeve.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Metoda e mbledhjes	Nxirret nga planet ekzistuese të mbarështimit.
Metoda e verifikimit	Krahasim me regjistrin pyjor dhe planet e miratuara.
Njësia matëse	Hektarë
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor, sipas organikës së miratuar të bashkisë.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm sipërfaqen e mbuluar me plan mbarështimi dhe nuk vlerëson cilësinë e planeve, nivelin e zbatimit të tyre apo efektivitetin e masave të planifikuara.

275A03 PUNONJËS PËR 1,000 HEKTARË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	275A03

Emërtimi i treguesit	Punonjës për 1,000 hektarë
Shërbimi	Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor publik
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi i treguesit	Të monitorojë kapacitetin njerëzor të bashkisë për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor në raport me sipërfaqen që menaxhon.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi vlerëson burimet njerëzore të dedikuara nga bashkia për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor. Matja e numrit të punonjësve për çdo 1,000 hektarë ndihmon në kuptimin e shkallës së përkushtimit institucional për administrimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e këtyre sipërfaqeve.
Rëndësia e treguesit	Treguesi vlerëson nëse bashkia disponon kapacitete njerëzore të mjaftueshme për administrimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor.
Formula	(D50 / D48) × 1000
Njësia matëse	Punonjës / 1,000 ha
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të lartë të kapaciteteve njerëzore të dedikuara për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor në raport me sipërfaqen e administruar.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik.

Disagregimi	Nuk aplikohet.
Metoda e verifikimit	DQA e formulës.
Kufizimet	Treguesi mat numrin e punonjësve në raport me sipërfaqen e administruar, por nuk vlerëson kualifikimin, përvojën ose efektivitetin e tyre në kryerjen e detyrave.

D50 NUMRI I PUNONJËSVE PËR MENAXHIMIN E FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D50
Emërtimi i të dhënës	Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor
Përshkrimi i të dhënës	Tregon numrin e punonjësve të përhershëm ose të përkohshëm të angazhuar në strukturat përgjegjëse të bashkisë për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë kapacitetin njerëzor të dedikuar për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e kapaciteteve institucionale të bashkisë.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Metoda e verifikimit	Të dhënat kontrollohen përmes listëpagesave dhe dokumentacionit të burimeve njerëzore.
Njësia matëse	Numër
Metoda e mbledhjes	Mbledhja kryhet nëpërmjet deklarimit të numrit të punonjësve nga sektori përkatës dhe/ose zyra e financës në bashki.

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor, sipas organikës së miratuar të bashkisë.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e punonjësve të angazhuar dhe nuk vlerëson kualifikimin, përvojën, ngarkesën në punë apo efektivitetin e tyre në administrimin e fondit pyjor dhe kullosor.

D48 SIPËRFAQJA GJITHSEJ E FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR NË BASHKI

Shtjelluar me lart.



SHOQATA KOMBËTARE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË

SISTEMI I MATJES SË PERFORMANCËS



FUNKSIONI 29.2

Hartimi i planeve strategjike të zhvillimit ekonomik vendor

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS

SHOQATA KOMBËTARE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË

Ky botim është produkt i Forumit të Performancës
ngritur nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë.

Mbështetur nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS

FUNKSIONI 28.1

HARTIMI I PLANEVE STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK VENDOR

FUNKSIONI 28.1 - HARTIMI I PLANEVE STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK VENDOR

Funksioni **28.1** synon të mbështesë zhvillimin ekonomik vendor nëpërmjet hartimit, miratimit dhe monitorimit të dokumenteve strategjike dhe instrumenteve të planifikimit që orientojnë zhvillimin ekonomik të territorit të bashkisë. Në kuadër të këtij funksioni, bashkia planifikon përdorimin e territorit për zhvillim ekonomik, përcakton zonat me potencial zhvillimi, promovon investimet dhe krijon kushte për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në përputhje me dokumentet e planifikimit vendor.
Monitorimi i këtij funksioni mbështetet në katër dimensione kryesore:

- **investimin publik në zhvillimin ekonomik**, nëpërmjet monitorimit të burimeve buxhetore të dedikuara për zhvillimin ekonomik vendor;
- **planifikimin strategjik dhe territorial**, nëpërmjet ekzistencës dhe zbatimit të dokumenteve strategjike, Planeve të Përgjithshme Vendore (PPV) dhe Planeve të Detajuara Vendore (PDV);
- **zhvillimin e zonave ekonomike**, nëpërmjet monitorimit të sipërfaqes, intensitetit dhe numrit të zonave ekonomike të planifikuara në territor;
- **efikasitetin administrativ**, nëpërmjet monitorimit të procesit të shqyrtimit të lejeve të zhvillimit në zonat ekonomike.

Këta tregues mundësojnë vlerësimin e kapacitetit të bashkisë për të planifikuar zhvillimin ekonomik, për të orientuar investimet dhe për të krijuar një mjedis të favorshëm për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në territor.

281A01 SHPENZIMET PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK NË % TË BUXHETIT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	281A01
Emërtimi	Shpenzimet për zhvillimin ekonomik në % të buxhetit
Shërbimi	Planifikimi strategjik ekonomik
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të matë peshën që zënë shpenzimet për zhvillimin ekonomik vendor në totalin e shpenzimeve faktike të bashkisë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet raportin ndërmjet shpenzimeve faktike të kryera nga bashkia për programet dhe aktivitetet e zhvillimit ekonomik dhe totalit të shpenzimeve faktike të bashkisë gjatë të njëjtit vit raportues. Në

	shpenzimet për zhvillimin ekonomik përfshihen shpenzimet e evidentuara në programin buxhetor përkatës, përfshirë Programin 04130.
Rëndësia	Treguesi evidenton nivelin e prioritetit financiar që bashkia i jep zhvillimit ekonomik vendor. Ai ndihmon në vlerësimin e lidhjes ndërmjet objektivave strategjikë të zhvillimit ekonomik dhe burimeve financiare të përdorura për realizimin e tyre.
Formula	(D146 / D96) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e shpenzimeve të bashkisë është orientuar drejt zhvillimit ekonomik vendor. Interpretimi duhet të bëhet në lidhje me objektivat dhe masat e parashikuara në dokumentet strategjike dhe buxhetore të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për financat, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas vitit raportues; kur të dhënat e lejojnë, sipas programeve ose aktiviteteve të zhvillimit ekonomik.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet raportit vjetor të zbatimit të buxhetit, pasqyrave financiare, evidencave të realizimit faktik të shpenzimeve dhe klasifikimit programor të buxhetit.
Kufizimet	Krahasueshmëria ndërmjet bashkive ose ndërmjet viteve mund të ndikohet nga mënyra e klasifikimit të shpenzimeve për zhvillimin ekonomik, riklasifikimet ndërmjet programeve buxhetore dhe përfshirja e shpenzimeve të ngjashme në programe të tjera. Treguesi mat peshën financiare, por jo domosdoshmërisht cilësinë ose rezultatet e shpenzimeve.

D96 TOTALI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË BASHKISË

Eshtë shtjelluar më lart në manual në seksionin për treguesit financiarë. Në këtë tregues ajo përdoret si emërues dhe përfaqëson totalin faktik të shpenzimeve të bashkisë.

D146 SHPENZIME PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK (LEKË)

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D146

Emërtimi	Shpenzime për zhvillimin ekonomik (lekë)
Përshkrimi	Vlera totale e shpenzimeve faktike të realizuara nga bashkia gjatë vitit raportues për programet dhe aktivitetet që lidhen me zhvillimin ekonomik vendor. Në Excel-in burimor kjo e dhënë lidhet me shpenzimet për programet e zhvillimit ekonomik, përfshirë Programin 04130.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë vlerën e shpenzimeve faktike të realizuara nga bashkia për zhvillimin ekonomik vendor dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e prioritizimit financiar të këtij funksioni.
Njësia matëse	Lekë
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për financat në bashki, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Metoda e mbledhjes	Merret nga sistemi financiar dhe raportet e realizimit të buxhetit, duke identifikuar shpenzimet faktike të regjistruara në programin buxhetor të zhvillimit ekonomik dhe në aktivitetet përkatëse.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet raportit të realizimit të buxhetit, pasqyrave financiare, evidencave kontabël dhe klasifikimit programor të shpenzimeve.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna pasqyron vetëm shpenzimet faktike të realizuara dhe nuk vlerëson efektivitetin, cilësinë apo ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik vendor.

TREGUESI 281A02 PBB LOKALE PËR FRYMË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	281A02
Emërtimi	PBB lokale për frymë
Shërbimi	Planifikimi strategjik i zhvillimit ekonomik vendor
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo

Qëllimi	Të vlerësojë nivelin e zhvillimit ekonomik të territorit të bashkisë përmes Prodhimit të Brendshëm Bruto lokal për frymë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet vlerën e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të gjeneruar në territorin e bashkisë, të llogaritur për çdo banor. Ai shërben si një tregues sintetik i nivelit të aktivitetit ekonomik dhe mirëqenies ekonomike relative në territor.
Rëndësia	PBB-ja lokale për frymë mundëson krahasimin e nivelit të zhvillimit ekonomik ndërmjet bashkive dhe monitorimin e ndryshimeve në kohë. Gjithashtu ndihmon në vlerësimin e ndikimit të politikave dhe investimeve për zhvillimin ekonomik vendor.
Formula	Vlera e PBB-së lokale për frymë sipas burimit zyrtar të të dhënave.
Njësia matëse	Lekë/banor
Interpretimi	Vlera më e lartë tregon një nivel më të lartë të aktivitetit ekonomik për banor në territorin e bashkisë. Interpretimi duhet të bëhet në raport me strukturën ekonomike të territorit dhe zhvillimet në nivel kombëtar.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas vitit raportues.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet të dhënave statistikore zyrtare të publikuara nga INSTAT ose burime të tjera zyrtare kombëtare.
Kufizimet	PBB-ja lokale nuk llogaritet drejtpërdrejt nga bashkia dhe disponueshmëria e saj varet nga publikimi i statistikave zyrtare. Për disa vite ose bashki mund të përdoren vlerësime statistikore.

D147 PBB LOKALE PËR FRYMË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D147
Emërtimi	PBB lokale për frymë
Përshkrimi i të dhënës	Vlera e Prodhimit të Brendshëm Bruto të territorit të bashkisë e llogaritur për një banor, sipas të dhënave statistikore zyrtare.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin e Prodhimit të Brendshëm Bruto për banor në territorin e bashkisë dhe të mundësojë analizën e zhvillimit ekonomik vendor.
Njësia matëse	Lekë/banor
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	INSTAT ose burime të tjera statistikore zyrtare.
Metoda e mbledhjes	Merret nga publikimet zyrtare statistikore për PBB-në lokale ose nga vlerësimet statistikore të disponueshme për nivelin vendor.
Metoda e verifikimit	Verifikohet me publikimet zyrtare të INSTAT dhe dokumentacionin metodologjik përkatës.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna bazohet në statistika zyrtare dhe disponueshmëria e saj varet nga publikimet e INSTAT ose burimeve të tjera zyrtare. Bashkia nuk e prodhon dhe nuk e përditëson drejtpërdrejt këtë të dhënë.

TREGUESI 281A03 PËRQINDJA E TERRITORIT TË MBULUAR ME ZONA EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	281A03
Emërtimi	Përqindja e territorit të mbuluar me zona ekonomike
Shërbimi	Planifikimi strategjik i zhvillimit ekonomik vendor
Pjesë e SMP Kombëtare	Po
Qëllimi	Të vlerësojë shkallën në të cilën dokumentet e planifikimit vendor parashikojnë hapësira të dedikuara për zhvillimin ekonomik.
Përshkrimi	Treguesi mat përqindjen e territorit të bashkisë që, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), është përcaktuar për zona ekonomike ose funksione ekonomike. Ai pasqyron rëndësinë që i jepet zhvillimit ekonomik në planifikimin territorial vendor.

Rëndësia	Treguesi ndihmon në vlerësimin e potencialit të planifikuar për zhvillim ekonomik dhe të kapacitetit të bashkisë për të rezervuar hapësira të përshtatshme për investime, industri, shërbime dhe aktivitete të tjera ekonomike.
Formula	(D151 / D113) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e territorit të bashkisë është planifikuar për zhvillim ekonomik. Interpretimi duhet të bëhet në raport me karakteristikat territoriale, potencialin ekonomik dhe objektivat e zhvillimit vendor.
Frekuenca e raportimit	Vjetore (ose pas miratimit/ndryshimit të PPV-së)
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për zhvillimin ekonomik.
Disagregimi	Sipas vitit raportues.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet PPV-së së miratuar, hartave tematike dhe dokumentacionit teknik të planifikimit territorial.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm sipërfaqen e planifikuar dhe nuk vlerëson nivelin e zhvillimit real apo shkallën e shfrytëzimit të zonave ekonomike.

D151 SIPËRFAQJA E MBULUAR ME ZONA EKONOMIKE (HA)

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D151
Emërtimi	Sipërfaqja e mbuluar me zona ekonomike (ha)
Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja totale e territorit të bashkisë që, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), është përcaktuar për zhvillim ekonomik ose për funksione ekonomike.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë sipërfaqen e territorit të planifikuar për zhvillim ekonomik dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e mbulimit territorial me zona ekonomike.
Njësia matëse	Hektarë (ha)

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki.
Metoda e mbledhjes	Nxirret nga PPV-ja e miratuar, hartat tematike dhe dokumentacioni teknik që identifikon zonat ekonomike në territorin e bashkisë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet PPV-së së miratuar, dokumentacionit hartografik dhe sistemit GIS, kur është i disponueshëm.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm sipërfaqen e planifikuar për zhvillim ekonomik dhe nuk vlerëson nivelin e zhvillimit, investimeve apo përdorimit real të këtyre zonave.

D113 SIPËRFAQJA TOTALE E TERRITORIT TË BASHKISË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D113
Emërtimi	Sipërfaqja totale e territorit të bashkisë
Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja totale administrative e territorit të bashkisë, e shprehur në hektarë, sipas kufijve administrativë në fuqi. Kjo e dhënë përdoret si bazë për llogaritjen e treguesve që matin mbulimin territorial të shërbimeve, infrastrukturës, zonave funksionale ose elementeve të planifikimit vendor.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë sipërfaqen administrative të territorit të bashkisë dhe të shërbejë si bazë referimi për llogaritjen e treguesve që matin mbulimin territorial të shërbimeve, infrastrukturës, zonave funksionale dhe elementeve të planifikimit vendor.
Njësia matëse	Hektarë (ha)
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki, bazuar në të dhënat zyrtare të kufijve administrativë.
Metoda e mbledhjes	Merret nga regjistrat administrativë, dokumentet zyrtare të planifikimit territorial, sistemi GIS i bashkisë ose burime të tjera zyrtare që përcaktojnë sipërfaqen administrative të bashkisë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), dokumentacionit hartografik zyrtar, të dhënave gjeohapësinore ose burimeve të tjera zyrtare të administrimit territorial.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna paraqet sipërfaqen administrative të bashkisë dhe nuk pasqyron mënyrën e përdorimit të territorit, statusin juridik të tokës apo kufizimet funksionale të saj.

281A04 PËRQINDJA E TERRITORIT TË MBULUAR ME PLANE TË DETAJUARA VENDORE (PDV) PËR ZONA EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	281A04
Emërtimi	Përqindja e territorit të mbuluar me Plane të Detajuara Vendore (PDV) për zona ekonomike
Shërbimi	Planifikimi strategjik ekonomik
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë shkallën e planifikimit të detajuar të zonave ekonomike në territorin e bashkisë.
Përshkrimi	Treguesi mat përqindjen e territorit të bashkisë që mbulohet nga Plane të Detajuara Vendore (PDV) të miratuara për zona ekonomike. Ai pasqyron nivelin e avancimit të planifikimit urbanistik të këtyre zonave dhe gatishmërinë e tyre për zhvillim dhe investime.
Rëndësia	Planet e Detajuara Vendore janë instrumente të rëndësishme për realizimin e zhvillimit ekonomik në territor. Prania e tyre krijon siguri juridike dhe teknike për investimet, orienton zhvillimin e infrastrukturës dhe lehtëson administrimin e lejeve të zhvillimit.
Formula	(D152 / D113) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)

Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e territorit të bashkisë është mbuluar me planifikim të detajuar për zhvillim ekonomik.
Frekuenca e raportimit	Vjetore ose pas miratimit të një PDV-je të re.
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për zhvillimin ekonomik.
Disagregimi	Sipas vitit raportues.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet Planeve të Detajuara Vendore të miratuara, dokumentacionit teknik dhe hartave zyrtare të planifikimit territorial.
Kufizimet	Treguesi mat mbulimin me planifikim të detajuar dhe jo shkallën e zhvillimit real ose të shfrytëzimit të zonave ekonomike.

D152 SIPËRFAQJA E MBULUAR ME PLANE TË DETAJUARA VENDORE (PDV) PËR ZONA EKONOMIKE (HA)

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D152
Emërtimi	Sipërfaqja e mbuluar me Plane të Detajuara Vendore (PDV) për zona ekonomike (ha)
Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja totale e zonave ekonomike për të cilat janë miratuar Plane të Detajuara Vendore (PDV), e shprehur në hektarë. Të dhënat përfshijnë vetëm planet në fuqi gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë sipërfaqen e zonave ekonomike të mbuluara me Plane të Detajuara Vendore dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e nivelit të planifikimit të detajuar të zhvillimit ekonomik.
Njësia matëse	Hektarë (ha)
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Nxirret nga regjistri i Planeve të Detajuara Vendore të miratuara, dokumentacioni teknik dhe sistemi GIS i bashkisë, kur është i disponueshëm.

Metoda e mbledhjes	Nxirret nga regjistri i Planeve të Detajuara Vendore (PDV) të miratuara, dokumentacioni teknik i planifikimit territorial dhe sistemi GIS i bashkisë, kur është i disponueshëm.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet vendimeve të miratimit të PDV-ve, dokumentacionit teknik dhe hartografisë zyrtare të bashkisë
Disagregimi	Nuk Aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm sipërfaqen e mbuluar me PDV dhe nuk vlerëson nivelin e zhvillimit, investimeve apo zbatimin e planeve.

D113 SIPËRFAQJA TOTALE E TERRITORIT TË BASHKISË

Shtjelluar me lart

281A05 INTENSITETI I ZONAVE EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	281A05
Emërtimi	Intensiteti i zonave ekonomike
Shërbimi	Planifikimi strategjik ekonomik
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë peshën që zënë zonat ekonomike në territorin administrativ të bashkisë.
Përshkrimi	Treguesi mat raportin ndërmjet sipërfaqes së përgjithshme të zonave ekonomike dhe sipërfaqes totale të territorit të bashkisë. Ai pasqyron shkallën e dedikimit territorial për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe investimeve.
Rëndësia	Intensiteti i zonave ekonomike tregon potencialin territorial që bashkia ka rezervuar për zhvillimin ekonomik. Ky tregues ndihmon në analizimin e politikave të planifikimit territorial dhe të orientimit strategjik të zhvillimit vendor.
Formula	(D154 / D113) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e territorit të bashkisë është e dedikuar për zhvillim ekonomik. Interpretimi duhet të

	bëhet në funksion të karakteristikave territoriale, potencialit ekonomik dhe objektivave të zhvillimit vendor.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për zhvillimin ekonomik.
Disagregimi	Sipas vitit raportues.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet Planit të Përgjithshëm Vendor, regjistrit të zonave ekonomike dhe dokumentacionit teknik të planifikimit territorial.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm shtrirjen territoriale të zonave ekonomike dhe nuk jep informacion mbi nivelin e zhvillimit, investimeve apo shkallën e shfrytëzimit të tyre.

D154 SIPËRFAQJA E ZONAVE EKONOMIKE (HA)

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D154
Emërtimi	Sipërfaqja e zonave ekonomike (ha)
Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja totale e të gjitha zonave ekonomike të përcaktuara në territorin e bashkisë, e shprehur në hektarë. Përfshihen zonat ekonomike të parashikuara ose të miratuara në dokumentet e planifikimit territorial, pavarësisht statusit të zhvillimit të tyre.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë sipërfaqen totale të zonave ekonomike në territorin e bashkisë dhe të shërbejë si bazë për analizën e intensitetit të zhvillimit ekonomik.
Njësia matëse	Hektarë (ha)
Frekuenca e raportimit	Nxirret nga Plani i Përgjithshëm Vendor, regjistri i zonave ekonomike dhe dokumentacioni teknik i planifikimit territorial. Nëse bashkia administron një sistem GIS, sipërfaqja llogaritet mbi bazën e të dhënave gjeohapësinore.
Institucioni raportues	Vjetore
Institucioni Përgjegjës	Bashkia

Metoda e mbledhjes	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet dokumenteve të planifikimit territorial, hartografisë zyrtare dhe sistemit GIS, kur është i disponueshëm.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm sipërfaqen territoriale të zonave ekonomike dhe nuk jep informacion mbi nivelin e zhvillimit, investimeve apo shkallën e shfrytëzimit të tyre.

D113 SIPËRFAQJA TOTALE E TERRITORIT TË BASHKISË

Shtjelluar me lart

281A06 NUMRI I ZONAVE EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	281A06
Emërtimi	Numri i zonave ekonomike
Shërbimi	Planifikimi strategjik ekonomik
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të evidentojë numrin e zonave ekonomike të identifikuara dhe të parashikuara në territorin e bashkisë si instrument për zhvillimin ekonomik vendor.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të zonave ekonomike të identifikuara në territorin e bashkisë, të përcaktuara në dokumentet e planifikimit territorial ose në akte të tjera zyrtare të miratuara. Zonat ekonomike mund të përfshijnë zona industriale, zona për zhvillim biznesi, parqe industriale, parqe teknologjike ose zona të tjera të dedikuara për aktivitete ekonomike.
Rëndësia	Numri i zonave ekonomike pasqyron shkallën e organizimit territorial për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e hapësirave të dedikuara për investime. Ky tregues ndihmon në monitorimin e politikave të planifikimit ekonomik dhe të potencialit të bashkisë për të tërhequr investime.
Formula	D153
Njësia matëse	Numër

Interpretimi	Një numër më i madh tregon një diversifikim më të lartë të zonave të dedikuara për zhvillim ekonomik. Megjithatë, treguesi nuk mat madhësinë, nivelin e zhvillimit apo funksionalitetin e këtyre zonave.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas llojit të zonës ekonomike, kur një klasifikim i tillë administrohet nga bashkia.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet Planit të Përgjithshëm Vendor, Planeve të Detajuara Vendore, regjistrit të zonave ekonomike dhe dokumentacionit përkatës të planifikimit territorial.
Kufizimet	Treguesi evidenton vetëm ekzistencën e zonave ekonomike dhe nuk jep informacion mbi sipërfaqen, nivelin e zhvillimit, shkallën e investimeve apo funksionimin efektiv të tyre.

D153 NUMRI I ZONAVE EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D153
Emërtimi	Numri i zonave ekonomike
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i zonave ekonomike të identifikuara dhe të përcaktuara në dokumentet zyrtare të planifikimit territorial ose në akte të tjera të miratuara nga autoritetet kompetente. Në këtë numër përfshihen vetëm zonat ekonomike që janë në fuqi gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e zonave ekonomike të planifikuara ose të miratuara në territorin e bashkisë dhe të mbështesë monitorimin e zhvillimit ekonomik vendor.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Metoda e mbledhjes	Nxirret nga Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV), Planet e Detajuara Vendore (PDV), regjistri i zonave ekonomike dhe dokumentacioni teknik i administruar nga bashkia.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet dokumenteve zyrtare të planifikimit territorial, regjistrit të zonave ekonomike dhe akteve administrative përkatëse.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e zonave ekonomike dhe nuk jep informacion mbi sipërfaqen, nivelin e zhvillimit apo funksionalitetin e tyre.

281A07 LEJE ZHVILLIMI TË MIRATUARA NË ZONAT EKONOMIKE KUNDREJT APLIKIMEVE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	281A07
Emërtimi	Leje zhvillimi të miratuara në zonat ekonomike kundrejt aplikimeve
Shërbimi	Planifikimi strategjik ekonomik
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë shkallën e miratimit të aplikimeve për leje zhvillimi në zonat ekonomike dhe efektivitetin e procesit administrativ të shqyrtimit të tyre.
Përshkrimi	Treguesi paraqet raportin ndërmjet numrit të lejeve të zhvillimit të miratuara dhe numrit total të aplikimeve të paraqitura për zhvillim në zonat ekonomike gjatë vitit raportues.
Rëndësia	Treguesi ndihmon në monitorimin e funksionimit të administrimit të zhvillimit në zonat ekonomike dhe jep informacion mbi shkallën e përpunimit pozitiv të kërkesave për investim. Ai mund të përdoret gjithashtu për të identifikuar pengesa procedurale ose nevoja për përmirësimin e procesit të shqyrtimit të aplikimeve.
Formula	(D161 / D155) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)

Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e aplikimeve për leje zhvillimi është miratuar. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë cilësinë e aplikimeve dhe përputhshmërinë e tyre me legjislacionin dhe dokumentet e planifikimit territorial.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
Disagregimi	Sipas vitit raportues dhe, kur është e mundur, sipas llojit të zhvillimit ose zonës ekonomike.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të aplikimeve për leje zhvillimi, vendimeve të miratimit dhe sistemit elektronik të administrimit të lejeve, kur është i disponueshëm.
Kufizimet	Treguesi nuk vlerëson arsyet e mosmiratimit të aplikimeve. Një normë më e ulët miratimi nuk nënkupton domosdoshmërisht performancë të dobët administrative, pasi mund të lidhet me aplikime të paplota ose që nuk përmbushin kërkesat ligjore dhe teknike.

D155 NUMRI I APLIKIMEVE PËR LEJE ZHVILLIMI NË ZONAT EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D155
Emërtimi	Numri i aplikimeve për leje zhvillimi në zonat ekonomike
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i aplikimeve të depozituara gjatë vitit raportues për pajisje me leje zhvillimi në zonat ekonomike të përcaktuara në dokumentet e planifikimit territorial.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë kërkesën për zhvillim në zonat ekonomike dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e aktivitetit zhvillimor dhe efikasitetit administrativ.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistri i aplikimeve për leje zhvillimi ose sistemi elektronik i administrimit të lejeve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të aplikimeve, dokumentacionit administrativ dhe sistemit elektronik të lejeve, kur është i disponueshëm.
Disagregimi	Sipas llojit te lejes të zhvillimit
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e aplikimeve të paraqitura dhe nuk jep informacion mbi cilësinë, statusin apo rezultatin e shqyrtimit të tyre.

D161 NUMRI I LEJEVE TË ZHVILLIMIT TË MIRATUARA NË ZONAT EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D161
Emërtimi	Numri i lejeve të zhvillimit të miratuara në zonat ekonomike
Përshkrimi i të dhënës	Numri i lejeve të zhvillimit të miratuara gjatë vitit raportues për zhvillime që realizohen brenda zonave ekonomike të përcaktuara në dokumentet e planifikimit territorial.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e lejeve të zhvillimit të miratuara në zonat ekonomike dhe të mbështesë monitorimin e aktivitetit zhvillimor në këto zona.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistri i lejeve të zhvillimit të miratuara ose sistemi elektronik i administrimit të lejeve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet vendimeve për miratimin e lejeve të zhvillimit, regjistrit administrativ dhe sistemit elektronik të lejeve, kur është i disponueshëm.

Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e lejeve të miratuara dhe nuk jep informacion mbi madhësinë, vlerën apo ndikimin e investimeve të autorizuara.

281A08 KOHA MESATARE E TRAJTIMIT TË LEJEVE TË ZHVILLIMIT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	281A08
Emërtimi	Koha mesatare e trajtimit të lejeve të zhvillimit
Shërbimi	Planifikimi strategjik ekonomik
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë efikasitetin e bashkisë në shqyrtimin dhe trajtimin e aplikimeve për leje zhvillimi në zonat ekonomike.
Përshkrimi	Treguesi paraqet kohën mesatare të nevojshme për trajtimin e aplikimeve për leje zhvillimi, duke filluar nga data e regjistrimit të aplikimit deri në marrjen e vendimit administrativ përfundimtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Rëndësia	Kohëzgjatja e procedurës së trajtimit të lejeve është një tregues i rëndësishëm i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve administrative të bashkisë. Reduktimi i kohës së trajtimit përmirëson klimën e investimeve dhe lehtëson zhvillimin ekonomik vendor.
Formula	D156
Njësia matëse	Ditë kalendarike
Interpretimi	Një vlerë më e ulët tregon një proces administrativ më efikas, për sa kohë respektohen procedurat dhe afatet ligjore të shqyrtimit të aplikimeve.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Disagregimi	Sipas vitit raportues dhe, kur është e mundur, sipas kategorisë së lejes së zhvillimit ose zonës ekonomike.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të aplikimeve, vendimeve administrative dhe sistemit elektronik të administrimit të lejeve, duke krahasuar datën e regjistrimit të aplikimit me datën e vendimmarrjes.
Kufizimet	Treguesi nuk evidenton rastet kur afatet e trajtimit janë pezulluar për shkak të plotësimit të dokumentacionit nga aplikuesi ose shkaqeve të tjera të parashikuara nga legjislacioni. Për këtë arsye, interpretimi duhet të bëhet në përputhje me procedurat administrative në fuqi.

Pasaporta e të dhënës D156

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D156
Emërtimi	Koha mesatare e trajtimit të lejeve të zhvillimit
Përshkrimi i të dhënës	Numri mesatar i ditëve kalendarike të nevojshme për trajtimin e aplikimeve për leje zhvillimi, i llogaritur nga data e regjistrimit të aplikimit deri në datën e marrjes së vendimit administrativ përfundimtar për aplikimet e përfunduara gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	
Njësia matëse	Ditë kalendarike
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit
Metoda e mbledhjes	Llogaritet mbi bazën e të dhënave të regjistrit të aplikimeve ose sistemit elektronik të administrimit të lejeve, duke përllogaritur mesataren e ditëve të trajtimit për të gjitha aplikimet e përfunduara gjatë periudhës raportuese.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të aplikimeve, vendimeve administrative dhe sistemit elektronik të administrimit të lejeve.
Disagregimi	Nuk aplikohet

Kufizimet	E dhëna paraqet kohën mesatare të trajtimit dhe nuk pasqyron rastet kur procedura është pezulluar për arsye të parashikuara nga legjislacioni apo për shkak të plotësimit të dokumentacionit nga aplikuesi

TREGUESI 281A09 PPV ME KOMPONENT EKONOMIK TË MIRATUAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	281A09
Emërtimi	PPV me komponent ekonomik të miratuar
Shërbimi	Planifikimi strategjik ekonomik
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të evidentojë nëse bashkia disponon një Plan të Përgjithshëm Vendor (PPV) të miratuar që përfshin komponentë të dedikuar për zhvillimin ekonomik vendor.
Përshkrimi	Treguesi mat ekzistencën e një Plani të Përgjithshëm Vendor të miratuar, në të cilin janë parashikuar objektiva, politika, zona ose masa që lidhen me zhvillimin ekonomik të territorit. Komponenti ekonomik mund të përfshijë, ndër të tjera, planifikimin e zonave ekonomike, zhvillimin industrial, tregtar, turistik ose aktivitete të tjera me ndikim ekonomik.
Rëndësia	Përfshirja e komponentit ekonomik në PPV siguron që zhvillimi ekonomik të integrohet me planifikimin territorial dhe përdorimin e tokës. Ky tregues vlerëson gatishmërinë strategjike të bashkisë për të orientuar zhvillimin ekonomik në mënyrë të qëndrueshme dhe të koordinuar.
Formula	D150
Njësia matëse	Po/Jo
Interpretimi	Vlera **"Po"** tregon se bashkia ka një PPV të miratuar që përmban komponent ekonomik. Vlera **"Jo"** tregon mungesën e këtij elementi në dokumentin e planifikimit territorial.
Frekuenca e raportimit	Vjetore ose pas miratimit apo përditësimit të PPV-së.
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Disagregimi	Nuk aplikohet.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet vendimit të miratimit të PPV-së dhe dokumentacionit përkatës të planifikimit territorial.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm ekzistencën e komponentit ekonomik në PPV dhe nuk vlerëson cilësinë, nivelin e zbatimit apo efektivitetin e politikave të parashikuara në të.

D150 PPV ME KOMPONENT EKONOMIK TË MIRATUAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D150
Emërtimi	PPV me komponent ekonomik të miratuar
Përshkrimi i të dhënës	Të dhënë që evidenton nëse bashkia ka një Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar, në të cilin përfshihen objektiva, politika ose masa të dedikuara për zhvillimin ekonomik vendor.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nëse bashkia disponon një Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar që përfshin komponent të zhvillimit ekonomik.
Njësia matëse	Po/Jo
Frekuenca e raportimit	Vjetore ose pas miratimit apo përditësimit të PPV-së.
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki.
Metoda e mbledhjes	Të dhënë që evidenton nëse bashkia ka një Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar, në të cilin përfshihen objektiva, politika ose masa të dedikuara për zhvillimin ekonomik vendor.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar dhe dokumentacionit shoqërues që dëshmon përfshirjen e komponentit ekonomik.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna konfirmon ekzistencën e komponentit ekonomik në PPV, por nuk vlerëson cilësinë, nivelin e zbatimit apo efektivitetin e politikave të parashikuara.

TREGUESI 281A10 DOKUMENTE STRATEGJIKE EKONOMIKE TË MIRATUARA	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	281A10
Emërtimi	Dokumente strategjike ekonomike të miratuara
Shërbimi	Planifikimi strategjik ekonomik
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të evidentojë ekzistencën dhe numrin e dokumenteve strategjike të miratuara nga bashkia për planifikimin dhe zhvillimin ekonomik vendor.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e dokumenteve strategjike të miratuara nga organet kompetente të bashkisë, të cilat përcaktojnë objektivat, prioritetet, politikat ose masat për zhvillimin ekonomik vendor. Në këtë kategori përfshihen strategjitë, planet e veprimit, programet sektoriale dhe dokumente të tjera strategjike që mbështesin zhvillimin ekonomik të territorit.
Rëndësia	Dokumentet strategjike krijojnë bazën për planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit ekonomik. Ato ndihmojnë në koordinimin e politikave publike, orientimin e investimeve dhe monitorimin e progresit drejt objektivave të zhvillimit vendor.
Formula	D157
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një numër më i lartë tregon se bashkia ka zhvilluar dhe miratuar më shumë instrumente strategjike për zhvillimin ekonomik. Megjithatë, treguesi nuk mat cilësinë, nivelin e zbatimit apo ndikimin e këtyre dokumenteve.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për planifikimin strategjik.
Disagregimi	Sipas llojit të dokumentit strategjik (strategji, plan veprimi, program sektorial etj.), kur kjo është e mundur.

Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet vendimeve të organeve kompetente për miratimin e dokumenteve strategjike dhe dokumentacionit zyrtar përkatës.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e dokumenteve të miratuara dhe nuk jep informacion mbi cilësinë, shkallën e zbatimit, monitorimin apo efektet e tyre në zhvillimin ekonomik vendor.

D157 NUMRI I DOKUMENTEVE STRATEGJIKE EKONOMIKE TË MIRATUARA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D157
Emërtimi	Numri i dokumenteve strategjike ekonomike të miratuara
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i dokumenteve strategjike për zhvillimin ekonomik vendor të miratuara nga organet kompetente të bashkisë dhe në fuqi gjatë vitit raportues. Në këtë kategori përfshihen strategjitë, planet e veprimit, programet sektoriale dhe dokumente të tjera të ngjashme që adresojnë zhvillimin ekonomik të territorit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë dokumentet strategjike të miratuara për zhvillimin ekonomik vendor dhe të mbështesë monitorimin e kapacitetit planifikues të bashkisë.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për planifikimin strategjik dhe sekretarinë e Këshillit Bashkiak.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistri i akteve të miratuara, dokumentet strategjike të bashkisë dhe vendimet e Këshillit Bashkiak ose të organeve të tjera kompetente.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet dokumenteve strategjike të miratuara, vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Disagregimi	Nuk Aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e dokumenteve strategjike të miratuara dhe nuk vlerëson cilësinë, shkallën e zbatimit apo ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik vendor.

FUNKSIONI 28.2 - ADMINISTRIMI I TREGJEVE

Funksioni **"Administrimi i tregjeve"** përfshin organizimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve publike në territorin e bashkisë, me synim krijimin e kushteve të përshtatshme për tregtimin e produkteve bujqësore, blegtorale dhe produkteve të tjera të lejuara sipas legjislacionit në fuqi. Në kuadër të këtij funksioni, bashkia siguron funksionimin e tregjeve publike, administrimin e hapësirave të shitjes, mirëmbajtjen e infrastrukturës, zbatimin e rregulloreve të funksionimit, si dhe mbikëqyrjen e standardeve të higjienës, sigurisë dhe kushteve të tregtimit.

Administrimi i tregjeve synon të mbështesë prodhuesit lokalë dhe fermerët duke krijuar kanale të organizuara për shitjen e produkteve, të përmirësojë aksesin e konsumatorëve në produkte të freskëta dhe të sigurta, si dhe të kontribuojë në zhvillimin ekonomik vendor. Njëkohësisht, funksioni përfshin administrimin e tregjeve të gjësë së gjallë, duke garantuar respektimin e kërkesave për kontroll veterinar, siguri ushqimore dhe mbrojtje të shëndetit publik.

Performanca e këtij funksioni vlerësohet përmes treguesve që matin disponueshmërinë dhe kapacitetin e tregjeve publike, nivelin e përdorimit të tyre, cilësinë e infrastrukturës, efektivitetin e administrimit, mbështetjen për prodhuesit lokalë, si dhe zbatimin e standardeve ligjore dhe veterinare në funksionimin e tregjeve.

TREGUESI 282A01 NUMRI TOTAL I TREGJEVE PUBLIKE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A01
Emërtimi	Numri total i tregjeve publike bujqësore
Shërbimi	Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të evidentojë numrin e tregjeve publike bujqësore që administrohen nga bashkia dhe janë funksionale gjatë vitit raportues.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të tregjeve publike bujqësore në administrim të bashkisë, të destinuara për tregtimin e produkteve bujqësore dhe agro-ushqimore. Përfshihen vetëm tregjet që janë funksionale dhe ofrojnë shërbim gjatë vitit raportues.
Rëndësia	Tregjet publike bujqësore janë një element i rëndësishëm i infrastrukturës ekonomike vendore. Numri i tyre pasqyron kapacitetin e bashkisë për të krijuar dhe administruar hapësira të organizuara për tregtimin e

	produkteve bujqësore, duke mbështetur prodhuesit lokalë dhe furnizimin e konsumatorëve.
Formula	D162
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një numër më i lartë tregon një rrjet më të zhvilluar të tregjeve publike bujqësore në territorin e bashkisë. Megjithatë, treguesi nuk jep informacion mbi madhësinë, kapacitetin apo cilësinë e infrastrukturës së tregjeve.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike ose struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas njësive administrative ose sipas llojit të tregut, kur një klasifikim i tillë administrohet nga bashkia.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të tregjeve publike, akteve administrative për krijimin ose administrimin e tyre dhe evidencave të strukturës përgjegjëse.
Kufizimet	Treguesi evidenton vetëm numrin e tregjeve funksionale dhe nuk mat kapacitetin, nivelin e përdorimit apo cilësinë e infrastrukturës së tyre.

D162 NUMRI TOTAL I TREGJEVE PUBLIKE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D162
Emërtimi	Numri total i tregjeve publike bujqësore
Përshkrimi i të dhënës	Numri i tregjeve publike bujqësore që administrohen nga bashkia dhe janë funksionale gjatë vitit raportues. Përfshihen vetëm tregjet e destinuara për tregtimin e produkteve bujqësore dhe agro-ushqimore që ofrojnë shërbim në mënyrë të rregullt.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e tregjeve publike bujqësore funksionale në administrim të bashkisë dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e kapacitetit të infrastrukturës tregtare.
Njësia matëse	Numër

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike ose struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistri i tregjeve publike, evidencat administrative dhe dokumentacioni i strukturës përgjegjëse për administrimin e tregjeve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të tregjeve publike, akteve administrative dhe evidencave të administrimit të tregjeve.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative ose sipas llojit të tregut, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e tregjeve funksionale dhe nuk jep informacion mbi madhësinë, kapacitetin, nivelin e përdorimit apo cilësinë e infrastrukturës së tyre.

282A02 SIPËRFAQJA TOTALE E TREGJEVE PUBLIKE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A02
Emërtimi	Sipërfaqja totale e tregjeve publike bujqësore
Shërbimi	Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të evidentojë kapacitetin fizik të tregjeve publike bujqësore në administrim të bashkisë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet sipërfaqen totale të tregjeve publike bujqësore funksionale, të shprehur në metra katrorë. Në këtë sipërfaqe përfshihen hapësirat e destinuara për zhvillimin e aktivitetit të tregtimit, përfshirë vendet e shitjes, hapësirat e qarkullimit, ambientet mbështetëse dhe pjesët e tjera funksionale të tregut.
Rëndësia	Sipërfaqja e tregjeve publike është një tregues i rëndësishëm i kapacitetit të bashkisë për të ofruar hapësira të përshtatshme për tregtimin e produkteve bujqësore. Ajo ndihmon në vlerësimin e potencialit për

	akomodimin e prodhuesve lokalë dhe për përmirësimin e aksesit të konsumatorëve në tregje të organizuara.
Formula	D163
Njësia matëse	Metra katrorë (m²)
Interpretimi	Një sipërfaqe më e madhe tregon një kapacitet më të lartë fizik të tregjeve publike bujqësore. Megjithatë, treguesi nuk jep informacion mbi shkallën e përdorimit apo cilësinë e infrastrukturës.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet dokumentacionit teknik të tregjeve, planeve të administrimit, regjistrit të aseteve dhe dokumentacionit kadastral, sipas rastit.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm sipërfaqen fizike të tregjeve dhe nuk pasqyron nivelin e shfrytëzimit, gjendjen e infrastrukturës apo cilësinë e shërbimeve të ofruara.

D163 SIPËRFAQJA TOTALE E TREGJEVE PUBLIKE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D163
Emërtimi	Sipërfaqja totale e tregjeve publike bujqësore
Përshkrimi i të dhënës	Sipërfaqja totale e të gjitha tregjeve publike bujqësore funksionale në administrim të bashkisë, e shprehur në metra katrorë. Përfshihen të gjitha hapësirat që shërbejnë për funksionimin e tregut, sipas dokumentacionit teknik të administrimit të tij.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë sipërfaqen totale të tregjeve publike bujqësore në administrim të bashkisë dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e kapacitetit fizik të tyre.
Njësia matëse	Metra katrorë (m²)

Frekuenca e raportimit	Të dhënat merren nga regjistri i aseteve të bashkisë, dokumentacioni teknik i tregjeve, projektet e ndërtimit ose dokumentet e administrimit të tyre.
Institucioni raportues	Vjetore
Institucioni Përgjegjës	Bashkia
Metoda e mbledhjes	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për administrimin e aseteve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet dokumentacionit teknik, planeve të tregjeve, regjistrit të pasurive dhe matjeve zyrtare të sipërfaqeve.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor, kur informacioni është i disponueshëm.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm sipërfaqen fizike të tregjeve dhe nuk pasqyron nivelin e përdorimit, gjendjen e infrastrukturës apo cilësinë e shërbimeve të ofruara.

TREGUESI 282A03 SIPËRFAQJA MESATARE PËR TREG BUJQËSOR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A03
Emërtimi	Sipërfaqja mesatare për treg bujqësor
Shërbimi	Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë madhësinë mesatare të tregjeve publike bujqësore në administrim të bashkisë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet sipërfaqen mesatare të një tregu publik bujqësor, duke pjesëtuar sipërfaqen totale të tregjeve publike bujqësore me numrin total të tregjeve funksionale gjatë vitit raportues.
Rëndësia	Madhësia mesatare e tregjeve ndihmon në vlerësimin e kapacitetit fizik të infrastrukturës tregtare të bashkisë dhe mund të përdoret për krahasime ndërmjet bashkive ose për monitorimin e zgjerimit të kapaciteteve në kohë.
Formula	D163 / D162

Njësia matëse	Metra katrorë për treg (m^2/treg)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se tregjet publike bujqësore kanë, mesatarisht, një sipërfaqe më të madhe. Interpretimi duhet të bëhet së bashku me treguesit për përdorimin e vendeve të shitjes dhe numrin e tregtarëve, pasi një sipërfaqe më e madhe nuk nënkupton domosdoshmërisht përdorim më efikas.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Metoda e verifikimit	Verifikohet duke krahasuar sipërfaqen totale të tregjeve me numrin e tregjeve funksionale të raportuara gjatë vitit.
Kufizimet	Treguesi paraqet një mesatare statistikore dhe nuk reflekton ndryshimet në madhësi ndërmjet tregjeve individuale. Bashki me pak tregje mund të paraqesin vlera mesatare që nuk pasqyrojnë shpërndarjen reale të kapaciteteve.

D162 NUMRI TOTAL I TREGJEVE PUBLIKE BUJQËSORE

E dhëna D162 është shtjelluar më lart në manual.

D163 SIPËRFAQJA TOTALE E TREGJEVE PUBLIKE BUJQËSORE

E dhëna D163 është shtjelluar më lart në manual.

TREGUESI 282A04 NUMRI I PIKAVE TË SHITJES

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A04
Emërtimi	Numri i pikave të shitjes
Shërbimi	Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo

Qëllimi	Të evidentojë kapacitetin e tregjeve publike bujqësore për të akomoduar tregtarë dhe prodhues lokalë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të pikave të shitjes të disponueshme në tregjet publike bujqësore që administrohen nga bashkia. Pikat e shitjes përfshijnë tezgat, stendat ose hapësirat e përcaktuara për ushtrimin e aktivitetit tregtar nga fermerët dhe subjektet e tjera të autorizuara.
Rëndësia	Numri i pikave të shitjes pasqyron kapacitetin operacional të tregjeve publike dhe mundësinë për të ofruar hapësira të organizuara për tregtimin e produkteve bujqësore. Ky tregues është bazë për analizimin e nivelit të shfrytëzimit të tregjeve dhe planifikimin e zgjerimit të kapaciteteve.
Formula	D164
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një numër më i madh tregon një kapacitet më të lartë të tregjeve për të akomoduar shitës. Interpretimi duhet të bëhet së bashku me treguesin e përdorimit të vendeve të shitjes (282A05), pasi një numër i lartë pikash nuk nënkupton domosdoshmërisht përdorim të plotë të tyre.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor dhe, kur është e mundur, sipas kategorisë së produkteve që tregtohen.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të tregjeve, planimetrive të tregjeve dhe evidencave administrative të vendeve të shitjes.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e pikave të shitjes të disponueshme dhe nuk jep informacion mbi përdorimin, gjendjen fizike apo funksionalitetin e tyre.

PASAPORTA E TË DHËNËS D164

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D164
Emërtimi	Numri i pikave të shitjes

Përshkrimi i të dhënës	Numri total i pikave të shitjes (tezga, stenda ose hapësira të përcaktuara për tregtim) në tregjet publike bujqësore të administruara nga bashkia, të disponueshme për zhvillimin e aktivitetit tregtar gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e pikave të shitjes të disponueshme në tregjet publike bujqësore dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e kapacitetit të tregjeve.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistri i tregjeve publike, planimetria e tregjeve dhe evidencat administrative të strukturës përgjegjëse për administrimin e tyre.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet planimetrive të tregjeve, regjistrit të vendeve të shitjes dhe inspektimeve administrative.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor, kur është e mundur.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e pikave të shitjes të disponueshme dhe nuk jep informacion mbi përdorimin, gjendjen fizike apo funksionalitetin e tyre.

TREGUESI 282A05 PËRDORIMI MESATAR I VENDEVE TË SHITJES

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A05
Emërtimi	Përdorimi mesatar i vendeve të shitjes
Shërbimi	Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë shkallën e shfrytëzimit të pikave të shitjes në tregjet publike bujqësore.

Përshkrimi	Treguesi paraqet raportin ndërmjet numrit mesatar të pikave të shitjes të zëna gjatë periudhës raportuese dhe numrit total të pikave të shitjes të disponueshme në tregjet publike bujqësore. Ai mat nivelin e përdorimit të kapacitetit ekzistues të tregjeve.
Rëndësia	Treguesi ndihmon në vlerësimin e efektivitetit të administrimit të tregjeve dhe atraktivitetit të tyre për fermerët dhe tregtarët. Një nivel i lartë përdorimi tregon se infrastruktura e tregut po shfrytëzohet në mënyrë efikase, ndërsa një nivel i ulët mund të sinjalizojë nevojën për përmirësime në administrim, infrastrukturë ose organizim.
Formula	(D165 / D164) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një shkallë më të lartë të shfrytëzimit të pikave të shitjes në tregjet publike bujqësore. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë sezonalitetin e aktivitetit bujqësor dhe ditët e funksionimit të tregut.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor dhe, kur është e mundur, sipas periudhës së vitit ose ditëve të funksionimit të tregut.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të administrimit të tregjeve, evidencave të zënies së vendeve të shitjes dhe kontratave ose autorizimeve për përdorimin e tyre.
Kufizimet	Treguesi mund të ndikohet nga sezonaliteti i prodhimit bujqësor, kushtet klimatike dhe frekuenca e organizimit të tregut. Për këtë arsye, rekomandohet që numri i pikave të zëna të llogaritet si mesatare për periudhën raportuese.

PASAPORTA E TË DHËNËS D164

E dhëna D164 është shtjelluar më lart në manual.

D165 NUMRI MESATAR I PIKAVE TË SHITJES TË ZËNA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D165

Emërtimi	Numri mesatar i pikave të shitjes të zëna
Përshkrimi i të dhënës	Numri mesatar i pikave të shitjes të përdorura nga tregtarët ose prodhuesit gjatë periudhës raportuese në tregjet publike bujqësore të administruara nga bashkia.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nivelin mesatar të përdorimit të pikave të shitjes në tregjet publike bujqësore dhe të mbështesë vlerësimin e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Institucioni raportues	Vjetore
Institucioni Përgjegjës	Bashkia
Metoda e mbledhjes	Llogaritet mbi bazën e evidencave të administrimit të tregjeve, duke regjistruar numrin e pikave të shitjes të zëna në çdo ditë funksionimi të tregut dhe duke përllogaritur mesataren për periudhën raportuese
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të administrimit të tregut, kontratave ose autorizimeve për përdorimin e pikave të shitjes dhe evidencave të pagesave, kur ato ekzistojnë.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor dhe, kur është e mundur, sipas periudhës së vitit ose ditëve të funksionimit të tregut.
Kufizimet	E dhëna paraqet një vlerë mesatare dhe mund të ndikohet nga sezonaliteti i prodhimit bujqësor, frekuenca e funksionimit të tregut dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në zënien e vendeve të shitjes.

TREGUESI 282A06 TË ARDHURAT NGA TREGJET BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A06
Emërtimi	Të ardhurat nga tregjet bujqësore
Shërbimi	Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo

Qëllimi	Të vlerësojë nivelin e të ardhurave të realizuara nga administrimi i tregjeve publike bujqësore.
Përshkrimi	Treguesi paraqet vlerën totale të të ardhurave të arkëtuara nga bashkia gjatë vitit raportues nga administrimi i tregjeve publike bujqësore. Në këto të ardhura përfshihen tarifat për përdorimin e vendeve të shitjes, tarifat e administrimit dhe çdo e ardhur tjetër e lidhur drejtpërdrejt me funksionimin e tregjeve publike bujqësore, sipas legjislacionit dhe akteve të miratuara nga bashkia.
Rëndësia	Treguesi ndihmon në vlerësimin e performancës financiare të administrimit të tregjeve publike dhe aftësisë së bashkisë për të gjeneruar të ardhura nga ofrimi i këtij shërbimi. Gjithashtu, ai mund të përdoret për të analizuar efektivitetin e administrimit dhe nivelin e përdorimit të tregjeve.
Formula	D166
Njësia matëse	Lekë
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon nivel më të lartë të të ardhurave të realizuara nga administrimi i tregjeve publike bujqësore. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë numrin e tregjeve, kapacitetin e tyre dhe nivelin e përdorimit të vendeve të shitjes.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për financat.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor, kur evidencat financiare e lejojnë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet evidencave financiare, regjistrave të arkëtimeve, sistemit të financave të bashkisë dhe dokumentacionit kontabël.
Kufizimet	Treguesi pasqyron vetëm të ardhurat e realizuara dhe nuk jep informacion mbi kostot e administrimit të tregjeve apo mbi rentabilitetin e këtij shërbimi. Ndryshimet në tarifat vendore ose në nivelin e arkëtimit mund të ndikojnë në krahasueshmërinë ndërmjet viteve.

D166 TË ARDHURAT NGA TREGJET BUJQËSORE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D166

Emërtimi	Të ardhurat nga tregjet bujqësore
Përshkrimi i të dhënës	Vlera totale e të ardhurave të arkëtuara gjatë vitit raportues nga administrimi i tregjeve publike bujqësore, përfshirë tarifat për përdorimin e vendeve të shitjes dhe të ardhura të tjera të lidhura me funksionimin e tregjeve, sipas akteve të miratuara nga bashkia. **D166 përfshin vetëm të ardhurat e arkëtuara (cash basis)** gjatë vitit raportues dhe **jo detyrimet e papaguara ose të faturuara por ende të paarkëtuara**.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë të ardhurat e realizuara nga administrimi i tregjeve publike bujqësore dhe të mbështesë vlerësimin e performancës financiare të këtij shërbimi.
Njësia matëse	Lekë
Frekuenca e raportimit	Vjetore.
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për financat, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për administrimin e tregjeve.
Metoda e mbledhjes	Verifikohet nëpërmjet pasqyrave financiare, regjistrave të arkëtimeve, dokumentacionit kontabël dhe akteve për miratimin e tarifave vendore
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet pasqyrave financiare, regjistrave të arkëtimeve, dokumentacionit kontabël dhe akteve për miratimin e tarifave vendore.
Disagregimi	Nuk Aplikohet
Kufizimet	E dhëna pasqyron vetëm të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit raportues dhe nuk jep informacion mbi kostot e administrimit, rentabilitetin apo detyrimet e paarkëtuara.

TREGUESI 282A07 NUMRI I INSPEKTIMEVE NË TREGJE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A07
Emërtimi	Numri i inspektimeve në tregje bujqësore
Shërbimi	Administrimi i tregjeve

Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë intensitetin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të ushtruar nga bashkia për funksionimin e tregjeve publike bujqësore.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të inspektimeve të kryera gjatë vitit raportues në tregjet publike bujqësore nga strukturat përgjegjëse të bashkisë ose nga struktura të tjera kompetente që ushtrojnë funksione kontrolli në bashkëpunim me bashkinë. Inspektimet mund të lidhen me respektimin e rregullores së tregut, kushteve higjieno-sanitare, përdorimin e hapësirave, tarifat vendore dhe kërkesa të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
Rëndësia	Kryerja e inspektimeve periodike kontribuon në garantimin e funksionimit të rregullt të tregjeve, respektimin e standardeve të sigurisë dhe higjienës, mbrojtjen e konsumatorit dhe krijimin e kushteve të barabarta për ushtrimin e aktivitetit tregtar.
Formula	D167
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një numër më i lartë i inspektimeve tregon një nivel më të lartë të mbikëqyrjes administrative. Megjithatë, ai nuk tregon domosdoshmërisht cilësinë apo efektivitetin e kontrolleve të kryera.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturat e inspektimit dhe policinë bashkiake, sipas kompetencave.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor dhe, kur është e mundur, sipas llojit të inspektimit.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të inspektimeve, procesverbaleve të kontrollit dhe raporteve të strukturave përgjegjëse.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e inspektimeve të kryera dhe nuk jep informacion mbi rezultatet, shkeljet e konstatuara apo masat e marra pas tyre.

D167 NUMRI I INSPEKTIMEVE NË TREGJE BUJQËSORE	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D167
Emërtimi	Numri i inspektimeve në tregje bujqësore
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i inspektimeve të kryera gjatë vitit raportues në tregjet publike bujqësore nga strukturat përgjegjëse për administrimin dhe kontrollin e tregjeve, sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e inspektimeve të kryera në tregjet publike bujqësore dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e intensitetit të mbikëqyrjes dhe kontrollit të ushtruar nga bashkia.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, policia bashkiake dhe strukturat e tjera të kontrollit, sipas kompetencave.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat e inspektimeve, procesverbalet e kontrollit dhe raportet periodike të strukturave përgjegjëse.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të inspektimeve, procesverbaleve dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e inspektimeve të kryera dhe nuk jep informacion mbi rezultatet, shkeljet e konstatuara apo masat e marra pas tyre.

TREGUESI 282A08 MASAT ADMINISTRATIVE NË TREGJE BUJQËSORE	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	282A08
Emërtimi	Masat administrative në tregje bujqësore

Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Qëllimi	Të evidentojë masat administrative të marra për shkeljet ose problematikat e konstatuara gjatë kontrollit të tregjeve bujqësore.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e masave administrative të vendosura gjatë vitit raportues nga strukturat kompetente për shkeljet e konstatuara në tregjet bujqësore. Përfshihen vetëm masat e dokumentuara në përputhje me procedurat administrative përkatëse.
Rëndësia	Treguesi ndihmon në vlerësimin e zbatimit të rregullave të funksionimit të tregjeve dhe të reagimit institucional ndaj shkeljeve të evidentuara. Ai plotëson informacionin mbi kontrollet dhe inspektimet e kryera, duke treguar nëse konstatimet janë shoqëruar me masa administrative.
Formula	D168
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se gjatë vitit janë vendosur më shumë masa administrative. Megjithatë, treguesi nuk duhet interpretuar automatikisht si performancë pozitive ose negative, pasi rezultati mund të ndikohet si nga niveli i shkeljeve, ashtu edhe nga intensiteti dhe efektiviteti i kontrollit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin dhe kontrollin e tregjeve, sipas kompetencave.
Disagregimi	Sipas tregut bujqësor dhe, kur evidencat e mundësojnë, sipas llojit të masës administrative.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet procesverbaleve të kontrollit, vendimeve administrative, regjistrit të masave dhe dokumentacionit tjetër zyrtar që provon marrjen e masës.
Kufizimet	Numri i masave administrative nuk pasqyron rëndësinë e shkeljeve, nivelin e zbatimit të masave apo rezultatin e procedurave të ankimit. Krahasimi ndërmjet bashkive duhet të marrë parasysh edhe numrin e tregjeve dhe intensitetin e kontrolleve.

D168 MASAT ADMINISTRATIVE NË TREGJE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D168
Emërtimi	Masat administrative në tregje bujqësore
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i masave administrative të marra gjatë vitit raportues për shkeljet e konstatuara në tregjet bujqësore, të dokumentuara nga strukturat kompetente.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin dhe kontrollin e tregjeve.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë, procesverbalet e kontrollit dhe vendimet për masat e marra gjatë vitit raportues.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet procesverbaleve, vendimeve administrative dhe regjistrit të masave të marra.
Disagregimi	Sipas llojit te mases.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e masave administrative të vendosura dhe nuk vlerëson rëndësinë e shkeljeve, efektivitetin e masave apo nivelin e përmbushjes së tyre.

TREGUESI 282A09 TREGJE BUJQËSORE ME INFRASTRUKTURË TË PLOTË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A09
Emërtimi	Tregje bujqësore me infrastrukturë të plotë
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve

Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë përqindjen e tregjeve publike bujqësore që disponojnë infrastrukturën bazë të nevojshme për funksionimin e tyre.
Përshkrimi	Treguesi mat raportin ndërmjet numrit të tregjeve bujqësore që plotësojnë kriteret minimale të infrastrukturës dhe numrit total të tregjeve publike bujqësore të administruara nga bashkia.
Rëndësia	Infrastruktura e përshtatshme është një kusht themelor për funksionimin efikas të tregjeve, garantimin e sigurisë ushqimore, përmirësimin e kushteve të punës për tregtarët dhe ofrimin e një shërbimi cilësor për qytetarët. Ky tregues ndihmon bashkinë të identifikojë nevojat për investime dhe rehabilitim të tregjeve ekzistuese.
Formula	(D169 / D162) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një përqindje më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e tregjeve publike bujqësore disponojnë infrastrukturën bazë të kërkuar për funksionim.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet inspektimeve në terren, inventarit të aseteve dhe dokumentacionit teknik të tregjeve.
Kufizimet	Krahasueshmëria e treguesit varet nga zbatimi i një përkufizimi të unifikuar të konceptit "infrastrukturë e plotë". Në mungesë të kritereve të standardizuara, bashkitë mund të raportojnë në mënyrë të ndryshme.

D169 NUMRI I TREGJEVE BUJQËSORE ME INFRASTRUKTURË TË PLOTË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D169
Emërtimi	Numri i tregjeve bujqësore me infrastrukturë të plotë

Përshkrimi i të dhënës	Numri i tregjeve publike bujqësore që gjatë vitit raportues plotësojnë kriteret minimale të infrastrukturës të përcaktuara nga legjislacioni ose aktet rregullatore të bashkisë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e tregjeve publike bujqësore që plotësojnë standardet e infrastrukturës së përcaktuara nga bashkia dhe të mbështesë vlerësimin e cilësisë së infrastrukturës së tregjeve.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga inventari i tregjeve, raportet e inspektimit dhe dokumentacioni teknik i administrimit të tregjeve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet dokumentacionit teknik, raporteve të inspektimit dhe verifikimeve në terren.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e tregjeve që konsiderohen me infrastrukturë të plotë dhe nuk jep informacion mbi cilësinë e elementeve individuale të infrastrukturës apo nivelin e mirëmbajtjes së tyre.

TREGUESI 282A10PRODHUES LOKALË QË TREGTOJNË NË TREGJE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A10
Emërtimi	Prodhues lokalë që tregtojnë në tregje bujqësore
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të evidentojë numrin e prodhuesve lokalë që përdorin tregjet publike bujqësore për tregtimin e produkteve të tyre.

Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e prodhuesve lokalë që kanë ushtruar aktivitet tregtar në tregjet publike bujqësore gjatë vitit raportues. Për prodhues lokal konsiderohet çdo fermer ose subjekt prodhues me aktivitet në territorin e bashkisë ose në zonën funksionale që shërben tregu, i regjistruar sipas procedurave të administrimit të tregut.
Rëndësia	Treguesi vlerëson rolin e tregjeve publike në mbështetjen e prodhimit vendas dhe krijimin e mundësive për akses të drejtpërdrejtë të fermerëve në treg. Një numër më i lartë prodhuesish lokalë tregon një kontribut më të madh të tregut në zhvillimin ekonomik lokal dhe në forcimin e zinxhirit të shkurtër të furnizimit.
Formula	D170
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se tregjet publike bujqësore përdoren nga një numër më i madh prodhuesish lokalë. Interpretimi duhet të bëhet në raport me madhësinë e bashkisë, numrin e tregjeve dhe potencialin bujqësor të territorit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor dhe, kur është e mundur, sipas njësive administrative ose kategorisë së produkteve bujqësore.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të përdoruesve të tregut, autorizimeve për përdorimin e vendeve të shitjes dhe evidencave administrative të bashkisë.
Kufizimet	Treguesi nuk mat sasinë apo vlerën e produkteve të tregtuara dhe nuk pasqyron frekuencën e pjesëmarrjes së secilit prodhues në treg.

D170 NUMRI I PRODHUESVE LOKALË QË TREGTOJNË NË TREGJE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D170
Emërtimi	Numri i prodhuesve lokalë që tregtojnë në tregje bujqësore

Përshkrimi i të dhënës	Numri total i prodhuesve lokalë që kanë tregtuar produktet e tyre në tregjet publike bujqësore gjatë vitit raportues. Çdo prodhues raportohet vetëm një herë, pavarësisht numrit të ditëve të pjesëmarrjes ose tregjeve ku ka ushtruar aktivitet.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e prodhuesve lokalë që ushtrojnë aktivitet tregtar në tregjet publike bujqësore dhe të mbështesë vlerësimin e rolit të tregjeve në promovimin e prodhimit vendor.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistri i përdoruesve të tregjeve publike, autorizimet për ushtrimin e aktivitetit dhe evidencat administrative të strukturës përgjegjëse për administrimin e tregjeve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të tregtarëve/prodhuesve, autorizimeve për përdorimin e vendeve të shitjes dhe dokumentacionit mbështetës.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e prodhuesve lokalë pjesëmarrës dhe nuk jep informacion mbi vëllimin e tregtimit, frekuencën e pjesëmarrjes apo performancën ekonomike të tyre.

TREGUESI 282A11 HAPËSIRA PËR PRODHUES LOKALË NË TREGJE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A11
Emërtimi	Hapësira për prodhues lokalë në tregje bujqësore
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë shkallën në të cilën tregjet publike bujqësore rezervojnë hapësira të dedikuara për prodhuesit lokalë.

Përshkrimi	Treguesi mat përqindjen e pikave të shitjes në tregjet publike bujqësore që janë të rezervuara për prodhuesit lokalë, në raport me numrin total të pikave të shitjes. Ai pasqyron politikat e bashkisë për promovimin e prodhimit vendas dhe lehtësimin e aksesit të fermerëve lokalë në treg.
Rëndësia	Rezervimi i hapësirave për prodhuesit lokalë kontribuon në forcimin e ekonomisë vendore, rritjen e mundësive të tregtimit të drejtpërdrejtë dhe reduktimin e ndërmjetësimit. Treguesi ndihmon në vlerësimin e masave që bashkia ndërmerr për mbështetjen e fermerëve lokalë.
Formula	(D171 / D164) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e kapacitetit të tregut është rezervuar për prodhuesit lokalë. Interpretimi duhet të bëhet së bashku me treguesin për numrin e prodhuesve lokalë që tregtojnë në tregje bujqësore, për të vlerësuar nëse këto hapësira përdoren në praktikë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet planimetrive të tregjeve, rregullores së administrimit, akteve për ndarjen e hapësirave dhe evidencave të administrimit të tregjeve.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm hapësirat e rezervuara dhe jo domosdoshmërisht hapësirat e përdorura nga prodhuesit lokalë. Për këtë arsye, ai duhet të analizohet së bashku me treguesit që matin përdorimin real të tregut.

D171 NUMRI I PIKAVE TË SHITJES TË REZERVUARA PËR PRODHUESIT LOKALË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D171
Emërtimi	Numri i pikave të shitjes të rezervuara për prodhuesit lokalë

Përshkrimi i të dhënës	Numri i pikave të shitjes në tregjet publike bujqësore që, sipas rregullores ose akteve administrative të bashkisë, janë të dedikuara ose të rezervuara për përdorim nga prodhuesit lokalë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e hapësirave të rezervuara për prodhuesit lokalë në tregjet publike bujqësore dhe të mbështesë monitorimin e politikave të bashkisë për promovimin e prodhimit vendor.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga planimetria e tregjeve, regjistrat administrativë dhe aktet e bashkisë që përcaktojnë ndarjen e hapësirave të shitjes.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet planimetrive të tregjeve, regjistrave të administrimit dhe dokumentacionit administrativ që përcakton rezervimin e pikave të shitjes.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e hapësirave të rezervuara dhe nuk jep informacion mbi përdorimin efektiv apo shkallën e zënies së tyre.

D164 NUMRI I PIKAVE TE SHITJES

Shtjelluar me lart

282A12 PANAIRE / TREGJE FERMERËSH TË ORGANIZUAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A12
Emërtimi	Panaire / tregje fermerësh të organizuar
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo

Qëllimi	Të vlerësojë angazhimin e bashkisë në promovimin e prodhimit vendas dhe krijimin e mundësive të reja për tregtimin e produkteve bujqësore përmes organizimit të panaireve dhe tregjeve të fermerëve.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e panaireve ose tregjeve të fermerëve të organizuara nga bashkia ose në bashkëpunim me institucione, organizata apo aktorë të tjerë gjatë vitit raportues, me qëllim promovimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore lokale.
Rëndësia	Organizimi i panaireve dhe tregjeve të fermerëve kontribuon në zhvillimin ekonomik lokal, promovimin e produkteve vendase, krijimin e lidhjeve të drejtpërdrejta ndërmjet prodhuesve dhe konsumatorëve, si dhe në rritjen e vizibilitetit të prodhuesve lokalë. Ky tregues pasqyron rolin aktiv të bashkisë në mbështetjen e sektorit bujqësor.
Formula	D172
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një angazhim më të madh të bashkisë në organizimin ose mbështetjen e aktiviteteve që promovojnë prodhuesit lokalë dhe produktet bujqësore.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose administrimin e tregjeve publike.
Disagregimi	Sipas llojit të aktivitetit (panair, treg fermerësh) dhe, kur është e mundur, sipas njësive administrative.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet urdhrave për organizimin e aktiviteteve, raporteve të realizimit, programeve të aktiviteteve, materialeve promovuese dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e aktiviteteve të organizuara dhe nuk pasqyron madhësinë, kohëzgjatjen, numrin e pjesëmarrësve apo ndikimin ekonomik të tyre.

PASAPORTA E TË DHËNËS D172

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D172
Emërtimi	Numri i panaireve / tregjeve të fermerëve të organizuara

Përshkrimi i të dhënës	Numri total i panaireve ose tregjeve të fermerëve të organizuara ose bashkëorganizuara nga bashkia gjatë vitit raportues, me pjesëmarrjen e prodhuesve lokalë dhe me qëllim promovimin e produkteve bujqësore.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë aktivitetet e organizuara nga bashkia për promovimin e prodhuesve lokalë dhe zhvillimin e tregtimit të produkteve bujqësore.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik lokal, administrimin e tregjeve ose marrëdhëniet me publikun, sipas organizimit të bashkisë.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga kalendari i aktiviteteve të bashkisë, raportet e realizimit, urdhrat administrativë dhe dokumentacioni i strukturave organizatore.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet dokumentacionit administrativ, raporteve të aktiviteteve, listave të pjesëmarrësve dhe materialeve promovuese.
Disagregimi	Sipas llojit të aktivitetit (panair, treg fermerësh etj.) dhe, kur është e mundur, sipas njësisë administrative.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e aktiviteteve të organizuara dhe nuk vlerëson pjesëmarrjen, ndikimin ekonomik apo rezultatet e tyre.

282A13 NUMRI I VIZITORËVE NË TREGJET KRYESORE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A13
Emërtimi	Numri i vizitorëve në tregjet kryesore bujqësore
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë nivelin e frekuentimit të tregjeve kryesore bujqësore dhe atraktivitetin e tyre për konsumatorët.

Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të vizitorëve që kanë frekuentuar tregjet kryesore bujqësore gjatë vitit raportues. Ai shërben si një tregues i përdorimit të tregjeve dhe i aftësisë së tyre për të tërhequr konsumatorë.
Rëndësia	Frekuentimi i tregjeve publike bujqësore është një tregues indirekt i cilësisë së shërbimit, aksesueshmërisë dhe rolit të tregjeve në ekonominë lokale. Një numër më i madh vizitorësh mund të lidhet me një ofertë më të pasur produktesh, kushte më të mira infrastrukturore dhe organizim më efikas të tregut.
Formula	D173
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të madh frekuentimi të tregjeve kryesore bujqësore. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë madhësinë e tregut, numrin e ditëve të funksionimit dhe sezonalitetin e aktivitetit bujqësor.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor dhe, kur është e mundur, sipas periudhës së vitit.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të hyrjes, sistemeve elektronike të numërimit të vizitorëve ose metodave të tjera të dokumentuara të vlerësimit të frekuentimit.
Kufizimet	Në mungesë të sistemeve të numërimit automatik, të dhënat mund të bazohen në vlerësime administrative, duke ndikuar në saktësinë dhe krahasueshmërinë e treguesit ndërmjet bashkive.

D173 NUMRI I VIZITORËVE NË TREGJET KRYESORE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D173
Emërtimi	Numri i vizitorëve në tregjet kryesore bujqësore

Përshkrimi i të dhënës	Numri total i vizitorëve që kanë frekuentuar tregjet kryesore bujqësore gjatë vitit raportues, bazuar në regjistrimet ose vlerësimet e dokumentuara të bashkisë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e vizitorëve në tregjet kryesore bujqësore dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e frekuentimit dhe atraktivitetit të tyre.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga sistemet e numërimit të vizitorëve, regjistrat e hyrjes ose, në mungesë të tyre, nga vlerësime periodike të dokumentuara të kryera nga struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të administrimit, raporteve periodike ose dokumentacionit mbështetës të përdorur për vlerësimin e frekuentimit.
Disagregimi	Nuk Aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e vizitorëve dhe, në mungesë të sistemeve automatike të numërimit, mund të bazohet në vlerësime administrative që ndikojnë në saktësinë dhe krahasueshmërinë e saj.

TREGUESI 282A14 NUMRI I ANKESAVE PËR TREGJET BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A14
Emërtimi	Numri i ankesave për tregjet bujqësore
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo

Qëllimi	Të monitorojë problematikat e evidentuara nga qytetarët, tregtarët dhe prodhuesit lidhur me funksionimin e tregjeve publike bujqësore.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të ankesave të regjistruara gjatë vitit raportues në lidhje me funksionimin e tregjeve publike bujqësore. Ankesat mund të lidhen me infrastrukturën, higjienën, administrimin e tregut, tarifat, shpërndarjen e hapësirave të shitjes, sigurinë ose çështje të tjera që lidhen me ofrimin e shërbimit.
Rëndësia	Treguesi shërben si një mekanizëm për monitorimin e cilësisë së shërbimit dhe identifikimin e problematikave që kërkojnë ndërhyrje nga bashkia. Analiza e ankesave ndihmon në përmirësimin e administrimit të tregjeve dhe rritjen e kënaqësisë së përdoruesve të tyre.
Formula	D174
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një numër më i lartë ankesash mund të tregojë problematika në administrimin ose funksionimin e tregjeve. Megjithatë, ai mund të reflektojë gjithashtu ekzistencën e mekanizmave funksionalë për paraqitjen dhe regjistrimin e ankesave. Për këtë arsye, treguesi duhet të analizohet së bashku me informacionin mbi trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për trajtimin e ankesave të qytetarëve.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor dhe, kur është e mundur, sipas llojit të ankesës.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të ankesave, sistemit elektronik të menaxhimit të kërkesave dhe ankesave, si dhe dokumentacionit përkatës të administrimit të tregjeve.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e ankesave të regjistruara dhe nuk pasqyron rëndësinë e tyre, kohën e trajtimit apo nivelin e zgjidhjes së tyre. Gjithashtu, numri i ankesave mund të ndikohet nga niveli i ndërgjegjësimit të qytetarëve për mekanizmat e raportimit.

D174 NUMRI I ANKESAVE PËR TREGJET BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D174
Emërtimi	Numri i ankesave për tregjet bujqësore
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i ankesave të regjistruara gjatë vitit raportues nga qytetarët, tregtarët ose prodhuesit në lidhje me funksionimin e tregjeve publike bujqësore. Çdo ankesë raportohet vetëm një herë, pavarësisht fazës së trajtimit të saj.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e ankesave të regjistruara për funksionimin e tregjeve publike bujqësore dhe të mbështesë monitorimin e cilësisë së shërbimit.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistri i ankesave të bashkisë, sistemi elektronik i menaxhimit të kërkesave dhe ankesave ose evidencat administrative të strukturës përgjegjëse për administrimin e tregjeve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të ankesave, dokumentacionit të trajtimit të tyre dhe sistemit të administrimit të kërkesave dhe ankesave.
Disagregimi	Nuk Aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm ankesat e regjistruara zyrtarisht dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht të gjitha problematikat ose nivelin e kënaqësisë së përdoruesve.

TREGUESI 282A15 EKZISTENCA E RREGULLORES SË TREGJEVE BUJQËSORE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A15

Emërtimi	Ekzistenca e rregullores së tregjeve bujqësore
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë nëse bashkia ka miratuar një rregullore që përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregjeve publike bujqësore.
Përshkrimi	Treguesi evidenton ekzistencën e një rregulloreje të miratuar nga organet kompetente të bashkisë, e cila përcakton rregullat për administrimin, përdorimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin e tregjeve publike bujqësore, si dhe të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve të tyre.
Rëndësia	Ekzistenca e një rregulloreje përbën bazën ligjore dhe administrative për funksionimin e tregjeve publike bujqësore. Ajo siguron transparencë, trajtim të barabartë të përdoruesve, përcaktim të procedurave të administrimit dhe zbatim të standardeve të funksionimit.
Formula	D175
Njësia matëse	Po / Jo (1 = Po; 0 = Jo)
Interpretimi	Vlera **1** tregon se bashkia ka një rregullore të miratuar dhe në fuqi për administrimin e tregjeve publike bujqësore. Vlera **0** tregon mungesën e një rregulloreje të tillë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike, në bashkëpunim me strukturën juridike të bashkisë.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet vendimit të Këshillit Bashkiak ose aktit tjetër përkatës që miraton rregulloren, si dhe dokumentit të rregullores në fuqi.
Kufizimet	Treguesi evidenton vetëm ekzistencën formale të rregullores dhe nuk vlerëson cilësinë, përmbajtjen apo nivelin e zbatimit të saj në praktikë.

D175 KZISTENCA E RREGULLORES SË TREGJEVE BUJQËSORE	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D175
Emërtimi	Ekzistenca e rregullores së tregjeve bujqësore
Përshkrimi i të dhënës	Evidenton nëse bashkia ka një rregullore të miratuar dhe në fuqi që rregullon organizimin, administrimin dhe funksionimin e tregjeve publike bujqësore.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nëse bashkia disponon një rregullore të miratuar për administrimin dhe funksionimin e tregjeve publike bujqësore.
Njësia matëse	Po / Jo (1 = Po; 0 = Jo)
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura juridike dhe struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga aktet normative të bashkisë dhe dokumentacioni i Këshillit Bashkiak.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet vendimit të Këshillit Bashkiak dhe kopjes së rregullores së miratuar dhe në fuqi.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	E dhëna konfirmon vetëm ekzistencën e rregullores dhe nuk vlerëson përmbajtjen, cilësinë, nivelin e zbatimit apo efektivitetin e saj.

TREGUESI 282A16 TREGJE BUJQËSORE NË PËRPUTHJE ME PPV	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	282A16
Emërtimi	Tregje bujqësore në përputhje me PPV
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve

Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë shkallën e përputhshmërisë së tregjeve publike bujqësore me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) të bashkisë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet përqindjen e tregjeve publike bujqësore që janë të vendosura dhe funksionojnë në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor, në raport me numrin total të tregjeve publike bujqësore në administrim të bashkisë.
Rëndësia	Përputhshmëria me PPV siguron që tregjet bujqësore zhvillohen në përputhje me planifikimin territorial të bashkisë, duke garantuar përdorim të qëndrueshëm të territorit, akses të përshtatshëm dhe integrim me infrastrukturën urbane dhe rurale. Treguesi ndihmon në monitorimin e zbatimit të instrumenteve të planifikimit vendor.
Formula	(D176 / D162) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një përqindje më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e tregjeve publike bujqësore janë në përputhje me parashikimet e PPV-së.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për planifikimin e territorit.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet Planit të Përgjithshëm Vendor, hartave të planifikimit, dokumentacionit teknik dhe regjistrit të tregjeve publike.
Kufizimet	Treguesi varet nga ekzistenca e një PPV-je të miratuar dhe nga identifikimi i qartë i tregjeve publike në dokumentet e planifikimit territorial. Në rastet kur PPV është në proces rishikimi, interpretimi duhet të bëhet me kujdes.

D176 NUMRI I TREGJEVE BUJQËSORE NË PËRPUTHJE ME PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR (PPV)

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D176
Emërtimi	Numri i tregjeve bujqësore në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV)
Përshkrimi i të dhënës	Numri i tregjeve publike bujqësore që gjatë vitit raportues rezultojnë të jenë të vendosura dhe të funksionojnë në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e tregjeve publike bujqësore që janë në përputhje me dokumentet e planifikimit vendor dhe të mbështesë monitorimin e përputhshmërisë territoriale.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për planifikimin e territorit, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendor, dokumentacioni teknik i bashkisë dhe regjistri i tregjeve publike
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet krahasimit të vendndodhjes dhe statusit të tregjeve me dokumentet dhe hartat e miratuara të PPV-së.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm përputhshmërinë formale me dokumentet e planifikimit vendor dhe nuk vlerëson gjendjen fizike apo funksionalitetin e tregjeve.

TREGUESI 282A17 TREGJE BUJQËSORE ME PLAN EMERGJENCE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A17
Emërtimi	Tregje bujqësore me plan emergjence

Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë shkallën e përgatitjes së tregjeve publike bujqësore për përballimin e situatave emergjente dhe garantimin e sigurisë së përdoruesve.
Përshkrimi	Treguesi paraqet përqindjen e tregjeve publike bujqësore që disponojnë një plan emergjence të miratuar dhe në fuqi, në raport me numrin total të tregjeve publike bujqësore të administruara nga bashkia. Plani i emergjencës përfshin procedurat për reagimin ndaj zjarreve, fatkeqësive natyrore, aksidenteve ose situatave të tjera që mund të rrezikojnë sigurinë e njerëzve dhe funksionimin e tregut.
Rëndësia	Ekzistenca e planeve të emergjencës rrit nivelin e sigurisë në tregjet publike, ndihmon në uljen e rrezikut për jetën dhe pronën dhe siguron reagim të koordinuar në raste emergjente. Treguesi mbështet monitorimin e gatishmërisë së bashkisë për menaxhimin e rreziqeve.
Formula	(D177 / D162) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një përqindje më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e tregjeve publike bujqësore janë të pajisura me plane emergjence, duke reflektuar një nivel më të lartë të përgatitjes për menaxhimin e situatave të jashtëzakonshme.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për mbrojtjen civile dhe menaxhimin e emergjencave.
Disagregimi	Sipas tregut publik bujqësor.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet planeve të emergjencës të miratuara, dokumentacionit të administrimit të tregjeve dhe evidencave të strukturave përgjegjëse për mbrojtjen civile.
Kufizimet	Treguesi evidenton vetëm ekzistencën e planit të emergjencës dhe nuk vlerëson cilësinë, përditësimin, testimin apo zbatimin praktik të tij.

D177 NUMRI I TREGJEVE BUJQËSORE ME PLAN EMERGJENCE	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D177
Emërtimi	Numri i tregjeve bujqësore me plan emergjence
Përshkrimi i të dhënës	Numri i tregjeve publike bujqësore që gjatë vitit raportues disponojnë një plan emergjence të miratuar dhe në fuqi për menaxhimin e situatave emergjente.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e tregjeve publike bujqësore që disponojnë plan emergjence dhe të mbështesë vlerësimin e gatishmërisë për menaxhimin e situatave emergjente.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve publike dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga dokumentacioni i administrimit të tregjeve, planet e emergjencës dhe evidencat e strukturave përgjegjëse për mbrojtjen civile.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet planeve të emergjencës të miratuara, vendimeve administrative dhe dokumentacionit mbështetës përkatës.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	E dhëna konfirmon vetëm ekzistencën e planit të emergjencës dhe nuk vlerëson cilësinë, përditësimin apo zbatueshmërinë e tij.

TREGUESI 282A18 NUMRI I TREGJEVE TË GJËSË SË GJALLË	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	282A18
Emërtimi	Numri i tregjeve të gjësë së gjallë
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve

Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të evidentojë kapacitetin e bashkisë për ofrimin e tregjeve të dedikuara për tregtimin e gjësë së gjallë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të tregjeve të gjësë së gjallë që administrohen ose autorizohen nga bashkia gjatë vitit raportues. Në këtë kategori përfshihen tregjet e destinuara për tregtimin e kafshëve të gjalla, të organizuara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat veterinare e higjieno-sanitare.
Rëndësia	Tregjet e gjësë së gjallë janë një element i rëndësishëm i infrastrukturës ekonomike në zonat rurale dhe kontribuojnë në zhvillimin e aktivitetit blegtoral. Treguesi ndihmon në monitorimin e aksesit të fermerëve në tregje të organizuara dhe në planifikimin e investimeve për këtë infrastrukturë.
Formula	D178
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se bashkia disponon një numër më të madh tregjesh të dedikuara për tregtimin e gjësë së gjallë. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë madhësinë e territorit, numrin e fermerëve dhe profilin ekonomik të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për bujqësinë dhe shërbimin veterinar, sipas kompetencave.
Disagregimi	Sipas njësive administrative ose sipas llojit të tregut të gjësë së gjallë, kur është e mundur.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të tregjeve, akteve administrative për funksionimin e tyre dhe dokumentacionit përkatës.
Kufizimet	Treguesi evidenton vetëm numrin e tregjeve dhe nuk jep informacion mbi madhësinë, kapacitetin, frekuencën e organizimit apo nivelin e përdorimit të tyre.

D178 NUMRI I TREGJEVE TË GJËSË SË GJALLË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D178
Emërtimi	Numri i tregjeve të gjësë së gjallë
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i tregjeve të gjësë së gjallë që administrohen ose autorizohen nga bashkia dhe kanë funksionuar gjatë vitit raportues, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e tregjeve funksionale të gjësë së gjallë në administrim të bashkisë dhe të shërbejë si bazë për monitorimin e këtij shërbimi.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për bujqësinë dhe shërbimin veterinar.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistri i tregjeve të bashkisë, aktet administrative për funksionimin e tyre dhe evidencat e strukturës përgjegjëse për administrimin e tregjeve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të tregjeve, licencave ose autorizimeve për funksionim dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Disagregimi	Sipas njesise administrative nese eshte e mundur
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e tregjeve funksionale të gjësë së gjallë dhe nuk jep informacion mbi kapacitetin, nivelin e përdorimit apo cilësinë e infrastrukturës së tyre.

TREGUESI 282A19 FREKUENCA E ORGANIZIMIT TË TREGJEVE TË GJËSË SË GJALLË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A19

Emërtimi	Frekuenca e organizimit të tregjeve të gjësë së gjallë
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë rregullsinë e organizimit të tregjeve të gjësë së gjallë dhe aksesin e fermerëve në këto tregje.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e rasteve gjatë vitit raportues kur janë organizuar tregjet e gjësë së gjallë në territorin e bashkisë. Ai mat vazhdimësinë e funksionimit të këtyre tregjeve dhe mundësinë që u ofrohet fermerëve për tregtimin e kafshëve të gjalla.
Rëndësia	Organizimi i rregullt i tregjeve të gjësë së gjallë lehtëson aktivitetin ekonomik të fermerëve, përmirëson funksionimin e tregut blegtoral dhe krijon kushte më të mira për tregtim të organizuar dhe të kontrolluar. Treguesi ndihmon bashkinë të monitorojë nivelin e ofrimit të këtij shërbimi dhe të identifikojë nevojat për përmirësim.
Formula	D179
Njësia matëse	Numër (aktivitete/organizime në vit)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se tregjet e gjësë së gjallë organizohen më shpesh gjatë vitit, duke krijuar më shumë mundësi tregtimi për fermerët. Interpretimi duhet të bëhet në raport me kërkesën lokale dhe numrin e tregjeve ekzistuese.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për bujqësinë dhe shërbimin veterinar.
Disagregimi	Sipas tregut të gjësë së gjallë dhe, kur është e mundur, sipas muajit ose sezonit të organizimit.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kalendarit të organizimit të tregjeve, urdhrave administrativë, regjistrave të funksionimit dhe dokumentacionit mbështetës.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm frekuencën e organizimit dhe nuk pasqyron numrin e pjesëmarrësve, volumin e tregtisë apo kohëzgjatjen e secilit aktivitet.

PASAPORTA E TË DHËNËS D179	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D179
Emërtimi	Frekuenca e organizimit të tregjeve të gjësë së gjallë
Përshkrimi i të dhënës	Numri i rasteve gjatë vitit raportues në të cilat janë organizuar tregjet e gjësë së gjallë në territorin e bashkisë, sipas kalendarit ose programit të funksionimit të tyre.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë frekuencën e organizimit të tregjeve të gjësë së gjallë dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e nivelit të ofrimit të këtij shërbimi.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për bujqësinë dhe shërbimin veterinar
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat e administrimit të tregjeve, kalendarët e organizimit dhe dokumentacioni administrativ përkatës..
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kalendarëve të organizimit, regjistrave të funksionimit dhe dokumentacionit mbështetës të bashkisë.
Disagregimi	Sipas tregut të gjësë së gjallë dhe, kur është e mundur, sipas muajit ose sezonit të organizimit.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm frekuencën e organizimit të tregjeve dhe nuk pasqyron numrin e pjesëmarrësve, volumin e tregtisë apo kohëzgjatjen e secilit aktivitet.

TREGUESI 282A20 NUMRI I TREGTARËVE/FERMERËVE PJESËMARRËS NË TREGJE TË GJËSË SË GJALLË	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	282A20
Emërtimi	Numri i tregtarëve/fermerëve pjesëmarrës në tregje të gjësë së gjallë

Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë nivelin e përdorimit të tregjeve të gjësë së gjallë nga fermerët dhe tregtarët, si një tregues i rëndësishëm i funksionalitetit dhe atraktivitetit të tyre.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të tregtarëve dhe fermerëve që kanë marrë pjesë në tregjet e gjësë së gjallë gjatë vitit raportues. Në këtë numër përfshihen të gjithë operatorët që kanë ushtruar aktivitet tregtimi në tregjet e organizuara nga ose nën administrimin e bashkisë.
Rëndësia	Numri i pjesëmarrësve është një tregues i drejtpërdrejtë i përdorimit të tregjeve dhe i rëndësisë së tyre për ekonominë lokale. Një pjesëmarrje më e lartë reflekton akses më të mirë në treg, interes më të madh nga fermerët dhe potencialisht një funksionim më efektiv të infrastrukturës tregtare.
Formula	D180
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon përdorim më të madh të tregjeve të gjësë së gjallë. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë numrin e tregjeve, frekuencën e organizimit dhe karakteristikat ekonomike të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për bujqësinë dhe shërbimin veterinar.
Disagregimi	Sipas tregut të gjësë së gjallë dhe, kur është e mundur, sipas kategorisë së pjesëmarrësve (fermerë, tregtarë ose subjekte të tjera).
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të pjesëmarrjes, evidencave të administrimit të tregut, lejeve të hyrjes ose dokumentacionit tjetër administrativ.
Kufizimet	Treguesi nuk mat volumin e tregtisë, vlerën ekonomike të transaksioneve apo numrin e kafshëve të tregtuara. Gjithashtu, në mungesë të një sistemi unik regjistrimi, i njëjti operator mund të numërohet disa herë nëse merr pjesë në organizime të ndryshme gjatë vitit.

D180 NUMRI I TREGTARËVE/FERMERËVE PJESËMARRËS NË TREGJE TË GJËSË SË GJALLË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D180
Emërtimi	Numri i tregtarëve/fermerëve pjesëmarrës në tregje të gjësë së gjallë
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i pjesëmarrjeve të fermerëve dhe tregtarëve në tregjet e gjësë së gjallë gjatë vitit raportues, bazuar në regjistrat administrativë të tregjeve.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e tregtarëve dhe fermerëve pjesëmarrës në tregjet e gjësë së gjallë dhe të mbështesë vlerësimin e nivelit të përdorimit të tyre.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për bujqësinë dhe shërbimin veterinar.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat e pjesëmarrjes, listat e operatorëve, lejet e ushtrimit të aktivitetit ose evidencat e administrimit të tregjeve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të pjesëmarrjes, listave të operatorëve dhe dokumentacionit administrativ të tregjeve.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e pjesëmarrësve dhe nuk jep informacion mbi volumin e tregtisë, frekuencën e pjesëmarrjes apo vlerën ekonomike të aktivitetit.

TREGUESI 282A21 MBULIMI I TREGJEVE ME KONTROLL VETERINAR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A21
Emërtimi	Mbulimi i tregjeve me kontroll veterinar

Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë shkallën e mbulimit të tregjeve të gjësë së gjallë me shërbim të kontrollit veterinar, si një element kyç për garantimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së shëndetit publik dhe të kafshëve.
Përshkrimi	Treguesi paraqet përqindjen e tregjeve të gjësë së gjallë që gjatë vitit raportues kanë qenë të mbuluara me kontroll veterinar, në raport me numrin total të tregjeve të gjësë së gjallë në administrim të bashkisë.
Rëndësia	Kontrolli veterinar është një kërkesë thelbësore për funksionimin e sigurt të tregjeve të gjësë së gjallë. Ai kontribuon në parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, garantimin e mirëqenies së kafshëve dhe respektimin e standardeve veterinare dhe higjieno-sanitare.
Formula	(D181 / D178) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një përqindje më e lartë tregon mbulim më të plotë të tregjeve me shërbim veterinar dhe një nivel më të lartë sigurie në funksionimin e tyre.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturat veterinare kompetente.
Disagregimi	Sipas tregut të gjësë së gjallë dhe njësisë administrative, kur është e mundur.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet evidencave të kontrollit veterinar, marrëveshjeve me shërbimin veterinar dhe dokumentacionit të administrimit të tregjeve.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm ekzistencën e mbulimit me kontroll veterinar dhe nuk vlerëson cilësinë, shpeshtësinë apo rezultatet e kontrolleve të kryera.

PASAPORTA E TË DHËNËS D181	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D181
Emërtimi	Numri i tregjeve të gjësë së gjallë me kontroll veterinar
Përshkrimi i të dhënës	Numri i tregjeve të gjësë së gjallë që gjatë vitit raportues kanë qenë të mbuluara me shërbim të rregullt kontrolli veterinar, sipas legjislacionit në fuqi.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e tregjeve të gjësë së gjallë ku ofrohet kontroll veterinar dhe të mbështesë monitorimin e mbulimit të këtij shërbimi.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve dhe shërbimi veterinar kompetent.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga administrata e tregjeve dhe strukturat veterinare përgjegjëse
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të kontrolleve veterinare, raporteve të inspektimit dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm ekzistencën e kontrollit veterinar në tregje dhe nuk vlerëson cilësinë, frekuencën apo efektivitetin e kontrolleve të kryera.

TREGUESI 282A22 INTENSITETI I KONTROLLEVE VETERINARE	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	282A22
Emërtimi	Intensiteti i kontrolleve veterinare
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve

Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë shpeshtësinë e kontrolleve veterinare të kryera në raport me organizimin e tregjeve të gjësë së gjallë, si tregues i nivelit të mbikëqyrjes veterinare.
Përshkrimi	Treguesi paraqet raportin ndërmjet numrit të kontrolleve veterinare të kryera gjatë vitit raportues dhe numrit të organizimeve të tregjeve të gjësë së gjallë. Ai mat intensitetin e mbikëqyrjes veterinare gjatë zhvillimit të aktivitetit tregtar.
Rëndësia	Kryerja e kontrolleve veterinare në mënyrë sistematike është thelbësore për garantimin e shëndetit të kafshëve, mbrojtjen e shëndetit publik dhe respektimin e standardeve veterinare. Treguesi ndihmon bashkinë dhe autoritetet përgjegjëse të monitorojnë nivelin e mbikëqyrjes së tregjeve.
Formula	D182 / D179
Njësia matëse	Numër kontrollesh për organizim tregu
Interpretimi	Një vlerë **1** tregon se, mesatarisht, është kryer një kontroll veterinar për çdo organizim të tregut. Vlera mbi **1** tregon më shumë se një kontroll për organizim, ndërsa vlera nën **1** tregon se jo çdo organizim është mbuluar me kontroll veterinar.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me shërbimin veterinar kompetent.
Disagregimi	Sipas tregut të gjësë së gjallë, njësisë administrative ose periudhës së raportimit, kur është e mundur.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të kontrolleve veterinare, raporteve të inspektimit dhe evidencave të organizimit të tregjeve.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm sasinë e kontrolleve dhe nuk pasqyron cilësinë, gjetjet apo efektivitetin e tyre. Në disa raste mund të kryhen disa kontrolle gjatë të njëjtit organizim, gjë që rrit vlerën e treguesit pa nënkuptuar domosdoshmërisht një nivel më të lartë sigurie.

D182 NUMRI I KONTROLLEVE VETERINARE TË KRYERA NË TREGJET E GJËSË SË GJALLË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D182
Emërtimi	Numri i kontrolleve veterinare të kryera në tregjet e gjësë së gjallë
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i kontrolleve veterinare të kryera gjatë vitit raportues në tregjet e gjësë së gjallë, nga autoritetet veterinare kompetente.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e kontrolleve veterinare të kryera në tregjet e gjësë së gjallë dhe të mbështesë vlerësimin e intensitetit të mbikëqyrjes veterinare.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Shërbimi veterinar kompetent, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për administrimin e tregjeve.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat e kontrolleve veterinare, procesverbalet e inspektimit dhe evidencat e administrimit të tregjeve.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet raporteve të inspektimit, regjistrave të kontrolleve dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e kontrolleve të kryera dhe nuk jep informacion mbi rezultatet e tyre, shkeljet e konstatuara apo masat e marra.

282A23 TË ARDHURAT NGA TREGJET E GJËSË SË GJALLË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A23
Emërtimi	Të ardhurat nga tregjet e gjësë së gjallë

Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë të ardhurat e realizuara nga administrimi i tregjeve të gjësë së gjallë, si një tregues i performancës financiare dhe i shfrytëzimit të kësaj infrastrukture publike.
Përshkrimi	Treguesi paraqet shumën totale të të ardhurave të arkëtuara nga bashkia gjatë vitit raportues nga funksionimi i tregjeve të gjësë së gjallë. Në këto të ardhura përfshihen tarifat e përdorimit të tregut, tarifat e zënies së vendeve të tregtimit, tarifat e hyrjes, si dhe çdo e ardhur tjetër e lidhur drejtpërdrejt me administrimin e këtyre tregjeve, sipas legjislacionit dhe akteve vendore në fuqi.
Rëndësia	Treguesi ndihmon në vlerësimin e aftësisë së bashkisë për të administruar në mënyrë efektive tregjet e gjësë së gjallë dhe për të gjeneruar të ardhura nga përdorimi i kësaj infrastrukture. Ai mbështet analizën e eficiencës financiare dhe planifikimin e investimeve për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e tregjeve.
Formula	D183
Njësia matëse	Lekë
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon nivel më të madh të të ardhurave të realizuara nga tregjet e gjësë së gjallë. Interpretimi duhet të bëhet në raport me numrin e tregjeve, frekuencën e organizimit dhe politikat tarifore të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për financat vendore.
Disagregimi	Sipas tregut të gjësë së gjallë ose sipas kategorisë së të ardhurave, kur është e mundur.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet evidencave financiare, regjistrave të arkëtimeve dhe sistemit të kontabilitetit të bashkisë.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm të ardhurat e arkëtuara dhe nuk pasqyron kostot e administrimit, mirëmbajtjes apo investimeve në tregjet e gjësë së gjallë. Për këtë arsye, ai nuk duhet të interpretohet si tregues i rentabilitetit financiar.

D183 TË ARDHURAT NGA TREGJET E GJËSË SË GJALLË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D183
Emërtimi	Të ardhurat nga tregjet e gjësë së gjallë
Përshkrimi i të dhënës	Shuma totale e të ardhurave të arkëtuara nga bashkia gjatë vitit raportues nga administrimi dhe funksionimi i tregjeve të gjësë së gjallë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë të ardhurat e realizuara nga administrimi i tregjeve të gjësë së gjallë dhe të mbështesë vlerësimin e performancës financiare të këtij shërbimi.
Njësia matëse	Lekë
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për financat vendore, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për administrimin e tregjeve.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat financiarë, evidencat e arkëtimeve dhe sistemi i kontabilitetit të bashkisë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet pasqyrave financiare, mandat-arkëtimeve, raporteve të të ardhurave dhe evidencave kontabël të bashkisë.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna pasqyron vetëm të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit raportues dhe nuk jep informacion mbi kostot e administrimit apo rentabilitetin e shërbimit.

282A24 RREGULLORE PËR TREGJET E GJËSË SË GJALLË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	282A24
Emërtimi	Rregullore për tregjet e gjësë së gjallë
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve

Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë nëse bashkia disponon një rregullore të miratuar që përcakton organizimin, administrimin dhe funksionimin e tregjeve të gjësë së gjallë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Përshkrimi	Treguesi evidenton ekzistencën e një rregulloreje të miratuar nga organi kompetent i bashkisë, e cila rregullon procedurat e funksionimit të tregjeve të gjësë së gjallë, kushtet për pjesëmarrjen e operatorëve, masat higjieno-sanitare dhe veterinare, si dhe përgjegjësitë e administratorëve dhe përdoruesve të tregut.
Rëndësia	Rregullorja krijon bazën administrative dhe ligjore për funksionimin e sigurt dhe të rregullt të tregjeve të gjësë së gjallë. Ajo kontribuon në garantimin e mirëqenies së kafshëve, mbrojtjen e shëndetit publik, respektimin e standardeve veterinare dhe transparencën në administrimin e tregjeve.
Formula	D184
Njësia matëse	Po / Jo (1 = Po; 0 = Jo)
Interpretimi	Vlera **1** tregon se bashkia ka një rregullore të miratuar dhe në fuqi për administrimin e tregjeve të gjësë së gjallë. Vlera **0** tregon mungesën e një rregulloreje të tillë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturën juridike të bashkisë dhe autoritetet veterinare kompetente.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet vendimit të Këshillit Bashkiak ose aktit tjetër kompetent për miratimin e rregullores dhe dokumentit të rregullores në fuqi.
Kufizimet	Treguesi evidenton vetëm ekzistencën formale të rregullores dhe nuk vlerëson cilësinë, përmbajtjen, përditësimin apo nivelin e zbatimit të saj në praktikë.

D184 EKZISTENCA E RREGULLORES PËR TREGJET E GJËSË SË GJALLË	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D184
Emërtimi	Ekzistenca e rregullores për tregjet e gjësë së gjallë
Përshkrimi i të dhënës	Evidenton nëse bashkia ka një rregullore të miratuar dhe në fuqi që rregullon organizimin, administrimin dhe funksionimin e tregjeve të gjësë së gjallë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë nëse bashkia disponon një rregullore të miratuar për administrimin dhe funksionimin e tregjeve të gjësë së gjallë.
Njësia matëse	Po / Jo (1 = Po; 0 = Jo)
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura juridike dhe struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve të bashkisë.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga aktet normative të bashkisë, vendimet e Këshillit Bashkiak dhe dokumentacioni administrativ përkatës.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet vendimit të Këshillit Bashkiak dhe kopjes së rregullores së miratuar dhe në fuqi.
Disagregimi	Nuk aplikohet.
Kufizimet	E dhëna konfirmon vetëm ekzistencën e rregullores dhe nuk vlerëson përmbajtjen, cilësinë, nivelin e zbatimit apo efektivitetin e saj.

282A25 TREGJE TË GJËSË SË GJALLË ME INFRASTRUKTURË MINIMALE	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	282A25
Emërtimi	Tregje të gjësë së gjallë me infrastrukturë minimale
Funksioni	28.2 – Administrimi i tregjeve
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo

Qëllimi	Të vlerësojë përqindjen e tregjeve të gjësë së gjallë që plotësojnë kërkesat minimale infrastrukturore për zhvillimin e aktivitetit në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me standardet veterinare, higjieno-sanitare dhe të mirëqenies së kafshëve.
Përshkrimi	Treguesi paraqet përqindjen e tregjeve të gjësë së gjallë që disponojnë infrastrukturën minimale të nevojshme për funksionimin e tyre, në raport me numrin total të tregjeve të gjësë së gjallë në administrim të bashkisë. Infrastrukturë minimale konsiderohen elementët bazë të nevojshëm për zhvillimin e aktivitetit, sipas legjislacionit dhe standardeve teknike në fuqi.
Rëndësia	Disponueshmëria e infrastrukturës minimale është një kusht thelbësor për zhvillimin e sigurt të tregtimit të kafshëve të gjalla, mbrojtjen e shëndetit publik, mirëqenien e kafshëve dhe funksionimin efektiv të tregjeve. Treguesi ndihmon bashkitë të identifikojnë nevojat për investime dhe përmirësim të infrastrukturës.
Formula	(D185 / D178) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një përqindje më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e tregjeve të gjësë së gjallë plotësojnë kërkesat minimale infrastrukturore. Vlera prej **100%** tregon se të gjitha tregjet janë të pajisura me infrastrukturën bazë të kërkuar.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për investimet publike dhe shërbimin veterinar.
Disagregimi	Sipas tregut të gjësë së gjallë dhe njësisë administrative, kur është e mundur.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet inspektimeve në terren, dokumentacionit teknik të tregjeve dhe procesverbaleve të kontrollit.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm plotësimin e kërkesave minimale infrastrukturore dhe nuk vlerëson gjendjen teknike, cilësinë ose nivelin e mirëmbajtjes së infrastrukturës.

D185 NUMRI I TREGJEVE TË GJËSË SË GJALLË ME INFRASTRUKTURË MINIMALE	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D185
Emërtimi	Numri i tregjeve të gjësë së gjallë me infrastrukturë minimale
Përshkrimi i të dhënës	Numri i tregjeve të gjësë së gjallë që gjatë vitit raportues plotësojnë kërkesat minimale infrastrukturore të përcaktuara nga legjislacioni dhe standardet teknike në fuqi për funksionimin e tyre.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e tregjeve të gjësë së gjallë që plotësojnë nivelin minimal të infrastrukturës funksionale dhe të mbështesë vlerësimin e kushteve bazë të funksionimit të tyre.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për administrimin e tregjeve, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për investimet publike dhe shërbimin veterinar.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga inspektimet në terren, regjistrat e administrimit të tregjeve dhe dokumentacioni teknik i bashkisë
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet raporteve të inspektimit, procesverbaleve teknike dhe dokumentacionit fotografik ose teknik, sipas rastit.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e tregjeve që plotësojnë nivelin minimal të infrastrukturës dhe nuk jep informacion mbi cilësinë, gjendjen teknike apo nivelin e mirëmbajtjes së infrastrukturës.

28.3 MBËSHTETJA PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT TË VOGËL, NËPËRMJET VEPRIMTARIVE NXITËSE, TË TILLA SI PANAIRE E REKLAMA NË VENDE PUBLIKE

Ky funksion përfshin kompetencat e bashkisë për të mbështetur zhvillimin e biznesit të vogël në territorin e saj nëpërmjet organizimit dhe promovimit të aktiviteteve që nxisin sipërmarrjen lokale dhe rrisin mundësitë për zhvillim ekonomik. Këto aktivitete përfshijnë, ndër të tjera, organizimin e panaireve, ekspozitave, aktiviteteve promovuese dhe formave të

tjera të marketingut territorial që synojnë promovimin e produkteve, shërbimeve dhe sipërmarrjeve vendore.
Në ushtrimin e këtij funksioni, bashkia krijon mundësi për lidhjen e prodhuesve dhe sipërmarrësve lokalë me tregun, promovon identitetin ekonomik të territorit dhe mbështet zhvillimin e sektorëve me potencial, në veçanti bizneset e vogla dhe të mesme. Aktivitetet promovuese kontribuojnë në rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë vendore, tërheqjen e investimeve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat.
Treguesit e këtij funksioni monitorojnë dinamikën e aktivitetit sipërmarrës në territorin e bashkisë, duke përfshirë numrin e bizneseve aktive, krijimin dhe mbylljen e bizneseve, si dhe strukturën e ekonomisë lokale, me fokus të veçantë në sektorët agro-përpunues dhe të turizmit. Këta tregues ofrojnë informacion mbi zhvillimin e bazës ekonomike vendore dhe mbështesin planifikimin e politikave për zhvillimin ekonomik lokal.

TREGUESI 283A01 NUMRI I BIZNESEVE AKTIVE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	283A01
Emërtimi	Numri i bizneseve aktive
Funksioni	28.3 – Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë numrin total të subjekteve ekonomike aktive që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë, si një tregues bazë i zhvillimit ekonomik vendor dhe i klimës së biznesit.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e bizneseve aktive të regjistruara dhe që ushtrojnë aktivitet ekonomik gjatë vitit raportues në territorin e bashkisë, pavarësisht formës së organizimit ose sektorit të aktivitetit. Ai shërben si baza për llogaritjen e një sërë treguesish të tjerë të zhvillimit ekonomik vendor.
Rëndësia	Numri i bizneseve aktive pasqyron kapacitetin ekonomik të territorit, nivelin e zhvillimit të sipërmarrjes dhe potencialin për krijimin e vendeve të punës. Treguesi përdoret për të monitoruar dinamikën e ekonomisë lokale dhe për të vlerësuar efektivitetin e politikave të bashkisë për mbështetjen e biznesit.
Formula	D186
Njësia matëse	Numër

Interpretimi	Një numër më i lartë i bizneseve aktive tregon një bazë ekonomike më të zhvilluar dhe një nivel më të lartë të aktivitetit sipërmarrës. Interpretimi duhet të bëhet në raport me madhësinë e popullsisë, strukturën ekonomike dhe karakteristikat territoriale të bashkisë.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, madhësisë së biznesit, formës juridike ose njësisë administrative, kur këto të dhëna janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave administrativë të bizneseve dhe të dhënave zyrtare të institucioneve përgjegjëse për regjistrimin e subjekteve ekonomike.
Kufizimet	Treguesi evidenton vetëm numrin e bizneseve aktive dhe nuk jep informacion mbi madhësinë ekonomike të tyre, numrin e të punësuarve apo nivelin e aktivitetit ekonomik që ato gjenerojnë.

D186 NUMRI I BIZNESEVE AKTIVE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D186
Emërtimi	Numri i bizneseve aktive
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i subjekteve ekonomike aktive që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e bizneseve aktive në territorin e bashkisë dhe të shërbejë si bazë për monitorimin e zhvillimit ekonomik vendor dhe llogaritjen e treguesve të sipërmarrjes.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni Përgjegjës	Strukturat përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të institucioneve përgjegjëse për regjistrimin e bizneseve dhe përpunohen nga bashkia për qëllime raportimi.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet të dhënave zyrtare të regjistrit të bizneseve dhe evidencave administrative të disponueshme për bashkinë.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, madhësisë së biznesit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm bizneset e regjistruara si aktive dhe nuk jep informacion mbi nivelin e aktivitetit ekonomik, numrin e të punësuarve apo performancën financiare të tyre.

TREGUESI 283A02 NUMRI I BIZNESEVE TË REJA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	283A02
Emërtimi	Numri i bizneseve të reja
Funksioni	28.3 – Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë dinamikën e sipërmarrjes në territorin e bashkisë nëpërmjet numrit të bizneseve të reja të krijuara gjatë vitit raportues.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e subjekteve ekonomike të regjistruara për herë të parë dhe që kanë filluar aktivitetin në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues. Ai pasqyron aftësinë e ekonomisë vendore për të gjeneruar iniciativa të reja sipërmarrëse dhe për të tërhequr investime të reja.
Rëndësia	Krijimi i bizneseve të reja është një tregues i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik vendor, klimës së favorshme për sipërmarrje dhe efektivitetit të politikave mbështetëse të bashkisë. Rritja e këtij treguesi lidhet me zgjerimin e bazës ekonomike, krijimin e vendeve të reja të punës dhe diversifikimin e aktivitetit ekonomik.
Formula	D187

Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon ritëm më të lartë të krijimit të bizneseve të reja dhe një klimë më dinamike sipërmarrëse. Interpretimi duhet të bëhet në raport me numrin total të bizneseve aktive dhe karakteristikat ekonomike të territorit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, formës juridike, madhësisë së biznesit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave zyrtarë të regjistrimit të bizneseve dhe evidencave administrative përkatëse.
Kufizimet	Treguesi evidenton vetëm numrin e regjistrimeve të reja dhe nuk pasqyron qëndrueshmërinë e bizneseve të krijuara apo nivelin e aktivitetit të tyre ekonomik.

D187 NUMRI I BIZNESEVE TË REJA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D187
Emërtimi	Numri i bizneseve të reja
Përshkrimi i të dhënës	Numri i subjekteve ekonomike të regjistruara për herë të parë dhe që kanë filluar aktivitetin në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues. Për qëllime të këtij treguesi, **biznes i ri** konsiderohet çdo subjekt ekonomik që është regjistruar për herë të parë dhe ka filluar aktivitetin gjatë vitit raportues. Nuk përfshihen ndryshimet e formës juridike, transferimet e selisë, riorganizimet apo riaktivizimet e subjekteve ekzistuese, përveç rasteve kur ato trajtohen si regjistrime të reja sipas metodologjisë së institucionit që administron regjistrin kombëtar të bizneseve. Për të garantuar krahasueshmërinë ndërmjet viteve, rekomandohet përdorimi i të njëjtit burim administrativ për raportimin e këtij treguesi.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e bizneseve të reja të regjistruara gjatë vitit raportues dhe të mbështesë monitorimin e dinamikës së sipërmarrjes në territorin e bashkisë.

Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të institucioneve përgjegjëse për regjistrimin e bizneseve dhe përpunohen për territorin e bashkisë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet evidencave zyrtare të regjistrimit të bizneseve dhe regjistrave administrativë përkatës.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, madhësisë së biznesit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm bizneset e regjistruara për herë të parë gjatë periudhës raportuese dhe nuk jep informacion mbi jetëgjatësinë apo suksesin e tyre ekonomik.

TREGUESI 283A03 NORMA E KRIJIMIT TË BIZNESEVE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	283A03
Emërtimi	Norma e krijimit të bizneseve
Funksioni	28.3 – Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë ritmin e krijimit të bizneseve të reja në raport me bazën ekzistuese të bizneseve aktive në territorin e bashkisë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet përqindjen që zënë bizneset e reja të krijuara gjatë vitit raportues ndaj numrit total të bizneseve aktive. Ai shërben për të vlerësuar dinamikën e sipërmarrjes dhe aftësinë e ekonomisë vendore për të gjeneruar aktivitete të reja ekonomike.

Rëndësia	Norma e krijimit të bizneseve është një tregues i rëndësishëm i vitalitetit ekonomik të territorit. Një normë e lartë tregon një mjedis më dinamik për sipërmarrjen, ndërsa një normë e ulët mund të sinjalizojë ngadalësim të zhvillimit ekonomik ose barriera për hyrjen e bizneseve të reja në treg.
Formula	(D187 / D186) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se bizneset e reja përbëjnë një pjesë më të madhe të bazës ekzistuese të bizneseve aktive, duke reflektuar një ritëm më të lartë të zhvillimit të sipërmarrjes. Interpretimi duhet të bëhet në kombinim me treguesit për mbylljen e bizneseve dhe numrin total të bizneseve aktive.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, madhësisë së biznesit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet të dhënave administrative mbi bizneset aktive dhe regjistrimet e reja.
Kufizimet	Treguesi nuk jep informacion mbi jetëgjatësinë apo suksesin e bizneseve të reja dhe mund të ndikohet nga ndryshimet në metodologjinë e regjistrimit të subjekteve ekonomike.

PASAPORTA E TË DHËNËS

Të dhënat D186 dhe D187 janë shtjelluar më lart në manual.

TREGUESI 283A04 NORMA E MBYLLJES SË BIZNESEVE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	283A04
Emërtimi	Norma e mbylljes së bizneseve
Funksioni	28.3 – Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike

Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë ritmin e mbylljes së bizneseve në raport me numrin total të bizneseve aktive në territorin e bashkisë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet përqindjen që zënë bizneset që kanë ndërprerë aktivitetin gjatë vitit raportues ndaj numrit total të bizneseve aktive. Ai shërben për të monitoruar dinamikën e daljes së bizneseve nga tregu dhe për të vlerësuar stabilitetin e mjedisit ekonomik vendor.
Rëndësia	Norma e mbylljes së bizneseve është një tregues i rëndësishëm i qëndrueshmërisë së ekonomisë lokale. Analiza e saj, së bashku me normën e krijimit të bizneseve, ndihmon në vlerësimin e klimës së biznesit, efektivitetit të politikave mbështetëse dhe tendencave të zhvillimit ekonomik vendor.
Formula	(D188 / D186) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e bizneseve aktive kanë ndërprerë aktivitetin gjatë vitit raportues. Interpretimi duhet të bëhet në lidhje me normën e krijimit të bizneseve, pasi një normë e lartë mbylljeje mund të kompensohet nga një nivel i lartë i krijimit të bizneseve të reja.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, madhësisë së biznesit, formës juridike ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave administrativë të bizneseve dhe të dhënave zyrtare mbi çregjistrimet ose ndërprerjet e aktivitetit.
Kufizimet	Treguesi nuk jep informacion mbi arsyet e mbylljes së bizneseve dhe mund të ndikohet nga ndryshimet në procedurat ose metodologjinë e regjistrimit të çregjistrimeve.

D188 NUMRI I BIZNESEVE TË MBYLLURA	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D188
Emërtimi	Numri i bizneseve të mbyllura
Përshkrimi i të dhënës	Numri i subjekteve ekonomike që kanë ndërprerë aktivitetin ose janë çregjistruar gjatë vitit raportues në territorin e bashkisë. Për qëllime të këtij treguesi, si **biznese të mbyllura** konsiderohen subjektet që kanë ndërprerë aktivitetin ose janë çregjistruar sipas regjistrit zyrtar gjatë periudhës së raportimit. Për të garantuar krahasueshmërinë ndërmjet viteve dhe bashkive, si numëruesi ashtu edhe emëruesi duhet të bazohen në të njëjtin burim administrativ dhe në të njëjtën periudhë raportimi.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e bizneseve që kanë ndërprerë aktivitetin ose janë çregjistruar gjatë vitit raportues dhe të mbështesë monitorimin e dinamikës së daljes së bizneseve nga tregu.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të institucioneve përgjegjëse për regjistrimin e bizneseve dhe përpunohen sipas territorit të bashkisë..
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet evidencave zyrtare të çregjistrimit ose ndërprerjes së aktivitetit të subjekteve ekonomike.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, madhësisë së biznesit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm bizneset e mbyllura sipas regjistrit administrativ dhe nuk jep informacion mbi arsyet e mbylljes apo ndikimin ekonomik të tyre

D186 NUMRI I BIZNESEVE AKTIVE

E dhena D186 eshte shtjelluar më lart në manual.

283A05 PESHA E BIZNESEVE AGRO-PËRPUNUESE DHE TURIZMIT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	283A05
Emërtimi	Pesha e bizneseve agro-përpunuese dhe turizmit
Funksioni	28.3 – Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të vlerësojë rëndësinë që zënë bizneset agro-përpunuese dhe ato të sektorit të turizmit në strukturën ekonomike të bashkisë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet përqindjen e bizneseve që ushtrojnë aktivitet në sektorin agro-përpunues dhe në sektorin e turizmit në raport me numrin total të bizneseve aktive në territorin e bashkisë. Ai pasqyron shkallën e specializimit ekonomik të territorit në dy sektorë me rëndësi strategjike për zhvillimin ekonomik vendor.
Rëndësia	Sektorët agro-përpunues dhe të turizmit përbëjnë motorë të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik në shumë bashki. Monitorimi i peshës së tyre ndihmon në vlerësimin e strukturës së ekonomisë lokale, identifikimin e potencialeve zhvillimore dhe orientimin e politikave vendore për mbështetjen e sektorëve prioritarë.
Formula	(D189 / D186) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se bizneset agro-përpunuese dhe ato të turizmit përbëjnë një pjesë më të madhe të ekonomisë vendore. Interpretimi duhet të bëhet në funksion të profilit ekonomik të bashkisë, pasi rëndësia e këtyre sektorëve ndryshon sipas karakteristikave territoriale dhe burimeve natyrore të disponueshme.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas sektorit të aktivitetit (agro-përpunim dhe turizëm), si dhe sipas njësive administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave administrativë të bizneseve dhe klasifikimit të tyre sipas aktivitetit ekonomik.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e bizneseve dhe nuk pasqyron madhësinë ekonomike, xhiron, numrin e të punësuarve apo kontributin e tyre në ekonominë vendore. Rezultatet varen nga klasifikimi korrekt i aktivitetit ekonomik të subjekteve.

D189 NUMRI I BIZNESEVE AGRO-PËRPUNUESE DHE TË TURIZMIT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D189
Emërtimi	Numri i bizneseve agro-përpunuese dhe të turizmit
Përshkrimi i të dhënës	Numri i bizneseve aktive që ushtrojnë aktivitet në sektorin agro-përpunues ose në sektorin e turizmit gjatë vitit raportues në territorin e bashkisë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e bizneseve që ushtrojnë aktivitet në sektorin agro-përpunues dhe në sektorin e turizmit dhe të mbështesë monitorimin e strukturës ekonomike të bashkisë.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga regjistrat administrativë të bizneseve dhe klasifikohen sipas aktivitetit ekonomik kryesor të subjektit.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet klasifikimit të aktiviteteve ekonomike sipas regjistrit zyrtar të bizneseve dhe evidencave administrative përkatëse.
Disagregimi	Sipas sektorit të aktivitetit (agro-përpunim/turizëm) dhe, kur është e mundur, sipas njësisë administrative.

Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e bizneseve të regjistruara në këta sektorë dhe nuk jep informacion mbi madhësinë, aktivitetin ekonomik apo kontributin e tyre në ekonominë vendore.

D186 NUMRI I BIZNESEVE AKTIVE

E dhena D186 eshte shtjelluar më lart në manual.

28.4 ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK VENDOR, SI INFORMACIONI PËR BIZNESET, AKTIVITETET PROMOVUESE, VËNIA NË DISPOZICION E ASETEVE PUBLIKE ETJ.

Ky funksion përfshin kompetencat e bashkisë për të organizuar dhe ofruar shërbime që mbështesin zhvillimin ekonomik vendor, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për biznesin, investimet dhe sipërmarrjen. Këto shërbime përfshijnë, ndër të tjera, ofrimin e informacionit dhe asistencës për bizneset, organizimin e aktiviteteve promovuese, lehtësimin e komunikimit ndërmjet administratës vendore dhe sektorit privat, si dhe vënien në dispozicion të aseteve publike për nxitjen e zhvillimit ekonomik.
Në kuadër të këtij funksioni, bashkia luan një rol koordinues në identifikimin dhe promovimin e mundësive për investime, mbështetjen e iniciativave sipërmarrëse, promovimin e produkteve dhe potencialeve lokale, si dhe krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit me biznesin dhe aktorët e tjerë ekonomikë. Përmes këtyre shërbimeve, synohet rritja e konkurrueshmërisë së territorit, përmirësimi i klimës së biznesit dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.
Treguesit e këtij funksioni monitorojnë masat që ndërmerr bashkia për të mbështetur zhvillimin ekonomik vendor, duke përfshirë planifikimin strategjik, dialogun me biznesin, promovimin e investimeve, administrimin dhe përdorimin e aseteve publike, si dhe zbatimin e instrumenteve që krijojnë kushte më të favorshme për zhvillimin e ekonomisë lokale. Në këtë mënyrë, ato ofrojnë një pasqyrë mbi angazhimin institucional të bashkisë në krijimin e një ekosistemi mbështetës për zhvillimin ekonomik.

TREGUESI 284A01 NUMRI I KONSULTIMEVE PUBLIKE NË FUSHËN E EKONOMISË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	284A01
Emërtimi	Numri i konsultimeve publike në fushën e ekonomisë
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo

Qëllimi	Të masë angazhimin e bashkisë në konsultimin e aktorëve ekonomikë dhe të publikut gjatë hartimit, zbatimit ose monitorimit të politikave dhe iniciativave për zhvillimin ekonomik vendor.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e konsultimeve publike të organizuara nga bashkia gjatë vitit raportues për çështje që lidhen me zhvillimin ekonomik vendor, klimën e biznesit, investimet, turizmin, përdorimin e aseteve publike ose tema të tjera me ndikim ekonomik.
Rëndësia	Konsultimet publike janë një instrument i rëndësishëm i qeverisjes së mirë dhe zhvillimit ekonomik gjithëpërfshirës. Ato mundësojnë përfshirjen e biznesit, organizatave të shoqërisë civile, institucioneve dhe qytetarëve në proceset vendimmarrëse, duke përmirësuar cilësinë dhe legjitimitetin e politikave vendore.
Formula	D158
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një angazhim më të madh të bashkisë në dialogun me aktorët ekonomikë. Megjithatë, treguesi mat numrin e konsultimeve dhe jo cilësinë, përfaqësueshmërinë ose ndikimin e tyre në vendimmarrje.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për konsultimin publik.
Disagregimi	Sipas tematikës së konsultimit, kategorisë së pjesëmarrësve ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet procesverbaleve, listave të pjesëmarrjes, njoftimeve publike dhe dokumentacionit që provon zhvillimin e konsultimit.
Kufizimet	Treguesi nuk vlerëson cilësinë e procesit të konsultimit, nivelin e pjesëmarrjes apo ndikimin e rekomandimeve të marra në politikat përfundimtare.

D158 NUMRI I KONSULTIMEVE PUBLIKE NË FUSHËN E EKONOMISË	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D158
Emërtimi	Numri i konsultimeve publike në fushën e ekonomisë
Përshkrimi i të dhënës	Numri i konsultimeve publike të organizuara nga bashkia gjatë vitit raportues për çështje që lidhen me zhvillimin ekonomik vendor, biznesin, investimet, turizmin ose politika të tjera me ndikim ekonomik.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e konsultimeve publike të organizuara nga bashkia për çështje që lidhen me zhvillimin ekonomik vendor dhe të mbështesë vlerësimin e angazhimit të saj në dialogun me biznesin, aktorët ekonomikë dhe publikun.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor dhe struktura përgjegjëse për koordinimin e konsultimeve publike.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga evidencat administrative të bashkisë mbi konsultimet publike të zhvilluara gjatë vitit raportues.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet dokumentacionit të konsultimeve, përfshirë njoftimet, procesverbalet, listat e pjesëmarrësve dhe raportet përmbledhëse.
Disagregimi	Sipas tematikës së konsultimit, kategorisë së pjesëmarrësve ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e konsultimeve të zhvilluara dhe nuk vlerëson cilësinë e procesit, nivelin apo përfaqësueshmërinë e pjesëmarrjes dhe ndikimin e rekomandimeve në vendimmarrje

TREGUESI 284A02 NUMRI I RAPORTEVE TË MONITORIMIT EKONOMIK

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	284A02
Emërtimi	Numri i raporteve të monitorimit ekonomik
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë kapacitetin e bashkisë për të monitoruar në mënyrë sistematike zhvillimin ekonomik vendor dhe për të prodhuar analiza që mbështesin planifikimin dhe vendimmarrjen.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e raporteve të monitorimit ekonomik të përgatitura nga bashkia gjatë vitit raportues. Raportet mund të trajtojnë zhvillimin e ekonomisë lokale, ecurinë e sektorëve prioritarë, klimën e biznesit, investimet, punësimin, turizmin ose tema të tjera me rëndësi për zhvillimin ekonomik vendor.
Rëndësia	Monitorimi i rregullt i zhvillimit ekonomik i mundëson bashkisë të identifikojë tendencat, sfidat dhe mundësitë e territorit, duke mbështetur hartimin e politikave të bazuara në evidencë dhe përmirësimin e ndërhyrjeve për zhvillimin ekonomik vendor.
Formula	D159
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një numër më i lartë raportesh tregon një praktikë më të konsoliduar të monitorimit dhe analizës ekonomike. Megjithatë, treguesi mat vetëm sasinë e raporteve dhe jo cilësinë, përmbajtjen apo ndikimin e tyre në proceset vendimmarrëse.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.

Disagregimi	Sipas tematikës së raportit (zhvillim ekonomik, investime, biznes, turizëm, sektorë prioritarë etj.), kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet raporteve të miratuara ose të publikuara nga bashkia, evidencave administrative dhe dokumentacionit mbështetës.
Kufizimet	Treguesi nuk vlerëson cilësinë metodologjike, thellësinë analitike apo përdorimin e raporteve në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes.

D159 NUMRI I RAPORTEVE TË MONITORIMIT EKONOMIK

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D159
Emërtimi	Numri i raporteve të monitorimit ekonomik
Përshkrimi i të dhënës	Numri i raporteve analitike ose monitoruese të përgatitura nga bashkia gjatë vitit raportues mbi zhvillimin ekonomik vendor ose tematika të lidhura me të.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e raporteve të monitorimit dhe analizës ekonomike të përgatitura nga bashkia dhe të mbështesë vlerësimin e kapacitetit të saj për monitorimin sistematik të zhvillimit ekonomik vendor.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor dhe arkiva dokumentare e bashkisë.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga evidencat administrative të strukturës përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor dhe nga dokumentacioni zyrtar i bashkisë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet ekzistencës së raporteve, datës së hartimit, miratimit ose publikimit të tyre dhe dokumentacionit mbështetës.
Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e raporteve të prodhuara dhe nuk vlerëson cilësinë metodologjike, thellësinë e analizës, përdorimin apo ndikimin e tyre në planifikim dhe vendimmarrje.

TREGUESI 284A03 PJESËMARRJA E BASHKISË NË GRUPE PUNE / KOMITETE SEKTORIALE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	284A03
Emërtimi	Pjesëmarrja e bashkisë në grupe pune / komitete sektoriale
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë angazhimin institucional të bashkisë në mekanizma bashkëpunimi dhe koordinimi që kontribuojnë në planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin ekonomik vendor.
Përshkrimi	Treguesi paraqet pjesëmarrjen e bashkisë në grupe pune, komitete sektoriale, forume ose struktura të tjera të formalizuara bashkëpunimi që trajtojnë çështje të zhvillimit ekonomik vendor, investimeve, sipërmarrjes, turizmit, punësimit ose fushave të tjera të lidhura me zhvillimin ekonomik.
Rëndësia	Pjesëmarrja aktive në mekanizma koordinues forcon bashkëpunimin ndërinstitucional, mundëson shkëmbimin e informacionit dhe praktikave të mira, si dhe kontribuon në harmonizimin e politikave dhe ndërhyrjeve për zhvillimin ekonomik vendor. Ajo rrit kapacitetin e bashkisë për të përfaqësuar interesat e territorit dhe për të ndërtuar partneritete efektive me aktorë të tjerë publikë dhe privatë.
Formula	D160
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një angazhim më të madh të bashkisë në mekanizmat institucionalë të koordinimit për zhvillimin ekonomik. Megjithatë, treguesi nuk mat cilësinë e pjesëmarrjes, nivelin e kontributit apo rezultatet konkrete të arritura përmes këtyre mekanizmave.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas nivelit të grupit ose komitetit (vendor, rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar), sipas sektorit ekonomik ose sipas institucionit koordinues, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet vendimeve të emërimit, ftesave zyrtare, procesverbaleve të mbledhjeve, listave të pjesëmarrjes ose dokumentacionit tjetër që provon pjesëmarrjen e bashkisë.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm pjesëmarrjen formale të bashkisë dhe nuk vlerëson ndikimin e saj në vendimmarrje ose rezultatet e grupeve të punës dhe komiteteve.

PASAPORTA E TË DHËNËS D160

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D160
Emërtimi	Pjesëmarrja e bashkisë në grupe pune / komitete sektoriale
Përshkrimi i të dhënës	Numri i grupeve të punës, komiteteve sektoriale ose mekanizmave të tjerë formalë të koordinimit në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, ku bashkia ka marrë pjesë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë pjesëmarrjen e bashkisë në mekanizma formalë të koordinimit dhe bashkëpunimit në fushën e zhvillimit ekonomik vendor dhe të mbështesë vlerësimin e angazhimit të saj institucional në këto struktura.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor dhe dokumentacioni administrativ i bashkisë.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga evidencat administrative të bashkisë mbi pjesëmarrjen në mekanizma formalë të koordinimit dhe bashkëpunimit.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet procesverbaleve, listave të pjesëmarrjes, vendimeve administrative ose dokumenteve të tjera që provojnë pjesëmarrjen e bashkisë në grupet e punës ose komitetet sektoriale.

Disagregimi	Nuk aplikohet
Kufizimet	E dhëna evidenton pjesëmarrjen formale të bashkisë në mekanizmat e koordinimit, por nuk vlerëson intensitetin dhe cilësinë e pjesëmarrjes, kontributin e bashkisë apo rezultatet e arritura përmes tyre.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D 160

Për qëllime të këtij treguesi, **grupe pune ose komitete sektoriale** konsiderohen vetëm mekanizmat formalë të krijuar me akt administrativ, marrëveshje bashkëpunimi ose vendim institucional, të cilët trajtojnë çështje që lidhen me zhvillimin ekonomik vendor. Në raportim përfshihen vetëm mekanizmat ku bashkia ka marrë pjesë aktive gjatë vitit raportues. Nuk përfshihen takimet informale, konsultimet sporadike ose aktivitetet që nuk janë pjesë e një mekanizmi të formalizuar koordinimi.

TREGUESI 284A04 PESHA E NVM-VE TË ASISTUARA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	284A04
Emërtimi	Pesha e NVM-ve të asistuara
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë përqindjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) që kanë përfituar shërbime mbështetëse nga bashkia gjatë vitit raportues, në raport me numrin total të bizneseve aktive në territor.
Përshkrimi	Treguesi paraqet peshën që zënë NVM-të e asistuara nga bashkia përmes shërbimeve të informacionit, këshillimit, orientimit, promovimit, ndërmjetësimit, trajnimit ose formave të tjera të mbështetjes, ndaj numrit total të bizneseve aktive në territor.
Rëndësia	Mbështetja e NVM-ve është një nga instrumentet kryesore të zhvillimit ekonomik vendor. Ky tregues vlerëson shkallën e mbulimit të shërbimeve mbështetëse të bashkisë dhe aftësinë e saj për të arritur bizneset që operojnë në territor. Një mbulim më i gjerë nënkupton një rol më aktiv të bashkisë në zhvillimin e sipërmarrjes lokale.
Formula	(D191 / D186) × 100

Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e bizneseve aktive kanë përfituar mbështetje nga bashkia. Interpretimi duhet të bëhet duke marrë parasysh llojin dhe intensitetin e shërbimeve të ofruara, pasi treguesi mat mbulimin dhe jo cilësinë apo efektivitetin e asistencës.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas llojit të asistencës së ofruar, sektorit ekonomik, madhësisë së ndërmarrjes ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të përfituesve, evidencave të aktiviteteve të asistencës dhe dokumentacionit administrativ të bashkisë.
Kufizimet	Treguesi nuk mat ndikimin e asistencës në performancën e NVM-ve dhe nuk bën dallim ndërmjet niveleve të ndryshme të mbështetjes së ofruar.

D191 NUMRI I NVM-VE TË ASISTUARA NGA BASHKIA

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D191
Emërtimi	Numri i NVM-ve të asistuara nga bashkia
Përshkrimi i të dhënës	Numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që kanë përfituar të paktën një shërbim mbështetës të ofruar ose të koordinuar nga bashkia gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që kanë përfituar të paktën një shërbim mbështetës nga bashkia dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e mbulimit të NVM-ve me shërbime mbështetëse.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor dhe dokumentacioni administrativ i bashkisë.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat administrativë të strukturës përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor dhe evidencat e aktiviteteve mbështetëse të realizuara nga bashkia.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet listave të përfituesve, formularëve të pjesëmarrjes, raporteve të aktiviteteve ose dokumentacionit tjetër që provon ofrimin e shërbimit.
Disagregimi	Sipas llojit të asistencës, sektorit ekonomik, madhësisë së ndërmarrjes ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton numrin e NVM-ve të asistuara, por nuk mat intensitetin, cilësinë apo efektivitetin e asistencës së ofruar. Çdo NVM duhet të numërohet vetëm një herë gjatë vitit raportues, pavarësisht numrit të shërbimeve të përfituara.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D191

Për qëllime të këtij treguesi, **NVM e asistuar** konsiderohet çdo ndërmarrje e vogël ose e mesme që ka përfituar të paktën një shërbim mbështetës të ofruar ose të koordinuar nga bashkia gjatë vitit raportues, si këshillim, informacion, trajnim, ndërmjetësim, promovim apo forma të tjera asistence. Çdo NVM raportohet vetëm një herë, pavarësisht numrit të shërbimeve të përfituara gjatë vitit. Treguesi llogaritet duke pjesëtuar numrin e NVM-ve të asistuara (**D191**) me numrin total të bizneseve aktive (**D186**) dhe duke shumëzuar rezultatin me 100. Për të garantuar krahasueshmërinë ndërmjet bashkive, rekomandohet përdorimi i të njëjtit përkufizim të NVM-së dhe i të njëjtave procedura administrative të regjistrimit të përfituesve.

D186 NUMRI I BIZNESEVE AKTIVE

E dhena D186 eshte shtjelluar më lart në manual.

TREGUESI 284A05 NUMRI I SESIONEVE TË INFORMIMIT/KËSHILLIMIT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	284A05
Emërtimi	Numri i sesioneve të informimit/këshillimit
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.

Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë intensitetin e aktiviteteve të informimit dhe këshillimit të organizuara nga bashkia për mbështetjen e ndërmarrjeve, sipërmarrësve dhe investitorëve potencialë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e sesioneve të informimit ose këshillimit të organizuara nga bashkia gjatë vitit raportues mbi tema që lidhen me zhvillimin ekonomik vendor, klimën e biznesit, mundësitë e financimit, procedurat administrative, investimet, sipërmarrjen, inovacionin ose çështje të tjera me interes për biznesin.
Rëndësia	Ofrimi i informacionit dhe këshillimit për bizneset është një ndër shërbimet bazë të zhvillimit ekonomik vendor. Organizimi i sesioneve informuese ndihmon në rritjen e aksesit të bizneseve në informacion, përmirëson komunikimin ndërmjet administratës vendore dhe sektorit privat dhe kontribuon në zhvillimin e një mjedisi më të favorshëm për sipërmarrjen.
Formula	D192
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një angazhim më të madh të bashkisë në ofrimin e shërbimeve të informimit dhe këshillimit. Megjithatë, treguesi nuk mat cilësinë e sesioneve, nivelin e pjesëmarrjes apo ndikimin e tyre në zhvillimin e bizneseve.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas tematikës së sesionit, grupit të synuar (NVM, sipërmarrës të rinj, fermerë, investitorë etj.) ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet programeve të aktiviteteve, listave të pjesëmarrjes, materialeve informuese, procesverbaleve ose dokumentacionit tjetër mbështetës.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e sesioneve të zhvilluara dhe nuk vlerëson cilësinë, kohëzgjatjen apo rezultatet e tyre.

D192 NUMRI I SESIONEVE TË INFORMIMIT/KËSHILLIMIT	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D192
Emërtimi	Numri i sesioneve të informimit/këshillimit
Përshkrimi i të dhënës	Numri i sesioneve të informimit ose këshillimit të organizuara nga bashkia gjatë vitit raportues për mbështetjen e zhvillimit ekonomik vendor dhe biznesit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e aktiviteteve të informimit dhe këshillimit të organizuara ose bashkëorganizuara nga bashkia për bizneset, sipërmarrësit dhe investitorët dhe të mbështesë monitorimin e shërbimeve të ofruara për zhvillimin ekonomik vendor.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor dhe dokumentacioni administrativ i bashkisë.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga evidencat administrative të strukturës përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor mbi aktivitetet e organizuara gjatë vitit raportues.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet programeve të aktiviteteve, listave të pjesëmarrjes, materialeve të shpërndara, raporteve të aktiviteteve ose dokumentacionit tjetër mbështetës.
Disagregimi	Sipas tematikës së sesionit, grupit të synuar (NVM, sipërmarrës, fermerë, investitorë etj.) ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e sesioneve të dokumentuara dhe nuk vlerëson cilësinë, kohëzgjatjen, numrin e përfituesve apo rezultatet e tyre.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D192

Për qëllime të këtij treguesi, **sesion informimi/këshillimi** konsiderohet çdo aktivitet i organizuar ose i bashkëorganizuar nga bashkia që synon informimin, orientimin ose këshillimin e bizneseve, sipërmarrësve apo investitorëve mbi çështje që lidhen me zhvillimin ekonomik vendor. Në raportim përfshihen seminaret, ditët informuese, takimet këshilluese, sesionet

individuale ose në grup dhe aktivitetet e ngjashme. Çdo aktivitet raportohet si një sesion i veçantë, pavarësisht numrit të pjesëmarrësve. Në raportim përfshihen vetëm sesionet e dokumentuara me evidenca administrative.

TREGUESI 284A06 NUMRI I PJESËMARRËSVE NË SESIONE DHE TRAJNIME EKONOMIKE	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	284A06
Emërtimi	Numri i pjesëmarrësve në sesione dhe trajnime ekonomike
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë shtrirjen e aktiviteteve të informimit, këshillimit dhe ngritjes së kapaciteteve të organizuara nga bashkia për aktorët ekonomikë në territor.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e pjesëmarrësve në sesione informimi, këshillimi, trajnime, seminare ose aktivitete të tjera të organizuara ose të bashkëorganizuara nga bashkia në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor. Në këtë kategori përfshihen përfaqësues të bizneseve, sipërmarrës, investitorë potencialë, fermerë, organizata të biznesit dhe aktorë të tjerë ekonomikë.
Rëndësia	Numri i pjesëmarrësve pasqyron shkallën e përfshirjes së komunitetit të biznesit në aktivitetet mbështetëse të bashkisë. Një pjesëmarrje më e lartë tregon një shtrirje më të gjerë të shërbimeve të ofruara dhe një potencial më të madh për përmirësimin e njohurive, aftësive dhe aksesit në informacion të aktorëve ekonomikë.
Formula	D193
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se aktivitetet e organizuara nga bashkia kanë arritur një numër më të madh përfituesish. Megjithatë, treguesi nuk mat cilësinë e pjesëmarrjes, nivelin e përvetësimit të njohurive apo ndikimin e trajnimeve në performancën e bizneseve.
Frekuenca e raportimit	Vjetore

Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas gjinisë, kategorisë së pjesëmarrësit (biznes, fermer, sipërmarrës, investitor etj.), llojit të aktivitetit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet listave të pjesëmarrjes, formularëve të regjistrimit, certifikatave të pjesëmarrjes, raporteve të aktiviteteve ose dokumentacionit tjetër mbështetës.
Kufizimet	Treguesi mat numrin e pjesëmarrjeve dhe nuk pasqyron cilësinë e aktiviteteve, nivelin e angazhimit të pjesëmarrësve apo rezultatet konkrete të arritura.

D193 NUMRI I PJESËMARRËSVE NË SESIONE DHE TRAJNIME EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D193
Emërtimi	Numri i pjesëmarrësve në sesione dhe trajnime ekonomike
Përshkrimi i të dhënës	Numri i personave që kanë marrë pjesë në sesione informimi, këshillimi, trajnime ose aktivitete të tjera të organizuara ose të bashkëorganizuara nga bashkia gjatë vitit raportues në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e pjesëmarrësve të arritur përmes aktiviteteve të informimit, këshillimit dhe trajnimit të organizuara ose bashkëorganizuara nga bashkia dhe të mbështesë vlerësimin e shtrirjes së këtyre aktiviteteve.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor dhe dokumentacioni administrativ i aktiviteteve.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga listat e pjesëmarrjes dhe evidencat administrative të aktiviteteve të organizuara nga bashkia.

Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet listave të pjesëmarrjes, formularëve të regjistrimit, raporteve të aktiviteteve dhe dokumentacionit tjetër mbështetës.
Disagregimi	Sipas gjinisë, kategorisë së pjesëmarrësit (biznes, fermer, sipërmarrës, investitor etj.), llojit të aktivitetit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna pasqyron numrin e pjesëmarrjeve të regjistruara dhe jo domosdoshmërisht numrin e individëve unikë, pasi i njëjti person mund të marrë pjesë në më shumë se një aktivitet. Nuk vlerëson cilësinë e aktivitetit, përvetësimin e njohurive apo rezultatet e arritura

TREGUESI 284A07 NUMRI I INVESTIMEVE TË REJA NË TERRITOR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	284A07
Emërtimi	Numri i investimeve të reja në territor
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë numrin e investimeve të reja të realizuara në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues, si një tregues i atraktivitetit ekonomik dhe dinamikës së investimeve vendore.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e investimeve të reja të realizuara gjatë vitit raportues në territorin e bashkisë, pavarësisht nëse janë investime private, publike apo të realizuara në partneritet. Ai pasqyron zhvillimin e aktivitetit investues dhe aftësinë e territorit për të tërhequr ose gjeneruar investime të reja.
Rëndësia	Investimet e reja kontribuojnë në zgjerimin e aktivitetit ekonomik, krijimin e vendeve të punës, rritjen e produktivitetit dhe zhvillimin e territorit. Monitorimi i tyre ndihmon bashkinë të vlerësojë efektivitetin e politikave të zhvillimit ekonomik dhe të identifikojë sektorët me potencial më të lartë investimi.
Formula	D198
Njësia matëse	Numër

Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një aktivitet më të madh investues në territor. Megjithatë, treguesi nuk pasqyron madhësinë financiare, ndikimin ekonomik apo kohëzgjatjen e investimeve të realizuara. Për këtë arsye, ai duhet të analizohet së bashku me treguesin për vlerën e investimeve të reja (284A08).
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas llojit të investimit (publik, privat ose partneritet publik-privat), sektorit ekonomik ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet dokumentacionit administrativ, lejeve përkatëse, kontratave të investimit, marrëveshjeve ose burimeve të tjera zyrtare që dokumentojnë realizimin e investimit.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e investimeve dhe nuk pasqyron vlerën financiare, shkallën e zbatimit apo ndikimin ekonomik të secilit investim.

D198 NUMRI I INVESTIMEVE TË REJA NË TERRITOR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D198
Emërtimi	Numri i investimeve të reja në territor
Përshkrimi i të dhënës	Numri i investimeve të reja të realizuara gjatë vitit raportues në territorin e bashkisë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e investimeve të reja të realizuara në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues dhe të mbështesë monitorimin e dinamikës së aktivitetit investues vendor.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni Përgjegjës	Bashkia, institucionet publike përgjegjëse, investitorët ose dokumentacioni administrativ përkatës.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga evidencat administrative të bashkisë, strukturat përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor dhe burime të tjera institucionale që dokumentojnë investimet e realizuara.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kontratave, lejeve, certifikatave të përfundimit të investimit, raporteve të zbatimit ose dokumentacionit tjetër mbështetës.
Disagregimi	Sipas llojit të investimit (publik, privat ose partneritet), sektorit ekonomik ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton numrin e investimeve të reja të dokumentuara, por nuk pasqyron vlerën financiare, madhësinë, shkallën e realizimit apo ndikimin ekonomik të tyre. Mirëmbajtjet rutinë dhe zëvendësimet që nuk krijojnë ose zgjerojnë kapacitete ekonomike nuk përfshihen.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D198

Për qëllime të këtij treguesi, **investim i ri** konsiderohet çdo projekt investimi që ka filluar ose është realizuar gjatë vitit raportues dhe që krijon ose zgjeron kapacitete ekonomike në territorin e bashkisë. Në raportim përfshihen investimet publike, private dhe ato të realizuara në partneritet, për sa kohë që janë të dokumentuara dhe lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik vendor. Nuk përfshihen mirëmbajtjet rutinë, riparimet e zakonshme apo zëvendësimet e aseteve që nuk sjellin krijim ose zgjerim të kapaciteteve ekonomike.

TREGUESI 284A08 VLERA E INVESTIMEVE TË REJA NË TERRITOR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	284A08
Emërtimi	Vlera e investimeve të reja në territor
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë vlerën monetare të investimeve të reja të realizuara në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.

Përshkrimi	Treguesi paraqet vlerën totale financiare të investimeve të reja të realizuara në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues. Në këtë kategori përfshihen investimet private, publike dhe ato të realizuara në partneritet, të cilat kontribuojnë në zhvillimin ekonomik vendor.
Rëndësia	Vlera e investimeve është një tregues kyç për vlerësimin e zhvillimit ekonomik të territorit dhe atraktivitetit të tij për investime. Krahas numrit të investimeve, ky tregues ndihmon në vlerësimin e shkallës së kapitalit të mobilizuar dhe potencialit për krijimin e vendeve të punës, zgjerimin e aktivitetit ekonomik dhe rritjen e konkurrueshmërisë së territorit.
Formula	D199
Njësia matëse	Lekë
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të madh investimesh të realizuara në territor. Megjithatë, interpretimi duhet të bëhet së bashku me numrin e investimeve (284A07), pasi një numër i vogël investimesh mund të përfaqësojë investime me vlerë të lartë dhe anasjelltas.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas llojit të investimit (publik, privat, partneritet publik-privat), sektorit ekonomik ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kontratave të investimit, lejeve të ndërtimit, dokumentacionit financiar, deklarimeve të investitorëve ose burimeve të tjera zyrtare.
Kufizimet	Treguesi nuk mat ndikimin ekonomik, social ose mjedisor të investimeve dhe mund të ndikohet nga disponueshmëria dhe saktësia e të dhënave financiare të raportuara.

D199 VLERA E INVESTIMEVE TË REJA NË TERRITOR

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D199
Emërtimi	Vlera e investimeve të reja në territor

Përshkrimi i të dhënës	Vlera totale financiare e investimeve të reja të realizuara gjatë vitit raportues në territorin e bashkisë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë vlerën financiare të investimeve të reja të realizuara në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues dhe të mbështesë monitorimin e kapitalit të mobilizuar për zhvillimin ekonomik vendor.
Njësia matëse	Lekë
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Bashkia, investitorët, institucionet publike përgjegjëse dhe dokumentacioni administrativ përkatës.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga dokumentacioni administrativ i bashkisë, investitorëve, institucioneve publike ose burimeve të tjera zyrtare që dokumentojnë vlerën e investimeve të realizuara.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kontratave të investimit, dokumenteve financiare, lejeve, raporteve të zbatimit ose dokumentacionit tjetër mbështetës.
Disagregimi	Sipas llojit të investimit (publik, privat ose partneritet), sektorit ekonomik ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna pasqyron vetëm vlerën e investimeve të dokumentuara me burime të verifikueshme dhe nuk mat ndikimin ekonomik, social apo mjedisor të tyre. Për investimet shumëvjeçare duhet të raportohet vetëm vlera e realizuar gjatë vitit raportues.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D199

Për qëllime të këtij treguesi, **vlera e investimeve të reja** përfaqëson shumën e kapitalit të investuar në projektet e reja të realizuara gjatë vitit raportues në territorin e bashkisë. Në raportim përfshihet vetëm vlera e investimeve të dokumentuara me burime zyrtare ose dokumentacion financiar të verifikueshëm. Kur investimet shtrihen në më shumë se një vit, raportohet vetëm vlera e investimit e realizuar gjatë vitit raportues, sipas progresit të dokumentuar të zbatimit.

TREGUESI 284A09 NUMRI I INVESTIMEVE NË ZONAT EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	284A09
Emërtimi	Numri i investimeve në zonat ekonomike
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë numrin e investimeve të realizuara në zonat ekonomike të territorit të bashkisë gjatë vitit raportues, si tregues i zhvillimit të këtyre zonave dhe tërheqjes së investimeve.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e investimeve të reja të realizuara në zona ekonomike, parqe industriale, zona të zhvillimit ekonomik ose hapësira të tjera të përcaktuara për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në territorin e bashkisë.
Rëndësia	Zonat ekonomike janë instrumente të rëndësishme për nxitjen e investimeve, zhvillimin industrial dhe krijimin e vendeve të punës. Monitorimi i numrit të investimeve në këto zona ndihmon në vlerësimin e efektivitetit të politikave vendore për zhvillimin ekonomik dhe të përdorimit të infrastrukturës së dedikuar për biznesin.
Formula	D201
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të madh të aktivitetit investues në zonat ekonomike të bashkisë. Megjithatë, treguesi nuk pasqyron vlerën financiare, madhësinë apo ndikimin ekonomik të investimeve të realizuara.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.

Disagregimi	Sipas llojit të zonës ekonomike, sektorit të aktivitetit ekonomik ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave administrativë, kontratave të investimit, lejeve përkatëse, marrëveshjeve të vendosjes në zonën ekonomike ose dokumentacionit tjetër mbështetës.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e investimeve dhe nuk jep informacion mbi vlerën, përmasat apo rezultatet ekonomike të tyre. Interpretimi duhet të bëhet së bashku me treguesit mbi vlerën e investimeve dhe zhvillimin ekonomik të territorit.

D201 NUMRI I INVESTIMEVE NË ZONAT EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D201
Emërtimi	Numri i investimeve në zonat ekonomike
Përshkrimi i të dhënës	Numri i investimeve të reja të realizuara gjatë vitit raportues në zonat ekonomike të territorit të bashkisë.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e investimeve të reja të realizuara në zonat ekonomike gjatë vitit raportues dhe të mbështesë vlerësimin e nivelit të aktivitetit investues në këto zona.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Bashkia, administratori i zonës ekonomike, institucionet përgjegjëse për zhvillimin ekonomik dhe dokumentacioni administrativ përkatës.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga evidencat administrative të bashkisë, administratorëve të zonave ekonomike dhe dokumentacioni mbi investimet e realizuara.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kontratave të investimit, marrëveshjeve të vendosjes në zonën ekonomike, lejeve përkatëse dhe dokumentacionit tjetër mbështetës.
Disagregimi	Sipas zonës ekonomike, llojit të zonës, sektorit të aktivitetit ekonomik ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.

Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e investimeve të reja të dokumentuara brenda zonave ekonomike dhe nuk jep informacion mbi vlerën financiare, madhësinë, shkallën e realizimit apo rezultatet ekonomike të tyre.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D201

Për qëllime të këtij treguesi, **zonë ekonomike** konsiderohet çdo zonë e krijuar ose e njohur sipas legjislacionit në fuqi për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, përfshirë parqet industriale, zonat teknologjike, zonat e lira ekonomike ose forma të tjera të ngjashme. Në raportim përfshihen vetëm investimet e reja të dokumentuara që janë realizuar brenda kufijve të këtyre zonave gjatë vitit raportues. Çdo investim raportohet vetëm një herë, pavarësisht fazave të zbatimit të tij.

TREGUESI 284A10NVM TË INTEGRUARA NË ZINXHIRË VLERE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	284A10
Emërtimi	NVM të integruara në zinxhirë vlere
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë numrin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) që janë integruar në zinxhirë vlere gjatë vitit raportues, si rezultat i zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike dhe mbështetjes për zhvillimin e biznesit.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e NVM-ve që janë bërë pjesë e zinxhirëve të furnizimit, prodhimit, përpunimit, shpërndarjes ose tregtimit të produkteve dhe shërbimeve, duke krijuar lidhje të qëndrueshme me ndërmarrje të tjera, tregje ose rrjete ekonomike.
Rëndësia	Integrimi i NVM-ve në zinxhirë vlere rrit konkurrueshmërinë, aksesin në tregje, mundësitë për inovacion dhe bashkëpunim ndërmjet bizneseve. Ky tregues ndihmon në vlerësimin e efektivitetit të politikave vendore për zhvillimin e sipërmarrjes dhe fuqizimin e ekonomisë lokale.
Formula	D203
Njësia matëse	Numër

Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se më shumë NVM janë integruar në marrëdhënie ekonomike të qëndrueshme me aktorë të tjerë të tregut. Megjithatë, treguesi nuk mat intensitetin ekonomik të këtyre marrëdhënieve apo përfitimet financiare që burojnë prej tyre.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, llojit të zinxhirit të vlerës (agro-ushqimor, turizëm, industri, shërbime etj.), madhësisë së ndërmarrjes ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, kontratave tregtare, programeve të mbështetjes, raporteve të projekteve ose dokumentacionit tjetër që provon integrimin e NVM-ve në zinxhirë vlere.
Kufizimet	Treguesi nuk mat nivelin e përfitimeve ekonomike, qëndrueshmërinë apo kohëzgjatjen e integrimit në zinxhirët e vlerës. Rezultatet varen nga disponueshmëria e informacionit të verifikueshëm mbi marrëdhëniet ndërmjet bizneseve.

D203 NUMRI I NVM-VE TË INTEGRUARA NË ZINXHIRË VLERE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D203
Emërtimi	Numri i NVM-ve të integruara në zinxhirë vlere
Përshkrimi i të dhënës	Numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që gjatë vitit raportues janë integruar në zinxhirë vlere nëpërmjet krijimit të marrëdhënieve të qëndrueshme të furnizimit, prodhimit, përpunimit, shpërndarjes ose tregtimit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e NVM-ve që janë integruar në zinxhirë vlere përmes marrëdhënieve të dokumentuara ekonomike dhe të mbështesë monitorimin e lidhjeve dhe bashkëpunimit ndërmjet bizneseve.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore

Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor, programet e zhvillimit ekonomik, organizatat mbështetëse të biznesit dhe dokumentacioni administrativ përkatës.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga evidencat administrative të bashkisë, programet e mbështetjes së biznesit, projektet e zhvillimit ekonomik dhe dokumentacioni i subjekteve përfituese.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kontratave, marrëveshjeve të bashkëpunimit, dokumenteve të projekteve, deklarimeve të bizneseve ose evidencave të tjera që provojnë integrimin në zinxhirë vlere.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, llojit të zinxhirit të vlerës (agro-ushqimor, turizëm, industri, shërbime etj.), madhësisë së ndërmarrjes ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton numrin e NVM-ve me integrim të dokumentuar në zinxhirë vlere, por nuk mat intensitetin, vlerën ekonomike, kohëzgjatjen apo qëndrueshmërinë e marrëdhënieve të krijuara. Çdo NVM raportohet vetëm një herë gjatë vitit.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D203

Për qëllime të këtij treguesi, **NVM e integruar në zinxhir vlere** konsiderohet çdo ndërmarrje e vogël ose e mesme që, gjatë vitit raportues, ka krijuar ose ka konsoliduar marrëdhënie të dokumentuara furnizimi, prodhimi, përpunimi, shpërndarjeje ose tregtimi me aktorë të tjerë ekonomikë, duke u bërë pjesë e një zinxhiri vlere. Çdo NVM raportohet vetëm një herë, pavarësisht numrit të marrëdhënieve tregtare ose zinxhirëve të vlerës ku është përfshirë. Për të garantuar krahasueshmërinë ndërmjet bashkive, rekomandohet përdorimi i kritereve të njëjta për identifikimin dhe dokumentimin e integrimit në zinxhirët e vlerës.

TREGUESI 284A11 MARRËVESHJE BASHKI-BIZNES	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	284A11
Emërtimi	Marrëveshje Bashki–Biznes
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.

Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë bashkëpunimin formal ndërmjet bashkisë dhe sektorit privat për realizimin e iniciativave që mbështesin zhvillimin ekonomik vendor.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara ose aktive gjatë vitit raportues ndërmjet bashkisë dhe bizneseve ose organizatave përfaqësuese të biznesit, me qëllim promovimin e investimeve, zhvillimin e sipërmarrjes, fuqizimin e zinxhirëve të vlerës, zhvillimin e turizmit, përmirësimin e aftësive profesionale ose nisma të tjera që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik vendor.
Rëndësia	Bashkëpunimi i strukturuar ndërmjet bashkisë dhe biznesit është një element kyç i zhvillimit ekonomik vendor. Marrëveshjet formale krijojnë baza për koordinimin e veprimeve, mobilizimin e burimeve dhe zbatimin e iniciativave të përbashkëta që përmirësojnë klimën e biznesit dhe rrisin konkurrueshmërinë e territorit.
Formula	D202
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të madh bashkëpunimi institucional ndërmjet bashkisë dhe sektorit privat. Megjithatë, treguesi mat ekzistencën e marrëveshjeve dhe jo zbatimin apo rezultatet konkrete të tyre.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas llojit të partnerit (biznes individual, shoqatë biznesi, dhomë tregtie, klaster etj.), fushës së bashkëpunimit ose sektorit ekonomik, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara, memorandumeve të mirëkuptimit, kontratave të bashkëpunimit ose dokumentacionit tjetër administrativ që provon ekzistencën e marrëveshjes.
Kufizimet	Treguesi nuk mat shkallën e zbatimit, kohëzgjatjen apo ndikimin e marrëveshjeve në zhvillimin ekonomik vendor.

D202 NUMRI I MARRËVESHJEVE BASHKI-BIZNES	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D202
Emërtimi	Numri i marrëveshjeve Bashki–Biznes
Përshkrimi i të dhënës	Numri i marrëveshjeve formale të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe bizneseve ose organizatave përfaqësuese të biznesit që kanë qenë aktive ose janë nënshkruar gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e marrëveshjeve formale të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe sektorit privat dhe të mbështesë monitorimin e partneriteteve për zhvillimin ekonomik vendor.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor, sekretaria e bashkisë dhe arkiva e marrëveshjeve.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga evidencat administrative të bashkisë mbi marrëveshjet e bashkëpunimit dhe partneritetet me sektorin privat.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara, memorandumeve të mirëkuptimit, vendimeve administrative ose dokumentacionit tjetër mbështetës.
Disagregimi	Sipas statusit të administrimit të qendrës, vendndodhjes ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e qendrave funksionale dhe nuk pasqyron cilësinë e shërbimit, orarin e funksionimit, kapacitetet njerëzore apo nivelin e përdorimit të tyre. Pikat e përkohshme të informacionit për evente të veçanta nuk përfshihen.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D202

Për qëllime të këtij treguesi, **marrëveshje Bashki-Biznes** konsiderohet çdo marrëveshje formale bashkëpunimi e nënshkruar ndërmjet bashkisë dhe një ose më shumë subjekteve të sektorit privat ose organizatave që përfaqësojnë interesat e biznesit, me objekt zhvillimin ekonomik vendor. Në raportim përfshihen marrëveshjet që janë nënshkruar ose kanë qenë aktive gjatë vitit raportues. Nuk përfshihen kontratat e prokurimit publik, kontratat për

ofrimin e shërbimeve apo marrëdhëniet kontraktore që nuk kanë si qëllim bashkëpunimin për zhvillimin ekonomik vendor.

284A12 – NUMRI I QENDRAVE TË INFORMACIONIT TURISTIK (TIC).

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	284A12
Emërtimi	Numri i qendrave të informacionit turistik (TIC)
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë kapacitetin institucional të bashkisë për ofrimin e shërbimeve të informacionit dhe orientimit për vizitorët dhe turistët në territor.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e qendrave të informacionit turistik (Tourist Information Centres – TIC) që funksionojnë në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues. Qendrat ofrojnë informacion mbi atraksionet turistike, trashëgiminë kulturore e natyrore, aktivitetet turistike, shërbimet e akomodimit, transportin dhe shërbime të tjera të nevojshme për vizitorët.
Rëndësia	Qendrat e informacionit turistik janë një element i rëndësishëm i infrastrukturës mbështetëse të turizmit. Ato kontribuojnë në përmirësimin e përvojës së vizitorëve, promovimin e destinacionit, orientimin e turistëve drejt produkteve dhe shërbimeve lokale dhe rritjen e ndikimit ekonomik të turizmit në territor.
Formula	D212
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një kapacitet më të madh institucional për ofrimin e informacionit turistik. Megjithatë, treguesi nuk mat cilësinë e shërbimeve, nivelin e përdorimit apo efektivitetin e qendrave në promovimin e destinacionit.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas statusit të qendrës (e administruar nga bashkia, në partneritet ose nga operatorë të tjerë), vendndodhjes ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet evidencave administrative të bashkisë, akteve të krijimit ose administrimit të qendrave dhe verifikimeve në terren.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm ekzistencën e qendrave dhe nuk pasqyron cilësinë e shërbimeve, oraret e funksionimit, burimet njerëzore apo numrin e vizitorëve të shërbyer.

D212 NUMRI I QENDRAVE TË INFORMACIONIT TURISTIK (TIC)

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D212
Emërtimi	Numri i qendrave të informacionit turistik (TIC)
Përshkrimi i të dhënës	Numri i qendrave të informacionit turistik funksionale në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e qendrave funksionale të informacionit turistik në territorin e bashkisë dhe të mbështesë vlerësimin e kapacitetit vendor për ofrimin e informacionit dhe orientimit për vizitorët dhe turistët.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin, bashkia dhe dokumentacioni administrativ përkatës.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga evidencat administrative të bashkisë dhe strukturës përgjegjëse për turizmin mbi qendrat funksionale të informacionit turistik.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrit të qendrave, dokumentacionit administrativ dhe verifikimeve në terren, sipas rastit.
Disagregimi	Nuk aplikohet

Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e qendrave funksionale dhe nuk pasqyron cilësinë e shërbimit, orarin e funksionimit, kapacitetet njerëzore apo nivelin e përdorimit të tyre. Pikat e përkohshme të informacionit për evente të veçanta nuk përfshihen.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D202

Për qëllime të këtij treguesi, **qendër e informacionit turistik (TIC)** konsiderohet çdo strukturë fizike e dedikuar për ofrimin e informacionit, orientimit dhe asistencës për vizitorët dhe turistët, e cila funksionon gjatë vitit raportues. Në raportim përfshihen vetëm qendrat funksionale që ofrojnë shërbime të rregullta dhe janë të administruara nga bashkia ose nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit. Nuk përfshihen pikat e përkohshme të informacionit të krijuara vetëm për aktivitete sezonale ose evente të veçanta.

TREGUESI 284A13 NUMRI I VIZITORËVE NË QENDRAT E INFORMACIONIT TURISTIK (TIC)

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	284A13
Emërtimi	Numri i vizitorëve në qendrat e informacionit turistik (TIC)
Funksioni	28.4 – Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë shkallën e përdorimit të qendrave të informacionit turistik nga vizitorët dhe turistët gjatë vitit raportues.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të vizitorëve që kanë përfituar shërbime në qendrat e informacionit turistik (TIC) në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues. Vizitorët mund të jenë turistë vendas ose të huaj, individë ose grupe, të cilët kanë marrë informacion, orientim ose shërbime të tjera informuese.
Rëndësia	Ky tregues pasqyron nivelin e përdorimit të qendrave të informacionit turistik dhe ndihmon në vlerësimin e rolit të tyre në promovimin e destinacionit dhe orientimin e vizitorëve. Së bashku me treguesin për numrin e qendrave (284A12), ai mundëson vlerësimin e kapacitetit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës së informacionit turistik.
Formula	D213

Njësia matëse	Numër vizitorësh
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon përdorim më të madh të qendrave të informacionit turistik. Megjithatë, treguesi nuk mat kënaqësinë e vizitorëve, cilësinë e shërbimit apo ndikimin e tij në zhvillimin e turizmit lokal.
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas qendrës së informacionit turistik, turistëve vendas dhe të huaj, periudhës së vitit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të vizitorëve, sistemeve elektronike të numërimit, statistikave administrative ose evidencave të mbajtura nga qendrat e informacionit turistik.
Kufizimet	Treguesi nuk mat numrin unik të turistëve, pasi i njëjti vizitor mund të regjistrohet më shumë se një herë nëse viziton qendrën në ditë ose periudha të ndryshme. Gjithashtu, nuk pasqyron numrin total të turistëve që vizitojnë bashkinë, por vetëm ata që përdorin shërbimet e qendrave të informacionit turistik.

D213 NUMRI I VIZITORËVE NË QENDRAT E INFORMACIONIT TURISTIK (TIC)

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D213
Emërtimi	Numri i vizitorëve në qendrat e informacionit turistik (TIC)
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i vizitorëve që kanë marrë shërbime informacioni ose orientimi në qendrat e informacionit turistik gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e vizitave të regjistruara në qendrat e informacionit turistik dhe të mbështesë vlerësimin e shkallës së përdorimit të këtyre shërbimeve.
Njësia matëse	Numër vizitorësh

Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Qendrat e informacionit turistik dhe struktura përgjegjëse për turizmin në bashki.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat fizikë ose elektronikë të vizitorëve, sistemet e numërimit ose evidencat administrative të qendrave të informacionit turistik.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të vizitorëve, raporteve periodike të qendrave dhe dokumentacionit administrativ mbështetës.
Disagregimi	Sipas njesise administrative nese te dhenat jane te disponueshme
Kufizimet	E dhëna pasqyron numrin e vizitave të regjistruara dhe jo domosdoshmërisht numrin unik të individëve, pasi i njëjti vizitor mund të regjistrohet më shumë se një herë. Ajo nuk përfaqëson numrin total të turistëve në bashki, por vetëm përdoruesit e shërbimeve të TIC-ve.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D213

Për qëllime të këtij treguesi, **vizitor** konsiderohet çdo person që gjatë vitit raportues ka përfituar të paktën një shërbim informacioni ose orientimi në një qendër të informacionit turistik (TIC). Raportohet numri i vizitave të regjistruara në qendra dhe jo domosdoshmërisht numri unik i individëve. Për të siguruar krahasueshmërinë e të dhënave ndërmjet bashkive, rekomandohet përdorimi i një metodologjie të unifikuar për regjistrimin e vizitorëve dhe raportimin periodik të tyre.

FUNKSIONI 28.5 PUBLIKIMI I BROSHURAVE, PORTALEVE ME PROFIL EKONOMIK DHE MATERIALEVE PROMOVUESE PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK VENDOR

Ky funksion përfshin hartimin, publikimin dhe përditësimin e materialeve informuese dhe promovuese që synojnë të rrisin vizibilitetin ekonomik të territorit dhe të mbështesin tërheqjen e investimeve, zhvillimin e sipërmarrjes, turizmit dhe aktiviteteve të tjera ekonomike. Materialet mund të përfshijnë broshura, guida investimesh, profile ekonomike të bashkisë, katalogë të aseteve publike, harta tematike, portale elektronike, platforma digjitale dhe mjete të tjera komunikimi.
Nëpërmjet këtij funksioni, bashkia promovon potencialet ekonomike të territorit, mundësitë për investime, burimet natyrore dhe njerëzore, sektorët prioritarë të zhvillimit dhe shërbimet që ofrohen për biznesin. Njëkohësisht, funksioni kontribuon në rritjen e transparencës dhe aksesit në informacion për investitorët, sipërmarrësit dhe aktorët e tjerë ekonomikë.

Funksioni mbështet zbatimin e politikave të zhvillimit ekonomik vendor duke siguruar që informacioni ekonomik të jetë i organizuar, i përditësuar, lehtësisht i aksesueshëm dhe i përshtatur sipas nevojave të përdoruesve.

TREGUESI 285A01 PËRQINDJA E APLIKIMEVE ONLINE PËR SHËRBIME EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	285A01
Emërtimi	Përqindja e aplikimeve online për shërbime ekonomike
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Qëllimi	Të masë shkallën e përdorimit të kanaleve elektronike për aplikimin në shërbimet ekonomike të ofruara ose të administruara nga bashkia.
Përshkrimi	Treguesi paraqet përqindjen e aplikimeve për shërbime ekonomike që janë paraqitur online, kundrejt numrit të përgjithshëm të aplikimeve për këto shërbime gjatë vitit raportues. Ai pasqyron nivelin e digjitalizimit dhe përdorimit praktik të shërbimeve elektronike nga bizneset dhe subjektet e tjera ekonomike.
Rëndësia	Ofrimi dhe përdorimi i shërbimeve ekonomike online mund të reduktojë kohën dhe kostot administrative, të lehtësojë aksesin e bizneseve në shërbimet bashkiake dhe të përmirësojë transparencën dhe efikasitetin e administratës vendore. Treguesi ndihmon në vlerësimin jo vetëm të disponueshmërisë së kanaleve elektronike, por edhe të përdorimit të tyre real.
Formula	(D148/D149)×100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një përqindje më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e aplikimeve për shërbime ekonomike kryhet përmes kanaleve online. Vlera 100% nënkupton se të gjitha aplikimet e regjistruara për shërbimet ekonomike të përfshira në raportim janë paraqitur online. Një vlerë e ulët mund të lidhet me disponueshmërinë e kufizuar të shërbimeve elektronike, përdorimin e ulët të tyre ose preferencën për aplikim fizik.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor, shërbimet ndaj biznesit dhe teknologjinë e informacionit, sipas organizimit të bashkisë.

Disagregimi	Sipas llojit të shërbimit ekonomik, kanalit të aplikimit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Krahasimi i regjistrave elektronikë të aplikimeve me regjistrin e përgjithshëm të aplikimeve për shërbime ekonomike. Verifikimi mund të mbështetet në sistemin elektronik të aplikimeve, protokollin elektronik, regjistrat administrativë dhe raportet e strukturave përgjegjëse.
Kufizimet	Treguesi varet nga klasifikimi i njëjtë i shërbimeve ekonomike në numërues dhe emërues. Ai nuk mat cilësinë, shpejtësinë e përpunimit apo përfundimin me sukses të aplikimeve online. Gjithashtu, një aplikim i nisur online, por i paplotë ose i paregjistruar zyrtarisht, nuk duhet të përfshihet në llogaritje.

D148 NUMRI I APLIKIMEVE ONLINE PËR SHËRBIME EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D148
Emërtimi	Numri i aplikimeve online për shërbime ekonomike
Përshkrimi i të dhënës	Numri i aplikimeve për shërbime ekonomike që janë paraqitur dhe regjistruar nëpërmjet një platforme, portali ose sistemi elektronik gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e aplikimeve për shërbime ekonomike të paraqitura në mënyrë elektronike dhe të mbështesë monitorimin e përdorimit të kanaleve digjitale për ofrimin e shërbimeve.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Platforma elektronike e aplikimeve dhe struktura përgjegjëse për shërbimet ekonomike.
Metoda e mbledhjes	Nxjerrje nga sistemi elektronik ose regjistri administrativ ku evidentohen aplikimet e paraqitura online.
Metoda e verifikimit	Verifikohet përmes regjistrave të platformës elektronike, numrit unik të aplikimit, protokollit elektronik dhe raporteve të gjeneruara nga sistemi.
Disagregimi	Sipas llojit të shërbimit ekonomik, platformës së përdorur ose njësisë administrative, kur është e mundur.

Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm aplikimet e regjistruara zyrtarisht në sistemet elektronike dhe nuk pasqyron cilësinë e shërbimit, kohën e përpunimit apo rezultatin përfundimtar të aplikimit.

D149 NUMRI TOTAL I APLIKIMEVE PËR SHËRBIME EKONOMIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D149
Emërtimi	Numri total i aplikimeve për shërbime ekonomike
Përshkrimi i të dhënës	Numri i përgjithshëm i aplikimeve të regjistruara për shërbime ekonomike gjatë vitit raportues, pavarësisht nëse janë paraqitur online apo fizikisht.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Numri i përgjithshëm i aplikimeve të regjistruara për shërbime ekonomike gjatë vitit raportues, pavarësisht nëse janë paraqitur online apo fizikisht.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Regjistrat administrativë të bashkisë, sistemi elektronik i aplikimeve dhe struktura përgjegjëse për shërbimet ekonomike.
Metoda e mbledhjes	Përmbledhje e të gjitha aplikimeve të regjistruara për shërbimet ekonomike të përfshira në raportim, si në formë elektronike ashtu edhe fizike.
Metoda e verifikimit	Verifikohet përmes regjistrit të përgjithshëm të aplikimeve, protokollit, sistemit elektronik dhe evidencave të strukturave përgjegjëse.
Disagregimi	Sipas llojit të shërbimit ekonomik, mënyrës së aplikimit ose njësisë administrative, kur është e mundur.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm aplikimet e regjistruara dhe nuk jep informacion mbi kohën e përpunimit, cilësinë e shërbimit apo rezultatin e aplikimeve.

285A02 NUMRI I TURISTËVE TË HUAJ

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	285A02
Emërtimi	Numri i turistëve të huaj
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë numrin e turistëve të huaj që vizitojnë territorin e bashkisë gjatë vitit raportues, si një tregues i atraktivitetit turistik dhe i zhvillimit të sektorit të turizmit.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e shtetasve të huaj që vizitojnë territorin e bashkisë për qëllime turistike gjatë vitit raportues. Ai mundëson monitorimin e zhvillimit të turizmit ndërkombëtar dhe ndihmon në vlerësimin e ndikimit të politikave vendore për promovimin e destinacionit.
Rëndësia	Turistët e huaj kontribuojnë në zhvillimin ekonomik vendor përmes konsumit të shërbimeve të akomodimit, gastronomisë, transportit, aktiviteteve rekreative dhe produkteve lokale. Monitorimi i këtij treguesi ndihmon bashkinë në planifikimin e investimeve, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe hartimin e politikave të promovimit të territorit.
Formula	D204
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një fluks më të madh turistësh të huaj në territorin e bashkisë. Megjithatë, treguesi nuk jep informacion mbi kohëzgjatjen e qëndrimit, nivelin e shpenzimeve apo ndikimin ekonomik të vizitorëve.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas shtetit të origjinës, muajit, sezonit turistik, njësisë administrative ose llojit të akomodimit, kur të dhënat janë të disponueshme.

Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet statistikave zyrtare të turizmit, regjistrave të strukturave akomoduese, evidencave të qendrave të informacionit turistik dhe burimeve të tjera administrative.
Kufizimet	Treguesi varet nga cilësia e raportimit të strukturave akomoduese dhe burimeve të tjera administrative. Ai nuk përfshin domosdoshmërisht turistët që nuk përdorin struktura akomoduese të regjistruara ose që nuk evidentohen në sistemet e raportimit.

D204 NUMRI I TURISTËVE TË HUAJ

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D204
Emërtimi	Numri i turistëve të huaj
Përshkrimi i të dhënës	Numri i shtetasve të huaj që kanë vizituar territorin e bashkisë për qëllime turistike gjatë vitit raportues, sipas burimeve zyrtare të raportimit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e turistëve të huaj që vizitojnë territorin e bashkisë dhe të mbështesë monitorimin e zhvillimit të turizmit ndërkombëtar.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Bashkia, strukturat akomoduese, INSTAT dhe institucione të tjera përgjegjëse për statistikat e turizmit.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga strukturat akomoduese, sistemi kombëtar i statistikave të turizmit, qendrat e informacionit turistik ose burime të tjera administrative të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet raporteve statistikore, regjistrave të strukturave akomoduese dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Disagregimi	Sipas shtetit të origjinës, muajit, sezonit turistik, njësisë administrative ose llojit të akomodimit, kur të dhënat janë të disponueshme.

Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm turistët e regjistruar sipas burimeve administrative dhe nuk përfshin domosdoshmërisht turistët që nuk evidentohen në sistemet zyrtare të raportimit.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D204

Për qëllime të këtij treguesi, **turist i huaj** konsiderohet çdo shtetas jo-rezident që viziton territorin e bashkisë për qëllime turistike, rekreative, kulturore, sportive, profesionale ose të ngjashme, pa ushtruar aktivitet të paguar në vendin e vizitës. Raportimi duhet të bazohet në të njëjtën metodologji dhe burim të dhënash nga një vit në tjetrin për të siguruar krahasueshmërinë e rezultateve. Në rast se përdoren të dhëna nga strukturat akomoduese, duhet të sqarohet se treguesi pasqyron turistët e regjistruar në këto struktura dhe jo domosdoshmërisht numrin total të turistëve që kanë vizituar territorin e bashkisë.

TREGUESI 285A03 NUMRI I VIZITORËVE DITORË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	285A03
Emërtimi	Numri i vizitorëve ditorë
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë numrin e vizitorëve që frekuentojnë territorin e bashkisë gjatë ditës, pa kaluar të paktën një natë në një strukturë akomoduese në territorin e saj.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e vizitorëve vendas ose të huaj që vizitojnë territorin e bashkisë për qëllime turistike, rekreative, kulturore, sportive, fetare, biznesi ose aktivitete të tjera, por që largohen brenda të njëjtës ditë pa kaluar natën në territor.
Rëndësia	Vizitorët ditorë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të fluksit turistik në shumë bashki, veçanërisht në destinacionet bregdetare, natyrore, kulturore ose pranë qendrave urbane. Edhe pse nuk përdorin shërbime akomodimi, ata gjenerojnë konsum në sektorët e gastronomisë, transportit, tregtisë dhe aktiviteteve rekreative. Monitorimi i këtij treguesi ndihmon bashkinë në planifikimin e shërbimeve publike, infrastrukturës turistike dhe menaxhimin e flukseve të vizitorëve.
Formula	D205
Njësia matëse	Numër

Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një fluks më të madh vizitorësh ditorë në territorin e bashkisë. Treguesi nuk jep informacion mbi kohëzgjatjen e vizitës gjatë ditës, nivelin e shpenzimeve apo ndikimin ekonomik të vizitorëve.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas muajit, sezonit turistik, atraksionit të vizituar, njësisë administrative ose origjinës së vizitorëve (vendas/të huaj), kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet sistemeve të numërimit të vizitorëve, biletarisë elektronike, statistikave të atraksioneve turistike, qendrave të informacionit turistik, anketave ose burimeve të tjera administrative.
Kufizimet	Matja e vizitorëve ditorë është më komplekse se ajo e turistëve të akomoduar dhe shpesh mbështetet në vlerësime ose burime indirekte. Ekziston rreziku i numërimit të dyfishtë të vizitorëve që frekuentojnë disa atraksione gjatë së njëjtës ditë.

D205 NUMRI I VIZITORËVE DITORË

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D205
Emërtimi	Numri i vizitorëve ditorë
Përshkrimi i të dhënës	Numri i personave që vizitojnë territorin e bashkisë gjatë ditës për qëllime turistike ose rekreative, pa kaluar natën në territor gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e vizitorëve ditorë në territorin e bashkisë dhe të mbështesë monitorimin e flukseve turistike dhe rekreative.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni Përgjegjës	Bashkia, administratorët e atraksioneve turistike, qendrat e informacionit turistik, INSTAT ose institucione të tjera që disponojnë statistika mbi vizitorët.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga sistemet e numërimit të vizitorëve, biletaritë, qendrat e informacionit turistik, anketat ose burime të tjera administrative të përshtatshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave administrativë, sistemeve elektronike të numërimit, raporteve statistikore ose metodave të tjera të dokumentuara të vlerësimit.
Disagregimi	Sipas muajit, sezonit turistik, atraksionit të vizituar, origjinës së vizitorëve ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna mund të bazohet në vlerësime ose burime indirekte dhe ekziston rreziku i numërimit të shumëfishtë të të njëjtit vizitor gjatë së njëjtës ditë.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D205

Për qëllime të këtij treguesi, **vizitor ditor** konsiderohet çdo person që viziton territorin e bashkisë për më pak se 24 orë dhe nuk kalon të paktën një natë në një strukturë akomoduese brenda territorit të saj. Për të shmangur mbivlerësimin e treguesit, rekomandohet përdorimi i metodologjive që minimizojnë numërimin e shumëfishtë të të njëjtit vizitor gjatë së njëjtës ditë. Kur treguesi bazohet në vlerësime statistikore ose anketa, metodologjia e

TREGUESI 285A04 NETË-QËNDRIME NË TERRITOR

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	285A04
Emërtimi	Netë-qëndrime në territor
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë volumin e qëndrimeve turistike në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues, si tregues i intensitetit të aktivitetit turistik dhe përdorimit të kapaciteteve akomoduese.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të netëve të kaluara nga turistët në strukturat akomoduese të territorit të bashkisë gjatë vitit raportues. Çdo

	natë e kaluar nga një turist në një strukturë akomoduese llogaritet si një netë-qëndrim.
Rëndësia	Netë-qëndrimet përbëjnë një nga treguesit kryesorë të performancës së sektorit të turizmit, pasi pasqyrojnë jo vetëm numrin e turistëve, por edhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre. Rritja e këtij treguesi zakonisht shoqërohet me konsum më të lartë të shërbimeve turistike dhe ndikim më të madh ekonomik në territor.
Formula	D206
Njësia matëse	Numër netë-qëndrimesh
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se turistët kalojnë më shumë net në territorin e bashkisë. Treguesi duhet të analizohet së bashku me numrin e turistëve, pasi një rritje e netë-qëndrimeve mund të vijë si rezultat i shtimit të turistëve ose i zgjatjes së kohëzgjatjes mesatare të qëndrimit.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas muajit, sezonit turistik, llojit të strukturës akomoduese, turistëve vendas dhe të huaj ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të strukturave akomoduese, statistikave zyrtare të turizmit dhe dokumentacionit administrativ të raportuar sipas legjislacionit në fuqi.
Kufizimet	Treguesi mbështetet në raportimin e strukturave akomoduese dhe nuk përfshin netë-qëndrimet në struktura informale ose në banesa private që nuk raportojnë sipas legjislacionit. Cilësia e të dhënave varet nga plotësia dhe saktësia e raportimit administrativ.

D206 NUMRI I NETË-QËNDRIMEVE NË TERRITOR

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D206
Emërtimi	Numri i netë-qëndrimeve në territor
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i netëve të kaluara nga turistët në strukturat akomoduese të territorit të bashkisë gjatë vitit raportues.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin total të netë-qëndrimeve në strukturat akomoduese dhe të mbështesë monitorimin e intensitetit të aktivitetit turistik.
Njësia matëse	Numër netë-qëndrimesh
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Strukturat akomoduese, bashkia, INSTAT dhe institucione të tjera përgjegjëse për statistikat e turizmit.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga raportimet administrative të strukturave akomoduese dhe nga statistikat zyrtare të turizmit.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të strukturave akomoduese, raporteve statistikore dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Disagregimi	Sipas muajit, sezonit turistik, llojit të strukturës akomoduese, turistëve vendas dhe të huaj ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm netë-qëndrimet e raportuara nga strukturat akomoduese të regjistruara dhe nuk përfshin akomodimet informale.

TREGUESI 285A05 NUMRI I STRUKTURAVE AKOMODUESE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	285A05
Emërtimi	Numri i strukturave akomoduese
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë kapacitetin e territorit të bashkisë për ofrimin e shërbimeve të akomodimit për turistët dhe vizitorët.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e strukturave akomoduese që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues. Në këtë kategori përfshihen hotelet, bujtinat, resortet, kampingjet, fshatrat turistikë, apartamentet

	turistike dhe strukturat e tjera të akomodimit të licencuara sipas legjislacionit në fuqi.
Rëndësia	Numri i strukturave akomoduese pasqyron nivelin e zhvillimit të ofertës turistike dhe kapacitetin e territorit për të pritur turistë. Monitorimi i këtij treguesi ndihmon bashkinë në planifikimin e politikave të zhvillimit të turizmit, identifikimin e nevojave për investime dhe vlerësimin e potencialit të destinacionit.
Formula	D207
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një ofertë më të madhe të strukturave akomoduese në territor. Megjithatë, treguesi nuk pasqyron madhësinë, cilësinë, kategorinë apo normën e shfrytëzimit të tyre.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas llojit të strukturës akomoduese, kategorisë së klasifikimit, njësisë administrative ose statusit të aktivitetit, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave administrativë të strukturave akomoduese, regjistrave të licencimit, regjistrit të biznesit dhe evidencave të institucioneve përgjegjëse për turizmin.
Kufizimet	Treguesi nuk pasqyron kapacitetin akomodues të secilës strukturë, nivelin e shërbimit apo shkallën e përdorimit të tyre. Gjithashtu, nuk përfshin strukturat informale ose ato që nuk janë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi.

D207 NUMRI I STRUKTURAVE AKOMODUESE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D207
Emërtimi	Numri i strukturave akomoduese
Përshkrimi i të dhënës	Numri i strukturave akomoduese të regjistruara dhe funksionale në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e strukturave akomoduese funksionale në territorin e bashkisë dhe të mbështesë monitorimin e kapacitetit të ofertës turistike.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Bashkia, Ministria përgjegjëse për turizmin, INSTAT, QKB dhe institucione të tjera përgjegjëse për regjistrimin dhe klasifikimin e strukturave akomoduese.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat administrativë të bashkisë, regjistri kombëtar i strukturave akomoduese dhe burime të tjera zyrtare.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave zyrtarë të strukturave akomoduese, dokumentacionit të regjistrimit ose licencimit dhe evidencave administrative të përditësuara.
Disagregimi	Sipas llojit të strukturës, kategorisë së klasifikimit, statusit të aktivitetit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e strukturave dhe nuk jep informacion mbi kapacitetin, cilësinë apo nivelin e shfrytëzimit të tyre.

TREGUESI 285A06 NUMRI I SHTRETËRVE NË STRUKTURAT AKOMODUESE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	285A06
Emërtimi	Numri i shtretërve në strukturat akomoduese
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë kapacitetin akomodues të territorit të bashkisë për pritjen e turistëve dhe vizitorëve.

Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të shtretërve të disponueshëm në strukturat akomoduese që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues. Ai përfaqëson kapacitetin maksimal teorik të akomodimit që ofron territori.
Rëndësia	Kapaciteti akomodues është një tregues themelor për vlerësimin e ofertës turistike të një bashkie. Ai ndihmon në analizimin e potencialit për zhvillimin e turizmit, planifikimin e investimeve dhe vlerësimin e raportit ndërmjet ofertës dhe kërkesës turistike. Ky tregues përdoret gjithashtu si bazë për llogaritjen e treguesve të efikasitetit të sektorit, siç është numri i turistëve për shtrat.
Formula	D208
Njësia matëse	Numër shtretërish
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një kapacitet më të madh akomodues në territorin e bashkisë. Megjithatë, treguesi nuk pasqyron shkallën e zënies së shtretërve, cilësinë e strukturave apo shpërndarjen sezonale të kapacitetit.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas llojit të strukturës akomoduese, kategorisë së klasifikimit, njësisë administrative ose zonës turistike, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të strukturave akomoduese, dokumentacionit të klasifikimit ose licencimit dhe evidencave administrative të institucioneve përgjegjëse.
Kufizimet	Treguesi pasqyron kapacitetin e deklaruar të strukturave akomoduese dhe nuk tregon sa shtretër janë realisht në përdorim gjatë vitit. Gjithashtu, nuk përfshin kapacitetet informale ose të paregjistruara.

D208 NUMRI I SHTRETËRVE NË STRUKTURAT AKOMODUESE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D208
Emërtimi	Numri i shtretërve në strukturat akomoduese

Përshkrimi i të dhënës	Numri total i shtretërve të disponueshëm në strukturat akomoduese të regjistruara dhe funksionale në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë kapacitetin akomodues të strukturave turistike dhe të shërbejë si bazë për analizimin e ofertës turistike dhe llogaritjen e treguesve përkatës.
Njësia matëse	Numër shtretërish
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Bashkia, Ministria përgjegjëse për turizmin, INSTAT, regjistrat e strukturave akomoduese dhe burime të tjera administrative zyrtare.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat administrativë të strukturave akomoduese dhe nga evidencat e institucioneve përgjegjëse për turizmin.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të klasifikimit të strukturave akomoduese, dokumentacionit të licencimit dhe evidencave administrative të përditësuara.
Disagregimi	Sipas llojit të strukturës akomoduese, kategorisë së klasifikimit, zonës turistike ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme
Kufizimet	E dhëna evidenton kapacitetin e deklaruar të shtretërve dhe nuk pasqyron përdorimin real apo shkallën e zënies së tyre.

VËREJTJE METODOLOGJIKE 208

Për qëllime të këtij treguesi, **numri i shtretërve** përfaqëson kapacitetin maksimal të akomodimit të strukturave akomoduese të regjistruara dhe funksionale gjatë vitit raportues. Në raportim përfshihen vetëm shtretërit e autorizuar për përdorim në përputhje me dokumentacionin zyrtar të strukturës. Për të siguruar krahasueshmërinë ndërmjet bashkive dhe ndërmjet viteve, të dhënat duhet të bazohen në të njëjtin burim administrativ dhe të përditësohen sipas ndryshimeve në kapacitetet akomoduese.

TREGUESI 285A07 TURISTË PËR SHTRAT

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	285A07
Emërtimi	Turistë për shtrat
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë raportin ndërmjet numrit të turistëve të huaj dhe kapacitetit akomodues të territorit, duke vlerësuar nivelin e shfrytëzimit potencial të shtretërve në strukturat akomoduese.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e turistëve të huaj për çdo shtrat të disponueshëm në strukturat akomoduese gjatë vitit raportues. Ai përdoret për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet kërkesës turistike dhe ofertës së kapaciteteve akomoduese.
Rëndësia	Treguesi ndihmon në analizimin e përputhshmërisë ndërmjet fluksit të turistëve dhe kapaciteteve akomoduese të territorit. Ai mund të shërbejë si bazë për planifikimin e investimeve në sektorin e turizmit dhe për identifikimin e rasteve kur kapacitetet ekzistuese janë të pamjaftueshme ose të pashfrytëzuara.
Formula	D204 / D208
Njësia matëse	Turistë për shtrat
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se çdo shtrat i disponueshëm i korrespondon një numri më të madh turistësh gjatë vitit, duke sinjalizuar një përdorim më intensiv të kapaciteteve akomoduese. Megjithatë, treguesi nuk përfaqëson normën e zënies së shtretërve, pasi nuk merr në konsideratë kohëzgjatjen e qëndrimit të turistëve. Për analizën e përdorimit real të kapaciteteve duhet të përdoret së bashku me treguesin e netë-qëndrimeve (285A04).
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.

Disagregimi	Sipas njësisë administrative, zonës turistike ose kategorisë së strukturës akomoduese, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Llogaritet duke përdorur të dhënat e raportuara për numrin e turistëve të huaj dhe numrin e shtretërve në strukturat akomoduese.
Kufizimet	Treguesi nuk mat shkallën reale të zënies së shtretërve dhe nuk merr parasysh sezonin turistik, kohëzgjatjen e qëndrimit apo turistët që akomodohen në struktura informale. Ai duhet të interpretohet së bashku me treguesit e tjerë të sektorit të turizmit.

E DHËNA D204 ËSHTË SHTJELLUAR MË LART NË MANUAL.

E DHËNA D208 ËSHTË SHTJELLUAR MË LART NË MANUAL.

TREGUESI 285A08 NUMRI I ATRAKSIONEVE TË INVENTARIZUARA

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	285A08
Emërtimi	Numri i atraksioneve të inventarizuara
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë shkallën e identifikimit dhe dokumentimit të atraksioneve turistike në territorin e bashkisë, si bazë për planifikimin, promovimin dhe zhvillimin e turizmit.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e atraksioneve turistike të inventarizuara dhe të dokumentuara nga bashkia gjatë vitit raportues. Atraksionet mund të jenë natyrore, kulturore, historike, arkeologjike, fetare, rekreative ose të një natyre tjetër me potencial turistik.
Rëndësia	Inventarizimi i atraksioneve turistike është hapi i parë për zhvillimin e një destinacioni turistik. Një inventar i plotë ndihmon bashkinë në hartimin e strategjive të zhvillimit dhe promovimit të turizmit, përgatitjen e materialeve promocionale, krijimin e itinerareve turistike dhe orientimin e investimeve në sektor.
Formula	D210
Njësia matëse	Numër

Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të plotë të identifikimit dhe dokumentimit të potencialit turistik të territorit. Megjithatë, treguesi nuk mat cilësinë, gjendjen e ruajtjes, aksesueshmërinë apo nivelin e vizitueshmërisë së atraksioneve.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas llojit të atraksionit (natyror, kulturor, historik, arkeologjik, fetar, rekreativ etj.), njësisë administrative ose statusit të mbrojtjes, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet inventarit zyrtar të atraksioneve turistike, databazave të bashkisë, hartave tematike, dokumentacionit teknik ose verifikimeve në terren.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm atraksionet e inventarizuara dhe nuk pasqyron nivelin e zhvillimit të tyre si produkte turistike. Ai gjithashtu nuk mat numrin e vizitorëve apo ndikimin ekonomik të atraksioneve.

D210 NUMRI I ATRAKSIONEVE TË INVENTARIZUARA

Elementi	Përshkrimi
Kodi i të dhënës	D210
Emërtimi	Numri i atraksioneve të inventarizuara
Përshkrimi i të dhënës	Numri i atraksioneve turistike të identifikuara, dokumentuara dhe të përfshira në inventarin e bashkisë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e atraksioneve turistike të inventarizuara dhe të mbështesë planifikimin, promovimin dhe zhvillimin e turizmit vendor.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni Përgjegjës	Bashkia, Ministria përgjegjëse për turizmin, institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, zonat e mbrojtura dhe burime të tjera zyrtare.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga inventari i atraksioneve turistike, dokumentet e planifikimit territorial, regjistrat e trashëgimisë kulturore dhe evidencat administrative të bashkisë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet inventarit të bashkisë, dokumentacionit teknik, koordinatave gjeografike, regjistrave administrativë ose verifikimeve në terren.
Disagregimi	Sipas llojit të atraksionit, statusit të mbrojtjes ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm atraksionet e inventarizuara dhe nuk pasqyron gjendjen e tyre, aksesueshmërinë, vizitueshmërinë apo nivelin e zhvillimit si produkte turistike.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D210

Për qëllime të këtij treguesi, **atraksion i inventarizuar** konsiderohet çdo objekt, vend ose element me potencial turistik që është identifikuar dhe dokumentuar në një inventar zyrtar të bashkisë ose të institucioneve përgjegjëse. Çdo atraksion regjistrohet vetëm një herë, edhe nëse promovohet në më shumë se një itinerar turistik ose material promocional. Inventari duhet të përditësohet periodikisht për të reflektuar identifikimin e atraksioneve të reja, ndryshimet në statusin e tyre ose përmirësimet në dokumentimin e tyre. Treguesi nuk mat numrin total të atraksioneve ekzistuese në territor, por vetëm ato që janë inventarizuar sipas metodologjisë së miratuar.

TREGUESI 285A09 NUMRI I OPERATORËVE TURISTIKË / GUIDAVE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	285A09
Emërtimi	Numri i operatorëve turistikë / guidave
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë kapacitetin e sektorit turistik në territorin e bashkisë për ofrimin e shërbimeve të organizimit, ndërmjetësimit dhe udhërrëfimit turistik.

Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e operatorëve turistikë dhe guidave turistike që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues. Në këtë kategori përfshihen agjencitë turistike, operatorët turistikë dhe guidat turistike të licencuara ose të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi.
Rëndësia	Operatorët turistikë dhe guidat janë aktorë kyç në zhvillimin e turizmit vendor, pasi kontribuojnë në promovimin e destinacionit, organizimin e paketave turistike dhe ofrimin e shërbimeve profesionale për vizitorët. Monitorimi i këtij treguesi ndihmon bashkinë të vlerësojë kapacitetin e sektorit privat dhe potencialin për zhvillimin e produkteve turistike.
Formula	D211
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një ofertë më të zhvilluar të shërbimeve turistike në territor. Megjithatë, treguesi nuk pasqyron cilësinë e shërbimeve, numrin e turistëve të shërbyer apo nivelin e aktivitetit ekonomik të operatorëve dhe guidave.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas llojit të subjektit (operator turistik, agjenci turistike, guidë turistike), njësisë administrative ose fushës së specializimit, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të subjekteve ekonomike, regjistrave të licencimit, evidencave të institucioneve përgjegjëse për turizmin dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e operatorëve dhe guidave të regjistruara ose aktive dhe nuk pasqyron nivelin e aktivitetit të tyre, cilësinë e shërbimeve apo kontributin ekonomik në zhvillimin e turizmit.

D211 NUMRI I OPERATORËVE TURISTIKË / GUIDAVE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D211
Emërtimi	Numri i operatorëve turistikë / guidave
Përshkrimi i të dhënës	Numri i operatorëve turistikë, agjencive turistike dhe guidave turistike që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e operatorëve turistikë dhe guidave aktive në territor dhe të mbështesë monitorimin e kapaciteteve të sektorit turistik.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Bashkia, Ministria përgjegjëse për turizmin, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), regjistrat e licencimit dhe institucione të tjera përgjegjëse.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat administrativë të bashkisë, regjistri kombëtar i bizneseve, regjistrat e licencimit dhe burime të tjera zyrtare.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave zyrtarë të operatorëve dhe guidave turistike, dokumentacionit të licencimit ose regjistrimit dhe evidencave administrative të përditësuara.
Disagregimi	Sipas llojit të subjektit, fushës së specializimit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm subjektet e regjistruara ose aktive dhe nuk vlerëson cilësinë e shërbimeve, nivelin e aktivitetit apo kontributin ekonomik të tyre.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D211

Për qëllime të këtij treguesi, **operator turistik** dhe **guidë turistike** konsiderohen subjektet ose individët që ofrojnë shërbime turistike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në raportim përfshihen vetëm operatorët dhe guidat që kanë ushtruar aktivitet ose kanë qenë të regjistruar si aktivë gjatë vitit raportues.

Çdo subjekt ose guidë numërohet vetëm një herë, pavarësisht numrit të paketave turistike, tureve ose shërbimeve të ofruara gjatë vitit. Për të garantuar krahasueshmërinë e të dhënave, rekomandohet që raportimi të bazohet në regjistra administrativë të përditësuar dhe në të njëjtat kritere identifikimi në çdo vit raportues.

TREGUESI 285A10 NUMRI I EVENTEVE KULTURORE/TURISTIKE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	285A10
Emërtimi	Numri i eventeve kulturore/turistike
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë angazhimin e bashkisë në organizimin ose mbështetjen e aktiviteteve kulturore dhe turistike që promovojnë territorin dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik vendor.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e eventeve kulturore dhe turistike të organizuara ose të mbështetura nga bashkia gjatë vitit raportues. Në këtë kategori përfshihen festivale, panaire, aktivitete artistike, aktivitete tradicionale, evente gastronomike, sportive dhe aktivitete të tjera që synojnë promovimin e territorit dhe rritjen e fluksit të vizitorëve.
Rëndësia	Eventet kulturore dhe turistike kontribuojnë në promovimin e identitetit lokal, rritjen e atraktivitetit të destinacionit dhe gjenerimin e aktivitetit ekonomik në sektorë si akomodimi, gastronomia, transporti dhe tregtia. Monitorimi i këtij treguesi ndihmon bashkinë të vlerësojë intensitetin e aktiviteteve promovuese dhe të planifikojë kalendarin vjetor të eventeve.
Formula	D214
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të madh aktivitetesh kulturore dhe turistike të organizuara ose të mbështetura nga bashkia. Megjithatë, treguesi nuk pasqyron pjesëmarrjen në evente, cilësinë e organizimit apo ndikimin ekonomik të tyre.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për kulturën, turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.

Disagregimi	Sipas llojit të eventit (kulturor, turistik, gastronomik, sportiv, tradicional etj.), periudhës së organizimit, njësisë administrative ose organizatorit, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kalendarit të aktiviteteve, programeve zyrtare, vendimeve administrative, kontratave të financimit, raporteve të realizimit dhe dokumentacionit mbështetës të eventeve.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e eventeve dhe nuk pasqyron shkallën e pjesëmarrjes, kohëzgjatjen, cilësinë apo ndikimin ekonomik dhe social të tyre.

D214 NUMRI I EVENTEVE KULTURORE/TURISTIKE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D214
Emërtimi	Numri i eventeve kulturore/turistike
Përshkrimi i të dhënës	Numri i eventeve kulturore dhe turistike të organizuara ose të mbështetura nga bashkia gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e eventeve kulturore dhe turistike të organizuara ose të mbështetura nga bashkia dhe të mbështesë monitorimin e aktiviteteve promovuese të territorit.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për kulturën, turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga kalendari vjetor i aktiviteteve, evidencat administrative të bashkisë dhe raportet e strukturave përgjegjëse për kulturën dhe turizmin.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet programeve zyrtare, raporteve të realizimit, dokumentacionit financiar ose administrativ dhe materialeve promovuese të eventeve.
Disagregimi	Sipas llojit të eventit, periudhës së organizimit, organizatorit ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.

Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e eventeve dhe nuk pasqyron pjesëmarrjen, cilësinë, kohëzgjatjen apo ndikimin ekonomik dhe social të tyre.

TREGUESI 285A11 NUMRI I MATERIALEVE PROMOCIONALE

Elementi	Përshkrimi
Kodi i treguesit	285A11
Emërtimi	Numri i materialeve promocionale
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë përpjekjet e bashkisë për promovimin e territorit, atraksioneve turistike dhe mundësive ekonomike nëpërmjet materialeve informuese dhe promocionale.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e materialeve promocionale të përgatitura ose të publikuara nga bashkia gjatë vitit raportues. Në këtë kategori përfshihen broshurat, hartat turistike, guidat, katalogët, materialet audiovizive, publikimet elektronike, materialet informuese dhe produkte të tjera të komunikimit të destinuara për promovimin e territorit.
Rëndësia	Materialet promocionale janë një instrument i rëndësishëm për rritjen e vizibilitetit të bashkisë, promovimin e atraksioneve turistike dhe informimin e vizitorëve dhe investitorëve potencialë. Monitorimi i këtij treguesi ndihmon në vlerësimin e angazhimit të bashkisë për marketingun territorial dhe zhvillimin e destinacionit turistik.
Formula	D215
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një aktivitet më të madh të bashkisë në prodhimin dhe publikimin e materialeve promocionale. Megjithatë, treguesi nuk mat cilësinë e materialeve, shpërndarjen e tyre, audiencën e arritur apo ndikimin në rritjen e fluksit të turistëve ose investimeve.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia

Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin, komunikimin publik ose zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas llojit të materialit (broshurë, hartë, guidë, katalog, video promocionale, publikim elektronik etj.), formatit (fizik ose elektronik), tematikës ose gjuhës së publikimit, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet evidencave administrative të bashkisë, kopjeve të materialeve të prodhuara, kontratave të shërbimit, publikimeve në faqen zyrtare ose dokumentacionit mbështetës.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm numrin e materialeve të prodhuara ose të publikuara dhe nuk pasqyron cilësinë, nivelin e shpërndarjes, përdorimin apo efektivitetin e tyre në promovimin e territorit.

D215 NUMRI I MATERIALEVE PROMOCIONALE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D215
Emërtimi	Numri i materialeve promocionale
Përshkrimi i të dhënës	Numri i materialeve promocionale të prodhuara ose të publikuara nga bashkia gjatë vitit raportues për promovimin e turizmit, atraksioneve dhe potencialit ekonomik të territorit.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e materialeve promocionale të prodhuara ose të publikuara nga bashkia dhe të mbështesë monitorimin e aktiviteteve të promovimit të territorit.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin, komunikimin publik ose zhvillimin ekonomik, si dhe dokumentacioni administrativ përkatës.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga evidencat administrative të bashkisë, dokumentacioni i aktiviteteve promovuese dhe raportet e strukturave përgjegjëse.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kopjeve të materialeve, evidencave të publikimit, kontratave të prodhimit ose dokumentacionit tjetër mbështetës.

Disagregimi	Sipas llojit të materialit, formatit, tematikës ose gjuhës së publikimit, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm numrin e materialeve të prodhuara ose publikuara dhe nuk vlerëson cilësinë, shpërndarjen, përdorimin apo efektivitetin e tyre.

TREGUESI 285A12 NUMRI I TURISTËVE QË MARRIN INFORMACION NGA QENDRA E INFORMACIONIT TURISTIK (TIC)

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	285A12
Emërtimi	Numri i turistëve që marrin informacion nga Qendra e Informacionit Turistik (TIC)
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë përdorimin e shërbimeve të ofruara nga Qendra e Informacionit Turistik (TIC) dhe aksesin e vizitorëve në informacionin turistik të ofruar nga bashkia.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e turistëve dhe vizitorëve që kanë marrë informacion, orientim ose materiale informuese pranë Qendrës së Informacionit Turistik (TIC) gjatë vitit raportues. Informacioni mund të jepet në mënyrë fizike ose përmes kanaleve të tjera të administruara nga qendra, sipas praktikës së bashkisë.
Rëndësia	Treguesi ndihmon në vlerësimin e përdorimit të shërbimeve të informacionit turistik dhe jep një tregues indirekt mbi interesin e vizitorëve për destinacionin. Ai mund të përdoret për planifikimin e burimeve njerëzore, përmirësimin e shërbimeve të informacionit dhe vlerësimin e efektivitetit të aktiviteteve promovuese të bashkisë.
Formula	D304
Njësia matëse	Numër turistësh
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se më shumë vizitorë kanë përdorur shërbimet e Qendrës së Informacionit Turistik. Megjithatë, treguesi nuk përfaqëson numrin total të turistëve që vizitojnë bashkinë, pasi shumë prej tyre mund të mos përdorin shërbimet e TIC.
Frekuenca	Vjetore

Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose Qendra e Informacionit Turistik (TIC).
Disagregimi	Sipas muajit, origjinës së turistit (vendas/i huaj), mënyrës së ofrimit të informacionit ose Qendrës së Informacionit Turistik, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të Qendrës së Informacionit Turistik, evidencave të vizitorëve, raporteve periodike ose sistemeve elektronike të regjistrimit të kontakteve.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm turistët që kanë kontaktuar Qendrën e Informacionit Turistik dhe nuk pasqyron numrin total të vizitorëve në territor. Rezultatet mund të ndikohen nga mënyra e regjistrimit të vizitorëve ose nga përdorimi i kanaleve alternative të informacionit.

D304 NUMRI I TURISTËVE QË MARRIN INFORMACION NGA QENDRA E INFORMACIONIT TURISTIK (TIC)

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D304
Emërtimi	Numri i turistëve që marrin informacion nga Qendra e Informacionit Turistik (TIC)
Përshkrimi i të dhënës	Numri i turistëve dhe vizitorëve që kanë marrë informacion ose asistencë nga Qendra e Informacionit Turistik gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e turistëve dhe vizitorëve që kanë marrë informacion nga Qendra e Informacionit Turistik dhe të mbështesë monitorimin e përdorimit të këtij shërbimi.
Njësia matëse	Numër turistësh
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Qendra e Informacionit Turistik (TIC), bashkia dhe dokumentacioni administrativ përkatës.

Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat e Qendrës së Informacionit Turistik, sistemet elektronike të regjistrimit të vizitorëve ose evidencat administrative të bashkisë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të vizitorëve, raporteve periodike të TIC dhe evidencave administrative të strukturës përgjegjëse për turizmin.
Disagregimi	Sipas muajit, origjinës së turistit, mënyrës së ofrimit të informacionit ose Qendrës së Informacionit Turistik, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm përdoruesit e shërbimeve të TIC dhe nuk pasqyron numrin total të turistëve që vizitojnë territorin.

TREGUESI 285A13 NUMRI I TURISTËVE TË AKOMODUAR NË HOTELE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	285A13
Emërtimi	Numri i turistëve të akomoduar në hotele
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë numrin e turistëve që kanë përdorur shërbimet e akomodimit në hotele gjatë vitit raportues, si tregues i aktivitetit turistik në territorin e bashkisë.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin total të turistëve të regjistruar në hotele dhe struktura të tjera hoteliere në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues. Çdo turist regjistrohet një herë për çdo qëndrim të realizuar në një strukturë akomoduese.
Rëndësia	Numri i turistëve të akomoduar përbën një nga treguesit bazë për monitorimin e zhvillimit të turizmit. Ai ndihmon bashkinë të vlerësojë kërkesën për shërbime akomoduese, të analizojë tendencat e fluksit turistik dhe të planifikojë investimet në infrastrukturën dhe shërbimet turistike. Gjithashtu, ky tregues shërben si bazë për analizimin e të ardhurave nga taksa e qëndrimit në hotel dhe për vlerësimin e performancës së sektorit të akomodimit.
Formula	D295
Njësia matëse	Numër turistësh

Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një nivel më të lartë të përdorimit të kapaciteteve akomoduese dhe, në përgjithësi, një aktivitet turistik më të zhvilluar. Megjithatë, treguesi nuk pasqyron kohëzgjatjen e qëndrimit të turistëve, e cila analizohet nëpërmjet treguesit të netë-qëndrimeve.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas origjinës së turistëve (vendas dhe të huaj), muajit, njësisë administrative ose llojit të strukturës akomoduese, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave administrativë të strukturave akomoduese, raportimeve statistikore dhe evidencave të institucioneve përgjegjëse për turizmin.
Kufizimet	Treguesi përfshin vetëm turistët e regjistruar në struktura akomoduese formale dhe nuk pasqyron turistët që akomodohen në struktura informale, banesa private ose forma të tjera të paregjistruara të akomodimit.

D295 NUMRI I TURISTËVE TË AKOMODUAR NË HOTELE

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D295
Emërtimi	Numri i turistëve të akomoduar në hotele
Përshkrimi i të dhënës	Numri total i turistëve të regjistruar në hotele dhe struktura të tjera hoteliere në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e turistëve të akomoduar në hotele dhe struktura të tjera hoteliere dhe të mbështesë monitorimin e aktivitetit turistik në territor.
Njësia matëse	Numër turistësh
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Struktura përgjegjëse për turizmin ose zhvillimin ekonomik vendor.

Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat e strukturave akomoduese, raportimet statistikore dhe evidencat administrative të institucioneve përgjegjëse për turizmin.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave të strukturave akomoduese, raporteve statistikore dhe dokumentacionit administrativ përkatës.
Disagregimi	Sipas origjinës së turistëve, muajit, llojit të strukturës akomoduese ose njësisë administrative, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm turistët e regjistruar në struktura akomoduese formale dhe nuk përfshin format informale të akomodimit.

TREGUESI 285A14 TË ARDHURA NGA TAKSA E QËNDRIMIT NË HOTEL

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	285A14
Emërtimi	Të ardhura nga taksa e qëndrimit në hotel
Funksioni	28.5 – Informim ekonomik dhe turizëm
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë të ardhurat e realizuara nga bashkia nga taksa e qëndrimit në hotel, si një tregues i zhvillimit të aktivitetit turistik dhe i kontributit të tij në të ardhurat vendore.
Përshkrimi	Treguesi paraqet shumën e të ardhurave të arkëtuara nga bashkia gjatë vitit raportues nga taksa e qëndrimit në hotel, sipas legjislacionit në fuqi për taksat vendore.
Rëndësia	Të ardhurat nga taksa e qëndrimit në hotel përbëjnë një burim të rëndësishëm të ardhurash vendore për bashkitë me aktivitet turistik. Monitorimi i këtij treguesi ndihmon në vlerësimin e zhvillimit të sektorit të turizmit, efektivitetit të administrimit fiskal dhe planifikimit të investimeve në infrastrukturën dhe shërbimet turistike.
Formula	D296
Njësia matëse	Lekë
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon rritje të të ardhurave të realizuara nga taksa e qëndrimit në hotel. Megjithatë, kjo rritje mund të lidhet si me shtimin e

	numrit të turistëve, ashtu edhe me ndryshimet në nivelin e taksës ose përmirësimin e administrimit fiskal.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për financat vendore dhe administrimin e të ardhurave.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, subjektit tatimpagues ose periudhës raportuese, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet evidencave të sistemit të financave vendore, regjistrave të arkëtimeve dhe dokumentacionit kontabël të bashkisë.
Kufizimet	Treguesi pasqyron vetëm të ardhurat e arkëtuara dhe nuk jep informacion mbi numrin e turistëve, netë-qëndrimet apo nivelin e respektimit të detyrimeve tatimore nga subjektet.

D296 TË ARDHURA NGA TAKSA E QËNDRIMIT NË HOTEL

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D296
Emërtimi	Të ardhura nga taksa e qëndrimit në hotel
Përshkrimi i të dhënës	Shuma e të ardhurave të arkëtuara nga bashkia gjatë vitit raportues nga taksa e qëndrimit në hotel, sipas legjislacionit në fuqi.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë të ardhurat e arkëtuara nga taksa e qëndrimit në hotel dhe të mbështesë monitorimin e kontributit të aktivitetit turistik në të ardhurat vendore.
Njësia matëse	Lekë
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Bashkia, struktura përgjegjëse për financat vendore dhe administrimin e të ardhurave.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat merren nga sistemi i administrimit të të ardhurave vendore, regjistrat kontabël dhe evidencat financiare të bashkisë.

Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet raporteve financiare, regjistrave të arkëtimeve, ekstrakteve kontabël dhe dokumentacionit mbështetës.
Disagregimi	Sipas njësisë administrative, subjektit tatimpagues ose periudhës raportuese, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna pasqyron vetëm të ardhurat e arkëtuara dhe nuk jep informacion mbi numrin e turistëve, netë-qëndrimet apo nivelin e respektimit të detyrimeve tatimore nga subjektet

FUNKSIONI 28.6 - GRANTE PËR BIZNESET

Funksioni **"Grante për bizneset"** përfshin mbështetjen që bashkia u ofron sipërmarrjeve, veçanërisht bizneseve të reja dhe grupeve prioritare, nëpërmjet skemave të financimit, granteve ose instrumenteve të tjera të zhvillimit ekonomik vendor. Këto ndërhyrje synojnë të nxisin sipërmarrjen, inovacionin, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë lokale.
Treguesit e këtij funksioni vlerësojnë si karakteristikat e ekosistemit të biznesit, ashtu edhe rezultatet e drejtpërdrejta të programeve mbështetëse të bashkisë. Ata mundësojnë monitorimin e përfshirjes së grave në sipërmarrje, numrit të startup-eve të mbështetura dhe peshës që këto zënë në ekonominë vendore. Në këtë mënyrë, funksioni ofron informacion të vlefshëm për vlerësimin e efektivitetit të politikave vendore të zhvillimit ekonomik dhe për orientimin e programeve të ardhshme të mbështetjes për biznesin.

TREGUESI 286A01 PESHA E BIZNESEVE TË DREJTUARA NGA GRA

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	286A01
Emërtimi	Pesha e bizneseve të drejtuara nga gra
Funksioni	28.6 – Grante për bizneset
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë përfaqësimin e bizneseve të drejtuara nga gra në strukturën e biznesit vendor, si një tregues i përfshirjes ekonomike dhe i potencialit për mbështetje nëpërmjet skemave të granteve dhe programeve të zhvillimit ekonomik lokal.
Përshkrimi	Treguesi paraqet përqindjen që zënë bizneset e drejtuara nga gra ndaj numrit total të bizneseve aktive në territorin e bashkisë gjatë vitit raportues.

Rëndësia	Mbështetja e sipërmarrjes së grave është një objektiv i rëndësishëm i politikave të zhvillimit ekonomik vendor. Monitorimi i këtij treguesi ndihmon bashkinë të vlerësojë nivelin e përfshirjes së grave në aktivitetin ekonomik, të identifikojë nevojat për mbështetje dhe të orientojë programet e granteve, trajnimit dhe asistencës teknike drejt grupeve që kanë nevojë për nxitje më të madhe.
Formula	(D189 / D186) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon një përfaqësim më të madh të bizneseve të drejtuara nga gra në ekonominë vendore. Megjithatë, treguesi nuk jep informacion mbi madhësinë e bizneseve, sektorin ekonomik, nivelin e të ardhurave apo suksesin e tyre ekonomik.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, madhësisë së biznesit, njësisë administrative ose formës së organizimit, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Llogaritet duke përdorur regjistrat administrativë të bizneseve dhe evidencat për pronësinë ose drejtimin e tyre.
Kufizimet	Treguesi bazohet në të dhënat administrative mbi drejtimin ose pronësinë e biznesit dhe nuk pasqyron nivelin e pjesëmarrjes së grave në menaxhimin e përditshëm, performancën ekonomike apo numrin e të punësuarve.

E DHËNA D186

E dhëna D186 është shtjelluar më lart në manual.

D189 NUMRI I BIZNESEVE TË DREJTUARA NGA GRA

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D189
Emërtimi	Numri i bizneseve të drejtuara nga gra

Përshkrimi i të dhënës	Numri i bizneseve aktive në territorin e bashkisë që drejtohen ose zotërohen nga gra gjatë vitit raportues, sipas të dhënave administrative në dispozicion.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e bizneseve aktive të drejtuara ose zotëruara nga gra dhe të mbështesë monitorimin e përfaqësimit të grave në sipërmarrjen vendore.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Bashkia, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), INSTAT ose institucione të tjera që administrojnë regjistrat e bizneseve.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga regjistrat administrativë të bizneseve dhe burime të tjera zyrtare që identifikojnë pronësinë ose drejtimin e biznesit sipas gjinisë.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet regjistrave administrativë të bizneseve dhe dokumentacionit përkatës që identifikon gjininë e pronarit ose administratorit të biznesit.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, madhësisë së biznesit, njësisë administrative ose formës së organizimit, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton bizneset e identifikuara si të drejtuara ose të zotëruara nga gra sipas burimeve administrative dhe nuk pasqyron nivelin e pjesëmarrjes së grave në menaxhimin e përditshëm, performancën ekonomike apo numrin e të punësuarve

VËREJTJE METODOLOGJIKE 189

Për qëllime të këtij treguesi, **biznes i drejtuar nga gra** konsiderohet një biznes në të cilin pronarja ose administratorja kryesore është grua, sipas informacionit të regjistruar në burimet administrative të përdorura për raportim.

Treguesi llogaritet si raport ndërmjet numrit të bizneseve të drejtuara nga gra dhe numrit total të bizneseve aktive në territorin e bashkisë, i shprehur në përqindje. Për të garantuar krahasueshmërinë ndërmjet bashkive dhe ndërmjet viteve, është e rëndësishme që kriteri i identifikimit të bizneseve të drejtuara nga gra dhe burimi i të dhënave të mbeten të njëjtë në çdo periudhë raportimi.

TREGUESI 286A02 NUMRI I STARTUP-EVE TË MBËSHTETURA	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	286A02
Emërtimi	Numri i startup-eve të mbështetura
Funksioni	28.6 – Grante për bizneset
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë numrin e startup-eve që kanë përfituar mbështetje nga bashkia nëpërmjet skemave të granteve ose programeve të zhvillimit ekonomik vendor.
Përshkrimi	Treguesi paraqet numrin e startup-eve që kanë përfituar mbështetje financiare ose forma të tjera mbështetjeje nga bashkia gjatë vitit raportues. Mbështetja mund të përfshijë grante, financim fillestar, programe inkubimi, mentorim ose instrumente të tjera të miratuara nga bashkia.
Rëndësia	Mbështetja e startup-eve kontribuon në nxitjen e inovacionit, sipërmarrjes dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Ky tregues ndihmon në vlerësimin e zbatimit të programeve të zhvillimit ekonomik vendor dhe të angazhimit të bashkisë për mbështetjen e sipërmarrjeve të reja.
Formula	D216
Njësia matëse	Numër
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se më shumë startup-e kanë përfituar mbështetje gjatë vitit raportues. Megjithatë, treguesi nuk pasqyron madhësinë e mbështetjes, suksesin e startup-eve apo ndikimin ekonomik të programeve.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, gjinisë së themeluesit, njësisë administrative, llojit të mbështetjes ose programit nga i cili është financuar startup-i, kur të dhënat janë të disponueshme.

Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet dokumentacionit të skemave të granteve, vendimeve të financimit, kontratave të grantit dhe raporteve të zbatimit.
Kufizimet	Treguesi mat vetëm startup-et që kanë përfituar mbështetje nga bashkia dhe nuk përfshin startup-et që janë financuar nga programe të tjera publike ose private. Ai nuk mat mbijetesën apo performancën e startup-eve pas përfitimit të mbështetjes.

D216 NUMRI I STARTUP-EVE TË MBËSHTETURA

Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i të dhënës	D216
Emërtimi	Numri i startup-eve të mbështetura
Përshkrimi i të dhënës	Numri i startup-eve që kanë përfituar mbështetje financiare ose forma të tjera mbështetjeje nga bashkia gjatë vitit raportues.
Qëllimi i mbledhjes së të dhënës	Të evidentojë numrin e startup-eve që kanë përfituar mbështetje nga bashkia dhe të mbështesë monitorimin e zbatimit të programeve vendore për nxitjen e sipërmarrjes dhe inovacionit.
Njësia matëse	Numër
Frekuenca e raportimit	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni Përgjegjës	Bashkia, struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik dhe dokumentacioni i programeve të mbështetjes.
Metoda e mbledhjes	Të dhënat mblidhen nga dokumentacioni administrativ i programeve të granteve dhe skemave të mbështetjes së biznesit.
Metoda e verifikimit	Verifikohet nëpërmjet kontratave të grantit, listave të përfituesve, vendimeve të komisioneve të vlerësimit dhe raporteve të zbatimit.
Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, gjinisë së themeluesit, njësisë administrative, llojit të mbështetjes ose programit nga i cili është financuar startup-i, kur të dhënat janë të disponueshme.
Kufizimet	E dhëna evidenton vetëm startup-et që kanë përfituar mbështetje në kuadër të programeve të administruara nga bashkia dhe nuk përfshin ato të financuara nga programe të tjera publike ose private. Ajo nuk pasqyron nivelin e financimit, mbijetesën apo performancën ekonomike të startup-eve pas përfitimit të mbështetjes.

VËREJTJE METODOLOGJIKE D216

Për qëllime të këtij treguesi, **startup** konsiderohet një biznes i ri që përfiton mbështetje në kuadër të një programi ose skeme të administruar nga bashkia. Çdo startup raportohet vetëm një herë gjatë vitit raportues, edhe nëse përfiton më shumë se një formë mbështetjeje brenda të njëjtit program.

TREGUESI 286A03 PESHA E STARTUP-EVE TË MBËSHTETURA	
Elementi	**Përshkrimi**
Kodi i treguesit	286A03
Emërtimi	Pesha e startup-eve të mbështetura
Funksioni	28.6 – Grante për bizneset
Pjesë e SMP Kombëtare	Jo
Qëllimi	Të masë peshën që zënë startup-et e mbështetura nga bashkia në raport me numrin total të bizneseve aktive në territor.
Përshkrimi	Treguesi paraqet përqindjen e startup-eve të mbështetura nga bashkia ndaj numrit total të bizneseve aktive gjatë vitit raportues.
Rëndësia	Treguesi ndihmon në vlerësimin e shtrirjes së programeve të mbështetjes për sipërmarrjen dhe intensitetit të ndërhyrjes së bashkisë në zhvillimin e biznesit vendor. Ai mund të përdoret për të krahasuar nivelin e mbështetjes ndërmjet bashkive dhe për të monitoruar evolucionin e politikave vendore për nxitjen e sipërmarrjes.
Formula	(D216 / D186) × 100
Njësia matëse	Përqindje (%)
Interpretimi	Një vlerë më e lartë tregon se një pjesë më e madhe e bazës së bizneseve aktive ka përfituar mbështetje si startup. Megjithatë, treguesi nuk pasqyron vlerën e financimit, cilësinë e mbështetjes apo rezultatet afatgjata të startup-eve.
Frekuenca	Vjetore
Institucioni raportues	Bashkia
Institucioni përgjegjës	Struktura përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor.

Disagregimi	Sipas sektorit ekonomik, gjinisë së themeluesit, njësisë administrative ose programit të mbështetjes, kur të dhënat janë të disponueshme.
Metoda e verifikimit	Llogaritet duke përdorur numrin e startup-eve të mbështetura dhe numrin total të bizneseve aktive.
Kufizimet	Treguesi nuk pasqyron ndikimin ekonomik të mbështetjes apo mbijetesën e startup-eve dhe mund të ndikohet nga madhësia e bazës së bizneseve aktive në bashki.

E dhëna D186 është shtjelluar më lart në manual.

E dhëna D216 është shtjelluar më lart në manual.

